

INSTITUTI ALBANOLOGJIK

Edlira Mantho

BIBLIOTEKA

80

M27

Rreth argumentimit dhe tekstit argumentues në gjuhën shqipe



1953
Prishtinë, 2014

80
M 27

INSTITUTI ALBANOLOGJIK I PRISHTINËS

Doc. dr. EDLIRA MANTHO

**RRETH ARGUMENTIMIT DHE
TEKSTIT ARGUMENTUES
NË GJUHËN SHQIPE**

(Studim monografik)



Prishtinë, 2014

Botues

Instituti Albanologjik i Prishtinës

Recensues

Prof. dr. Klodeta Dibra, dekane dhe pedagoge pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Prof. dr. Qemal Murati, këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës

Realizimi i kopertinës

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18-26

Mantho, Edlira

Rreth argumentimit dhe tekstit argumentues në gjuhën shqipe : (studim monografik) / Edlira Mantho.

– Prishtinë : Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2014.

– 182 f. : ilustr. ; 21 cm.

Bibliografi : f. 171-179

ISBN 978-9951-596-91-6

Këtë libër ia kushtoj kujtimit të babait tim

HYRJE.....	7
KREU I	13
HISTORI E SHKURTËR E KONCEPTIT TË ARGUMENTIMIT	13
1.1. Fillesat e retorikës. Greqia e lashtë.....	13
1.1.1. Mendimi retorik dhe Aristoteli. Vepra “Retorika”	18
1.2. Zhvillimet e retorikës. Teknikat argumentuese klasike.....	22
1.2.1. Retorika nga Rilindja deri në shek. XVIII	22
1.2.2. Pesë rregullat e retorikës klasike.....	24
1.3. Retorika moderne. Shtrirja e këtij koncepti në gjuhësi	26
KREU II	29
ARGUMENTIMI NË KËNDVËSHTRIMIN E TEORIVE TË SOTME	
GJUHËSORE	29
2.1. Retorikë dhe pragmatikë. Kuptimi mbi argumentimin.....	29
2.2. Përfaqësuesit e Retorikës së re	31
2.2.1. Skema e argumentit sipas Stephen Toulmin-it.....	34
2.2.2. Teoria e argumentimit sipas Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s	
.....	39
2.3. <i>Topos-i</i> sipas Retorikës së re. Karakteri konvencional.....	41
KREU III	45
LIGJËRIMI ARGUMENTUES. LLOJET DHE TIPARET E TIJ	45
3.1. Format e shprehjes së ligjërimit argumentues	45
3.1.1. Forma verbale	45
3.1.2. Forma e shkruar	51
3.1.3. Forma joverbale	51
3.2. Tipare të përgjithshme të ligjërimit argumentues.....	52
3.2.1. Teza/antiteza	52
3.2.2. Pohimi/mohimi.....	53
3.2.3. Karakteri bindës	54
3.2.4. Karakteri dyshues.....	55
3.2.5. Karakteri dialogjik	57
3.2.6 Karakteri implicit	59
3.2.7. Karakteri polemizues	60
3.2.8. Karakteri qëllimor	60
3.2.9. Karakteri ndikues	61
3.2.10. Rendi sintaksor.....	62
3.3. Argumenti dhe tipet e argumenteve.....	63
3.3.1. Argumenti dhe përbërësit e tij.....	63
3.4. Tipet e argumenteve	65
3.4.1. Argument i bazuar në silogjizmin hipotetik.....	65
3.4.2. Argument i bazuar në silogjizmin kategorik	66
3.4.3. Argument i bazuar në eliminim.....	67
3.4.4. Argument i bazuar në matematikë	67

3.4.5. Argument i bazuar në parime	67
3.4.6. Argument i bazuar në autoritet.....	68
3.4.7. Argument i bazuar në analogji	69
3.4.8. Argument i bazuar në shenjë (tregues).....	69
3.4.9. Argument i bazuar në përgjithësime induktive	70
3.4.10. Argument i bazuar në një parashikim	70
3.4.11. Argument i bazuar në shkak.....	71
3.4.12. Argument i bazuar në ndjenjë	71
3.5. Marrëdhëniet argumentuese dhe ato logjike.....	72
3.6. Logjika e rreme. Teoria e falsiteteve	73
Përfundime për pjesën e parë.....	85
KREU IV	87
DISA NOCIONE BAZË PËR ANALIZËN E TEKSTIT.....	87
4.1. Koncepti “tekst” sipas gjuhësisë moderne	87
4.2. Analiza ligjërimore dhe mënyrat e organizimit ligjërimor	91
4.3. Thënia dhe akti kumtues.....	92
4.4. Koncepti i sekuencës	94
4.5. Koncepti “gjini” në letërsi dhe në gjuhësi	95
4.6. Teksti dhe shumëkuptimësia e tij	97
KREU V.....	101
5.1. Tipare të përgjithshme të tekstit argumentues	101
5.2. Struktura bazë e tekstit argumentues	103
5.3. Kundërshtimi në tekstin argumentues. Kundërthëniet – kundërrargumentet.....	106
5.3.1. Kuptimi i kundërthënieve. Qesharakja.....	107
5.3.2. Kuptimi i kundërrargumenteve.....	109
5.4. Eksplaciti dhe impliciti në tekstin argumentues.....	112
5.5. Konektorët dhe operatorët argumentues. Klasifikimi i tyre	116
5.5.1. Klasat gramatikore me të cilat shprehen konektorët argumentues	123
5.6. Roli i foljeve në tekstin argumentues	125
5.7. Roli i figurave të ndryshme pjesëmarrëse në tekstin argumentues..	128
5.8. Roli i intonacionit dhe i efekteve grafike në tekstin argumentues...	131
KREU VI	135
ANALIZA PRAKTIKE DHE KËSHILLA METODOLOGJIKE.....	135
6.1. Tipologjia e planeve argumentuese	135
6.2. Prania e argumenteve në tekste	160
Përfundime për pjesën e dytë.....	169
BIBLIOGRAFI.....	171

HYRJE

Ky punim mbështetet në kuadrin e gjuhësisë së tekstit dhe ka si objekt studimi argumentimin dhe tekstin argumentues në gjuhën shqipe. Gjuhësia e tekstit është një disiplinë gjuhësore e krijuar në botë në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XX dhe relativisht vonë e njohur brenda territorit shqiptar në kuadrin e studimeve albanologjike - aty në fund të viteve '90. Nëse gjuhësia botërore përballet me emrat e studiuesve: Robert-Alain de Beaugrande, Wolfgang Dressler,¹ Jean-Michel Adam,² Patrick Charaudeau,³ etj., gjuhësia shqiptare, ndonëse e vonuar në këtë disiplinë, njeh ndërnismëtarët Klodeta Dibra⁴, Nonda Varfi⁵ e duke vijuar me: Jani

¹ Robert-Alain de Beaugrande dhe Wolfgang Dressler krahas punimeve të tyre individuale (Beaugrande: "Factors in a Theory of Poetic Translating", Assen: van Gorcum, and Amsterdam: Rodopi, 1978; "Text, Discourse, and Process": Toward a Multidisciplinary Science of Texts. Norwood, N.J.: Ablex, 1980; "Linguistic Theory: The Discourse of Fundamental Works", London: Longman, 1991, apo Dressler: "Morphonology", Ann Arbor, Karoma Press. 1985; "Textlinguistik", Hardcover, Wissenschaftliche Buchgesellschaft, 1978), kanë edhe veprën me bashkautorësi: "Introduction to TextLinguistics", London - N.Y, 1981.

² Jean-Michel Adam, veçojmë punimet: "Éléments de linguistique textuelle (théorie et pratique de l'analyse textuelle)", Pierre Mardaga, 1990; "Cadre theorique d'une typologie sequentielle", tek *Etudes de Linguistique appliquee*, 1991; "Les textes: types et prototypes. Récit, description, argumentation, explication et dialogue", Paris, Nathan université, 1992; "Linguistique textuelle. Des genres de discours aux textes", Paris, Nathan université, 1999 etj.

³ Patrick Charaudeau, veçojmë punimet: "Langage et discours. Éléments de sémiolinguistique", Paris: Hachette, 1983; "Grammaire du sens et de l'expression", Paris, Nathan université, 1992; "Une analyse sémiolinguistique du discours", Paris: Hachette, 1995 etj.

⁴ Klodeta Dibra – Nonda Varfi: "Gjuhësi teksti", SHBLU, Tiranë, 1999, pasuar nga dy ribotime, përkatësisht: SHBLU, Tiranë, 2005, si dhe shtëpia botuese "Albatros", Tiranë, 2007. Punimet e këtyre dy autorëve i gjejmë të kristalizuara jo vetëm në botime të mirëfillta brenda dhe jashtë territorit shqiptar, por edhe nëpër buletine dhe periodikë shkencorë të veçantë. Përmendim: Klodeta Dibra – Nonda Varfi: "Deiksisi dhe shprehjet deiktike në gjuhën shqipe" te "Studime albanologjike", I, botim i universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, Tiranë, 2000, fq. 52 – 66, etj.

⁵ Nonda Varfi, veçojmë punimet: "Précis de lexicologie française", Tiranë, 1996; "Lexicologie" (exercices), Tiranë, 1999; "Introduction à la lexicologie du français", Lausanne, UNIL, 1999; Klodeta Dibra – Nonda Varfi, "Gjuhësi teksti", vep. e cituar; Sanda-Maria Ardeleanu, Eufrosinia Axenti, Ionana-Crina Coroi, Raul Lilo, Angela Soltan, Nonda Varfi, Ludmila Zbant: "Le discours en action - étude théorique et pratique sur la discursivité", Chişinău, CEP USM, 2007; N. Varfi – R. Lilo – E. Nasufi: "Recueil d'exercices" (Linguistique textuelle), Tiranë, 2008, etj.

Thomai⁶, Jolanda Kostari⁷, Linda Mëniku⁸, Josif Mita⁹, Shezai Rrokaj¹⁰, Gjovalin Shkurtaç¹¹, Hasan Mujaj¹², Arbër Çeliku¹³, Tefë Topalli¹⁴ a ndonjë tjetër. Në punimet e këtyre autorëve janë bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u prezantuar baza e hulumtimeve shkencore mbarëbotërore dhe bashkëkohore në fushën e kësaj disipline gjuhësore, janë rrokur shumë çështje dhe dukuri gjuhësore që lidhen me nocionin *tekst, ligjërim, lloj, tip, sekuencë, thënie, akt kumtues* etj., që janë padyshim instrumente të mendimit dhe të përshkrimit të dukurisë së ligjërimit në brendësi të komunikimit (verbal ose i shkruar qoftë), janë bërë klasifikime sipas tipologjive tekstore përkatëse, duke i analizuar dhe interpretuar në mënyrë tepër të thukët.¹⁵

Krahas punimeve të sipërpërmendura të emrave të njohur shqiptarë, sjellim në vëmendje edhe ato të rangut të studimeve pasuniversitare, në nivelin “*Master*” dhe “*Doktor i shkencave*”, (artikuj të veçantë të të cilave i gjejmë nëpër buletinë e periodikë të ndryshëm gjithashtu) e ku qerthulli i

⁶ Jani Thomai, veçojmë punimin: “Metoda e analizës së tekstit” te “*Teksti dhe gjuha*”, SHBLU, Tiranë, 1992.

⁷ Jolanda Kostari, veçojmë punimin: “Për disa çështje të koherencës anaforike si dukuri e gramatikës së tekstit” te “*Gjuha jonë*”, 1 – 4, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë si dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, Tiranë, 1995, fq. 66 – 73.

⁸ Linda Mëniku, veçojmë punimet: “Çështje të konektorëve të tekstit në gjuhën shqipe” te “*Studime albanologjike*”, I, botim i universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, Tiranë, 2000, fq. 67 – 85; “Konektorët e tekstit në veprën e Kadarese, tek “*Ismail Kadareja dhe vepra e tij*”, botimi i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2006, fq. 325 – 350 etj.

⁹ Josif Mita, veçojmë punimin: “Lidhjet anaforike dhe të kontekstit në periudhat rrethanore të kohës” te “*Studime albanologjike*”, II, botim i universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, Tiranë, 1996, fq. 124 – 135.

¹⁰ Shezai Rrokaj, veçojmë punimin: “*Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*”, SHBLU, Tiranë, 2000.

¹¹ Gjovalin Shkurtaç, veçojmë punimin: “*Si të shkruajmë shqip*”, Tiranë, 2008, 2012, 2013. (gjithsej tri botime).

¹² Hasan Mujaj, veçojmë punimin: “*Gjuhësia e tekstit*”, shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2004.

¹³ Arbër Çeliku, veçojmë punimin: “*Koherenca tekstore. Hyrje në konceptet bazë të gjuhësisë së tekstit nëpërmjet një qasjeje krahasuese të shqipes me gjermanishten*”, shtëpia botuese “Asdreni”, Shkup, 2005.

¹⁴ Tefë Topalli, veçojmë punimin: “*Gjuhësi teksti*”, shtëpia botuese “Gjergj Fishta”, Shkodër, 2011.

¹⁵ Përmendim në veçanti: “*Le discours en action - étude théorique et pratique sur la discursivité*” – grup autorësh. Vep. e cituar më lart.

akëcilave të marra së bashku, ndihmësojnë duke thelluar, pasuruar dhe përvijuar më tej një punë të gjatë hulumtuese.¹⁶

¹⁶ Përmendim: Klodeta Dibra: “*Il testo descrittivo nella lingua albanese e quella italiana*” (“*Teksti përshkrues në gjuhën shqipe dhe atë italiane*”) – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës italiane, 1997, Tiranë.

Lindita Gjata: “*Argumentimi në gjuhë dhe teksti argumentues në frëngjishte dhe në shqipe*” – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës frënge, 2005, Tiranë.

Eldina Nasufi: “*Shprehjet anaforike dhe roli i tyre në didaktikën e të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhë të huaj*” – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës frënge, 2009, Tiranë. Po nga kjo autore përmendim: “Disa veçori gjuhësore të fenomenit të anaforës” te “*Kërkime universitare*”, nr. 19, 2008, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 139 – 144 si dhe “Roli i anaforës në realizimin e kohezionit dhe koherencës”, te “*Kërkime universitare*”, nr. 32, 2012, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 111 – 124.

Viktor Bakillari: “*Mjetet lidhëse në frëngjisht dhe në shqip*” – punim për titullin “Master”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, 2006, Tiranë. Po nga ky autor përmendim: “Lidhëzorët kushtorë dhe hipotetikë në gjuhët frënge dhe shqipe”, te “*Kërkime universitare*”, nr. 25, 2009, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 149 – 155; “Analizë lidhëzore në një tekst argumentues”, te “*Kërkime universitare*”, nr. 32, 2012, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 127 – 131; “Lidhëzorët në gjuhët frënge dhe shqipe. Klasifikimi i tyre logjiko - semantik”, te “*Kërkime universitare*”, nr. 27, 2010, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 107 – 113;

Bledar Toska: “*Studim përmasës i konektorëve në tekstet argumentues të gjuhës angleze dhe asaj shqipe*” – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës angleze, 2012, Tiranë. Nyja:

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Bledar-Toska-Fakulteti-Gjuheve-te-Huaja.pdf>

Po nga ky autor përmendim: “Komunikimi, dialogjizmi bakhtinian dhe konektorët pragmatikë” te “*Kërkime universitare*”, nr. 19, 2008, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 145 – 154.

Linda Mëniku: “*Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*” – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, departamenti i gjuhës shqipe, 2013, Tiranë. Nyja:

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/09/Doktoratura-Linda-Meniku-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gjuhesise.pdf>

Jonida Gjuzi-Bushi: “*Anafora dhe deiksisi në gjermanisht dhe shqip*” – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave” (në proces), Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë. Po nga kjo autore përmendim: “Anafora dhe deiksisi: një përpjekje përkufizimi” te “*Kërkime universitare*”, nr. 34, 2012, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, fq. 177 – 181.

Në këtë hulli edhe punimi ynë, që tashmë del si botim monografik, fillimisht është paraqitur si tezë për mbrojtjen e doktoraturës (qershor 2010). Punimi është konceptuar në dy pjesë kryesore:

1. Rreth argumentimit
2. Rreth tekstit argumentues

1. Përkatësisht, në pjesën e parë përfshihet një histori e shkurtër e konceptit të argumentimit dhe zhvillimit që ka pësuar deri në ditët e sotme. Meqenëse rrënjët e argumentimit i gjejmë qysh në antikitetin e lashtë - kohë kur oratorët praktikonin të folurit retorik në publik - i folur ky që karakterizohej nga bukuria e shprehjes, elokuenca, hijeshia nga njëra anë dhe fuqia bindëse, logjika, vija argumentuese nga ana tjetër - atëherë e kemi parë të udhës të ndalemi shkurtimisht në disa nga figurat kryesore që kanë hedhur themelet e mendimit retorik, me në krye Aristotelin dhe Sokratin.

Kjo tablo historike përdhësohet me zhvillimin që pësoi retorika përgjatë periudhave të mëvonshme të Rilindjes e të Iluminizmit, përfaqësuesit e të cilave vazhdonin të ndiqnin po ato strategji argumentuese që kishin hartuar oratorët grekë përgjatë mbajtjes së një ligjërimi retorik e për të ardhur në shekujt XIX e në vijim. Nëse në të kaluarën e deri në vitet 1950, argumentimi është parë si një objekt analize në brendësi të retorikës e të logjikës, si dhe lidhej me ekzistencën e tri elementeve bazë: *logosin*, *etosin*, *patosin*, në vitet pasuese e në vijim u konstatua se argumentimi arrin efektshmërinë e vet jo vetëm përmes të folurit bukur e në mënyrë bindëse, por njëherazi dhe falë organizimit që vetë njerëzit iu bëjnë mjeteve gjuhësore, si dhe konteksteve ku vetë këto të fundit gjejnë përdorim. Pikërisht, ky argumentim me vlera pragmatike provokoi shfaqjen e një mendimi të ri në lëmin e gjuhësisë, që u kristalizua si një teori më vete, e njohur si teori e ligjëritimit bindës ose ndryshe si "*Teoria e argumentimit*".

2. Vetë argumentimi, duke qenë veprimtari verbale, vetvetiu na çon në dykuptimësinë proces - prodhim. Pra, kjo do të thotë që argumentimi i referohet jo vetëm aktivitetit të paraqitjes së arsyeve, por edhe teksteve të shkurtra a të gjata që rezultojnë nga ai. Pikërisht, tipi i tekstit argumentues, kuptimshmëria dhe domethënia rreth tij, tiparet që e karakterizojnë, elementet organizuese që e realizojnë atë në gjuhën shqipe, do të trajtohen në

Anila Çepani (Sema): "*Anafora në gjuhën shqipe*" – disertacion për marrjen e gradës shkencore "Doktor i shkencave", Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, departamenti i gjuhës shqipe, 2011, Tiranë. Vlen të theksojmë që ndonëse ky punim nuk i takon mirëfilltazi fushës së gjuhësisë së tekstit, por asaj të sintaksës, prapëseprapë shtjellimi që autorja i bën konceptit të anaforës gjen shtrirje gjithëpërfshirëse, duke rrokur edhe fushën ku bazohet interesi dhe qëllimi i punës sonë.

Nyja: http://fhf.edu.al/doktorata/Anila_Cepani.pdf

Të gjitha burimet e sipërpërmendura gjenden si punime pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Tiranë.

pjesën e dytë të këtij punimi. Po kështu, koncepte të tilla si: *analizë ligjërimore, ligjërim, sekuencë, strukturë sekuencore, tekst, thënie (kumtim), akt kumtues, situatë kumtuese, lokutorë*, të cilat janë baza e terminologjisë që zbatohen sot në praktikën e analizave të teksteve, do të gjejnë shtrirje konkrete në këtë pjesë si në planin teorik, ashtu edhe në atë praktik.

Sa i përket korpusit teorik, janë konsultuar kryesisht punimet e mjaft filozofëve të antikitetit si: *Aristotel, Platon, Sokrat*; punimet e një sërë gjuhëtarëve të huaj, si: *Stephen Edelston Toulmin, Chaim Perelman – Lucie Olbrechts-Tyteca, Oswald Ducrot, John Lyons, Wolfgang Dressler, Robert-Alain de Beaugrande, Jean-Michel Adam, Mikhail Bakhtine, Patrick Charaudeau, Dominique Maingueneau, Sharon Crowley*, si dhe të paktat e të çmuarat njëherazi punime të gjuhëtarëve të shquar shqiptarë: *Klodeta Dibra, Nonda Varfi, Linda Mëniku, Gjovalin Shkurtaj* a ndonjë tjetër. Ndërsa, sa i përket korpusit praktik, janë vjelë materiale ilustruese nga letërsia e huaj dhe ajo shqiptare, nga të përditshmet shqiptare si dhe nga site interneti.

Ky punim, është një sprovë për të përmbushur hapësirat e zbrazëta që ka gjuhësia e tekstit brenda hapësirave shqiptare, ndaj të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që i shërbejnë përmirësimit të mëtejshëm të punimit, janë të mirëpritura.

Së fundi, meqenëse ky punim fillimisht është paraqitur si tezë për mbrojtjen e doktoraturës, sikurse u përmend më lart, e ndiej për detyrë të bëj disa falënderime.

Në radhë të parë falënderimet e mia më të sinqerta janë për drejtuesin tim shkencor, prof. dr. Nonda Varfin, i cili me profesionalizmin dhe kompetencën e tij shkencore më ka drejtuar përgjatë ideimit, strukturimit dhe realizimit të këtij disertacioni.

Faleminderit dhe respekt të thellë për sugjerimet e vyera, për mbështetjen e pakursyer dhe kohën që më keni kushtuar Ju vetë, Profesor Nonda!

Falënderime të veçanta dhe mirënjohje i shpreh padyshim gjithashtu edhe prof. dr. Klodeta Dibrës, nismëtares në fushën e gjuhësisë së tekstit brenda dhe jashtë hapësirave shqiptare, e cila më ka përkrahur vazhdimisht dhe ka qenë gjithmonë e gjendshme për çfarëdo këshillë dhe motivim për të ecur përpara.

Faleminderit nga zemra, Profesore Klodet!

Falënderime dhe mirënjohje shumë e sinqertë u drejtohet gjithashtu të pestë anëtarëve të komisionit hartues, të cilët me vërejtjet e sugjerimet e tyre të dobishme profesionale dhe shkencore ndihmësuan në përmirësimin e më pas në kristalizimin e kësaj monografie.

Faleminderit: Profesore Aljula Jubani (kryetare), Profesor Artan Fuga (oponent), Profesor Seit Mansaku (oponent), Profesor Gjovalin Shkurtaj (anëtar), Profesore Klodeta Dibra (anëtare).

Përveç këtyre, dua të falënderoj të gjithë ata që mundësuan botimin e këtij libri me siglën e Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe në veçanti vetë këtë Institut, i cili, për më shumë se gjashtë dekada të punës së vet, ka shënuar rezultate në punën shkencore të albanologjisë në përgjithësi.

Falënderoj në veçanti prof. dr. Qemal Muratin, i cili tregoi bujarinë dhe dashamirësinë e tij të menjëhershme për daljen në dritë të këtij punimi.

Falënderime të gjithë miqve që më janë gjendur pranë në momente vështirësie përgjatë punës sime.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, falënderimet e mia shkojnë për familjen time dhe në veçanti për nënën time të dashur, e cila më ka motivuar, ndihmuar, mbështetur dhe nxitur pambarimisht.

Faleminderit, Nëna ime!

Autorja
Maj 2014

PJESA I

ARGUMENTIMI

KREU I

HISTORI E SHKURTËR E KONCEPTIT TË ARGUMENTIMIT

Fusha e argumentimit ka qenë dhe vazhdon të jetë thelbi i retorikës, si asaj antike, ashtu edhe i asaj në vijim, për të ardhur deri në kohët e sotme moderne. Meqenëse retorika është dyshemeja bazë prej nga hodhi themelet vetë argumenti dhe meqenëse koncepti i saj është zhvendosur shumë përgjatë historisë së saj 2500-vjeçare, gijkojmë të japim fillimisht një tablo kronologjike përmbledhëse të gjithë zhvillimit historik që ka pësuar qysh prej kohëve të lashta e deri në ditët e sotme.

1.1. Fillesat e retorikës. Greqia e lashtë

Retorika përkufizohet si arti i të folurit bukur e në mënyrë bindëse.¹⁷ Shprehja e bukur, e efektshme, e mbartur me aftësinë e vrojtimit, ishte mjete më i përshtatshëm në kohët e lashta, me të cilin vetë gojëtarët e përdorimit të këtij arti, përhapnin idetë dhe idealet e veta. E shfaqur për herë të parë në Greqinë e lashtë, fillimisht kishte si objekt të saj ritet e grekëve të vjetër.

¹⁷ Sipas "*Fjalorit enciklopedik*": **RETORIKË** - Arti i të folurit ose i të shkruarit në mënyrë bindëse për një auditor; elokuencë. ("*Fjalor enciklopedik*", hartoi dhe përgatiti Pasho Baku, shtëpia botuese "Bacchus", Tiranë, 2002, fq. 589). Sipas "*FSHS*"-së: **RETORIKË**, ~A f. libr. 1. Dija që shtjellon rregullat e parimet e gojëtarisë; mjeshtëria e gojëtarisë. 2. fig. keq. Retorizëm. **RETORIZËM**, ~MI m. libr. Përdorimi në të shkruar a në të folur i një stili të fryrë, me fjalë e shprehje të mëdha e të bukura, me figura të tepruara, por pa përmbajtje të thellë. ("*FSHS*", Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 2002, fq. 1104); Po kështu nëse i referohemi një fjalori të huaj dhe konkretisht atij të Oksfordit e gjejmë: **Rhetoric** - 1. art of using words impressively in speech and writing 2. language with much display and ornamentation (often with the implication of insincerity and exaggeration; the rhetoric of the politicians) – Retorikë - 1. arti i të përdorurit të fjalëve në mënyrë mbresëlënëse në ligjërim e në të shkruar. 2. gjuha me shumë shfaqje dhe zbulime (shpesh nënkupton mossinqeritet dhe ekzagjerim; retorika e politikanëve) tek: "*Oxford Advanced learner's dictionary of current English*", A. S. Hornby, Oxford University, Press 1974, fq. 741.

Rhetor ishte termi grek për oratorin: një *rhetor* ishte një qytetar që rregullisht drejtonte juri apo asamble politike dhe presupozohej se kishte përfutur njohuri bazë mbi ligjërimin publik, ligjërim ky që nënkuptonte të folurit e gjatë, të bukur, elokuent dhe njëherazi të logjikshëm e të argumentuar. Ndoshta, studimi i parë mbi forcën e gjuhës mund t'i atribuohet filozofit Empedokles, teoritë e të cilit mbi dijen njerëzore do të siguronin një bazë për shumë gojëtarë të ardhshëm. Manuali i parë i shkruar i takon *Koraksit* dhe nxënësit e bashkëqytetarit të tij, *Tisiasit*¹⁸.

Mësimdhënia në gojëtari u popullarizua në shek. V p.e.s. nga mësues endacakë të njohur si *sofistët* (nga greq. *sofia*, *dituri*), të cilët u bënë të njohur fillimisht në Athinë, e më vonë në tërë Greqinë e vjetër. Në gjithë mendimin filozofik të antikitetit grek, të sipërpërmendurit përbëjnë "*rrymën filozofike të sofistëve*". Këta ishin njerëz me njohje dhe dije mjaft të gjerë e të llojllojshme e që mëtonin të edukonin dhe të arsimonin çdokënd që kishte mundësi të paguante punën e tyre arsimore. E veçanta e këtyre oratorëve ishte se shpërngulën interesin e filozofisë nga natyra në atë ndaj studimit të njeriut, duke pyetur nëse mendja njerëzore mund të zbulojë ndonjë të vërtetë universale. Fokusi i tyre kryesor ishte *logosi*. Vetë fuqia e të folurit në mënyrë bindëse, spikaste gjatë gjithë bisedave që ata bënë për të mbrojtur bindshëm një mendim të vetin¹⁹. Ata kristalizuan kështu strategji argumentuese dhe shpallën se do t'u mësonin të tjerëve artin e retorikës, si arti i të folurit qartë, bukur e në mënyrë bindëse.

¹⁸ Sqarim: Koraksi – grek nga kolonia e Sirakuzës në Sicili; një ndër themeluesit e retorikës greke; i pari që hapi shkollën e retorikës në Athinë. Ndërsa Tisiasi ka qenë mësuesi i Isokratit, një nga sofistët e shquar të antikitetit.

¹⁹ Sqarim: Këtë lloj ndikimi e pasqyruan edhe shkrimtarë të kësaj kohe, siç mund ta lexojmë qartë tek "*Iliada*" e Homerit, ku heronj si: Akili, Nestori dhe Odisea nderoheshin për aftësinë e tyre oratorike, duke këshilluar dhe nxitur shokët e tyre në veprime të zgjuara. Sipas Muzafer Xhaxhiut: "*Shpesh Homeri i lavdëron heronjtë e tij jo vetëm për trimërinë në fushën e luftës, por edhe për këshillat e urta dhe fuqinë e fjalës. Në këngën I të "Iliadës", Nestori quhet me epitelin fjalambli". Konkretisht: Në mes të tyre u ngrit Nestor fjalëmbli,/ligjëruesi i fortë i pilëve, që nga goja/gurra bisedash posi mjalte i rridhnin..." (Homer: "*Iliada*", kënga I, vargu 318, shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1979, fq. 8.) Sipas Xhaxhiut vijohet: "*Në këngën IX, Feniksi, mësuesi i Akilit, i kujton këtij se si Peleu e kishte urdhëruar t'i mësonte të birit, Akilit, përveç të tjerave, edhe si të fliste bukur, sepse Akili ende s'ishte i regjur". (Muzafer Xhaxhiu: "*Letërsia antike greke*", SHBLU, Tiranë, 1998, fq. 239). Citojmë nga "*Iliada*": "...M'urdhroi kalorsi i vjetër,/yt atë Peleu, atë ditë kur larg prej Fiti/në moshë të njomë të nisi tek Atridi,/e s'ishe i regjur as në luftë të gjakshme,/as n'log kuvendi, ku burrat e mençur/ndahen në shenjë. Ndaj bashkë me ty më nisi/për të mësuar ty çdo gjë, të bëheshe/i zoti i punëve të mëdha e i gojës..." (Homer: "*Iliada*", vep. e cituar, kënga IX, vargu 521, fq. 156).**

Aristoteli, Sokrati dhe Platoni zënë vend kryesor në gjithë mendimin retorik të antikitetit. I pari hodhi themelet e Logjikës, pra të artit të arsytimit, ndërsa dy të tjerët hodhën themelet e Dialektikës,²⁰ pra të artit të diskutimit. Retorika u përcaktua tanimë si një nga tri elementet kryesore të filozofisë, bashkë me Logjikën dhe Dialektikën. Të tria këto: Retorika, Dialektika dhe Logjika formojnë së bashku një partneritet të një sistemi bindjeje, i bazuar në dije e në logjikë.

Po ç' do të thotë kjo në fakt?

Të jesh logjik ka të bëjë me shumë procese të të menduarit, por në kohët antike ky arsytim²¹ njihte dy format bazë të veta: logjikën induktive dhe atë deduktive.

1. Arsytimi deduktiv i njohur ndryshe si “logjika e pastër”, është proces arsytimi që nisët nga një tezë, ide ose konkluzion i përgjithshëm, dhe prej këtej nxjerr përfundime ose pasoja për sendet, dukuritë dhe problemet e veçanta²². Logjika e pastër mbështetet kryesisht në metodën

²⁰ Sqarim: Në filozofinë greke me fjalën “*dialektikë*” (nga greq. *dialektiké* – diskutim, arti i polemikës) kuptohej arti për të gjetur të vërtetën me anën e zbulimit të kontradiktave në gjykimet e kundërshtarit gjatë dialogut ose gjatë diskutimit. Por gradualisht dialektika filloi të përdorej dhe të zhvillohej si *metodë* e përgjithshme studimi. Autori Didie Zhylia bën një shtjellim të hollësishëm të kuptimit që ka pësuar kjo fjalë në kohë dhe konkretisht 1. kuptim negativ 2. kuptim pozitiv (a. kuptim idealist b. kuptim realist) 3. kuptim spiritualist 4. kuptim materialist. Sipas autorit: “*Fillimisht arti i dialogut: kur takohen dy individë me mendime të kundërta lind një diskutim. Secili përpiqet të hedhë poshtë mendimin e tjetrit; kundërvënia e tezave është forca lëvizëse e diskutimit. Nga kjo pikëpamje çdo dialog është dialektikë. Te kjo eksperiencë e thjeshtë gjejmë një aspekt të dyfishtë: aspektin negativ dhe aspektin pozitiv. Aristoteli ka pasur parasysh aspektin negativ kur ka përcaktuar dialektikën si artin e argumentimit dhe të hedhjes poshtë të një teze, të kundërvënies së tezave kontradiktore (Kanti). Në një sens pozitiv, dialektika është arti i ndërtimit të një njohjeje të vërtetë; duhet të kesh qenë i bindur për një mendim (tezë), pastaj të kesh pranuar drejtësinë e mendimit të kundërt (antitezë), për të njohur të vërtetën e plotë mbi diçka (sintezë). Pikërisht sepse njeriu nuk mund ta kuptojë gjithçka menjëherë; dija e tij është e shkallëzuar dhe dialektike*”. (Didie Zhylia: “*Fjalor i filozofisë*”, përktheu nga origjinali Rajmonda Vuçini, shtëpia botuese “Enciklopedike”, Tiranë, fq. 70. Gjithashtu lidhur me këtë koncept shih më gjerë: “*Fjalor i filozofisë*”, Botime enciklopedike, shtëpia botuese “8 Nëntori”, fq. 73 si dhe Zhane Hersh: “*Habia filozofike*”, përkthyer nga Artan Fuga, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1995, fq. 40, 47, 225, 303.

²¹ Sqarim: Arsytim – veprim logjik, me anën e të cilit, duke u mbështetur në disa dije ose gjykime të njohura që quhen premisa, fitohet një dije ose një gjykim i ri, i panjohur më parë, që quhet konkluzion apo përfundim. Shih: “*Fjalor i filozofisë*”, vep. e cit., fq. 36.

²² Sqarim: Deduksion (lat. deductio - nxjerrje) – kalimi nga e përgjithshmja në të veçantën, një nga mënyrat e arsytimit gjatë studimit që nisët nga teza, ide ose

matematikore të dijeve (inteligjencën matematike), në shndërrimin e një argumenti apo linje arsytimi në një formë bashkësie simbolike.

Një formë tradicionale e arsytimit deduktiv është silogjizmi,²³ që përbëhet nga një fjali kryesore, një fjali me më pak peshë se kryesorja, si edhe një përfundim. P.sh.:

Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm. (fjalja kryesore)

Unë jam njeri. (fjalja me më pak peshë)

prandaj:

Unë jam i vdekshëm. (përfundimi)

Fill këtu na ndërhyjnë logjika. Ajo nuk e pranon pohimin e mësipërm si të vërtetë. Arsytimi ynë i përditshëm i ka rrënjët në mënyrat se si e kuptojmë ne botën, mënyra këto që përfshijnë: hamendësimet, përpunimin e informacionit, përdorimin e *logjikës së thjeshtë*, përdorimin e vetë gjuhës në mënyrë të tillë që të mbartim më të qenësishmen në komunikimin njerëzor – kuptimin.

2. Arsytimi induktiv²⁴ është proces arsytimi që nisët nga një fakt i veçantë dhe nxjerr një konkluzion të përgjithshëm (e kundërta e deduksionit). Mjeshtër përdorimi i kësaj forme arsytimi ishte Sokrati, i cili përmes një arsytimi induktiv dialektik, synonte të provonte vërtetësinë apo falsitetin e gjërave.

Sokrati në më të shumtën e kohës argumenton duke shtruar pyetje:

“- Më thuaj dhe diçka tjetër, o Melet. Si është më mirë, të jetosh mes qytetarësh të mirë, a mes keqbërësish? Mos ngurro, përgjigju i dashur, nuk po të kërkoj ndonjë gjë shumë të vështirë. Keqbërësit nuk u bëjnë gjithnjë keq të tjerëve, ndërsa të mirët a nuk bëjnë gjithmonë mirë?”

- Sigurisht.

- A mendon vallë se mund të jetë ndokush, që do të parapëlqente të ishte më mirë i dëmtuar, se sa i favorizuar prej tjetrit?... A mund të ketë njeri që dëshiron të dëmtohet?

- Sigurisht që jo.

- Ndërsa ti më hedh në gjyq pse e korruptoj rininë, pse e shkatërroj atë në mënyrë të vetëdijshme apo pa dashje?

- Sigurisht pse e shkatërron me vetëdije²⁵.

konkluzione të përgjithshme dhe nxjerr prej tyre përfundime ose pasoja për sendet, dukuritë dhe problemet e veçanta. Shih: “*Fjalor i filozofisë*”, vep. e cit., fq. 62.

²³ Sqarim: Ky term i përdorur në dialektikë, njihet në retorikë me emrin *enthimemë*.

²⁴ Sqarim: Induksion (lat. *inductio* - futje brenda, çuarje) – një proces arsytimi, në të cilin kalohet nga faktet e veçanta në përfundime të përgjithshme. Shih: “*Fjalor i filozofisë*”, vep. e cit., fq. 195.

²⁵ Platoni: “*Apologjia e vërtetë e Sokratit; Kritoni, Fedoni, Elozhi i dashurisë ose simpoziumi*”, ” në origjinal nga Nino Marziano dhe shqipëruar nga Lazër Radi, shtëpia botuese “Liria”, Tiranë, 1997, fq. 26.

Kështu, hallkë pas hallke, të vërtetat ndjekin njëra-tjetrën, derisa mbërrihet në një rezultat të pakundërshtueshëm. Pikërisht në këtë çast, Sokrati, rikthehet fill tek arsyetimi i parë:

- Pa më thuaj, ku qëndron ky fakt, o Melet?... Kështu që unë, sipas shprehjeve të tua, mund t'i nënshtrohem një ndëshkimi të tillë me dëshirën time? Kështu që, ose unë nuk jam një korrupsues, ose në korruptojnë ndokënd, këtë e bëj krejt pa vetëdije; ndërsa ti si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, vetëm gënjen. Pastaj, edhe në e korruptojnë rininë në mënyrë të pavullnetshme, kemi të bëjmë me një faj të pavullnetshëm, të cilin as ligji nuk e dënon penalisht, por vetëm e thërret veças fajtorin dhe sipas gjithë rregullave e paralajmëron. Është e qartë pra, nëse paralajmërohem me të drejtë, unë nuk do ta përsëris më kurrë fajin tim të pavullnetshëm, ndërsa ti, përkundrazi, nuk denjove as të më thërrisje, as të më këshilloje, por më solle këtu përpara gjyqit, ku sipas ligjit, dërgohet vetëm ai që meriton të dënohet dhe jo ai që ka nevojë të këshillohet"²⁶. Gjithë këtë proces argumentimi, **Zhane Hersh** e përmbledh më së miri duke thënë: "Kështu deri në çastin kur Sokrati thotë: "Si është e mundur kjo? Më parë ne kemi arritur në një përfundim fillestar: tani arrijmë në një tjetër përfundim, krejt të mdryshëm. Si mund të bashkohen të dy?" Ky është çasti i hutimit, i lëkundjes, i përvojës së mosdijes. Tradita e ka quajtur këtë proces "ironia sokratike". Kjo traditë mbështetet në ndjekjen e mendimit të bashkëbiseduesit, po duke i shtyrë gjërat deri në atë pikë sa tjetri zbulon se ai nuk është dakord me vetveten, aq sa edhe ai vetë nuk e di më se çfarë kishte menduar. Atëherë e vetmja gjë që mbetet për t'u bërë është të rimerret e gjitha prej fillimit".²⁷

Në të kundërt të Sokratit, Aristoteli u fokusua në të dy format e provës logjike: enthimemës - një lloj silogjizmi i paplotë sipas tij, që në thelb ka logjikën deduktive (kalimi nga e përgjithshmja tek e veçanta), por që lëviz nga parimi global tek e vërteta specifike²⁸ si dhe shembullit, i cili përdor arsyetimin induktiv (nxirret një konkluzion final nga shembujt specifikë). Të mësipërmet i shtjellon gjerazi në veprën e tij "Retorika". Kjo


Kjo vepër nuk ka një strukturë dialoguese, por siç shpjegon edhe titulli, është mbrojtja e ndarë në tre monologë, të cilët Sokrati i shpalli para gjyqit të Athinës e që janë: "Kritoni, Fedoni, Elozhi i dashurisë ose simpoziumi".

Në shqip kemi edhe botimin tjetër: "Apologjia e vërtetë e Sokratit", në origjinal nga Kostas Varnalis dhe përkthyer në shqip nga Llambro Ruci, shtëpia botuese "Mësonjëtorja e parë", Tiranë, 2001.

²⁶ Platoni. Po aty.

²⁷ Zhane Hersh: "Habia filozofike", vep. e cit., fq. 30.

²⁸ Sipas retorikës, enthimemat janë arsyetime deduktive e që në dialektikë dhe shkencë njihen ndryshe si silogjizma. P.sh.: Dekarti thotë: "Mendoj, domethënë jam". Këtu mungon njëra nga premisat: Të mendosh, do të thotë të jesh. Atëherë: Mendoj, domethënë jam. Pra, enthimema ngërthen në vetveten e saj elipsën, pasi njëra nga pjesët e silogjizmit nuk shprehet, por nënkuptohet.



vepër, si më përfaqësuesja e mbarë retorikës antike, është bërë shpeshherë objekt studimi dhe shqyrtimi nga ana e gjuhëtarëve dhe e retorëve të sotëm lidhur me disa nocione bazë të saj. Ndaj, më poshtë po ndalemi përmbledhtas në strukturën dhe konceptet bazë të saj.

1.1.1. Mendimi retorik dhe Aristoteli. Vepra “Retorika”

Aristotelit ka meritën se për herë të parë filloi të ekzaminojë metodën me të cilën arrihet në njohjen e gjërave, duke hedhur bazat në formimin e sistemit themeltar të retorikës. Kështu, ai shkroi traktatet e shkencës mbi arsytimin (mbi logjikën), të cilat përbëjnë në tërësinë e tyre atë që ai e quajti *Organo*, domethënë mjeti, instrumenti për të arsytuar. Duke parashtruar si kritik i mprehtë ligjet mbi gojëtarinë, Aristoteli bëri që ta çojë retorikën në nivelin e një shkence, duke eksploruar në mënyrë sistematike efektet e folësit, fjalimin dhe audiencën. Të gjitha këto, ai i parashtrroi në veprën e tij “*Retorika*”²⁹, e cila shërbeu “*si guri mbështetës*”³⁰ në zhvillimin e teorisë retorike, prej antikitetit e deri në kohët moderne.

“*Retorika*” përbëhet nga tri libra:

Libri i parë ofron një prezantim të përgjithshëm lidhur me përkufizimin që i bëhet retorikës, qëllimeve që kjo ka në vetvete si dhe llojeve në të cilat vetë kjo ndahet.³¹

²⁹ Në origjinal (pra, në greqisht) vepra titullohet: “*Ῥητορικὴ Ἄρτη*” e transliteruar “*Ars Rhetorica*” e që daton në Greqinë e lashtë, aty nga shek. V p.e.r. Në anglisht e gjejmë në variantet: “*The Rhetoric*”, “*The Art of Rhetoric*”, “*Treatise on Rhetoric*” pra: “*Retorika*”, “*Arti i Retorikës*”, “*Traktat mbi Retorikën*”.

Rreshti i parë i “*Retorikës*” fillon: “*Retorika është sfondi plotësues i dialektikës.*” Aristoteli: “*Retorika*”, botim i eBooks@Adelaide, 2007, Libri I, kapitulli 1, [1354]. Varianti në anglisht gjendet në nyjen:

<http://ebooks.adelaide.edu.au/a/aristotle/a8rh/index.html>

³⁰ Patricia Bizzell – Bruce Herzberg: “*The Rhetorical Tradition*”: Readings from Classical Times to the Present. NY: Bedford/St. Martin’s, 2000, fq. 3.

³¹ Sipas Aristotelit: “*Retorika mund të përkufizohet si aftësia e të zbatuarit në çfarëdo rast të dhënë të mënyrave të disponueshme të bindjes. Ky s’është një funksion i cilido arti tjetër. Cilido art tjetër mund të udhëzojë ose të bindë përreth subjektit të tij të veçantë për shembull: mjekësia bind për çfarë është e shëndetshme ose jo, gjeometria për vetitë e madhësisë, matematika përreth numrave dhe në këtë kontekst e njëjta gjë është e vërtetë për artet dhe shkencat e tjera. Por në retorikën e shohim si fuqia e të vëzhguarit të mjeteve të bindjes pothuajse mbi cilindo subjekt që na prezantohet; dhe për këtë arsye në themi që në karakterin e vet teknik nuk merret me një klasë të caktuar ose të veçantë subjektësh*” te: “*Retorika*”, vep. e cit. Libri I, kapitulli 2, [1356a].

Libri i dytë parashtron me detaje tri mjetet e bindjes të cilat duhet të bazohet një orator: Mjetet e disponueshme të bindjes sipas Aristotelit bazohen në tri lloje provash ose arsyesimesh të përbashkëta logjike, të njohura nën mbulesën *topos*³²:

1. atë të bazuar në besueshmërinë e folësit, që manifestohet në inteligjencë, në karakter dhe vullnet të mirë – e njohur me termin *etos*³³. Vlerësimi i inteligjencës bazohet në zgjuarsia praktike dhe vlera të përbashkëta. Karakteri virtuoz ka të bëjë me imazhin e folësit si një person i mirë dhe i ndershëm. Vullneti i mirë është një gjykim pozitiv i qëllimit të folësit kundrejt audiencës.

2. atë të bazuar në ndjenjën, emocionin dhe psikologjinë që shkaktohet tek audienca përgjatë fjalimit të vetë oratorit – e njohur me termin *patos*³⁴. Edhe pse skeptik për oratorinë publike të ngarkuar emocionalisht, tipike të kohës së tij, Aristoteli u përpoq që të ndihmonte folësit të përdornin *patosin* në mënyrë etike.

3. atë të bazuar në modele të arsyesimit, me të cilat vjen vija argumentuese në fjalim – e njohur me termin *logos*³⁵.

Libri i tretë na njeh me elementet e stilit: zgjedhjen e fjalëve, metaforat dhe strukturat e fjalisë, si edhe me përgatitjen dhe organizimin që duhet të ketë një ligjëratë.

Si t'i kuptojmë më mirë *etosin*, *patosin*, *logosin*?

Sipas retorikës aristoteliane, të qenët etik ose virtuoz përballë audiencës është një element kryesor në të folurën e ligjëruesit. Fjalët e një folësi janë të rëndësishme, por nuk është e mjaftueshme për një folës thjesht të përqendrohet te mesazhi. Të bindurit është më shumë, më përtej, sesa një çështje thjesht mesazhi. Perceptimet tona për karakterin e folësit ndikojnë në mënyrën *se si* dhe *nëse* mesazhi i folësit na bind.

Në të njëjtën kohë ligjëruesi kërkon t'i ngjallë auditorit një emocion të caktuar: miqësi, pasion, siguri, zemërim, urrejtje, frikë, indinjatë, mëshirë – të gjitha këto në varësi të çështjes(ve) që është (janë) në qendër të analizës së tij. Duke iu drejtuar ndjeshmërisë së dëgjuesve, oratori përpiqet të mos zgjojë arsyen tek ta, çka do të rrezikonte në arritjen e qëllimit që i ka vënë vetes (shpesh thuhet se kur emocionin hyn nga dera, arsyeja arratiset). Ndaj, ai përdor mburrje, lavdërime apo mjete të ndryshme si: gjestet, tonin e zërit,

³² Sqarim: Termi "*topos*" (greq.) ose "*locis communis*" (lat.) në kuptimin e mirëfilltë "*vende të përbashkëta*", zë një vend qendror në gjithë retorikën aristoteliane. *Topos* tek Aristoteli lidhet me idenë që çdo qenie në hapësirë ka vendin e vet, një vendndodhje të përcaktuar. Aristoteli i klasifikoi *topos* në: "*të përgjithshëm*" dhe "*të veçantë*" (Aristoteli: "*Topika*", Paris: Bude, 1967).

³³ Nga greq. *ἦθος* që do të thotë: karakter, tipar ose mënyrë e zakonit e të jetuarit.

³⁴ Nga greq. *πάθος* që do të thotë: përvojë, emocion, vuajtje.

³⁵ Nga greq. *λόγος*, që do të thotë: fjalë, mendim, ide, argument, arsye, parim.

duke zgjedhur një stil mjaft të qartë me pasthirrma dhe pyetje retorike. E gjitha sa më lart ka të bëjë me *patosin*. Për Aristotelin *emocioni* i audiencës është po aq një mënyrë bindjeje, sa përmbajtja e një fjalimi apo karakteri i vetë folësit. Patosi i përgjegjshëm nuk përfshin strategjinë e manipulimit, që sipas tij, ndodh në rastet kur vëmë në përdorim monologë prekës apo nxisim frikën tek auditori nëpërmjet fjalimit frikësues. “*Kur jemi të kënaqur dhe miqësorë, gjykimet tona nuk janë të njëjta me ato kur jemi të lënduar apo armiqësorë*”, - thotë Aristoteli.³⁶

Por bindja nuk mund të arrihet pa arsyetim dhe pa argumente. Kështu, oratori thërret pranë arsytimit, logjikën, duke zgjedhur argumente solide dhe me peshë. Njëherazi përpiqet të shfrytëzojë shumëkuptimshmërinë dhe nuancat që vetë fjala merr në kontekste të ndryshme. Një pjesë e mënyrës me të cilën ne bindemi nga dikush, është nëpërmjet fjalëve që ai/ajo përdor dhe mënyrën *se si* ai/ajo i përdor këto fjalë. E gjitha kjo ka të bëjë me *logosin*. Një mënyrë efikase për të bindur dikë është të gjejmë elemente të përbashkëta që ekzistojnë mes nesh. Ky është një përfundim i përbashkët për të dy, një pikëpamje përfundimtare që të dyja palët duan. Duke pranuar këtë, ne më pas procedojmë duke i treguar rrugën se si kjo e fundit është më e mira e mundshme për të synuar. Një mënyrë solide për t’u dukur të arsyeshëm është të pranuarit nga ana jonë e pikëpamjes (ve) qendrore të kundërt(a) të kundërshtarit, por duke treguar mprehtësi në shpalosjen e mendimit se pikëpamja jonë është më e arsyeshme se e vetë atij. Ne duhet të përdorim logjikën për të vendosur besimin me kundërshtarit (marrësin). Në të kundërt çdo gjë rrëzohet.

Sipas Aristotelit, fjala e thënë gojarisht na siguron tri metoda të bindjes³⁷:

1. lloji i parë varet nga karakteri personal i folësit;
2. lloji i dytë varet nga të qenurit e audiencës në një gjendje të caktuar të menduarit;
3. lloji i tretë varet nga prova e qartë, e dhëna, nga fjalët e vetë ligjërit.

1. Bindja varet nga karakteri personal i folësit. Rishtazi sa përmendim këtë faktor, na vjen ndërmend të themi se bindja duhet të arrihet nga çfarë thotë folësi e jo nga çfarë njerëzit mendojnë për karakterin e tij, para se ai të fillojë të flasë. Në fakt, kjo nuk është plotësisht e vërtetë. Fakti se kush argumenton, sa i zoti është në fushën ku shtrihet argumenti i tij, si na drejtohet, janë disa faktorë që ndikojnë pashmangshmërisht në besimin tonë qysh në fillim të procesit të argumentimit. “*Ne u besojmë njerëzve të mirë më shumë dhe më shpejt se të tjerët: kjo është përgjithësisht e vërtetë cilado qoftë çështja, dhe plotësisht e vërtetë kur siguria absolute është e pamundur*”.

³⁶ Aristoteli: “*Retorika*”, vep. e cit., Libri I, kapitulli 2, [1356a].

³⁷ Aristoteli. Po aty.

dhe opinionet janë të ndara".³⁸ Kështu, mirësia personale e shpalosur nga folësi jo vetëm ndihmëson në fuqinë e bindjes, por gjithashtu mund të përbëjë mjetin më efikas në procesin e bindjes.

2. Bindja mund të vijë te dëgjuesit kur fjalimi trazon emocionet e tyre. Një pjesë e mirë e autorëve bashkëkohorë të retorikës, merren me studimin e këtyre përpjekjeve që bën folësi për të bërë efekt tek auditori të cilit i drejtohet.

3. Bindja arrihet përmes fjalimit, pasi ne kemi provuar një të vërtetë nëpërmjet mjeteve argumentuese, të përshtatura këto të fundit me çështjen në fjalë. Kështu, kur argumentojmë kemi si bazë vetë arsyen, logjikën e ftohtë, gjykimin. Por, kur duam të bindim të tjerët për diçka që në fakt s'është ashtu, atëherë ndërhyjmë me mjete të tjera, duke dashur t'i prekim në shpirt përmes emocionit të fortë. Këto mjete shërbejnë për të manipuluar situatën dhe vetë dëgjuesit. Përzgjedhja e fjalës dhe konotacioni që merr në kontekste të caktuara, mimika jonë, tonet e ndryshme të zërit janë mënyra që synojnë më tepër prejken e turmës, të publikut, sesa në fakt thelbin e një arsytimi të fortë e domethënës³⁹. Ndaj, duhet të bëjmë kujdes në dallimin e kufirit midis argumentimit dhe manipulimit.

Për sa më lart, gërshetimi i etosit – i logosit – i patosit, oratoria, elokuenca, të folurit bindës e plot pasion, ishin ndër veçoritë kryesore që spikatnin në një ligjërime të kohës antike. Koha ka treguar se ato janë të vetmet modele referimi në hartimin e një ligjërimi publik. Shumë dekada më parë, Martin Luter Kingu shprehu shpresën për një ëndërr për SHBA-të, e cila mbërtheu vëmendjen e shumë amerikanëve nga çdo fushë e jetës dhe shtresës së shoqërisë. Martin Luter Kingu, i martirizuar për të drejtat civile të të gjithë amerikanëve dhe njerëzimit, tha: *"Unë ëndërroj për një ditë, ku*

³⁸ Aristoteli. Po aty.

³⁹ Njëherë Demosteni nisi t'i qaj mikut të tij, Satir, se megjithëse ushtrohej më shumë nga gojtarët e tjerë dhe kishte harxhuar për këtë qëllim pothuaj tërë energjitë e veta, prapë nuk po arrinte të fitonte simpatinë e popullit, ndërkohë që ky ua vinte veshin dhe lejonte të bëheshin zotur të tribunës njerëz të tillë e të pagdhundur si marinarët. *"Kjo që thua ti o Demosten është e vërtetë, - ia ktheu Satiri, por unë mund t'ia gjej menjëherë ilaçin, po qe se ti do të më recitosh përmendsh diçka nga Euripidi ose nga Sofokliu"*. Pasi recitoi Demosteni, Satiri nisi t'i përsëriste të njëjtat vargje, po me aq hijeshi e aq në përshtatje me karakterin dhe ndjenjat e personazhit, sa iu dukën fare të ndryshme edhe vetë Demostenit. Ky kuptoi tani se ç'hir e ç'bukuri i jepte fjalës një deklamim i lartë dhe zuri ta çmonte pak, a më mirë aspak, të ushtruarit në gojëtarin në rastin kur lihej pas dore shqiptimi i mirë dhe plot ndjenja i fjalëve që thuhën. Prandaj hapi një dhomë pune nën tokë ku stërvitej çdo ditë për të përsosur mënyrën e deklamimit dhe për të rregulluar zërin. Shpesh qëndronte aty edhe dy - tri muaj rresht dhe e rruante gjysmën e kokës, me qëllim që, edhe sikur t'i hipte dëshira të dilte, të mos mundej prej turpfit. (Plutarku, *"Jetë njerëzish të shquar"*, shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1980, fq. 167).

njerëzit në SHBA nuk do ta gjykojnë njëri-tjetrin nga ngjyra e lëkurës, por nga përmbajtja dhe esenca e karakterit të tyre.”⁴⁰ Dhe sot, miliona amerikanë kanë zgjedhur të shohin përmbushjen e asaj ëndrre. Shembulli më domethënës është presidenti aktual i SHBA-ve, Obama: “Nëse ka ende ndonjë që dyshon për Amerikën si vendin ku çdo gjë është e mundur, që ende pyet veten nëse ëndrra e themeluesve të këtij vendi është gjallë në kohët që jetojmë, që ende vë në dyshim fuqinë e demokracisë sonë, nata e sotme është përgjigja për ta”⁴¹. Fjalimet e tij para njerëzve, që e dalluan edhe nga rivalët e tij, të japin përshtypjen e politikës në Athinën e lashtë, kur fjalimet publike para votuesve të thjeshtë ishin motori i politikës. Fjalimet e tij emetonin kaq e kaq teknika të retorikës antike. Sipas Obamës: “Për të kuptuar politikën amerikane të katër viteve të ardhshme, të duhet të kuptosh diçka nga politika e Greqisë dhe e Romës së lashtë”⁴². Ai vuri në përdorim mësimet retorike të Aristotelit, sipas të cilave një fjalim i mirë duhet të shoqërohet nga etosi, patosi, logosi, pra karakteri, emocioni, argumenti. Nëse Kingu bëri jehonë me frazën: “Unë kam një ëndërr”, Obama bëri të përloten me mijëra njerëz kur tha: “Unë jam djali i një zezaku nga Kenia dhe një gruajë të bardhë nga Kansasi. Jam rritur me ndihmën e një gjyshi të bardhë që i mbijetoi periudhës së trishtë të Depresionit të Madh dhe shërbeu në ushtri gjatë Luftës II Botërore, si dhe një gjysheje që ishte infermiere. Jam shkolluar në shkollat më të mira të Shteteve të Bashkuara dhe kam jetuar në një nga vendet më të varfra të botës”⁴³.

Kështu pra, këto fjalime u shquan mbi të gjitha nga thellësia e emocionit dhe ndikimit të vazhdueshëm të publikut.

1.2. Zhvillimet e retorikës. Teknikat argumentuese klasike

1.2.1. Retorika nga Rilindja deri në shek. XVIII

Në Romë, duke filluar nga shek. III p.e.r. e këndeje, u dukën shumë dijetarë të ardhur nga bota helene, të cilët sollën vlera dhe pasuri të mëdha shpirtërore e kulturore. Romakët u kujdesën të mësojnë prej mësuesve të tyre grekë shkathësinë dhe të folurit sa më bindshëm e sa më bukur. Ata punësuan gojëtarë grekë që të jepnin mësim në shkollat e tyre, duke imituar

⁴⁰ Keith David Miller: “Voice of Deliverance: The Language of Martin Luther King, Jr. and Its Sources”, New York: The Free Press, 1992. Shih nyjen:

<http://www9.georgetown.edu/faculty/bassr/heath/syllabuild/iguide/king.html>

⁴¹ Nga fjalimi i Obamës. Shih të përditshmen shqiptare “Korrieri”, e mërkurë, 5 nëntor, 2008.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

e përshtatur punët retorike greke në latinisht dhe me shembuj romakë. Ndër zërat më të fuqishëm në fushën e oratorisë të kësaj periudhe përmendim: *Ciceronin* dhe *Kuintilianin*, puna e të cilëve është një shtrirje e teorisë retorike sofiste, isokratike, aristoteliane dhe platonike. Në këtë hulli vazhduan punën të tjerë gojtarë të shquar të kësaj periudhe.⁴⁴

Nga ana tjetër, antikiteti greko-romak nuk është e vetmja kohë e kultivimit të retorikës. Studimit të saj vazhdon t'i kushtohet vëmendje edhe në periudhat e mëvonshme. Konkretisht, gjatë periudhës së Rilindjes retorika u shndërrua në art shkrimi të letrave (*ars dictaminis*) dhe të predikimeve (*ars praedicandi*). Ajo çka bie në sy, është fakti që mjaft përfaqësues të shek. XVI si: *Desiderio Erasmus*, *Peter Ramus*, *Xhon Milton* i përqendruan trajtesat e tyre kryesisht në pesë rregullat e retorikës. Nëse në këtë shekull shkrimet duhet të hartoheshin në latinisht dhe sipas modeleve të caktuara, në shekullin pasues kemi zhvillimin i një stili modern vendas e të mbështetur më shumë te modelet angleze, sesa tek ato greke a latine. Si përfaqësues kryesorë që u shquan gjatë shek. XVII përmendim: *Frensis Bekon* dhe *Tomas Hobs*.

Shekulli XVIII ishte koha kur institucionet arsimore filluan t'u ktheheshin modeleve klasike, veçanërisht atyre të Ciceronit dhe të Kuintilianit. Përqaftimi që iu bë modeleve klasike të retorikës, po ndodhte edhe në anën tjetër të Atlantikut. Ky shekull përfaqësonte një ndryshim të madh nga praktikat amerikane të shek. XVII, kohë kur u idealizua një stil i thjeshtë ligjërimit. Tashmë amerikanët dallojnë dukshëm "*stilin*" nga "*substanca*" (atë që Aristoteli dha në dallimin "*logos – lexis*"). Kjo pikëpamje e hershme ishte shprehur më mirë në teorinë e Peter Ramusit. Ndërkohë që amerikanët filluan të largoheshin nga retorika ramustike drejt retorikës klasike, ata erdhën në linjë me të folurin publik evropian, veçanërisht atë anglez. Kjo zhvendosje vëmendjeje reflektonte ndryshime më të gjera kulturore të vetë opinionit publik, duke shkaktuar kështu të bërët për vete të audiencës. Duke filluar nga mesi i shek. XVIII, universitetet e vendosën retorikën si lëndë për katër vjet dhe theksuan karakteristikat e saj publike dhe qytetare.

Krahas rëndësisë në rritje të retorikës neo-klasike, dy lëvizje të tjera të rëndësishme u shfaqën nga fundi i shek. XVIII në të dyja anët e Atlantikut:

- e para lidhej me elokucionin, që i mësonte përkrahësit e kësaj lëvizjeje se si ligjërimit i tyre t'i transmetonte audiencës ide dhe emocione në

⁴⁴ Përmendim: Plutarku me veprën e tij kryesore "*Jetët paralele*"; Mark Aureli me veprën "*Për vetveten*"; Lukiani me veprat "*Dialogët e perëndive*" dhe "*Dialogët e të vdekurve*" apo vëllezërit Grakë, sidomos më i riu, Gaj Graku. Për më tepër shih: Plutarku: "*Jetë njerëzish të shquar*", vep. e cituar.

mënyrë të suksesshme. Elokutorët siguruan metoda për të moduluar zërin, gjestet, dhe shprehjet e mimikës me qëllim që të mbërthenin emocionin.

- e dyta lidhej me retorikën “*belletristic-e*”⁴⁵. Kjo lloj retorike vlerësohet më shumë për bukurinë e jashtme, për artin, origjinalitetin e stilit dhe të tonit, sesa për idetë e saj dhe përbërjen e informacionit. Teoristët “*belletristic-ë*” bashkuan retorikën dhe “*letrat e bukura*” në një kategori të gjerë, së cilës i referoheshin si “*letërsi e mirësjellshme*” e që përfshinte dije të filozofisë, biografisë, gjuhësisë, letërsisë dhe historisë.

1.2.2. Pesë rregullat e retorikës klasike

Edhe pse shumica e gojëtarëve i referohen retorikës si *një art*, kjo shihej nga shumica si një masë rregullash apo ligjesh për t’u nxënë nga përdoruesit. Sipas praktikës klasike, formimi retorik u bazua në *pesë rregulla* (secili i një rëndësie të barabartë), që do të bëheshin pika referimi për shekuj të tërë nga vetë qarqet akademike. Sipas kësaj formule, oratori, i cili trajton logjikën e një argumenti ose zhvillimin e një ideje, duhet të grumbullojë të gjitha këto “pjesë”, që të bindë dhe ta bëjë për vete plotësisht një audiencë. Këto rregulla qenë:

1. *Inventio (invention)* – *sajesë, trillim, shpikje* – është procesi që çon në gjetjen, kërkimin, zhvillimin dhe përpunimin e një argumenti. Pikërisht *topoi* si kategori të mendimit, përdoren si tregues konvencionalë, me qëllim që të gjenden ide për material. Sajesa është e lidhur me thirrjen retorike që i bëhet logosit, duke qenë e orientuar në atë se *çfarë* do të thotë më shumë një autor, sesa në mënyrën *se si* kjo mund të thuhet.

2. *Dispositio (arrangement)* – *sistemim, rregullim, përndarje* – është procesi që vë në dispozicion argumentet, duke i renditur dhe organizuar në mënyrë të tillë që fjalimi të arrijë efektin maksimal ndikues. Zakonisht shoqërohet me *exordium* (parathënie) dhe përfshin të gjitha hapat e renditjes lineare të vetë ideve të parashtruara. Konkretisht:

⁴⁵ Sqarim: vjen nga frëngjishtja: belles-lettres (bël-lè`trə).

Shih më gjerë nyjen:

<http://www.artofmanliness.com/2010/11/30/history-of-rhetoric/>

Tabela nr. 1

Përgatitja e një fjalimi klasik	
Hyrja	exordium
Deklarimi i fakteve	narratio
Ndarja	partitio
Prova	confirmatio
Rrëzimi	refutatio
Konkluzioni	peroratio

Te hyrja (*exordium*) është e nevojshme që ligjëruesi të formojë autoritetin e vet. Hyrja njofton subjektin dhe përpiqet ta bëjë auditorin të ketë interes. Për pasojë ai përdor thirrjet etike (*etosi*). Në katër pjesët e tjera të fjalimit (*deklarimi i fakteve, ndarja, prova, rrëzimi*) mbizotërojnë kryesisht argumente logjike (*logosi*). Ndërsa te konkluzioni (*peroratio*), përdoren thirrjet emocionale (*patosi*), për të ndikuar përfundimisht dhe për të bërë efekt.

3. *Elocutio (style)* – stil, apo *pronuntiatio* – prezantim – është procesi që ka të bëjë me mënyrën *se si* thuhet diçka, duke zgjedhur fjalët e duhura dhe artificet retorike. Pra, nëse inventio adreson atë se *çfarë* duhet të thuhet, *elocutio* adreson mënyrën *se si* mund të thuhet diçka. Stili është thelbësor për retorikën, sepse *forma* (ose mjetet gjuhësore përmes të cilave komunikohet diçka), është po aq pjesë e mesazhit sa ç'është *përmbajtja*. (Aristoteli e përcaktoi këtë si dallim ndërmjet *logosit* - përmbajtja logjike e ligjërimit dhe *lexisit* - stili dhe akti prodhimtar i ligjërimit). Në funksion të bindjes së audiencës, vihen në përdorim të ashtuquajturat *figura retorike*,⁴⁶ të cilat herë janë konsideruar si pjesë e artificeve, e herë sikur përfaqësojnë gjithë retorikën (në aspekt letrar). Në fakt, përgjatë retorikës klasike dhe asaj vijuese të Rilindjes, zbulurimi nuk kishte të bënte aspak me sipërfaqen, sepse të zbuluroje do të thoshte të pajisje mendimet me shprehje verbale të përshtatshme për të përmbushur qëllimin e ligjërimit. Këto shprehje shoqërohen me vetë figurat retorike, ku ka të atilla, përdorimi i të cilave mund ta ngrejë moralisht autoritetin dhe besueshmërinë e folësit, ose në të kundërt, ta ulë atë.⁴⁷

⁴⁶ Figurat retorike përbëjnë në vetvete një fjalor të madh teknik. Për një klasifikim të përgjithshëm të tyre shih: Gjovalin Shkurtaj: “*Si të shkruajmë shqip*”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2008, fq. 90; Sharon Crowley: “*Ancient rhetorics for contemporary students*”, A. Simon & Schuster Company Needham Heights, Massachusetts 02194, 1994, fq. 193 – 218;

nyjen: http://en.wikipedia.org/wiki/Figure_of_speech.

⁴⁷ Sqarim: Sipas ndarjes klasike dallohen tri lloj figurash retorike: 1. *figura të etosit* 2. *figurat të patosit* 3. *figura të logosit* ose të *arsyes*.

4. *Memoria (memory)* – *kujtesa* – është procesi që ka të bëjë me memorizimin që folësi duhet t'i bëjë gjithë fjalimit të tij të shkruar. Fillimisht *kujtesa* kishte të bënte vetëm me konceptin *mnemonics* (gjëra që të risjellin ndërmend diçka, ato që freskojnë kujtesën), që do të ndihmonte një orator në fjalimin e vet. Në vijim, mësuesit romakë e shohin si një lloj teknike që ka të bëjë me më shumë sesa thjesht të mësuarit përmendsh, ose e thënë ndryshe ngulitja në mendje e ligjëratës para daljes në publik. Kështu, *kujtesa* është po aq e lidhur me domosdoshmërinë improvizuese të folësit, sa ç'është me nevojën për të memorizuar një fjalim të plotë për ligjërimit. Me fjalë të tjera, rregulli i kujtesës sugjeron që të merren parasysh dhe aspektet psikologjike të përgatitjes për të komunikuar dhe performuar këtë komunikim, veçanërisht në një mjedis gojor ose të improvizuar⁴⁸.

5. *Actio (delivery)* – *mbajtja e fjalimit, deklamimi* – është procesi që ka të bëjë me hapin final, me mënyrën se si gojëtar kumton dhe i prezantohet audiencës në mënyrë plot hijeshi dhe bindëse, se si ai gërsheton të gjitha elementet pjesëmarrëse përgjatë ligjërimit të tij: gjestet, mimikën, zërin etj. Mënyra *se si* ligjërohej një fjalim në antikitet, konsiderohej një faktor shumë i rëndësishëm në përkapjen kuptimore si dhe në efektshmërinë e tij, meqë gjatë aktit të ligjërimit përdorehin thirrjet e fuqishme bindëse të patosit (përgatitje vokale dhe përdorim i gjeleve). Kështu, vetë ligjërimiti, fillimisht i referohej retorikës gojore. Më pas e zgjeroi kuptimësinë e vet si mënyrë transmetimi jo vetëm e formës gojore, por edhe të shkruar, derisa në ditët e sotme, së bashku me *kujtesën*, shihet si formë e veçantë studimi në *pedagogjinë retorike*⁴⁹.

1.3. Retorika moderne. Shtrirja e këtij koncepti në gjuhësi

Shekujt në vijim sollën një lloj zgjerimi kuptimor të vetë retorikës. Tanimë trajtohet në kuadrin e një shkence dhe bëhet objekt studimi gjithashtu jo vetëm në shkencat si: filozofi, logjikë, gjuhësi, por njëherazi

⁴⁸ Oratorët inkurajoheshin të përfytyronin vendin ku ata do të flisnin si një lloj përgatitjeje për të memorizuar fjalimin e tyre. Pastaj pasi kishin përfunduar përgatitjen e fjalimit, ata duhej ta ndanin atë në pjesë të administrueshme; secilën nga ato ata duhet ta vendosnin në një pjesë të ndryshme të dhomës ku fjalimi duhej të ndodhte. Kështu duke hedhur sytë përqark fjalimit, ata do të kujtoheshin për pjesën tjetër të fjalimit.

⁴⁹ Pedagogjia retorike i referohet lidhjeve të ngushta ndërmjet leximit dhe shkrimit, të vëzhguarit dhe të hartuarit. Retoricieni Peter Ramus e ndau pedagogjinë retorike në dy aktivitete: *analizat* dhe *gjenezat* (zanafillat). Të folurit apo të shkruarit të suksesshëm (*analiza*) gjithmonë i paraprin vetë i foluri (të shkruarit) ynë (*gjeneza*), siç thotë Kuintiliani: "*Vir bonus peritus dicendi, "Flet mirë, një njeri i mirë"*".

dhe në shkencat sociale si: histori, letërsi, gazetari, fe, e madje në hartografi apo arkitekturë. Nëse në letërsi retorika u përcaktua nga retorët si fusha që merrej me studimin e figurave letrare (tropet), në gjuhësi filluan të shfaqeshin ide se retorika nuk nënkuptonte më thjesht të folurit bukur, në mënyrë bindëse e kundrejt një tërësie rregullash e normash që duhet të ndiqeshin, por më tepër se kaq. Ajo tanimë shihet si një teori e tërë argumentimi që merr vlera pragmatike, pasi ligjërimi ynë nuk është një ligjërim i shkëputur nga situata apo konteksti ku ky zhvillohet.

Kështu, punimet e autorëve si: *Stephen Toulmin-it*, *Chaim Perelman-it* dhe *Lucie Olbrechts-Tyteca-s*, *Oswald Ducrot-it* dhe *Jean-Claude Anscombres-së* e më pas të *Jacques Moeschler-it* dhe *Eddy Roulet-it*⁵⁰ etj., hodhën themelet e një Retorike të re, e njohur ndryshe si teoria e ligjërimin bindës, e realizuar nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar. Rivlerësimi që i bëhet pasurisë antike në tërësi dhe retorikës aristoteliane në veçanti, ishin interesi i përbashkët i këtyre punimeve.

Sipas kësaj perspektive, Neoretorika shkon deri aty sa t'i referohet vetëm formës së argumentimit dhe jo përmbajtjes së tij, duke denigruar format specifike të arsytimit verbal, në të gabuara ose të rreme, çka jep idenë se retorika është një mjet për të errësuar të vërtetën, procedurë kjo e përdorur në antikitet nga sofistët, me qëllim errësimin e së vërtetës⁵¹.

Le ta shtjellojmë më gjerësisht thelbin e Retorikës së re.

⁵⁰ Emrat e gjuhëtarëve të huaj paraqiten në të gjithë punimin sipas shkrimit në origjinal të shoqëruar me mbasesat rasore sipas paradigmave që këta emra dalin në kontekstet përkatëse dhe jo të shqipëruar tërësisht sipas parimeve të drejtshkrimit në shqipe. Kjo, për të qenë dhe në koherencë me mënyrën e listimit të autorëve në pjesën përbërëse të bibliografisë. (Shënimi ynë).

⁵¹ Sqarim: Sipas këtij konteksti, retorika merret me studimin e parimeve që kanë për bazë thënien dhe konkluzionin. Kështu nën analizën e arsyes, duke përdorur gjasat dhe argumentet, ajo shqyrton jo vetëm shkakësinë në thënie, por njëherazi klasifikon argumentet mbi bazë vërtetësie apo jo në: argumente të drejta (të vërteta) – argumente jo të drejta (false, të rreme).

KREU II

ARGUMENTIMI NË KËNDVËSHTRIMIN E TEORIVE TË SOTME GJUHËSORE

2.1. Retorikë dhe pragmatikë. Kuptimi mbi argumentimin

Filozofi Emanuel Kanti shprehet: “Njerëzit flasin me qëllim që të shprehin, të përcaktojnë, të njoftojnë diçka; pa këtë “me qëllim që...” të flasësh do të ishte diçka absurde. Kur formulojmë një parim moral apo një ligj shkencor, ne shprehim gjykime, me qëllim që ato të kenë një kuptim.”⁵² Kështu, një jurist flet në gjyq në atë lloj mënyre, me qëllim që të bindë një juri; një shitës i bën reklamë një produkti të ri, me qëllim që të bindë klientët ta blejnë këtë produkt; një ambientalist mban një fjalim përpara auditorit, me qëllim që të bindë njerëzit për mirëmbajtjen e mjedisit apo kërcënimin nga një ngrohje globale, një politikan u kërkon njerëzve të votojnë për të, një infermiere përpiqet të bindë një pacient të lërë cigaren, një agjent mobiluar përshkruan saktësisht karakteristikat e një shtëpie të re në mënyrë që ajo të shitet etj. Mesa duket, në thelb të gjithë ligjërimin tonë qëndron argumenti dhe argumentimi.

Në fakt, ç’është argumenti dhe argumentimi?

Nëse i referohemi fjalorëve si: *Fjalorit të shqipes së sotme*⁵³ dhe *Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe*,⁵⁴ vëmë re se argumenti është arsytim që

⁵² Zhane Hersh: “*Habia filozofike*”, vep. e cit., fq. 209.

⁵³ ARGUMENT, ~I m.sh. ~E, ~ET. Arsytim që vërteton ose kundërshton një mendim; provë që sillet për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë diçka. Argument bindës (shkencor). Flet me argumente.

ARGUMENTIM, ~I m.sh. ~E, ~ET. 1. Veprimi sipas ARGUMENTOJ, ARGUMENTOHET. Argumentim i thellë (shkencor). 2. Tërësia e argumenteve. Argumentim i dobët.

ARGUMENT/OJ kal., ~OVA, ~UAR. Paraqit argumente për një çështje, vërtetohet me argumente.

◇ Pës. ARGUMENTOHET në FSHS, vep. e cit., fq. 51.

⁵⁴ ARGUMENT, - I m. Arsytim që vërteton a kundërshton një mendim. **Provë.** Ky libër nuk mund të kuptohet veçse prej disa njerëzish që merrnin erë nga këto gjëra. Por çfarë force logjike kish ai, ç’mori provash të pamohueshme të rënies së shoqërisë së sotme, të bazuar në këtë sistem. (Let. art.).

ARGUMENTIM, - I m. Veprimi sipas **Argumentoj**. **Vërtetim.** **Mbështetje.** **Motivim.** Nëse do të pranohet se motivimi i kushteve, që përgatitën një Bardhë të tillë “në këtë dramë” nuk ka rëndësi, atëherë vlera e saj do të zvogëlohet. (Let. shkenc.).

vërteton a kundërshton një mendim. Me fjalë të tjera arsyetim i destinuar për të provuar apo kundërshtuar një propozim të dhënë, arsyetim i shprehur në mbështetje të një teze ose kundër kësaj.

Nga ana tjetër, argumentimi është dukuria me të cilën ne përballemi përditë. Ne debatojmë çdo herë për pikëpamjet tona dhe u kundërvihemi argumentimeve të të tjerëve (të shkruara ose gojore). Shpesh dëgjojmë të thuhet: “*E mbrojta argumentimin tim me të gjitha mjetet*”; “*Kishte një forcë të madhe argumentuese në ato çka tha*”; apo: “*Cili është argumenti yt që të të besoj?*” Kështu, argumentimi është veprimtari që ka për qëllim të shtojë a të pakësojë pranueshmërinë e një pikëpamjeje të debatueshme për dëgjuesin a lexuesin, duke propozuar një sistem pohimesh që kanë për qëllim të justifikojnë a të refuzojnë pikëpamjen përpara një gjykatësi racional. Rrjedhimisht, përveçse të qenët një aktivitet (i folur, i shkruar) i bazuar në arsytetime të destinuara të vërtetojnë apo të kundërshtojnë një mendim të dhënë (*kuptimi i parë*), argumentimi është njëherazi një aktivitet shoqëror që iu drejtohet të tjerëve për t’i bindur (*kuptimi i dytë*) si dhe një aktivitet racional që synon të mbrojë një pikëpamje në një mënyrë të tillë që është e pranueshme për një logjikë të shëndoshë (*kuptimi i tretë*). Kjo do të thotë që argumentimi ka të bëjë jo vetëm me shprehjen e arsytimeve tona, por njëherazi dhe me organizmin që u bëjmë mjeteve të ndryshme gjuhësore. Në këtë kontekst, argumentimi mund të haset në komunikimin ndërpersonal (shkëmbimi me dialog drejtpërdrejt ndërmjet individëve me gojë ose me shkrim), në komunikimin në grup e madje në kontekste më të gjera si ato të informacionit publik (komunikimi masiv). Gjithë kjo vlerë pragmatike e argumentimit, ngjalli kërshërinë e gjuhëtarëve. Nëse deri dje kuptimi i argumentimit sendërtohej brenda konceptit të retorikës klasike, tanimë vështrohet në aspektin gjuhësor si një teori e re, si *Teoria e argumentimit*. Ky argumentim nënkupton ndërveprimin e të paktën dy palëve. Nga vetë

ARGUMENTOJ kal. Paraqit argumente për diçka. **Provoj. Vërtetoj. Mbështet.** Kjo ka qenë periudha e matriarkatit në këtë vend dhe atij i mbetej vetëm të mbështeste shkencërisht të drejtën për këtë pozitë të lartë të gruas. (Pub.) **Motivoj.** “I përgatit nxënësit për punë të pavarur, e cila gjatë orës së mësimit luan një rol të rëndësishëm”. Kështu e motivon ai këtë formë pune të një mësuesi të zellshëm. (Pub.).

ARGUMENTUAR (i) mb. Që është provuar me argumente. **Vërtetuar** (i). Nevoja praktike për të zgjidhur ndonjë çështje shton interesin e fëmijëve për punën mësimore. Mirëpo është i vërtetuar tashmë mendimi se edhe për çështje të tjera të vështira është kreyt e mundshme një metodë për të ngjallur po aq interes. (Let. mës.). **Mbështetur** (i). **Provuar** (i). **Motivuar** (i). Teza mbi prejardhjen ilire është më e motivuar se tezat e tjera, nga shumë burime: arkeologjike, gjuhësore, historike... (Let. shkenc.) te “*Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*”: J. Thomai, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004, fq. 46.

etimologjia e fjalës “*ndërveprim*”, kuptojmë se kemi të bëjmë me një veprim të dyanshëm. Ky term përkufizohet si: “*ndikimet e dyanshme që ushtrojnë partnerët mbi veprimet e veta përkatëse, kur janë të pranishëm fizikisht njëri për tjetrin*”.⁵⁵ ose si: “*bashkëpunim dhe mbrojtje njëkohësisht, respektim i territorit të vet, por edhe i territorit të tjetrit, me qëllim që të mos rrezikohet i veti*”.⁵⁶ Ndërveprimi mund të realizohet jo vetëm në mënyrë reale, por njëherazi edhe në mënyrë imagjinare. Kjo do të thotë që partnerët mund të mos jenë aktiv realisht, por bëhen të tillë në mënyrë imagjinare.

Fusha e argumentimit përqendrohet tek analiza, vlerësimi dhe prezantimi i pikës së nisjes së një argumenti të caktuar si dhe në organizimin tërësor ligjërimit të tij. Kjo pikë nisjeje përbëhet nga premisa eksplicite dhe implicite, nga hamendësime të ndryshme që njerëzit bëjnë. Kështu, nga njëra anë argumentimi merret me organizimin logjik të arsyeve të ndryshme që paraqiten gjatë një pikëpamjeje të hedhur, dhe nga ana tjetër me rrëzimin ose pranimin e vetë kësaj pikëpamjeje.

Kuptohet që në këtë analizë vijnë e hyjnë në lojë edhe logjika, edhe pragmatika, edhe shumë disiplina të tjera gjuhësore, pasi ligjërimet tona nuk janë të shkëputura nga kontekstet dhe situatat ku vetë këto ligjërimet përfshihen. Ndaj, duke qenë këtu, është e rëndësishme të theksojmë se të gjitha përjasjet moderne të argumentimit në fushë gjuhësore, të zhvilluara në dekadat e kaluara, kanë mjaft ndikim nga dialektika, retorika klasike dhe jo post-klasike.

2.2. Përfaqësuesit e Retorikës së re

Sikurse përmendëm më lart, Neoretorika i pati shfaqjet e veta në *Teorinë e argumentimit*. Ndër zërat kryesorë që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ndikim në studimin e kësaj teorie veçojmë:

1. **Stephen Toulmin**. Vepra e tij: “*Përdorimet e argumentit*”,⁵⁷ mbahet sot e kësaj dite si modeli i argumentimit. Toulmin-i zhvilloi teorinë e vet të bazuar në shpjegimin se si ndodh argumentimi në procesin e natyrshëm të një ligjërimi të përditshëm. Ky model i njohur ndryshe si

⁵⁵ Erving Goffman (1922 – 1982, sociolog amerikan): “*Forms of Talk*”, University of Pennsylvania Publications in Conduct & Communication, Mars, 1981. (Shih: Christian Baylon – Xavier Mignot: “*Komunikimi*”, vep. e cit., fq. 164).

⁵⁶ David Lehman (poet, kritik amerikan i lindur më 1948): “*An alternative to speech*”, Princeton University Press, 1986. (Shih: Christian Baylon – Xavier Mignot: “*Komunikimi*”, vep. e cit., po aty).

⁵⁷ Stephen Edelston Toulmin: “*The uses of argument*”, Cambridge University Press, 1958.

“Skema e argumentit” përfaqëson formën procedurale të një ligjërimi argumentues: hapat që mund të ndjekim në mbrojtjen e një pikëpamjeje.

2. **Chaim Perelman dhe Lucie Olbrechts-Tyteca.** Vepra e këtyre bashkautorëve e titulluar “Retorika e re”⁵⁸ mëton të vendosë themelet filozofike të së ashtuquajturës “Retorike të re”. Këta i vunë theksin saktësisë argumentuese. Kjo, sipas këtyre, matet me mbështetjen e opinioneve nga ana e grupit të audiencës, para së cilës vetë ligjëruesi i ka parashtruar, që do të thotë: sa më shumë mbështetet dhe përkrahet nga ky grup x pikëpamje e dhënë, aq më shumë rezulton të jetë e saktë kjo pikëpamje. Ky grup i synuar mund të jetë një i vetëm - çka nënkupton një audiencë specifike, por mund të jetë edhe një tërësi shumë e madhe njerëzish, çka nënkupton një audiencë universale. Teoria e Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s konsiston më së shumti në një listë të gjatë elementesh⁵⁹, mbi bazën e të cilave ndërtohet argumentimi drejtuar audiencës.

3. **Oswald Ducrot⁶⁰ dhe Jean-Claude Anscombe⁶¹.** Me punimet e tyre veçmas dhe të përbashkëta, autorët janë të mendimit se çdo formë e përdorimit të gjuhës ka një aspekt argumentues. Këta dy autorë kërkojnë të integrojnë në përshkrimin linguistik një retorikë të marrëdhënieve argumentuese në kuadrin e një pragmatike të integruar, domethënë një teori gjithëpërfshirëse dhe jologjiciste të ligjërimin. Kështu, retorika e këtyre interesohet më tepër për strategjitë e ligjërimin bindës dhe konkretisht për mënyrat e arsyetimit joformal⁶² të të folurit natyror (langage), të cilat

⁵⁸ Chaim Perelman – Lucie Olbrechts-Tyteca: “*La nouvelle rhétorique: Traité de l’argumentation*”, Bruxelles: l’Université de Bruxelles, 1958, përkthyer në anglisht më 1969: “*The new rhetoric. A treatise on argumentacion*”, University of Notre Dame Press.

⁵⁹ Shih: Frans van Eemeren – Rob Grootendorst: “*Logic and argumentacion*”, Amsterdam, SICSAT, kapitulli 4, 1996.

⁶⁰ Oswald Ducrot: “*La preuve et le dire*”, Paris: Mame, J.P. Delarge, 1973; “*Les mots du discours*”, Paris: Minuit, 1980; “*Logique, structure et énonciation*”, Editions de Minuit, Paris, 1989; Ducrot, O. – J.-M. Schaeffer: “*Nouveau dictionnaire encyclopédique des sciences du langage*”, Paris: Seuil, 1995.

⁶¹ Jean-Claude Anscombe – Oswald Ducrot: “*L’argumentation dans la lingua*”, Bruxelles: Mardaga, 1983.

⁶² Me arsyetimin joformal merret logjika informale, e cila i ka fillimet e veta si një disiplinë në vitet ’60 të shek. XX. Nuk është një lloj i ri i logjikës, por është thjesht një përjasje në studimin normativ të argumentimit në gjuhën e përditshme, çka është më e përafërt me praktikën e argumentimit se logjika formale. Është një përpjekje zhvillimi e logjikës për të analizuar, vlerësuar dhe përmirësuar arsyetimin në gjuhën e përditshme. Pjesa më e madhe e studimeve në këtë fushë ka të bëjë me arsyetimin dhe argumentin dhe kryesisht në marrëdhënien midis premisave dhe përfundimeve në argumente. Një premisë është shpesh diçka që folësi dhe dëgjuesi bien dakord për të. Kur Enoja thotë: “*Ne dimë që...*” ai është duke ndërtuar një fjali. Ai do të thotë diçka për të cilën ne biem dakord, me synimin që të na bëjë të biem dakord edhe për

krijojnë një lloj efekti mbi auditorin, sesa për mjetet gjuhësore që i disponon subjekti folës, përgjatë arritjes së objektivave argumentuese që i ka vënë vetes në ligjëratën e tij⁶³.

4. Jacques Moeschler⁶⁴ dhe Eddy Roulet⁶⁵. Punimet e këtyre autorëve synojnë futjen e një metode analize hierarkike, funksionale dhe argumentuese të ligjërimin. Korniza e analizës së propozuar është ajo e pragmatikës gjuhësore, që shtron si hipotezë se kuptimet e thënieve përmbahen në vlerën e tyre si veprim. Kësaj i shtohet hipoteza se kuptimi ka natyrë argumentuese, se thëniet shërbejnë si argumente për përfundime nganjëherë të nënkuptuara. Produkti i këtyre orientimeve të reja është rivlerësimi që i bëjnë pasurisë antike si dhe retorikës së Aristotelit, vetë autorët e sipërpërmendur.

pjesën tjetër. Një premisë shërben si një bazë për diçka më shumë. Është pak a shumë situata kur ne themi: *"Po, dhe pastaj...?"* me qëllim që t'i tregojmë dikujt të na thotë se cili ishte konkluzioni nga ajo që sapo na u tha. Fjalët *"ndërsa"* ose *"qëkurse"* janë çelësa që na shërbejnë për të përkapur diçka që shërben si premisë për një konkluzion të ardhshëm.

Premisat e një argumenti duhet të plotësojnë tri kritere: 1. lidhjen kuptimore 2. mjaftueshmërinë 3. pranueshmërinë. Në rastin "e lidhjes kuptimore" çështja është nëse ka apo jo një lidhje të mjaftueshme (thelbësore) midis premisë dhe përfundimit të një argumenti; në rastin "e mjaftueshmërisë" çështja është nëse premisat na japin material të mjaftueshëm për përfundimin; në rastin "e pranueshmërisë" çështja është nëse premisat janë vetë të vërteta ose jo, të mundshme ose në një mënyrë tjetër të besueshme. Asnjë nga këto tri kritere nuk është e përcaktuar qartazi. Logjika informale nuk është ende një teori e mirëzhvilluar e argumentimit. Është më shumë një përfaqje në argumentim, pasi akoma është në një fazë të hershme programuese. Në këtë linjë logjika informale karakterizohet përgjithësisht nga hipoteza (të cilat mund të mos jenë të vërteta), besime të paqarta (si besimi në fat), mosmarrëveshje të forta në lidhje me atë që është e vërtetë dhe e gabuar, me pohime etike dhe estetike (të cilat rrallëherë mund të klasifikohen botërisht si të vërteta apo të gabuara), etj.

⁶³ Si ilustrim për çka po themi, demonstroi është figura e princit Lev Nikollajeviq Mishkini te vepra e Fjodor Dostojevski: *"Idioti"*: *"Të habiste me vëmendjen tepër të përqendruar deri në naivitet, me të cilën ndiqte çdo bisedë që i interesonte. Edhe përgjigjet që jepte, kur e pyesnin, po ashtu të habisnin. Tërë genia e tij, madje dhe pozicioni i trupit, e shprehnin këtë naivitet, këtë besim të verbër, ku përjashtoj çdo mundësi për nënqeshje apo ironi."*, shtëpia botuese "Uegen", Tiranë, 2000, fq. 310.

⁶⁴ Jacques Moeschler: *"Argumentation et Conversation – Eléments pour une analyse pragmatique du discours"*, Paris: Hatier - Crédif; Coll.: *"Langues et apprentissage des langues"*, 1985.

⁶⁵ Eddy Roulet: *"L'articulation du discours en français contemporain"*, Berne: Peter Lang, 1985.

5. Në vijim përmendim punimet e autorëve të tjerë bashkëkohorë si: në Holandë - **Antoine Braet**⁶⁶ (1985); në Francë - **Olivier Reboul**⁶⁷ (1988); në Gjermani - **Josef Kopperschmidt**⁶⁸ (1989); në Austri - **Manfred Kienpointner**⁶⁹ (1991). Në vitet pasuese në Gjermani - **Frans van Eemeren** dhe **Rob Grootendorst**⁷⁰ (1996); në Holandë - **Frans van Eemeren** dhe **Peter Houtlosser**⁷¹ (1999) etj.

Meqë punimet e Stephen Toulmin-it dhe të Perelman-it/Olbrechts-Tyteca-s u morën si modele dhe shërbyen si piketat kryesore në përdhësimin e mëtejshëm të *Teorisë së argumentimit*, po ndalemi përmbledhtazi më poshtë.

2.2.1. Skema e argumentit sipas Stephen Toulmin-it

Studimet bashkëkohore të retorikës në gjuhësi, tregojnë se modeli i propozuar nga filozofi britanik **Stephen Toulmin-it** në veprën e tij: *“Përdorimet e argumentit”* (*“The Uses of Argument”*)⁷² është thujtë i njëjtë me atë të një ligjërimi klasik retorik, sa i përket etapave të zhvillimit të vet. Konkretisht, nëse shqyrtojmë punimin, vërejmë se paraqitja e skemës së elementeve pjesëmarrëse në një ligjërim argumentues merr parasysh pesë etapat zhvilluese, sikurse i kemi trajtuar (shih tabelën nr. 1, fq. 25): *hyrja, deklarimi i fakteve, ndarja, prova, rrëzimi, konkluzioni*. Sipas Toulmin-it, *“Skema e argumentit”* paraqitet si më poshtë:

⁶⁶ Antoine Braet: *“De klassieke statusleer in modern perspectief”*, Groningen: Wolters - Noordhoff, 1984.

⁶⁷ Olivier Reboul: *“Can there be non - rhetorical argumentation?”* te *“Philosophy and Rhetoric 21”*, nr. 3, 1988, fq. 220 – 223; si dhe *“Rhetorique et dialectique chez Aristote”*, tek *“Argumentation 4”*, nr. 1, 1990, fq. 35 – 52.

⁶⁸ Josef Kopperschmidt: *“Methodik der Argumentationsanalyse”*, Stuttgart: Fromann - Holzboog, 1989.

⁶⁹ Manfred Kienpointner: *“Rhetoric and argumentation - relativism and beyond”*, te *“Philosophy and Rhetoric 24”*, nr. 1, 1991, fq. 43 – 53.


⁷⁰ Frans van Eemeren – Rob Grootendorst: *“Logic and argumentation”*, vep. e cituar.

⁷¹ Frans van Eemeren – Peter Houtlosser: *“Strategic manoeuvring in argumentative discourse”*, te *“Discourse Studies 1”*, nr. 4, 1999, fq. 479 – 497.

⁷² Stephen Edelston Toulmin: *“The uses of argument”*, vep. e cit., fq. 98.

Tabela nr. 2

FAZAT	SHPJEGIMET
Pretendimi, pohimi (claim)	Formulimi i bërë
Paraqitja e të dhënave (grounds)	Çka përdoret si baza e pretendimit.
Përcaktuesi (qualifier)	Përdorimi i fjalëve dhe i shprehjeve të caktuara për të bërë diçka të besueshme.
Garancia (warrant)	Një e dhënë tjetër, e cila përdoret për të lidhur të dhënat me pretendimin.
Mbështetja (backing)	Ky mund të jetë informacion shtesë, i cili mbështet pretendimin.
Kundërshtimi (rebuttal)	Shpesh pretendimet mund të mos mbështeten e si pasojë sjellin një kundërshtim.



Ja si i shtjellon Toulmin-i të gjitha këto elemente:

1. Pretendimi, pohimi

Një pretendim është një formulim, me anën e të cilit ne u kërkojmë të tjerëve që të na pranojnë. P.sh., nëse një person përpiqet të bindë dëgjuesin se ai është me shtetësi britanike, pohimi do të jetë i tipit:

Unë kam nënshtetësi britanike. (1)

Pretendimi përfshin informacion ku u kërkojmë të tjerëve ta pranojnë si të vërtetë ose veprime që të jenë të pranuara dhe të mirëqena. Në njëfarë kuptimi, kur ne ngremë një pretendim (pohojmë diçka), ne përcaktojmë përmes fjalëve kufij të e zonës sonë në botën që na rrethon, ndaj thuhet që pretendimet (pohimet) në vetvete janë njësi të kuptimit apo të njohurive. Sa herë themi diçka, dëgjojmë apo lexojmë pohime të ndryshme, ndërtojmë një kuptim të tyre. Pra, kur angazhohemi në reflektime të arsyetuara për thëniet e ndryshme, këtë e bëjmë mbi bazat e kuptimit apo të kuptimeve që kemi ndërtuar. Si njësi mendimi, thënia mund të jetë një pohim, një gjykim, një zgjidhje dileme apo një deklaratë besimi.

Pretendimi është përfundimi i një argumenti. Përfundimet e nxjerra duhet të jenë të themelta. P.sh., në fjalinë:

Ti duhet të përdorësh një ndihmës dëgjimor. (1)

në pamje të parë duket fillimisht thjesht një pohim, por më pas zbulojmë se ky pohim është nxitës drejt një dyshimi të mundshëm.

Nëse dikush na kërkon të bëjmë diçka, ne nuk do të biem dakord thjesht vetëm e vetëm se do ai. Ne sigurisht do ta pyesim përse duhet të biem dakord me të, e për rrjedhojë ne do të kërkojmë të provojmë pretendimin e tij. Këtu fill vjen e futet në lojë elementi i dytë – faktet, të dhënat.

2. Faktet, të dhënat

Të dhënat janë baza e besimit të vërtetë dhe ky i fundit përbëhet nga të dhëna e fakte të forta, të cilat na shërbejnë për të pohuar dhe mbështetur diçka. Të dhënat na dëshmojnë të vërtetën, mbi të cilën është bazuar një pohim. Kështu, personi që prezantohet më lart mund ta mbështesë pohimin e tij me të dhënën mbështetëse:

Kam lindur në Bermuda. (2)

apo shembulli tjetër forcohet me faktin:

Mbi 70% e njerëzve mbi 65 vjeç, kanë vështirësi dëgjimi. (2)

Faktet, të dhënat, janë një element shumë i fuqishëm i bindjes, ndonëse efekti është i ndryshëm në njerëz të ndryshëm. Ata që janë dogmatikë⁷³, logjikë, racionalë, do të preferonin të bindeshin më tepër nga të dhënat.

⁷³ Sqarim: Njerëzit që bien në dogmatizëm. Sipas FSHS-së: **DOGMATIZËM** – pikëpamje, ide, koncept, doktrinë etj., që merret si një e vërtetë e

Ndërsa të tjerët, ata që argumentojnë emocionalisht, ose do të dyshojnë, ose do t'i injorojnë këto fakte. Kështu, disa i pranojnë menjëherë, disa të tjerë do t'i hyjnë më thellësisht, duke kërkuar më tepër shpjegime. Në këtë pikë hyn elementi tjetër: përligjja, garancia.

3. Përligjja, garancia

Përligjja drejton lëvizjen tonë nga e dhëna në pohim, duke legjitimuar pohimin përmes ekspozimit të këtyre të dhënave. Garancia mund të jetë eksplicite ose implicite. Në fjalitë e mësipërme ky element i përgjigjet pyetjeve:

- (1) *Përse personi thekson vendin Bermuda?* dhe
 (2) *Përse e dhëna e mësipërme tregon që kjo gjë është e vërtetë?*

Në pohimin (1) personi duhet të sigurojë një lloj garancie për të lidhur boshllëkun ndërmjet:

- (1) *Unë kam nënshtetësi britanike.* dhe
 (2) *Kam lindur në Bermuda.*

me përcaktimin:

Një njeri i lindur në Bermuda, do të jetë zyrtarisht me nënshtetësi britanike. (3)

ose përligjja në shembullin tjetër do të ishte:

Një ndihmës dëgjimor i ndihmon më shumë njerëzit për të dëgjuar më mirë. (3)

4. Mbështetja

Elementet mbështetëse janë të paracaktuara të garantojnë përcaktimin e shprehur në përligje. Mbështetja e një argumenti i jep mbështetje plotësuese garancisë (në rastin kur kjo nuk është mjaftueshëm bindëse për lexuesin apo dëgjuesin), duke iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme. P.sh., nëse dëgjuesi nuk e shikon përligjen te pohimi (3) si të

besueshme, folësi do të ofrojë dispozita ligjore si deklaratë mbështetëse për të treguar se është e vërtetë që:

Një njeri i lindur në Bermuda do të jetë ligjërish me nënshtetësi britanike.
(4)

apo informacion shtesë të tipit:

Ndihmësit dëgjimorë gjenden në vende të caktuara. (4)

5. Kundërshtimi

Përcaktimet njohin frenime me anë të të cilave shprehet një pohim, ose e thënë ndryshe kemi përjashtime të pohimeve të bëra, - kundërshembuj dhe kundërarargumente. Kundërshtimi ilustron si në vijim:

Një njeri i lindur në Bermuda do të jetë zyrtarisht me kombësi britanike, veç në mos ai ka tradhtuar Britaninë dhe është bërë spiun i një vendi tjetër. (5)

apo:

Ekziston një departament që merret me problemet teknike.

Çdo kundërshtim është një argument në vetvete e si i tillë mund të përfshijë një pretendim, garanci, mbështetje e kështu me radhë. Dhe vetë ky njëherazi mund të kundërshtohet. Kështu që nëse ne parashtrijmë një argument, mund të përballemi me të dyja kundërshtimet e mundshme (kundërshti e kundërshtimit).

6. Përcaktuesi

Fjalët ose shprehjet përcaktuese shprehin shkallën e forcës ose të sigurisë së folësit lidhur me pohimin. Të tilla janë fjalët ose shprehjet: "ndoshta", "mundet", "e pamundur", "domosdoshmërisht", "sigurisht".
Thënia:

Unë sigurisht që jam me nënshtetësi britanike.

ka një shkallë më të lartë force, sesa pohimi:

Unë me sa duket jam me nënshtetësi britanike.

Apo në rastin e thënies së dytë do të kishim:

Unë sigurisht që dëgjoj më mirë me ndihmësin dëgjimor.

Sipas Toulmin-it kjo skemë është gjithmonë e njëjtë në çdo lloj argumentimi. Kështu, hapat që merren - të prezantuara në model - janë gjithmonë të njëjtët. Mbështetja që kërkohet është thjesht “e varur nga fusha”. Kjo do të thotë që një justifikim etik për shembull, kërkon një lloj tjetër mbështetje – atë të justifikimit ligjor.

2.2.2. Teoria e argumentimit sipas Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s

Zhvillimet e fundit të vërejtura në punën e **Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s**⁷⁴ (1958), ashtu sikurse te retorika aristoteliane, konsistojnë në çështje të lidhura me situatën. Për sa i përket specifikisht argumentimit, sintaksa e argumenteve nuk mund të shkëputet arbitrarisht nga kushtet e prodhimit të ligjërit.

Organizimi i argumentimit i shpie auditorit një hipotezë. Në këtë mënyrë Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca dallojnë statuse të ndryshme në premisat, të cilave u referohet argumentimi. Duke ndërtuar një listë të tillë elementesh, Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca vlerësojnë faktin që lokutori, për të ndërtuar argumentimin e tij, nisat nga një bazë, nga një lloj pakti, marrëveshje, të cilën e supozon të përbashkët me auditorin. Këto elemente shërbejnë si pikënisje ose si skema argumenti për ndërtimin e argumentimit. Me ndihmën e një skeme të tillë argumenti “gati-logjike”, e cila i ngjan një forme argumenti logjikisht të vlefshme në njëfarë mënyre, dikush për shembull mund të arrijë ndonjëherë efektin, sipas të cilit publiku e konsideron pikëpamjen të mbrojtur në një mënyrë të arsyeshme. P.sh.: *Klubi i futbollit mendohet se respekton disa rregullore dhe për pasojë anëtarët e tij janë po ashtu të përkushtuar ndaj kësaj rregulloreje.*

Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca propozuan skemën si më poshtë:

⁷⁴ Chaim Perelman – Lucie Olbrechts-Tyteca: “*La nouvelle rhétorique: Traité de l’argumentation*”, vep. e cituar.

Tabela nr. 3

Faktet	Janë objekte universale të njohura nga auditori. Për Perelmanin, nuk ka asnjë kriter të na lejojë në çdo rrethanë dhe pavarësisht nga qëndrimi i dëgjuesve, që të afirmojë se diçka është një fakt.
Të vërtetat	Sisteme më komplekse që kanë të bëjnë me lidhjen midis fakteve. (teoritë fetare etj.)
Supozimet	Gjëra të pranuar nga auditori, afërsisht të lidhura me normalen, me të vërtetat, por të cilave duhet t'u përforcojmë vlefshmërinë.
Vlerat	Objekt, qenie ideale, të cilat ne i përdorim për të nxitur veprimin.
Hierarkitë e vlerave	Hierarki të njohura mes vlerash (p.sh., njeriu është superior ndaj kafshës.)
Topos-i	Premisa shumë të përgjithshme, rubrika bosh, modele për të prodhuar argumente konkrete për ligjërime të përcaktuara. (p.sh.: "topos i sasisë": diçka vlen më shumë se një tjetër për arsye sasiore, "topos i cilësisë" që i kundërvihet të parit: diçka vlen më shumë se një tjetër për arsye cilësore etj., si këto).

Merita që ka skema e sipërpërmendur është se e sheh argumentimin të pandashëm me situatën e aktit kumtues, çka do të thotë nga statusi i lokutorit dhe i auditorit, por gjithashtu nuk është ndarje as nga besimet e këtij auditori, nga vlerat në përdorim në komunitetin në fjalë etj. Sipas Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s, termi *topos* (i përdorur dikur nga Aristoteli) iu referohet kategorive të mendimit që përdoren si tregues konvencionalë, me qëllim që të gjenden ide për material gjuhësor në diskutimin rreth një çështjeje; pra argumenteve të përgjithshme dhe të veçanta që përdor folësi për të bindur një audiencë⁷⁵. Sipas Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s, *topos* kanë tendencën të ngurtësohen, pra të prodhojnë të

⁷⁵ Sharon Crowley: "Fjala 'topos' fillimisht përdorej me kuptimin e mirëfilltë "vend". Listat e temave shkruheshin fillimisht në papirus dhe njerëzit që kërkonin të gjenin një temë specifike shpalosnin papiruset derisa arrinin të vendi i caktuar në rrotullën e papirusit ku vetë kjo temë ishte renditur. Më vonë, ky kuptim i mirëfilltë ('topos') u përdor dhe konceptualisht, për të shprehur një bazë intelektuale ose fushë që mbartte prova, të cilat mund të paraqiteshin në çfarëdo ligjëratë ku ishte e përshtatshme. Akoma më vonë, ky term i referohet strategjive krijuese formale ose strukturore si: përkufizim, ndarje ose klasifikim". (Shih: Sharon Crowley: "Ancient rhetorics for contemporary students", vep. e cit., fq. 49).

njëjtat përmbajtje. Këto vende të përbashkëta variojnë në funksion të epokave, të auditorëve, të tipit të ligjërimeve etj.

Sipas këtyre autorëve, *topos* mund të jetë i llojit:

- a. elementi i tretë është i përjashtuar. P.sh.,: Porta mund të jetë ose (gjysmë) e hapur, ose e (gjysmë) mbyllur. Mundësi tjetër të tretë nuk ka;
- b. lidhja midis veprimit dhe personit. P.sh.,: Ai që vret është vrasës;
- c. lidhja midis asaj që ka ndodhur më parë dhe asaj që pason. P.sh., mund të kemi një situatë të tillë: Një vrasës ka kryer krimin e për arsye rastësie apo ngjashmërie fajësohet dikush tjetër;
- d. lidhja e së tërës me pjesën apo e grupit me individin. P.sh.,: Nuk ngrihet shtëpia nëse nuk kemi arkitrarë, dysheme, tavan, mure mbrojtëse etj.;
- e. lidhja e të pandashmeve. P.sh.,: Nuk bëjmë omëletë pa thyer vezë etj.;

Sipas Perelman-it dhe Olbrechts-Tyteca-s të mësipërmet (*topos*) na sigurojnë njëfarë të vërtetë.

Përmbledhtazi, duke iu referuar të dyja modeleve të mësipërme vërejmë:

1. Sikurse Toulmin-i, edhe Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca injoruan rolin që zë logjika në procesin e argumentimit, kur në fakt këto lloj njohurish janë më se të domosdoshme në një ligjërimit argumentues.

2. Ndonëse Toulmin-i u përqendrua tek argumentet e izoluar të arsytimit, ndërsa Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca morën parasysh aspektin kontekstual të prodhimit të ligjërimit, prapëseprapë të dy palët lanë pa trajtuar aspekte të tjera pragmatike e kontekstuale, mjaft të rëndësishme në të kuptuarit e çdo ligjërime.

Megjithatë, pavarësisht të metave, prapëseprapë punimet e Toulmin-it si dhe të Perelman-it/Olbrechts -Tyteca-s shërbejnë si:

1. pikë referimi për skemën argumentuese në tërësi.
2. udhërrëfyese për shumë studiues që zhvilluan më tej *Teorinë e argumentimit në gjuhësi*.

2.3. *Topos-i* sipas Retorikës së re. Karakteri konvencional

Të punosh mbi argumentimin, nuk kërkon nga gjuhëtari të inventarizojë tërësinë e lidhjeve argumentuese që përbëjnë thellësinë e vetëdijes “ideologjike” mbi të cilin lidhet aktiviteti argumentues. Përkundrazi, ka të bëjë më shumë se kaq. Ai duhet të përqendrojë vëmendjen e tij te struktura e mekanizmit interpretues (tek ajo që autorët Perelman dhe Olbrechts-Tyteca e përfshinë nën termin *topos*), te lidhjet që mbajnë

argumentet me shenjat e ndryshme argumentuese, te mjetet e ndryshme që folësi vë në përdorim për të orientuar bisedën e tij drejt një argumenti, pra, me një fjalë, te gjithë mënyrat e ndryshme të realizimit të aktit të argumentimit. *Topos-i* na çon në përfundime joekzakte, por të ngjashme, ose siç thotë Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca në "*konkluzione pothuajse logjike*".⁷⁶ Më shumë se rregull, *topos-i* dallohet si nga silogjizmi, ashtu dhe nga rregulla të deduksionit natyror. Të dyja këto të fundit u paraqesin kushte arsyetimeve logjike. Le të bëjmë dallimet përmes pohimeve të mëposhtme:

1. Kjo makinë është e lirë. Ndaj duhet ta blejmë.

2. Edhe nëse bie shi do të shkojmë në kinema. (= Edhe pse me shi, ne do të shkojmë në kinema – deduksion natyror.

3. Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm.

Sokrati është njeri.

Sokrati është i vdekshëm. – Silogjizëm⁷⁷

Dukshëm vërehet se logjikisht, ndërhyrjet janë të vlefshme në pohimin e dytë dhe të tretë. Përkundrazi, askujt nuk i vjen nëpër mend ideja se, nëse shprehemi: *Kjo veturë është e lirë*, - duhet që medoemos ta blejmë. T'i atribuosh *topos-it* një statut rregullash të përgjithshme, nuk do të thotë se ka një karakter të detyruar. Pra, mesa shohim *topos-i* argumentues jo vetëm që nuk duhet të ngatërrohet me premisat e një silogjizmi apo deduksioni, por njëherazi në vetvete mbart edhe konvencionalitetet. Sipas **Ducrot-it** veçoria esenciale e *topos-it* është karakteri i tij gradual.⁷⁸ Një *topos* do të ishte atëherë një lidhje midis objekteve (O) dhe predikateve (P) në formë gjeneruese:

Shumë Pak	{	O është P	}		Shumë Pak	{	O' është P'	}
--------------	---	-----------	---	--	--------------	---	-------------	---

Ducrot-i vendos një korrespondencë mes dy vijave argumentuese {P dhe P'}.

Nëse marrim shembullin e mësipërm:

⁷⁶ Chaim Perelman – Lucie Olbrechts-Tyteca: "*La nouvelle rhétorique: Traité de l'argumentation*", vep. e cituar.

⁷⁷ Silogjizëm – një formë e arsyetimit deduktiv që përbëhet nga një fjali kryesore, një fjali me më pak peshë se kryesorja dhe një përfundim.

⁷⁸ Oswald Ducrot: "*Les mots du discours*", vep. e cituar.

Kjo makinë është me çmim të arsyeshëm, ndaj duhet ta blejmë.

përfundimi i aktit argumentues, ose më saktë, interpretimi që bëjmë për këtë akt argumentimi: “Sa më shumë një makinë është e lirë, aq më shumë duhet blerë” është dhënë automatikisht nga një *topos*.

Për ta bërë më të qartë rolin dhe rëndësinë e *topos-it* në tekstin argumentues, po marrim dhe një shembull tjetër:

Kemi thënien:

Eri është shumë e edukuar.

Vlera argumentuese në thënien e mësipërme, përcaktohet nga operatori e edukuar, që përkufizon një cilësi pozitive, i shprehur ky operator me mbiemër në shkallë sipërore. Përderisa ky operator shenjon një cilësi pozitive, atëherë edhe shenja (aksiologjike) do të jetë pozitive (+). Fakti që operatori e edukuar orienton thënien drejt një konkluzioni pozitiv, do të thotë se:

1. ky operator ka vlerë aksiologjike pozitive;
 2. e vendos thënien në shkallën më të lartë të kategorisë së mirësjelljes.
- Kështu, vetë shkalla përforcon vlerën argumentuese të ligjëratës. Konkretisht:

Eri është shumë e edukuar.

përbën një argument më të fortë se:

Eri është e edukuar.


apo:

Eri është disi e edukuar.

apo:

Eri është pak e edukuar.

Nga ana tjetër mbiemri shumë e edukuar kundërshton në brendësi të kësaj paradigme, përmbajtjet “e edukuar” “pak e edukuar”, “aspak e edukuar” etj., duke i dhënë kështu drejtim krejt të kundërt e në sens negativ kategorisë së mirësjelljes. Rrjedhimisht shenja aksiologjike do të jetë (-), ashtu sikurse shkalla më poshtë e tregon:



Dukshëm vërehet ndikimi në anën semantike dhe argumentuese në thënie, i vetë ndajfoljes që shoqëron mbiemrin e që s'është tjetër veçse konektor.

Si përfundim mund të themi se, argumentimi si një akt i finalizuar, realizohet jo vetëm falë paraqitjes së argumenteve nga ana a lokutorit, por edhe falë prezencës së një serie strukturash argumentuese, sipas një rregulli të caktuar. Kjo nënkupton skemën se nëse fillimisht kemi një “nëse” (konektor logjik) në ligjërime, atëherë ky domosdoshmërisht do të pasohet nga një “atëherë” (konektor argumentues), çka lidhet me konkluzionin e vetë argumentit. Mesa shihet “*topos-i hyn në marrëdhënie me shenjat argumentuese, konektorët*”⁷⁹, duke mundësuar kështu ecurinë e argumentimit dhe të shpënë e tij drejt një konkluzioni.

⁷⁹ Jacques Moeschler: “*Argumentation et Conversation – Eléments pour une analyse pragmatique du discours*”, vep. e cit., fq. 187.

KREU III

LIGJËRIMI ARGUMENTUES. LLOJET DHE TIPARET E TIJ

3.1. Format e shprehjes së ligjërimit argumentues

Ligjërimi argumentues si një pjesë e ligjërimit njerëzor në tërësi mund të jetë i formës verbale, të shkruar, joverbale, i realizuar përmes dy trajtave:

a. dialog

b. monolog

a. Dialogu. Ky është tipi i komunikimit me shkëmbim dhe përfshin zakonisht një kuptim dhe një rezultat për t'u informuar apo për t'u përballur për diçka. Këtu hyjnë llojet e diskutimeve të ndryshme mes palëve komunikuese.

b. Monologu. Njerëzit shpesh dëshirojnë të komunikojnë edhe me vetveten. Kjo është forma e ligjërimit përsiatës.

Në ligjërimin argumentues monologues, ndryshe nga ai dialogues, kemi praninë e vetëm një pjesëmarrësi. Por, nga ana tjetër, asgjë nuk pengon që një ligjëratë monologuese të bëhet dialoguese (si në rastin e ligjëratës polemizuese).

3.1.1. Forma verbale

Ligjërimet argumentuese gojore mund të jenë të formës:

a. bashkëbisedim

b. diskutim

c. fjalim publik

Ky shkëmbim gjuhësor realizohet mes dy palësh, por njëherazi gjen përdorimin e vet edhe në komunikimin në grup.

a. Bashkëbisedimi. Është forma e komunikimit të shoqërizuar dhe realizohet në një situatë shkëmbimi gjuhësor mes dy a më shumë interlokutorëve, për një çështje. Mund të realizohet në afërsi ose në distancë. Ndërmjet emetuesit dhe marrësit realizohet dukuria e *feedbackut* vetëm nëse marrësi është afër dhe i pranishëm, çka nuk ndodh kur po ky marrës nuk e ka mundësinë të marrë rolin e emetuesit dhe të përgjigjet. Këtu bëhet fjalë për rastet e komunikimeve zyrtare në distancë, në të cilat marrësi nuk është i pranishëm dhe është larg. Rrjedhimisht, mesazhi shpërndahet dhe kërkon një përpjekje qartësie dhe përshtatjeje nga ana e emetuesit.

b. Diskutimi. Çdo gojëtar që të arrinte efektshmërinë e duhur në fjalimin e tij, duhej të mirëharmonizonte pesë teknikat bazë klasike: *inventio, dispositio, elocutio, memoria, actio*, të cilat janë të domosdoshme edhe në ditët e sotme, pavarësisht nga lloji i fjalimit. Moszbatimi i tyre sjell nivel të ulët të ligjërimit e madje dhe të papranueshëm nga ana e auditorit. Ky moszbatim vjen si rezultat i një sërë faktorëve. Sipas akademikut **Rexhep Qosja**: *“Nuk mund të flasë siç duhet një njeri që s’ka njohuri dhe kulturë të përgjithshme shpirtërorë, që s’ka menduar përpara sa duhet rreth asaj për të cilën do të flasë, që nuk i beson asaj që thotë, që nuk njeh fare problemin mbi të cilin do të diskutojë, që nuk mendon së çfarë bindje do të ketë auditori mbas diskutimit të tij, që nuk njeh rolin e elokuencës, funksionin dhe efektin e saj, që nuk e njeh si duhet gjuhën në të cilën flet.”*⁸⁰

Në retorikën klasike çdo orator synonte të fliste bukur e në mënyrë bindëse përpara auditorit të tij. Sipas retorikës moderne, argumentimi nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me këtë. Procesi i argumentimit është një proces i ndërlikuar ku marrin pjesë shumësi faktorësh, ndaj le të bëjmë të qartë cilat janë dallimet midis këtyre dy ligjërimeve. Konkretisht:

1. Gjatë procesit të diskutimit, interlokutorët shqetësohen vetëm për të bërë të njohur apo për të provuar të gjitha argumentet pro e kundër të përcaktuara në një tezë. Ndërsa gjatë procesit të argumentimit bashkëbiseduesit kanë për qëllim të mbrojnë një qëllim të caktuar. Këtu secili bashkëbisedues kërkon të mbrojë tezën e vet dhe nuk shqetësohet për argumentet që nuk janë në favor të tij.

2. Diskutimi na paraqitet si një kërkim i sinqertë i vetvetes, ndërkohë kur në debatin argumentues shqetësohemi që teza jonë të triumfojë. Ai që mbron një këndvështrim të caktuar është i bindur që bëhet fjalë për një tezë që është objektivisht më e mira dhe triumfi i tij është për një kauzë të drejtë. P.sh., në një proces gjyqësor avokati i çdo pale synon më shumë të qartësojë, sesa të zhvillojë argumente në favor të tezës, pra, e thënë me fjalë të tjera, nuk qartëson, por argumenton. Apo në rastin e dikujt që ka pranuar të mbrojë një kandidaturë përpara një komisioni të caktuar - dialogu që ai do të zhvillojë me anëtarët e komisionit do të jetë më tepër i një natyre bindëse, sesa një kërkim i së vërtetës.

3. Diskutimi na çon drejt një qëllimi final të një përfundimi të pashmangshëm dhe unanimisht të pranuar. Ndërsa në procesin e argumentimit palët mund të mos bien dakord deri në fund, dhe për rrjedhojë kemi një fund pa fund, pra, secila palë mbron tezën e vet deri në fund.

Nga ana tjetër, tradicionalisht *argumentimi* është vënë në opozitë me *demonstrimin*. Konkretisht:

⁸⁰ Rexhep Qosja: “Gojëtaria ose Muza e harruar” te “*Panteoni i rralluar*”, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988, fq. 649.

1. Demonstrimi supozon përpjekje që ka për qëllim të provojë të vërtetën e një propozicioni,⁸¹ duke u nisur nga premisa⁸² të vërteta a të mundshme ose aksioma⁸³. Ndërsa arsyetimet argumentuese bazohen mbi të vërteta jopersonale, mbi opinione që kanë të bëjnë me teza të të gjitha llojeve. Kështu, fusha e aplikimit të teorisë së argumentimit gjen terren më të gjerë, sesa ajo e teorisë së demonstrimit.

2. Demonstrimi është i lidhur me ndërtimin e ligjërimit formal. Ndërsa argumentimi ushtrohet në gjuhën natyrore dhe integron tërësinë e burimeve që mund të shfrytëzohen për të mbrojtur një tezë të ngjashme; argumenti përbën një nivel analize të privilegjuar, por që nuk mund të jetë i

⁸¹ Sipas "Fjalorit të Termave Gramatikore dhe atyre të Retorikës" (shih nyjen: Glossary of Grammatical and Rhetorical Terms): termi "*proposition*" ka kuptimin: 1. propozim, sugjerim, pohim. (në aspektin retorik); 2. deklarata e subjektit të një argumenti ose një ligjërimi, ose ideja thelbësore që duhet mbrojtur (në aspektin logjik); 3. një deklaratë që pohon ose mohon diçka e që është ose e vërtetë ose e rremë (në aspektin filozofik).

Në logjikë dhe filozofi, propozicioni i referohet ose a) brendisë a kuptimit të një fjalie deklaruese kuptimplotë, ose b) modelit të simboleve, shenjave a tingujve që e bëjnë një fjali deklaruese kuptimplotë. Propozicionet në secilin rast janë formuluar të jenë drejt së vërtetës, çka do të thotë, ato janë ose të vërteta ose të rreme. Dy fjali - model deklaruese kuptimplota shprehin të njëjtin propozicion, vetëm nëse ato kumtojnë të njëjtën gjë. Përkufizimi i mësipërm, na çon në mendimin që dy fjali të cilat kanë të njëjtin kuptim dhe shprehin të njëjtin propozicion, mund të kenë vlera vërtetësie të ndryshme, p.sh.: "*Unë jam Tani*" e thënë nga vetë Tani dhe e thënë nga dikush tjetër; apo: "*Sot është e mërkurë*" - e thënë si të mërkurën, si të enjten.

Logjika aristoteliane e identifikon një propozicion si një fjali, që pohon ose mohon kallëzuesin e kryefjalës. Një propozicion aristotelian mund të jetë: "*Njerëzit janë të vdekshëm.*" ose "*Sokrati është njeri.*" Në shembullin e parë kryefjala është "*Njerëzit*" dhe kallëzuesi është "*janë të vdekshëm.*" Në fjalinë e dytë kryefjala është "*Sokrati*" dhe kallëzuesi është "*Është njeri.*" Shembulli i dytë është një element atomik në logjikën propozicionale. Shembulli i parë është një deklaratë në logjikën rrëfyese. Propozicioni i përbërë: "*Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm dhe Sokrati është njeri.*" bashkon dy propozicione të veçanta, dhe konsiderohet e vërtetë vetëm e vetëm nëse të dyja pjesët janë të vërteta.

⁸² Sipas Christian Baylon – Xavier Mignot: "*Ka vend për një dallim ndërmjet premisë dhe presupozimit.* Dhe këtu merr si shembull: "*Kështu thënia: Zhani pi pak verë*" nënkupton që Zhani ka pirë verë dhe si premisë kemi që sasia ka qenë e vogël. Ndryshe e kemi te "*Zhani ka pirë pak verë*", në të cilën ndodh anasjelltas: presupozohet sasia e vogël dhe kemi si premisë gëlltitjen e verës." (Shih: "*Komunikimi*", me autorë Christian Baylon – Xavier Mignot, përkthyer nga Xhevat Lloshi, Logos - A, Shkup, 2007, fq. 113).

⁸³ Aksiomë – shprehje evidente në vetvete. Në logjikën aristoteliane parimet e përgjithshme, të quajtura aksioma, janë të vërteta që s'kanë nevojë të argumentohen dhe që shërbejnë për vërtetimin e tezave të tjera. Për shembull "e tëra është më e madhe se pjesa". (Didie Zhylia: "*Fjalor i filozofisë*", vep. e cit., fq. 15).

shkëputur nga funksionimi global i ligjëratis. *Një silogjizëm* p.sh., nuk ka të njëjtin status në një mesazh publicitar nga njëra anë dhe në një thënie të filozofisë mesjetare nga ana tjetër. Pra, me fjalë të tjera, sintaksa e argumenteve nuk mund të shkëputet arbitrarisht nga kushtet e prodhimit të ligjërimit, çka Aristoteli e pohonte: *“Funksioni i retorikës është trajtimi i subjekteve përpara dëgjuesve të cilët nuk e kanë aftësinë që të nxjerrin konkluzione nga shkallë të shumta dhe të ndjekin një arsyetim nga një pikë e largët”*.⁸⁴ Po kështu D. Maingueneau-ja shprehet: *“Një argumentim është gjithmonë “në situatë” çka “bën të ndërhyjë aktiviteti i subjektit dhe ai i auditorit edhe në ndërtimin e ligjëratis”; “të jesh në situatë” për ligjërimin do të thotë që lokutori integron në thënieën e tij jo vetëm disa përbërës të elementeve të situatës që atij i duken të nevojshme të përmendë si premisa, por gjithashtu trajton në formën e përfutimit të presupozuar ato që ai i vlerëson të njohura nga bashkëlokutori”*.⁸⁵

3. Në kundërshtim me demonstrimin që mund të paraqitet në formën e një llogaritjeje, argumentimi ka për qëllim që të bindë dhe ai është i pranishëm vetëm në një kontekst psiko-sociologjik.

Nëse demonstrimi jep prova kundërshtuese, argumentimi paraqet arsye pro ose kundër një teze të caktuar. Këtij dallimi i korrespondojnë dy llojet e provave të studiuara nga Aristoteli: 1. provat analitike, si silogjizmat, të cilat tregojnë se si një konkluzion i vërtetë mund të nxirret nga premisat e vërteta, falë një arsytimi formalisht korrekt, dhe 2. provat dialektike të përdorura gjatë një ligjërimi intim, në ligjërimet me të tjerët si dhe në çdo ligjërim që synon të bindë një auditor të çfarëdoshëm⁸⁶.

c. **Fjalimi publik.** Nga të tri elementet e aktit ligjërimor: *folësi*, *mesazhi* dhe *personi i adresuar* (marrësi), është ky i fundit që përcakton objektin dhe qëllimin e ligjërimit të folësit. Marrësi (dëgjuesi) mund të jetë në rolin e një diskutuesi të thjeshtë, i cili thjesht sugjeron një mendim të vetin lidhur me një çështje të caktuar; mund të jetë në rolin e një gjykuesi, i cili mban një pozicion dhe jep një gjykim personal lidhur me çështjen në fjalë; por mund të jetë edhe thjesht një vëzhgues, i cili mund të mos pozicionohet në të tashmen, por që mund të vendosë ta bëjë këtë në të ardhmen. Rrjedhimisht, këto tri klasa dëgjuesish lidhen sipas Aristotelit me tri lloj ligjërimesh, të cilat i trajtoi hollësisht në librin e tij *“Retorika”*.⁸⁷ Ato janë:

⁸⁴ Aristoteli: *“Retorika”*, vep. e cit., Libri I, kapitulli 2, [1378 a].

⁸⁵ Dominique Maingueneau: *“L’analyse du discours. Introduction aux lectures des archives”*, vep. e cituar.

⁸⁶ Përdorimi i provave dialektike është analizuar gjerësisht nga Aristoteli në veprat *“Retorika”* dhe *“Topika”*.

⁸⁷ Aristoteli: *“Retorika”*, vep. e cit., Libri I, kapitulli 3, [1358 b].

1. **ligjërimi politik** (njihet ndryshe ligjërim deliberativ, diskutues)
2. **ligjërimi ligjor** (gjyqësor)
3. **ligjërimi ceremonial** (demonstrues, epideiktik)⁸⁸

1. *Ligjërimi politik* nxit të bëjmë ose të mos bëjmë diçka: një nga këto dy rrugë merret gjithmonë nga këshilltarët privatë, ashtu si nga njerëz që flasin përpara asambleve publike. Kjo është forma e ligjërimin e përdorur nga organet legjislativë ose mes miqsh që diskutojnë për të përfunduar sa më mirë një projekt të përbashkët. Sukses i ligjërimin tonë varet nga fakti nëse audienca mëson atë që ne vetë donim t'i transmetonim. Vetë Aristoteli për të ilustruar se çfarë kishte ndërmend me retorikën *diskutuese* përmend citatin nga bibla: "*Ejani, le të diskutojmë së bashku*".⁸⁹ Përdorimi i këtij tip ligjërimi mund të haset edhe në jetën e përditshme, si p.sh., në situata të tilla thëniesh:

- *Që mos të kthehemi prapë, eja njëherë të marrim ç'na duhet në supermarket, pastaj shkojmë të lajmë makinën.*

- *Nëse blejmë akulllore për motrën, rrezik të na shkrijë sa të mbërrijmë në shtëpi.*

Vihet re se qëllimi që thënësi ka në secilin rast, është të nxisë marrësin për një veprim që duhet ta kryejë ose jo në të ardhmen.

2. *Ligjërimi ligjor* sulmon ose mbron dikë: njëra ose tjetra nga këto dy veprime duhet të bëhet gjithmonë nga palët në një çështje. Ky është lloji i ligjërimin që përdoret nëpër gjykata. Nëse ligjërimi diskutues përpiqet të bindë dëgjuesit përreth diçkaje që pritet të ndodhë në të ardhmen, ai ligjor synon të bindë dëgjuesit përreth diçkaje që ka ndodhur në të shkuarën. P.sh., gjatë një procedure gjyqësore, avokati i çdo pale mëton më shumë të argumentojë në favor të tezës, sesa të qartësojë trupin gjykues për veprën e ndodhur. Shembulli vijues është konkretizim i këtij tipi ligjërimor:

- Kur Zoti ju drejtua Jobit⁹⁰: "*Ku ishte kur unë hidhja themelet e tokës?*", Zoti e vendos Jobin në rolin e të qenurit dëshmitar, duke krijuar kështu situatë të një ligjërimi ligjor.

⁸⁸ Fjala "epideiktik" do të thotë "e përshtatshme për t'u shfaqur". Në librin e tij "*Retorika dhe Poetika në antikitet*" ("*Rhetoric and Poetics in antiquity*"), vetë autori Jeffrey Walker pretendon që retorika e tipit epideiktik është më e herët se retorika e tipit gjyqësor dhe politik, studimi i së cilës filloi në shek. III ose IV p.e.s. me sofistët.

⁸⁹ Bibla: Is.1:18 "*Ejani, pra, dhe të diskutojmë së bashku, thotë Zoti, edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi*", përkthimi 1991 – 1994, botim i Shoqatës shqiptare të Biblës, Tiranë, korrik, 1995, fq. 717.

⁹⁰ Sqarim: Sipas Biblës, Jobi ishte një njeri i ndershëm dhe i drejtë, kishte frikë nga Perëndia dhe i largohej së keqes. Kishte shtatë bij dhe tri bija. Megjithëse u vu në prova të rënda nga vetë Perëndia ai nuk mëkatoi dhe nuk e paditi Atë. Thjesht guxoi

-“Veshi im kishte dëgjuar të fliste për ty, por tani syri im të sheh. Prandaj ndiej neveri ndaj vetes dhe pendohem mbi pluhurin dhe hirin.”

3. *Ligjërimi ceremonial* prezanton, mburr ose denoncon (dikë, një rrethanë apo ideologji). Ky lloj ka të bëjë me retorikën e tipit të ceremonisë, deklamacionit, demonstrimit apo shumë shpesh atë të funeraleve dhe ngjarjeve të tjera formale si p.sh., kur dikujt i akordohet një çmim:

- *Do të doja të falënderoja Akademinë për vlerësimin dhe besimin që patën tek unë.*

Këto tri lloj ligjërimesh retorike iu referohen tri llojeve të ndryshme të kohës. Kështu, oratori politik merret me të ardhmen: ai këshillon për pro ose kundër gjërave që duhen bërë në vazhdimësi.

Pala në një çështje gjyqi merret me të shkuarën; dikush akuzon tjetrin dhe tjetri mbron veten duke iu referuar gjërave tashmë të bëra.

Oratori ceremonial merret me të tashmen, meqë gjithë njerëzit mburrin ose fajësojnë duke pasur parasysh gjendjen e gjërave.

Përmbledhtazi po paraqesim më poshtë tiparet e tri llojeve të ligjërimit që përshkruan Aristoteli:⁹¹

Tabela nr. 4

	Ligjërimi politik	Ligjërimi ligjor	Ligjërimi ceremonial
Synimi...	nxit të bëjmë ose të mos bëjmë diçka	akuzon ose mbron dikë	mburr ose fajëson dikë
Koha më e mirë është...	e ardhme	e shkuar	e tashme
Përdoret në...	diskutime politikëbërëse	sallë gjyqi	ngjarje ceremoniale

Kuptohet që forca e fjalës dhe shkalla argumentuese nuk është e njëjta në tipet e mësipërme të ligjërimit. Një ligjërimit në një sallë gjyqi ka tjetër forcë argumentuese nga ai ceremonial i llojit vdekje apo martesë.

të argumentojë me të. Në citatin më lart është momenti kur Perëndia merr në pyetje Jobin në kuadrin e krijimit të tij. Për më tepër shih: Jobi: 37,38; fq. 592.

⁹¹ Aristoteli: “*Retorika*”, vep. e cit., Libri I, kapitulli 3, [1358 b].

3.1.2. Forma e shkruar

Ligjërimet argumentuese gojore mund të jenë njëherazi të shkruara. Kjo gjë mundësohet përmes mjetit *shkrim*. Shfaqja e shkrimit ka modifikuar thellësisht përdorimin apo ndërgjegjësimin që mund të kemi për gjuhën. Nëse gojarisht ne mbështetemi tek intonacioni dhe prozodia, me shkrim, mbështetemi vetëm te konteksti, çka e bën komunikimin të ftohtë. Gjithashtu kjo formë është krejt e zhveshur nga pantonima, pjesëmarrëse aktive kjo e fundit në ligjërimin gojor.

Në mbështetje të të kuptuarit të tekstit argumentues të shkruar vijnë elementet e tipografisë, të shenjave të pikësimit, elemente këto që do t'i shohim në mënyrë të detajuar në vijim të punimit tonë.

3.1.3. Forma joverbale

Formës joverbale të të shprehurit përgjatë një ligjërimi i është dhënë rëndësi qysh në kohët antike. Ishte Demosteni ai që e theksoi në veçanti rolin pjesëmarrës të gjestikulacionit në një ligjërim. Imazhet dhe fjalët janë së bashku dy procese të barabarta në aktin e komunikimit. Imazhet mund të jepen me forma të ndryshme si: manifestime trupore, shprehje të fytyrës, pantomimat etj. Këto ndërveprime komunikative joverbale përfaqësojnë një zë të dytë që zbulohet në një modalitet pamor. Një modalitet i tillë të çon në një realitet trupor të bazuar mbi një plotësues gjest apo shenjë. Gjestet janë elemente ndërtuese të një sistemi të vetëm të bazuara mbi një kod njohjeje që vendos një ekuivalencë ndërmjet një shenje gjestore dhe një elementi metaforik⁹².

Gjestet shprehin atë që lokutori dëshiron të komunikojë, duke vënë në pah një dimension pamor e duke treguar se si ligjërimi është shumë më tepër sesa fjalë e fjali. Ky raport ekzistencial midis kodit pamor të njohjes dhe kodit konceptor të njohjes, është i bazuar mbi metaforat me të cilat ne jetojmë. Dallohen dy tipe gjestesh:

- a. gjeste pamore
- b. gjeste metaforike

Të parat na çojnë drejt karakterit ekspllicit të gjuhës gjestore dhe të dytat mbi fuqinë e konotacionit dhe të denotacionit. Të dyja këto tipe janë të pranishme në ligjërimin argumentues e kryesisht të tipit ligjërim politik.

⁹² Për më gjerë shih: Danielle Bouvet: “*La dimension corporelle de la parole. Les marques posturo - mimo - gestuelles de la parole, leurs aspects métonymiques et métaphoriques, et leur rôle au cours d’un récit*”, Peeters, Paris, 2001, fq. 140.

Kështu, pamja e një burri politikan përgjatë fjalimit të tij publik kompletohet tërësisht nga gjestikulacioni i tij: vështrimet e kthyer nga kamera, lëvizjet e krahëve e të duarve, të cilat janë në funksion të mendimeve të tij, ngritja e vetullave që shkakton shfaqjen e emocioneve të ndryshme si: habi, pyetje, shqetësim, ngryse etj., orientimi i të folurit të tij brenda kohës së caktuar etj. Të gjitha këto janë elemente shtesë ndikuese në ligjërimin argumentues. Nëse vërejmë lëvizjet që ai bën, ato gjenden në sinkron me prodhimin ligjërimor. Të dyja format e shprehjes janë të lidhura dhe ndërtojnë një sistem të vetëm. Ato veprojnë së bashku edhe pse mënyra e trajtimit të tyre është e ndryshme.

3.2. Tipare të përgjithshme të ligjërimin argumentues

Ligjërimi argumentues, ashtu sikurse çdo ligjërim tjetër, karakterizohet nga një mori tiparesh. Le t'i shohim më poshtë këto tipare.

3.2.1. Teza/antiteza

Në ligjërimin argumentues ekzistojnë të paktën dy palë, çka nënkupton praninë e një teze dhe të një antiteze. Teza i kundërvihet një apo disa tezave të tjera përmes argumenteve. Shpалosja e kësaj teze nga njëra palë shkakton debatin nga ana tjetër, ku pala e dytë kërkon ta kundërshtojë po me të njëjtën mënyrë - thirrjen pranë të argumenteve, që tanimë janë kundërgjegje.

a. Opinioni personal mund të jetë baza e një sprove argumentuese, por, arsyeja, të dhënat dhe informacioni faktik duhet të mbështesin këtë opinion personal për të vërtetuar argumentin.

b. Një mënyrë për të forcuar argumentin tonë e që të shpалosim dije më të thellë për çështjen që mbrojmë, është të parashikojmë dhe të adresojmë kundërgjegje ose kundërshtime. Duke presupozuar të menduarit apo të folurit e kundërshtarit, ne dëshmojmë se e njohim mirë mënyrën e perceptimit të tij të gjërave dhe pikërisht kjo na lehtëson në ngritjen e kundërgjegjeve ndaj tij.

Shembull

Argumenti:

“Prozatori dhe diplomati Ylljet Aliçkaj thotë se: “shkrimtarët shqiptarë janë më të përkthyer e të pëlqyer se shkrimtarët maqedonas, serbë e boshnjakë, domethënë se shkrimtarët e Ballkanit në Francë, gjë të cilën unë e di mirë...”

Kundërargumenti:

Megjithëse, siç shihet, Ylljeta Aliçkaj e zbret një çik më poshtë nivelin e letërsisë shqipe, prapë nuk mund të thuhet se thotë gjithë të vërtetën. Ballkanin e përbëjnë edhe grekët, turqit, bullgarët, rumunët, malazeztë dhe kroatët, të cilët hidhërohen pa masë kur u thuhet se i takojnë Ballkanit! Po të dinte, vërtet, se kush përkthehet e kush lexohet në Francë dhe në Europë nga shkrimtarët e Ballkanit, Ylljet Aliçkaj do të na jepte disa të dhëna të tjera. Dhe, do të na thoshte, fjala vjen, se letërsia greke, letërsia rumune, letërsia bullgare, letërsia serbe, letërsia kroate janë shumë shumë më të përkthyer se letërsia shqipe në Europë, ndonjëra prej tyre tridhjetë, ndonjëra njëqind e ndonjëra, ndoshta, treqind për qind më të përkthyer se letërsia shqipe... Dhe pse të mos jenë më të përkthyer? Janë më të pasura, kanë tradita më të gjata, në përgjithësi janë më të zhvilluara se letërsia jonë. Në Serbi e në Kroaci sot ka shumë shkrimtarë të cilëve çdo roman që botojnë në gjuhën kombëtare u përkthehet shpejt në disa gjuhë evropiane. Drama të autorëve serbë e kroatë shfaqen në teatrot e Francës, të Austrisë, të Gjermanisë...Prania e letërsisë serbe e kroate dhe e krijuesve serbë dhe kroatë në Europë iu detyrohet jo vetëm lidhjeve të trashëguara e të reja të vetë krijuesve serbë e kroatë, po edhe shteteve të tyre. Kështu, p.sh., ambasada e Serbisë në Paris boton revistë mujore në gjuhën franceze me shkrime letrare e shkencore të autorëve serbë. Ministria e Kulturës e Serbisë ka komisionin e përbërë prej shkrimtarëve, studiuesve të letërsisë dhe historianëve të cilët bëjnë përzgjedhjen e veprave letrare e shkencore të cilat do të përkthehen në gjuhë të huaja, natyrisht të financuara prej asaj Ministrie. Ç'bëjnë ministritë tona të Kulturës? Ministria e Kulturës e Kosovës financon botimin e kësaj zbavitës muzikor dhe festivalet e kësaj miseve, por jo përkthimin e veprave letrare e shkencore që meritojnë të përkthehen".⁹³

3.2.2. Pohimi/mohimi

Ligjërimi argumentues ka si bazë **kuptimin e së kundërtës**. Kjo do të thotë që koncepti i argumentit ka dy anë: **pohimin dhe mohimin**. Pohimet ndikojnë në të kuptuarit e shkaqeve, në parashikimet që bëjmë, në mënyrën se si i vlerësojmë gjërat etj. Por, duke i shpjeguar dikujt diçka, jo medoemos tjetri do të na i pranojë mendimin automatikisht, pasi jo gjithçka që pohojmë është e vërtetë dhe e besueshme. Si rrjedhojë, lind ana tjetër e pohimit: **kundërshtimi**. Me anë të këtij ne synojmë të mohojmë ato që janë pohuar.

⁹³ Rexhep Qosja: "Mjerimi i provincializmit" tek e përditshmja shqiptare "Gazeta shqiptare", e enjte, 3 shtator 2009, fq. 19.

Pohimet dhe mohimet vërtiten rreth diçkaje që është dyshuese. Përmes arsyetimeve tona zbusim dyshimet dhe ngjallim bindje.

Shembull

Deklarata:

“Tirana është e gatshme për çfarëdo rasti edhe nëse Kosova ndahet. Shqipëria nuk jep garanci për mosndryshimin e kufijve” - është shprehur Besnik Mustafaj.

Akuza:

“Partia Socialiste kërkon shkarkimin e ministrit të Jashtëm Besnik Mustafaj nga detyra që mban si i paaftë për të drejtuar diplomacinë shqiptare...Ministri i Jashtëm ka përsëritur për të disatën herë gafat e tij diplomatike, duke shkaktuar shpeshherë reagime negative nga fqinjët dhe faktori ndërkombëtar dhe duke rrezikuar seriozisht çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës.”

Mohimi:

“Mustafaj sqaroi qëndrimin e tij para deputetëve të Kuvendit duke i cilësuar si të pabaza akuzat që janë bërë ndaj tij: “Ndër kushtet apo garancitë që duhet të shoqërojnë pavarësinë e Kosovës, detyrimisht që duhet të përfshihet edhe mosndryshimi i kufijve të Kosovës, qoftë me Shqipërinë, qoftë edhe me pjesë të ndonjë shteti tjetër.”⁹⁴

3.2.3. Karakteri bindës

Qëllimi kryesor i çdo ligjërimi argumentues është të bindë. Që ta bëjmë këtë, duhet të marrim parasysh opinionet e të tjerëve dhe të përpiqemi të kalojmë nga një nivel pranimi në tjetrin; na duhet jo vetëm që të shpjegojmë dhe mbështesim propozimin tonë, por dhe të parashikojmë e madje të tejkalojmë kundërgargumentet që vetë pala tjetër mund të ketë. Pikërisht këtu qëndron sekreti i argumentimit bindës. Nëse përballë nesh qëndron një marrës i pavendosur, një tjetër armiqësor a dikush tjetër që është lehtësisht i manipulueshëm, ky fakt do të përcaktojë strategjinë që ne do të zbatojmë.

Bindjet janë të formave të ndryshme, ndaj jo të gjitha janë të lehta për t’u shqyrtuar apo ndryshuar. Kështu, ato shfaqen në formën e besimeve, të mendimeve, të supozimeve. Besimet shpesh udhëheqin vendimet që marrim në jetë. P.sh., dikush beson në mundësinë e ekzistencës së jetës së jashtëtokësorëve, ndaj i hyn një studimi kërkimor; dikush tjetër beson se

⁹⁴ Arban Hasani: “Deklarata që tronditi kancelaritë perëndimore dhe diplomacinë rajonale. Përkthimi i Besnik Mustafajt” tek e përditshmjia shqiptare “Standard”, e shtunë, 18 mars 2006, fq. 18.

është i talentuar në muzikë, ndaj frekuenton një vegël muzikore e kështu me radhë. Por, nga ana tjetër takojmë njerëz që mendojnë: *“Unë kam të drejtë në mendimin tim dhe asgjë nuk ka për të ma ndryshuar atë.”* Me këtë ata duan të thonë që ata kanë të drejtë të kenë mendimin e vet dhe të drejtën për të mos e bërë atë mendim objekt shqyrtimi. P.sh., mendimet mund të na bëjnë të themi se shahu është sporti më tërheqës, pasi është lojë e trurit. Ndërsa, supozimet mund t’i japin forma të menduarit tonë edhe kur nuk jemi plotësisht të ndërgjegjshëm për këtë p.sh.: *“Pavarësisht talentit që ka ky njeri, kam frikë se nuk do të ketë të ardhme, për shkak të mungesës së arsimit përkatës në fushën e muzikës.”*

Karakteri bindës në ligjërime është mbizotërues në të tria llojet e ligjërimeve: ligjor, deliberativ, epideiktik. Kështu në llojin e ligjërimit ligjor, një avokat synon të bindë trupin gjykues për pafajësinë e të akuzuarit ose në rastin më të keq për lehtësim faji nga ana e tij, apo në llojin e ligjërimit politik, ligjëruesi synon të bindë njerëzit, të cilëve iu drejtohet.

Shembull

Edi Rama: “Pas disa orësh Tirana dhe e gjithë Shqipëria do të votojnë “Bashkë për të Ardhmen”, sepse ne mund të garantojmë që nesër fëmijët e socialistëve dhe të demokratëve të jetojnë në një vend të lirë e të mirëqenë...Ne kemi promovuar dritën e diturisë duke rindërtuar 30 shkolla të qytetit, të cilat janë shtuar me hapësira të reja klasash, laboratorësh, mjedisesh sportive dhe duke ndërtuar dhjetë shkolla krejtësisht të reja, të gjitha të standardeve të Bashkimit Europian...”⁹⁵

3.2.4. Karakteri dyshues

Ligjërimi argumentues lëviz shpesh në të vërtetën jo të provuar si dhe në logjikën e rreme. P.sh.: *“Ai nuk ishte i pranishëm në vendin e krimit. Si rrjedhojë, nuk është ai fajtori.”* Kështu, me anën e këtij lloji arsytimi, gjykojmë të drejtën, por jo të vërtetën. Të argumentosh nuk do të thotë të thuash të vërtetën, as të tregosh karakterin logjik të vlefshëm të një arsytimi. Të argumentosh do të thotë të japësh arsye, konkluzione të atilla për të. Ndaj që është e nevojshme të dallojmë proceset: të argumentojmë dhe të logjikojmë. P.sh.: *“Prej këtyre kritereve të Diana Çulit dhe të bashkëreaguesve të saj, duhet të nxjerrim përfundimin se një vepër letrare, një vepër shkencore a një vepër filozofike, e shkruar në gjuhën shqipe, ka vlerë letrare, shkencore a filozofike kombëtare dhe evropiane, vetëm në qoftë se të tjerët e çmojnë si vlerë, e përkthejnë dhe e shpërblejnë me çmime, medalje, dekorata, tituj të ndryshëm autorin e saj! Sipas kësaj logjike nuk*

⁹⁵ Edi Rama: “Ne e ardhmja, ata e shkuara” tek e përditshmja shqiptare “Zëri i popullit”, e shtunë, 17 shkurt 2007, fq. 3.

është e rëndësishme çka mendon ti vetë për ato vepra dhe për krijuesit e tyre; e rëndësishme është çka mendojnë dhe çka thonë ata, të tjerët, ata prej të cilëve varet edhe shumëçka në shtetin tënd...⁹⁶

Ekzistojnë argumente të tipit: *shembull, ilustrim, model*. Përgjithësimi i nisur nga *shembulli* është një tip i veçantë i argumentimit të zakonshëm. Mund të bëhet fjalë për shembuj historikë jo të vërtetë, kujtime personale etj. Si rrjedhojë, shembulli mund të jetë i besueshëm ose jo. P.sh.: “Nga këto që thamë më sipër, shumë muzikologë kanë arritur në përfundimin se *Bethoveni mbeti gjithë jetën e tij një analfabet i pagdhundur, gjë që nuk është e vërtetë. Dimë, për shembull, se shumë letra të Bethovenit meritojnë një vend të denjë në radhët e letërsisë gjermane. Nga ana tjetër, disa nga shkrimet e tij provojnë në mënyrë të prerë se ai ishte njeri me kulturë të gjerë, kishte lexuar shumë libra dhe kishte përfutur prej tyre. Nga letrat, nga biblioteka e tij private dhe nga Shindleri, marrim vesh se çfarë librash këndonte Bethoveni. Ja disa nga shkrimtarët, veprat e të cilëve ai i njihte mirë: Homeri, Sofokliu, Euripidi, Demosteni, Platoni, Aristoteli, Plutarku, Luciani, Ciceroni, Ovidi, Taciti, Shekspiri, Valter Skoti, Volteri, Rusoi, Kanti, Klopshtoku, Gëtja, Shileri, Shturmi dhe poetët persianë”⁹⁷*

Ilustrimi nuk synon të vendosë një rregull nga përgjithësimi, por të përforcojë një rregull, duke treguar interesimin e tij në zbatimin e varianteve. P.sh.: “Dua të theksoj se *inkuadrimi i paskajores gege, krahas disa vështirësive morfologjike që do të nxirrte (duhet me shkue, me shkue, me shkuar apo? etj.) nuk e di a do të ishte i nevojshëm sa kohë që shqipja ka kaq mundësi për ndërtimet me foljet modale dhe foljet aspektore (t’i quaj kështu). Kjo do të thotë që krahas ndërtimeve: duhet të punoj: duhet të punohet: duhet punuar – të shtoheshin edhe dy të tjera: duhet me punue, duhet me u punue... dhe më tutje: mund të shkoj, mundem me shkue; mund të shkohet, mundet me u shkue, dhe më tutje: vazhdoj të shkruaj: ka vazhduar të shkruhet, vazhdoj me shkruë (apo... shkruar) e të tjera...”⁹⁸*

Modelet përbëjnë një paradigmë për auditorin, i cili njeh faktin që ky model është një nxitje urdhëruese për ta imituar ose jo. P.sh.: “*Sikur shoqëria shqiptare të mos ishte e prapambetur siç është, sikur shoqëria shqiptare të mos ishte në krizë të rëndë shpirtërore dhe morale siç është, sikur prej jetës intelektuale të kësaj shoqërie të ishte mënjeluar modeli i mendimit dhe i sjelljes alla Ismail Kadare, atëherë nuk do të ndodhnin as reagime në të vërtetë trysni kooperativiste ndaj mendimit ndryshe, siç është*

⁹⁶ Rexhep Qosja: “Mjerimi i provincializmit” tek e përditshmja shqiptare “Gazeta shqiptare”, e enjte, 3 shtator 2009, fq. 19.

⁹⁷ Fan Noli: “Bethoveni dhe revolucioni francez” te “Vepra”, 5, shtëpia botuese “Kombinati Poligrafik”, Tiranë, 1989, fq. 107.

⁹⁸ Isa Bajnica: “Shqipja standarde dhe probleme rreth saj” te “Gjuha shqipe”, nr. 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007, fq. 46.

reagimi i Besnik Mustafajt, Diana Çulit, Ylljet Aliçkajt dhe Behar Gjakës ndaj një fjalie të Rexhep Qosjes, së cilës ata nuk janë aq të padijshëm që të mos i besojnë, që është reagim tipik për stalinizmin dhe për fashizmin."⁹⁹

3.2.5. Karakteri dialogjik

Ligjërimit argumentues ka karakter **dialogjik**. Këtu duhet të bëjmë kujdes në mënyrë që të mos ngatërrojmë termin "*dialogjik*" me termin "*dialogor*". Nëse ky i fundit ka të bëjë thjesht me formën e jashtme të ligjëratës, në ndryshim, termi "*dialogjik*" ka të bëjë me funksionin e ligjëratës. Nocioni i dialogjizmit u krijua nga **Mikhail Bakhtine-i**¹⁰⁰ për të përshkruar lidhjen e ndërsjellë të pohimeve në një tekst të dhënë. Sipas **Bakhtine-it**: "*Konteksti përbën sfondin e ngjarjeve, të pikëpamjeve dhe të zërave.*"¹⁰¹ Kështu, në binomin dhënës – marrës të aktit gjuhësor, kemi edhe shfaqjen e zërave, të cilët gjatë gjithë ngjarjes gjuhësore bëhen protagonistët e krijimit të së ashtuquajturës *polifoni*. Po të nisemi nga mendimet e Bakhtine-it, format gjuhësore konkretizohen dhe funksionojnë vetëm në sferën dialogjike; jashtë saj nuk kemi asgjë tjetër, veçse një virtualitet gramatikor dhe jo një realitet konkret gjuhësor me vlera komunikative.

Shpesh shumë çështje argumentuese përdoren në funksion të një çështjeje të vetme argumentuese. Kështu p.sh., nëse i referohemi emisioneve të tilla si: "*Shqip*" i Rudina Xhungës, "*Opinion*" i Blendi Fevziut, "*Pro dhe kundër*" i Ardit Gjebreas, vërejmë se të ftuarit në panel japin mendimin e vet, por që të gjitha mendimet rezultojnë në një të përbashkët të vetme: temën e parashtruar. Prandaj do të flasim për dialogjizmin, teori sipas së cilës asnjëherë thënia nuk kryhet nga individ i veçuar, pasi të thënet prodhohet në mënyrë të dyanshme nga folësi dhe dëgjuesi. Këta janë të dy prodhues dhe interpretues; madje edhe monologu është një formë e dialogut, por në virtualitet.

Rrjedhimisht, mund të dallojmë ligjëratë: monologore dhe dialogore (kryeartikull gazete, intervistë e një personi, peticion etj.); dialogore dhe dialogjike (forma e debatit apo bisedës mes palëve); dialogore dhe monologjike (që kryhet nga disa persona, të cilët përfaqësojnë një autoritet të lartë: p.sh., udhëzimet e MASH-it, që jepen në emër të shtetit); monologore dhe monologjike (përsiatje, lloj letrar: poezi, tregim etj.).

⁹⁹ Rexhep Qosja: "Mjerimi i provincializmit" tek e përditshmja shqiptare "*Gazeta shqiptare*", e enjte, 4 shtator 2009, fq. 19.

¹⁰⁰ Mikhail Bakhtine (1895 – 1975) – filozof rus, kritik letrar, semanticien. Lidhur me nocionin e dialogjizmit shih më tepër: "*The dialogic imagination*", The university of Texas Press, 1982.

¹⁰¹ Mikhail Bakhtine. Po aty.

Shembull lidhur me argumentin: A duhet të ndryshojë standardi i shqipes apo jo

Jorgo Buló: “Është e vërtetë se gjuha zyrtare është krijuar në bazë të toskërishtes, por me shumë pjesë të marra edhe nga gegërishtja, sidomos në aspektin leksikor. Vendimi për të krijuar një gjuhë zyrtare me bazë toskërishten nuk është një përpjekje për të mbisunduar një të folme ndaj një tjetre, por thjesht një zgjedhje shkencore, që shumë mirë mund të ishte edhe anasjelltas, pra që bazë e gjuhës zyrtare të ishte gegërishtja... Nuk e besoj se duhet të ndryshojë kjo gjuhë zyrtare që kemi”.¹⁰²

Ardian Vehbiu: “Për mendimin tim, standardi për arsye thjesht funksionale nuk e pranon dot paskajoren geqe tale quale, e cila më mirë të mbesë atje ku gjithnjë ka qenë: në gegërishten e folur dhe në variantet letrare të gegërishtes”.¹⁰³

Agron Tufa: “Gjuha standarde që është anuar nga toskërishtja, përbën një pengesë për të gjithë folësit e gegërishtes”. Ai shton: “gjuha standarde është përjashtuese dhe dëmton stilin e çdo shkrimtari gegë. Ku qëndron thjeshtësia fonetike, nëse dalim në ligjërimin e thukët të gjuhës së poezisë? Të thuash ‘menjëherë’ apo ‘saora’? Të thuash ‘vazhdimisht/gjithnjë/gjithmonë’ apo ‘prore’?”¹⁰⁴

Emil Lafa: “Pikëpamja e disave që ta nisim edhe një herë nga e para, sepse kjo gjuhë letrare u vendos në kohën e komunizmit, jo vetëm nuk është e dobishme, por madje është e dëmshme. Është pak a shumë njësoj sikur të vihet në diskutim a duhet të jetë Tirana kryeqytet i Shqipërisë? Flamuri u ngrit në Vlorë, por kryeqytet mund të kishte qenë edhe Elbasani, Durrësi ose Shkodra. Por këto punë vendosen një herë e mirë dhe nuk ka pse të bëjmë prapa!”¹⁰⁵

Shefkije Islamaj: “Do të ishte tepër e shtrenjtë një aventurë e tillë për një popull të vogël siç janë shqiptarët, për administratën shtetërore e publike dhe për mjetet e informimit publike. Andaj, shqiptarët do të dinë cila është rruga e tyre: shqipja standarde do të vazhdojë të mbetet gjuha e përbashkët e gjithë shqiptarëve, edhe e shqiptarëve të Kosovës, sepse duke pasur një gjuhë të përbashkët e një histori gjuhësore të përbashkët,

¹⁰² Jorgo Buló: “Kulla e Babelit...ose gegnishtja e standardit” tek e përditshmja shqiptare “Standard”, e shtunë, 29 mars 2008, fq. 3.

¹⁰³ Ardian Vehbiu: “Mistika me gegënishten mjegullon problemin real” tek e përditshmja shqiptare “Shekulli”, e diel, 5 gusht 2007, fq. 14.

¹⁰⁴ Ardian Vehbiu. Po aty.

¹⁰⁵ Emil Lafa: “Gjuha dhe shkrimi” te “Gjuha shqipe”, nr. 3, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007, fq. 10.

shqiptarët do të kenë një të ardhme të përbashkët përparuese dhe qytetëruese”.¹⁰⁶

Idriz Ajeti: “Toskërishten letrare nuk e ngriti politika komuniste në të cilën mbizotëronin folësit toskë. Epërsia e saj ndaj gegërishtes së shkruar ishte rezultat i përpjekjeve të sa e sa brezave të tërë shkencorë e kulturorë shqiptarë, të nisura këtu e mëse njëqind vjet”.¹⁰⁷

Xhevat Lloshi: “As shqipja dhe as shqiptarët nuk kanë nevojë për disa standarde, që do të çonin në gjuhë të ndryshme. Popuj të tjerë europianë me popullsi shumë herë më të madhe, me histori shumë më të gjatë të standardit, madje edhe në kushtet e shteteve e të kombeve të ndara, nuk kanë ecur në rrugën e krijimit të standardeve të ndryshme. Është i mjaftueshëm për këtë rasti i gjermanishtes... Atyre që duan ta rishikojnë standardin për të çelur shtegun që pastaj ta shkatërrojnë, duhet t’u përgjigjemi se në gjuhë nuk ka fitimtarë e të humbur, por mund të ketë fitore ose humbje të gjithë kombit”.¹⁰⁸

3.2.6 Karakteri implicit

Ligjërimi argumentues ka karakter implicit. Karakteri implicit lidhet me pjesën e fshehur ose të nënkuptuar të tekstit. Në ligjërimin argumentues nuk është qëllim që të gjejmë se çfarë ka në mendje në të vërtetë folësi apo autori në ato që artikulon, por të përcaktojmë pohimin që mbron ky folës apo autor në kontekstin dhe situatën e dhënë. Pjesa implicite është e vështirë të rrëmohet në ligjërim, pasi në njohjen e saj ndikojnë shumë faktorë, si: niveli kulturor i marrësit të këtij teksti, njohja me situatën dhe rrethanat ku dhe kur zhvillohet ky tekst etj.

Shembull

“Çadrat janë disa lloje: të vogla, nga ato që mbahen për në makinë, të zakonshme nga ato të kohës së Enverit, që iu thyhen telat shpesh, të mëdha me atë butonin në fund dhe ombrellat që arrijnë të përballojnë diku rrebeshin. Më logjike do të ishte që në kohë rrebeshesh, sikurse kalojmë sot, të mos ia vinin fajin çadrës. Kështu duhej ta mendonin edhe socialistët. Nuk e ka fajin shiu, faji është i atij që mendon se rrebeshi kalohet vetëm me një çadër, pa çizme llastiku, pa mushama e kështu me radhë...Ka raste kur rrebeshet të forta nuk i duron as ombrella më e fortë, por kur bëhemi qull nuk

¹⁰⁶ Shefkije Islamaj: “Shqipja standarde – vlerë kombëtare” te “Gjuha dhe identiteti”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2008, fq. 69.

¹⁰⁷ Qemal Murati: “Idriz Ajeti: prijatar për njësimin e gjuhës shqipe” te “Gjuha shqipe”, nr. 2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007, fq. 39.

¹⁰⁸ Qemal Murati: “Gjashtë pyetje për prof. Xhevat Lloshin” te “Gjuha shqipe”, nr. 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007, fq. 15.

do të thotë që fajin na e ka gjithnjë çadra”.¹⁰⁹ (Metafora çadër nënkupton konceptin e kreut, të udhëheqësit).

3.2.7. Karakteri polemizues

Karakteristikë e ligjërimit argumentues është nxjerrja në pah e forcës së fjalës. Që të mbrosh një tezë apo një konkluzion, do të thotë të hedhësh poshtë një tezë apo një tjetër konkluzion në mënyrë të tillë që mos të hyjmë në zënkë, por duke qëndruar gjithmonë te kundërargumentet. Si rrjedhojë, nuk duhet ngatërruar argumentimi me të zënë. Argumentimi është paraqitja e arsyeve për bindjen që kemi, kurse të zënë mund të shihet si një luftë me fjalë. Zënka sjell humbjen e gjakftohësisë dhe forcon egon. Ajo ka të bëjë me ndjenjat, nxjerr inatet dhe sjell shpërthime. Argumentimi synon në zbulimin e së vërtetës, duke e nxjerrë bindjen nën dritën e arsytimit. Argumentimi duhet të jetë një sfidë për arsyen dhe jo një ftesë për t’u zënë.

Shembull

“Ideja e hedhur për një gjuhë të re, të veçantë, për shqiptarët e Kosovës po përvijohet djallëzisht nëpër hapësirën tonë lehtë të lëndueshme politike, kulturore, fetare, gjuhësore, më në fund edhe kombëtare. Edhe ata më pak të informuarit e dinë dhe e kanë të qartë se gjuha standarde në Kosovë mund ta ndërrojë emrin, po jo edhe substancën e strukturën e saj...Përpyekjet për t’i çintegruar shqiptarët gjuhësisht, përpyekjet për t’i veçuar shqiptarët gjuhësisht, përpyekjet për ta përmbysur standardin për një pjesë të shqiptarëve, në të vërtetë do të thonë përpyekje për të sjellë regres gjuhësor, për të shkaktuar kaos gjuhësor e për të sjellë armiqësi gjuhësore...”¹¹⁰

3.2.8. Karakteri qëllimor

Ligjërimit argumentues ka karakter qëllimor. Karakterin qëllimor të aktit të argumentimit mund ta shohim në dy aspekte:

a) në faktin e paraqitjes së qëllim të një argumenti. Që të mbështetet ose të rrëzohet një tezë do të thotë që vetë thënies i vijnë në ndihmë qëllimtazi argumente të caktuara. Sa më bindëse është tërësia e serisë “së mbiqëllimeve” që lokutori i ka vënë vetes, e që këto të fundit

¹⁰⁹ Fatos Baxhaku: “Sa faj ka çadra kur zë rrebeshi?” tek e përditshmja shqiptare “Shqip”, e diel, 30 gusht 2009, fq. 8.

¹¹⁰ Shefkije Islamaj: “Shqipja standarde – vlerë kombëtare” te “Gjuha dhe identiteti”, vep. e cit., fq. 92.

s'janë veçse argumentet e ndryshme të lidhura pas një "strategjie" globale, aq më i finalizuar dhe përmbushës në qëllimin e vet do të jetë procesi i argumentimit.

b) në funksionin, qëllimshmërinë e tij. Kështu, nëse një ligjëratë A thuhet *e destinuar për t'i shërbyer një konkluzioni C*, kjo në vetvete nënkupton qëllimshmërinë e vetë argumentimit, qëllimshmëri që i shërben arritjes së një konkluzioni të caktuar.

Shembull

"Pse e përdor Platoni dialogun? E para për arsye metodologjike dhe spekulative, duke e lidhur me metodën sokratike të zbulimit të së vërtetës; metodë që e bën të zhdërvjelltësojë bashkëbisedimin dhe arritjen e rezultateve me anën e pyetje - përgjigjeve. Bashkëbisedimi klasik sokratian, sistematik dhe gjenial, synonte vetëm në arritjen e së vërtetës, të cilën e ka ngritur në kult, si dhe zotërimin e artit të vetëdijshëm të kërkimit; e dyta për arsye poetike. Dialogu i jep trilleve të krijuesit rastin më të përshtatshëm për t'i ndryshuar dhe për të pasuruar kornizat e mjedisit, vijat psikologjike, marrëdhëniet kohore mes realitetit dhe fantazisë, si dhe ta përshpejtojë apo ta shtrijë, me ndalesa të mençura, ritmin e diskutimit kulturor".¹¹¹

3.2.9. Karakteri ndikues

Ligjërimit argumentues ka karakter ndikues (efektshtëria). Çdo ligjërimit argumentues finalizohet me një konkluzion të caktuar. E gjithë paraqitja strukturore argumentuese (por dhe kundërgargumentuese) bëhet në mënyrë që jo vetëm të bindim auditorin, por njëherazi të ndikojmë tek ai. Në fund ai duhet të mos ketë asnjë lloj dyshimi në argumentet (kundërgargumentet) e dhëna. Efektshtëria arrihet nëse argumentimi ynë është i organizuar. Por ky nuk është një kriter i mjaftueshëm, pasi:

a. nga njëra anë nuk mjafton thjesht dhe vetëm lidhja e argumenteve njëra pas tjetrës dhe kjo e bërë pafundësisht. Çdo ligjëratë ka një shtrirje përdorimi të caktuar, variabël sipas rrethanave. Argumentet paraqiten sipas një rregulli që u jep atyre efektshtërinë më të madhe, pasi ndërsa ligjërata rrjedh, auditori transformohet në ndikimin e tij dhe një argument mund të jetë pa efekt mbi një auditor që nuk e ka pësuar këtë transformim.

Pikërisht, ishte retorika antike ajo që fillimisht merrej me repertorin e të gjitha teknikave të kushtëzimit që viheshin në përdorim për të ndikuar në sjelljen e auditorit. Një teori e cila vendos theksin tek *argumentimi racional*, ku ky i fundit ka për qëllim të bindë auditorin universal, saktësojnë

¹¹¹ "Platoni" në origjinal nga Nino Marziano dhe shqipëruar nga Lazër Radi: "Apologjia e vërtetë e Sokratit; Kritoni, Fedoni, Elozhi i dashurisë ose simpoziumi", vep. e cit., fq. 6.

Perelman-i dhe Olbrechts-Tyteca¹¹², do të mbështetet mbi të gjitha në përdorimin e teknikave të kushtëzimit përgjatë ligjërimit, teknika këto që do të rezultojnë si rrjedhoja për rregullsinë e argumenteve dhe vetë procesin e argumentimit.

b. nga ana tjetër, nuk mund të injorojmë cilësinë e llojit të auditorit, për të cilën është e destinuar një ligjëratë. Kështu, mund të dallojmë ligjërimin e një politikani, dijetari, avokati, teologu, filozofi, jo vetëm nga objekti i tyre, por gjithashtu edhe nga auditorët përkatës të cilëve u drejtohen. Efektshmëria e argumentimit është në funksion të përshtatjes me auditorin, ndaj dhe teknikat që përdoren, janë të tilla që vetë ky auditor të bindet.

Shembull

“Si historian i letërsisë shqipe nuk di shkrim që të ketë nxitur më shumë reagime se çka nxitur përgjigja ime “Realitet i shpërfillur” ndaj sprovës “Identiteti evropian i shqiptarëve”, me të cilën Ismail Kadare i kishte kundërshtuar pikëpamjet e mia të paraqitura në kreun Identiteti kombëtar dhe vetëdija fetare të trajtesës Ideologjia e shpërbërjes...

*Ndër mediat që mbajnë qëndrim objektiv, mjerisht, nuk do të mund të radhitej pa sadopak ngurrim as gazeta “Tirana Observer” dhe nuk do të mund të radhitej në radhë të parë për shkak të pyetjeve që u bën të ftuarve për deklarata në lidhje me polemikën: A mendoni se polemika e dëmton imazhin e shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare? Me të njëjtën arsye do të mund të bëhej pyetja: A mendoni se polemika e dëmton imazhin e shkrimtarit, historianit të letërsisë dhe intelektualit tonë të madh Rexhep Qosja? Shumë më normale, më frytdhënëse për kulturën e diskutimeve intelektuale politike do të ishte pyetja, që përjashton gara e hierarki sportive: Sa ndriçon çështjen e i kontribuon të vërtetës kjo polemikë?...Partitë në pushtet, po e tregon edhe kjo polemikë, ende përcaktojnë politikën, etikën dhe estetikën e shumicës prej nesh, prandaj edhe të shumë gazetave dhe mediave elektronike”.*¹¹³

3.2.10. Rendi sintaksor

Për sa i përket paraqitjes së argumenteve, janë të mundshme rende të ndryshme: nga më i dobëti deri te më i forti, nga më i forti te më i dobëti, rendi kronologjik, rendi i ekzaltimit të oratorit etj.

¹¹² Chaim Perelman – Lucie Olbrechts-Tyteca: “*La nouvelle rhétorique: Traité de l’argumentation*”, vep. e cituar.

¹¹³ Rexhep Qosja: “Kadare, nga Enveri tek antimyslimanizmi” tek e përditshmja shqiptare “*Shqip*”, e shtunë, 10 qershor 2006, fq. 11.

Shembull

“- *Them se çdo gjë është e qartë si drita e diellit. Katër mundësi ka: zonja Rodes është vrasë ose nga i shoqi, ose nga kamerierja, ose ka vrasë veten, ose tek e fundit, është vrasë nga dikush që ka ardhur nga jashtë dhe që askush nuk e ka parë kur ka hyrë e kur ka dalë.*

“- *Dhe kjo është e pamundur, - më ndërpreu zoti Rodes. Askush s'mund të hynte e të dilte në dhomën time pa e vënë re unë dhe askush s'mund të hynte e të dilte në dhomën e sime shoqeje pa e parë elektrikisti. Pastaj si drejtin paska dalë nga dhoma duke e lënë derën të kyçur e të mbyllur me reze nga brenda?*”¹¹⁴

Theksojmë faktin që sintaksa e argumenteve s'mund të shkëputet arbitrarisht nga kushtet e prodhimit të ligjëritimit.

3.3. Argumenti dhe tipet e argumenteve**3.3.1. Argumenti dhe përbërësit e tij**

Akti i komunikimit përfshin një *lokutor* që flet ose shkruan (subjekti folës) dhe një *interlokutor* (subjekti marrës). Shkëmbimi gjuhësor i realizuar në kuadrin fizik e mendor në të njëjtën kohë, krijon një situatë të caktuar komunikimi. Lënda gjuhësore e qarkulluar nga partnerët e këtij shkëmbimi, organizohet në ligjërim sipas parimeve që varen nga synimet komunikuese të subjektit folës: të kumtojë, të përshkruajë, të tregojë, të argumentojë. Kjo do të thotë që kur prodhohet një ligjërim argumentues, lënda gjuhësore përmban domosdoshmërisht argumente. Këto argumente kanë funksion të dyfishtë:

1. të thonë një të vërtetë
2. të bindin marrësin për këtë të vërtetë.

Pra, çdo argument është zakonisht një ide kryesore shpesh e cilësuar “pohim” ose “paraqitje tezash”, i mbështetur me të dhëna bindëse që përkrahin këtë ide.

Pohimet mund të jenë të thjeshta si të tipit:

Toka rrotullohet rreth boshtit të vet dhe rreth diellit.

Mund të jenë komplekse si:

“Sikur shoqëria shqiptare të mos ishte e prapambetur siç është, sikur shoqëria shqiptare të mos ishte në krizë të rëndë shpirtërore dhe

¹¹⁴ Agatha Christie: “Mis Marpëlli rrëfen një ngjarje” te “Dëshmitari i akuzës”, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2002, fq. 176

morale siç është, sikur demokracia shqiptare të mos ishte primitive, e ndotur dhe e korruptuar siç është, sikur kjo demokraci të mos ishte e sunduar prej ish-sekretarit të partisë, domethënë prej ish-stalinistit, atëherë inteligjenca jonë, e me ta edhe e Besnik Mustafaj, Diana Çuli, Ylljet Aliçkaj dhe Behar Gjoka do ta shihnin gjendjen tonë shoqërore, politike, kulturore, letrare, shkencore, urbane siç është në të vërtetë dhe nuk do të mashtronin veten e popullin me iluzione mbi nivelet tona të paqena letrare".¹¹⁵

Por, nga ana tjetër dallojmë pohime që mund të jenë thjesht një thënie e thjeshtë, ose një lidhje logjike e thjeshtë e dy thënieve, p.sh.:

Pi ujë.

apo:

Pi ujë për t'u dobësuar.

çka në të vërtetë nuk kanë të bëjnë me procesin e argumentimit.

Që një argument të quhet i tillë, sipas Charaudeau-së¹¹⁶ duhet të përbëhet nga të paktën tri hallka ose elemente:

1. Propozimi – është një thënie fillimi (A1), ose e dhënë, premisë, e cila pohon diçka mbi fenomenet e botës: ekzistencën e qenieve, cilësimin apo përshkrimin e veprimeve a fakteve të ndryshme, por përmes një marrëdhënieje argumentuese (nëse...atëherë)

$$\begin{array}{ccc} A1 & \text{---} & A2 \\ \text{(nëse)} & & \text{(pra) (atëherë)} \end{array}$$

P.sh.: *Nëse nuk je i kënaqur me jetën tënde, atëherë ndryshoje!*

2. Parashtrimi – një thënie mbërritjeje (A2), ose konkluzion, rezultat që paraqet atë që duhet të pranohet nga fakti i thënies së fillimit dhe i lidhjes së shkakësisë. Subjekti mund të jetë dakord ose jo me propozimin. Nëse nuk është dakord do të themi që ai është kundër propozimit, gjë që do ta detyrojë të zhvillojë një akt bindjeje i destinuar për të provuar falsitetin e propozimit, domethënë ta refuzojë (totalisht ose pjesërisht).

P.sh.: *Besohet që një produkt është i mirë, thjesht se është më i shtrenjtë.*

¹¹⁵ Rexhep Qosja: "Mjerimi i provincializmit" tek e përditshmja shqiptare "Gazeta shqiptare", e enjte, 4 shtator 2009, fq. 19.

¹¹⁶ Patrick Charaudeau: "Grammaire du sens et de l'expression", vep. e cituar.

3. Bindja – një a disa thënie kalimthi, ose referenca, prova, argumente që paraqesin një univers besimi në lidhje me mënyrën me të cilën faktet determinojnë njëra-tjetrën në përvojën ose njohjen e botës.

P.sh.: *Mundet të jetë kështu, por kush ju lejon juve të thoni këtë dhe kush jeni ju që e thoni një gjë të tillë!*

Të tri elementet e mësipërme lidhen ngushtësisht me njëra-tjetrën, për të synuar në fund të fundit qëllimin e argumentimit. Pikërisht ky karakter qëllimor është përbërës i përkufizimit të lidhjes argumentuese: nëse një ligjëratë A thuhet e destinuar për t'i shërbyer një konkluzioni C , kjo nënkupton që karakteri i qëllim të është i njohur, i ditur, për t'i shërbyer këtij konkluzioni:

Nëse Klea vjen, atëherë edhe Evani do të vijë.

Gjithçka do të zgjidhet vetëm në lidhje me situatën:

Situata 1: *Klea erdhi. Edhe Evani erdhi.*

Situata 2: *Klea nuk erdhi. Edhe Evani nuk erdhi.*

Të tria elementet e mësipërme organizohen me njëra-tjetrën duke na dhënë lloje apo tipe argumentesh. Le t'i shohim cilat janë ato.

3.4. Tipet e argumenteve

Kemi këto tipe argumentesh:

3.4.1. Argument i bazuar në silogjizmin hipotetik

Ky tip është një argument me tri nivele që logjikisht mbështetet në një formulim kushtëzues.

Shembull

“TEOREMË 2: Në qoftë se funksioni f është i diferencueshëm në pikën (x_0, y_0) dhe $dz = A\Delta x + B\Delta y$ është diferenciali i tij në këtë pikë, atëherë në pikën (x_0, y_0) ekzistojnë të dy derivatet e pjesshme të f -së dhe:

$$A=f_x(x_0, y_0), \quad B=f_y(x_0, y_0)$$

Pra diferenciali i plotë i funksionit në pikën (x_0, y_0) merr trajtën:

$$dz=f_x(x_0, y_0)\Delta x + f_y(x_0, y_0)\Delta y \quad (2)$$

Në qoftë se marrim $z=f(x, y)=x$, atëherë $f_x=1$; $f_y=0$ dhe nga (2) gjejmë $dx=\Delta x$. Po kështu, në qoftë se marrim $z=f(x, y)=y$ do të gjejmë $dy=\Delta y$. Pra

në rastin kur x dhe y janë ndryshore të pavarura diferencialin e $f(x, y)$ në një pikë (x_0, y_0) mund ta shkruajmë në trajtën:

$$dz = f_x(x_0, y_0) dx + f_y(x_0, y_0) dy \quad (3)$$

Vërejtje: Më sipër thamë se diferencueshmëria e funksionit në një pikë siguron ekzistencën e derivateve të pjesshme të tij në atë pikë. Për funksionin e një ndryshoreje kishte vend edhe pohimi i anasjellë: nga derivueshmëria e funksionit në një pikë rridhte diferencueshmëria e tij në atë pikë.

Për funksionin e dy ndryshoreve ky pohim nuk është i vërtetë”.¹¹⁷

3.4.2. Argument i bazuar në silogjizmin kategorik

Ky tip është një argument me tri nivele, në të cilin të gjitha formulimet janë pjesë e një pretendimi për marrëdhënien midis dy a më shumë kategorive. Sipas logjikës induktive tradicionale:

1. Lulet janë bimë.
2. Një tulipan është lule.
3. Tulipani është një bimë.

Rrjedhimisht një argument i bazuar në këtë logjikë do të ishte:

Shembull

Neni 71

1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.
2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit:
 - a. kur ai nuk bën betimin;
 - b. kur heq dorë nga mandati;
 - c. kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3;
 - d. kur mbaron mandati i Kuvendit;
 - e. kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend;
 - f. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”.¹¹⁸

¹¹⁷ Kristaq Kikina – Luljeta Gjoni: “Matematika e përgjithshme”, SHBLU, Tiranë, 2001, fq. 268.

¹¹⁸ QAKAPP: “Kushtetuta dhe materiale shpjeguese”, Tiranë, 1998, fq. 26.

3.4.3. Argument i bazuar në eliminim

Ky tip është një argument që kërkon logjikisht përjashtimin e mundësive të ndryshme derisa të ngelet një mundësi e vetme.

Shembull

“Së pari, duke i trajtuar rasat si kategori gramatikore, ne do të marrim në vështrim edhe formën, edhe përmbajtjen...

Së dyti, duke i trajtuar rasat si përbërëse të një sistemi të vetëm, ne do t'i vështrojmë ato të lidhura me njëra-tjetrën...

Së treti, homonimia e trajtave, më saktë e mbaresave, duhet pranuar vetëm në rrafshin ndërsistemor...

Së katërti, parimi i ndarjes duhet të jetë homogjen...

Duke pasur parasysh katër kriteret e parashtruara më sipër, është jashtë çdo diskutimi qenia e rasave emërore dhe kallëzore, përkatësisht rase e kryefjalës dhe e kundrinorit të drejtë, që në rrafshin formal dallohen midis tyre vetëm në trajtën e shquar njëjës (kusht i mjaftueshëm).¹¹⁹

3.4.4. Argument i bazuar në matematikë

Ky tip është argumenti që bazohet në llogaritje a matje matematikore.

Shembull

Keni tre kana: 8 litra, 5 litra, 3 litra. Kana 8-litërshe është mbushur me ujë. A mund të gjeni një mënyrë për ta hedhur ujin nëpër kana në mënyrë që në fund të ketë 4 litra ujë në kanën 8-litërshe dhe 4 litra ujë në kanën 5-litërshe. Nëpër kana nuk ka asnjë shenjë. Tregoni se si do t'i mbushnit dhe do t'i zbraznit kanat, duke përdorur 8 litra ujë në kanën 5-litërshe. Cili është numri më i vogël i lëvizjeve të duhura për ta zgjidhur problemin?¹²⁰

3.4.5. Argument i bazuar në parime

Ky tip është një argument që kërkon lokalizimin e një X parimi, parim ky i konsideruar si i vlefshëm dhe i zbatueshëm në një situatë të caktuar.

¹¹⁹ Fatmir Agalliu: “Sa rase ka në gjuhën shqipe?” te “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Kombinati Poligrafik, Tiranë, 1988, fq. 114.

¹²⁰ AEDP: “Studio gjithçka, arsyes vendin e parë”, fondacioni SOROS, Tiranë, 1998, fq. 134.

Shembull

*"Shqipja e sotme letrare funksionon për bukuri në veprimtarinë shtetërore, shoqërore, fetare, letrare etj., pra në të gjitha fushat ku mund të përdoret një gjuhë letrare. Shqipja e sotme letrare u sanksionua në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972. Ky kongres është një ngjarje e papërsëritshme, ashtu si p.sh., Kongresi i Manastirit ose Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968). Kongresi i Drejtshkrimit vendosi të njohë si gjuhë letrare të njësuar këtë gjuhë letrare që përdorim sot dhe miratoi parimet themelore të ndërtimit të rregullave të drejtshkrimit. Disa prej këtyre rregullave mund të pësojnë ndryshime të pjesshme, gjithashtu kodi i drejtshkrimit mund të pasurohet me rregulla të reja për çështje të patrajuara te libri i botuar më 1973. Por në themel, në parimet themelore dhe në rregullat më të rëndësishme ky drejtshkrim që kemi, është i qëndrueshëm."*¹²¹

3.4.6. Argument i bazuar në autoritet

Ky tip është argumenti, që në llojin e vet përbën atë të tipit të ashtuquajtur *mbështetës*. Përmendim këtu argumentin e autoritetit, proverbat, diktonet, sloganet (fjala e nderit e dhënë te dikush shërben si provë sigurie, por kjo fjalë do të varet edhe nga personi që e ka dhënë) etj.

Shembull

Në tragjedinë "Jul Qezar" të Shekspirit, Bruti në bashkëpunim me Kasin, vrasin Jul Qezarin, diktatorin e Romës. Autoriteti dhe respekti ndaj Brutit nga ana e Jul Qezarit që absolut, pasi ky e konsideronte mikun e tij më të ngushtë, ndaj dhe në momentin para se të mbyllte sytë, Qezari thërret: *"Dhe ti Brut!"*

CEZARI*Largohu! S'e ngre dot Olimpin!***DECI***Cezar i madh!***CEZARI***Dhe Bruti bie kot në gjunjë.***KASKA***Flisni për mua ju, o duar! (E goditin Cezarin me kama)***CEZARI***Dhe ti, o Brut? Ahere bjer, Cezar! (Vdes)*¹²²

¹²¹ Emil Lafe: "Gjuha dhe shkrimi" te "Gjuha shqipe", nr. 3, vep. e cit., fq. 9.

¹²² William Shakespeare: "Jul Qezari" te "Vëllimi I", shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1982, fq. 125.

3.4.7. Argument i bazuar në analogji

Ky është tipi i argumentit që krahason dy ose më shumë gjëra, me synimin për të dhënë arsye të mundshme që mbështesin një konkluzion. Me anë të këtij lloji parashikohet përfundimi, duke u nisur nga përfundimi i një situatë ose ngjarjeje tjetër të ngjashme (kjo mund t'u përkasë fushave të ndryshme nga çështja jonë në fjalë). Ajo çka është e rëndësishme është masa në të cilën ngjashmëritë përkatëse mund të përcaktohen midis dy konteksteve.

Shembull

"Gjithashtu nuk qëndron asgjëkund kinse argumenti, se standardi duhet të jetë sipas shumicës numerike të folësve. Kundërshtimi më i qartë për këtë është rasti i italishtes. Deri në fillim të shekullit XX italishtja letrare njihej vetëm nga 2,5% e italianëve, por askush nuk kërkonte që gjuha e Dantes, të flijohej për shifrën 97,5%. Sot është arritur ta zotërojnë mbi 60%, ndërsa njëkohësisht ka kujdes shumë më të madh edhe për variantet e tjera të italishtes e për gjuhët e tjera brenda atij territori".¹²³

3.4.8. Argument i bazuar në shenjë (tregues)

Ky tip argumenti, i njohur ndryshe argument shenjues, ka të bëjë me idenë që disa tipe të dhënash janë shenjuese të disa primeve ose përfundimeve më të përgjithshme. Supozojmë sikur të ishte thënë: *"Fakti që Sokrati ishte i ditur dhe i drejtë, është një shenjë që të diturit janë të drejtë"*. Këtu sigurisht që kemi një shenjë; por edhe pse propozimi është i vërtetë, argumenti është i rrëzueshëm, meqë nuk formon një silogjizëm. Supozojmë nga ana tjetër sikur të jetë thënë:

"Fakti që ai ka ethe, është një shenjë që ai ishte i sëmurë".

Këtu kemi llojin e pagabueshëm të shenjës, lloji i vetëm që përbën një provë konkrete, çka sjell një argument të mirëqenë e të pakundërshtueshëm.

Shembull

"Kali lëshoi një hingëllimë të dhimbshme. Të gjithë i mbanin sytë te kulla e tretë, duke pritur që nga grumbulli i këshjtellarëve, që rrinin te bedenat, të fluturonte një shigjetë e dytë. Por shigjetë të dytë nuk pati.

Ata mund ta vrasin kalin po të duan, por nuk e bëjnë këtë gjë për të treguar se nuk kanë ujësjellës - tha dikush me zë të ulët prapa shpinës së pashait... Ne mund ta qëllonim dhe ta vritnim kalin që në fillim, por nuk e

¹²³ Qemal Murati: "Gjashtë pyetje për prof. Xhevat Lloshin" te "Gjuha shqipe", nr. 1, 2007, vep. e cituar, fq. 13.

3.5. Marrëdhëniet argumentuese dhe ato logjike

Jo çdo pohim përbën argument dhe jo çdo gjë e bazuar në logjikë ka të bëjë me argumentin. Një marrëdhënie logjike mbizotërohet nga vërtetësia, pra nga dhënia e vlerave të vërteta fjalive të cilat ne artikulojmë. Ndërsa marrëdhëniet argumentuese nuk mund të përkufizohen si marrëdhënie logjike të veçanta dhe as si të vërteta. Kështu, shpesh e vërteta qëndron te faktorët që nuk janë shqyrtuar, p.sh., mund të ndodhë që një vrasës ka kryer krimin dhe për arsye rastësie apo ngjashmërie fajësohet dikush tjetër. Ajo që e bën një arsyetim të tillë logjik të vështirë është se vëmendja duhet të përqendrohet plotësisht në *atë* që thuhet dhe jo në *atë se si* thuhet.

Kur kuptojmë një thënie, ne përpunojmë jo vetëm fjalët e kësaj thënieje, por edhe informacionin plotësues të sfondit si dhe qëllimet e folësit si p.sh., në rastin e një të moshuari, i cili nuk ka asnjë provë për të treguar se ka jetuar gjatë, përveç moshës së tij. Por, kjo e vërtetë mund të mos jetë si e tillë në kuptimin e mirëfilltë që vërtetësia merr, në rastin kur ndodh të quajmë “plak” apo “të kaluar në moshë” dikë, që ndonëse është i ri në moshë, prapëseprapë jeta e tij është krejt pasive dhe pa interesa sa ajo e një njeriu plak e ulok.

Pra, për sa më lart, sipas një arsytimi logjik deduktiv, premisat e një argumenti deduktiv na garantojnë një vërtetësi të konkluzionit: nëse premisat janë të vërteta, atëherë s’ka se si konkluzioni të jetë i gabuar (i rremë). Por, kjo nuk do të thotë se konkluzioni i një argumenti deduktiv është gjithnjë i saktë (i vërtetë), pasi arsytimi varet nga kuptimi i fjalëve dhe kuptimi i këtyre të fundit nuk varet vetëm nga përkufizimet në fjalor, por edhe nga konteksti, supozimet e përbashkëta dhe asociacionet vetjake ku këto gjejnë përdorim. Ndaj që konkluzionet i kemi të tipit *të vërteta* dhe *të rreme*.

Për sa u tha më lart, le ta argumentojmë konkretisht. Marrim silogjizmin:

1. *Të gjithë fëmijët i pëlqejnë ëmbëlsirat.*
2. *Natalia është fëmijë.*
3. *Prandaj Natalia i pëlqen ëmbëlsirat.*

Vëmë re se konkluzioni që del nga premisat e vërteta, në fakt është i mundshëm. Kjo do të thotë që: Natalia jo domosdoshmërisht i pëlqen ëmbëlsirat. Ajo mund edhe mos t’i pëlqejë ato.

Por gjithashtu mund të kemi:

1. *Të gjithë fëmijët i pëlqejnë ëmbëlsirat.*
2. *Natalia i pëlqen ëmbëlsirat.*
3. *Prandaj Natalia është fëmijë.*

Kjo do të thotë që kemi edhe forma të arsytimit të gabuar.

Apo:

1. *Zoti është dashuri.* (premissa 1)
2. *Dashuria është e verbër.* (premissa 2)
3. *Iliri është i verbër.* (premissa 3)

Për pasojë: *Iliri është Zot.* (konkluzioni)

Vihet re që konkluzioni i rrjedhë nga premisat në të cilat është ndërtuar, nuk ka logjikë, pra, nuk është i vërtetë. Kjo do të thotë që nëse një argument është i dyshimtë që të vlerësohet brenda njësisë së të njëjtës klasë argumentuese, ai mund të vlerësohet edhe negativisht, që do të thotë mbi bazën e falsifikimit.

3.6. Logjika e rreme. Teoria e falsiteteve

Nocioni “logjikë e rreme” ka të bëjë me një nocion të gabuar, një deklaratë apo argument të bazuar në një deduksion të gabuar, apo e thënë ndryshe me pasaktësinë e të arsyetuarit. Në jetën e përditshme ekzistojnë lloje të ndryshme gabimesh logjike që vetë njerëzit bëjnë në prezantimin e pretendimit të tyre. Këto përbëjnë të ashtuquajturën “Teori e falsiteteve”. Është mirë t’i njohim të këtyllat në jetën tonë, pasi kështu mund t’i spikasim menjëherë përgjatë një debati të bërë. Dhe nëse ne evidentojmë te kundërshtari pikërisht këtë lloj arsytimi, të bazuar në një logjikë të rreme, atëherë kjo sigurisht që na jep avantazh. Por të fitosh pikë, nuk është qëllimi final. Qëllimi final është e vërteta. Në fakt, janë vetë këto gabime logjike që fshehin të vërtetën, pasi vetë këto nuk synojnë të bëjnë përcaktime sistematike, të cilat kanë si qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së argumenteve deduktive apo induktive qofshin, por të gjurmojnë e të studiojnë metodat e gabimeve logjike si një mjet i fuqishëm për analizën e arsytimit informal, çka do të thotë me anën e tyre ne gjykojmë të vërtetën, por jo atë që është e drejtë. Ndaj dhe këto lloj gabimesh logjike janë objekt studimi i logjikës informale.

Falsitetet e shkaktuara nga logjika e rreme mund të jenë të disa mënyrave. Le t’i shohim më poshtë.

1. Thirrje *ad hominem* (lat.) e që fjalë për fjalë do të thotë drejtuar njeriut/personit – me anën e kësaj mënyre sulmojmë individin në vend të argumentit.

Shembull

- “Sa leshko që je! Të gjithë të mashtrojnë, të gjithë ta hedhin....Si s’ke turp që u beson? Si s’e sheh që po bëjnë me ty ç’ua do qejfi?”

- E di që, në ndonjë rast, edhe më kanë gënjyer, - foli pa qejf e me gjysmë zëri princi. - Edhe ai është një nga ata, dhe e di që unë e di këtë, - shtoi pa e mbaruar mendimin.

- E di dhe i beson përsëri! Çudi e madhe! Po ne jse, nga ty ç’ nuk pret njeriu. Unë ç’kam që habitem? Po pse a ka parë bota njeri si ti? Tfu!”¹²⁸

2. Thirrje keqardhjes – me anën e kësaj mënyre dëgjuesi nxitet të pranojë argumentin e mbështetur në një apel referues të një emocioni, të një keqardhjeje etj.

Shembull

“Duke dhënë një nga feramat tuaja që vlen njëzet mijë franga, përveç dëmit që na bëni neve, kjo do të thotë që ta trumbetoni në të gjithë botën atë që ndodhi: ju duhej të mendoheshit, të paktën, për emrin e familjes sonë dhe për namnin që do të na dilte...”¹²⁹

3. Thirrje traditës – me anën e kësaj mënyre përpiqemi të bindim dëgjuesin të pranojë diçka, për hir të faktit që është bërë ose është besuar për një kohë të gjatë.

Shembull

“Nëse unë e shoh botën, duke përdorur mendjen time dhe përcaktoj që diçka është e tillë, kjo mbështetet në atë çka qenë gjithmonë ajo gjë. Po nuk është e thënë që ajo të jetë edhe tani dhe në të ardhmen e tillë. Kur ne mendojmë se ziarrin ngroh dhe uji freskon, kjo ndodh sepse të menduarit ndryshe na shkakton mundim. Me fjalë të tjera, ne nuk mund të mos besojmë diçka, po ne nuk duhet të mendojmë që besimi unë bazohet tek arsyeja”.¹³⁰

4. Thirrje forcës, dhunës – me anën e kësaj mënyre i bëhet e qartë dëgjuesit se, nëse nuk e pranon argumentin, diçka e keqe do t’i ndodhë.

Shembull

- “S’po e marr vesh, mos po të kruhet kurrizi, mos do ta vesh me një pëllëmbë?”

- Jo, nuk dua aspak. Veç, letra ju gëzoi, kurse ju këtë nuk doni ta shfaqni. E pse i trembeni asaj që ndieni? Dhe kurdoherë ju ndodh kështu.

¹²⁸ Fjodor Dostojevski: “Idioti”, vep. e cit., fq. 296.

¹²⁹ Gi dë Mopasan: “Një jetë”, shtëpia botuese “A. Z. Çajupi”, Tiranë, 1994, fq. 110.

¹³⁰ Linda Smith – William Raepër: “Një hyrje tek idetë. Besimi dhe filozofia në të shkuarën dhe të tashmen”, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1999, fq. 56.

- S' dua as të shoh e as të dëgjoj më për ty, - brofi e inatosur dhe dyll e verdhë në fytyrë. - Def të bëhesh!

- Kurse pas tri ditësh do vini vetë e do më ftoni për vizitë... Pse bëni kështu? Ato janë ndjenjat tuaja më të mira, pse u dashkan fshehur? Kështu mundoni veten...

- Vdekjen e pranoj, por që ti të më kalosh pragun e shtëpisë, këtë s'kam për ta pranuar!¹³¹

5. Thirrje diçkaje të mirënjohur dhe të pranuar nga shumica – me anën e kësaj mënyre dëgjuesi nxitet të pranojë një qëndrim, pasi pjesa më e madhe e njerëzve e mbështesin atë.

Shembull

- “Po ty, mama, ç'të duhet nëse ata martohen apo jo? Apo pyet veten nëse janë të lumtur? Ç'punë të prish ty?

- Sigurisht, Simone, për ty gjithçka është mirë. Po të të dëgjosh ty, ata që martohen janë budallenj. Nuk e kuptoj pse nuk martohen tani që kanë edhe një vajzë. Nëse, siç thua ti, nuk prish punë, le të martohen atëherë.

- Po lëri rehat të gjorët! Shiko motrën e saj që u martua njëzet e pesë vjeçe dhe tani është si një fuçi e deprimuar.

- Ç'lidhje ka kjo me martesën?

- Eh, e di, e di, nuk ka lidhje fare...

- Megjithatë, ke për të parë se, sapo të gjesh atë të duhurën, do të ndërrosh mendje edhe ti dhe do të martohesh menjëherë, pa e zgjatur.

- Ki besim, mama!

- Ah, po, sigurisht, derisa të vazhdosh të shoqërohesh me ato atje...

- Cilat ato atje? Çfarë do të thuash?

- E kuptove se çfarë dua të them, mos më bëj ta them, se është e diel, por e kuptove. Dhe pastaj, e tha edhe sot në mëngjes Papa në Anxhelus, se po të mos jesh i martuar, nuk je një familje.

- Po, të lumtë, fut edhe Papën në këtë mes tani, se mirë e kemi. Ku di gjë ai për martesat? A është martuar ndonjëherë ai? Sikur të mjaftonte vetëm të martohesh për të qenë një familje, do t'i kishim zgjidhur të gjitha problemet e botës.¹³²

6. Thirrje duke nxitur pyetje – me anën e kësaj mënyre supozojmë që është e vërtetë ajo çka përpiqemi t'i provojmë dëgjuesit.

¹³¹ Fjodor Dostojevski: “Idioti”, vep. e cit., fq. 298.

¹³² Fabio Volo: “Regëtimat e dritës së mëngjesit”, shtëpia botuese “Dudaj” Tiranë, 2012, fq. 39.

Shembull

“Po abati, që nuhaste ngadalë një pisk burrnoi pranë baroneshës së larë në lot, dhe që përpiqej të kryente misionin e tij të zbutësit të gjakrave, vijoi:

- Dëgjoni, zoti baron, ta themi midis nesh, edhe ai bëri si gjithë të tjerët. A njihni shumë burra ju që ju kanë mbetur besnik grave? - Dhe shtoi me një djallëzi të djallëzuar: - Ja, unë vë bast se edhe ju vetë keni historitë tuaja.

Vini dorën në zemër dhe më thoni: A nuk është e vërtetë? - Baroni ishte ndalur i turbulluar përballë klerikut që vijoi:

- Po, pra, keni bërë edhe ju si të tjerët. Ku ta dish bile se nuk jeni burbuletur me ndonjë izmeqarkë të vogël si kjo. Ju thashë se të gjithë kështu bëjnë.

Dhe gruaja juaj s'ka qenë më pak e lumtur dhe as më pak e dashuruar, apo jo?

...Baroni, aq i rrëmbyeshëm dhe i nxehur pak më parë tani s'guxonte të hapte gojën se trembej nga argumentimi që bëri abati qëparë, dhe nga shembulli i vet, të cilin e pati për të rritur i dhëndëri”.¹³³

7. Thirrje një shkak - pasoje – me anën e kësaj mënyre supozohet që pasoja lidhet me një shkak, pasi ngjarjet ndodhin njëherazi.

Shembull

“Kur sosi së lexuari, Xhejni, më e madhja dhe më e mençura ndër ne, u ngrit dhe tha se vetëm një gjë nuk ia mbushte mendjen. “Nëse burrat shkruajnë palaçollëqe të tilla”, pyeti ajo, “atëherë si e paskan humbur rininë nënat tona për t'i sjellë ata në jetë?””¹³⁴

8. Thirrje një argumenti rrethor – me anën e kësaj mënyre vetë personi që niston arsyetimin fillon pikërisht me atë gjë me të cilën do të përfundojë. (Ky lloj argumenti është i ngjashëm me atë të llojit numër gjashtë).

Kështu, përbërësit e një argumenti rrethor do të jenë logjikisht të vlefshëm, pasi nëse premisat janë të vërteta, atëherë edhe konkluzioni duhet të jetë i vërtetë. Një lloj argumenti i këtillë ka pak a shumë këtë formë: *A-ja është e vërtetë, sepse B-ja është e vërtetë. B-ja është e vërtetë, sepse A-ja është e vërtetë.* Kështu, nëse do ta konkretizonim me fjalinë:

Ju nuk mund të më vlerësoni me notën katër (4), pasi unë jam student i shkëlqyer.

¹³³ Gi de Mopasan: “Një jetë”, vep. e cit., fq. 100.

¹³⁴ Virginia Woolf: “Njolla në mur” (tregime), shtëpia botuese “Skanderberg books”, Tiranë, 2011, fq. 8.

mund të themi se pohimi është i ndërtuar mbi bazën e një të dhëne që nuk mund të pranohet si i vërtetë, pasi:

a. Si mund të pohojë vetë studenti të jetë student i shkëlqyer, kur ai ndërkaq u vlerësua me një notë jokaluese, pra, me notën katër.

b. Aq më tepër askush nuk mund të cilësohet si *një student i shkëlqyer* nga pikëpamja e përkufizimit si i tillë, kur dihet se në cilësimin si të këtillë marrin pjesë një sërë faktorësh ndikues: cilësia e shkollës ku vetë studenti ka kryer studimet, cilësia e stafit mësimdhënës, vendi ku është nxënë me dije (krahasojmë këtu: një shkollë të braktisur të një qendre rurale me një shkollë të standardeve evropiane në një kryeqytet të ndonjë shteti) etj.

Ndaj, fakti që studenti është i nivelit *shumë të mirë*, nuk do të thotë që pohimi të jetë i vlefshëm edhe për rastin konkret, pra, nuk do të thotë që ai mos të ngelet në këtë provim.

Kështu, propozicioni në këtë kontekst argumentimi nuk i përmbush standardet e nevojshme të të provuarit të deklaratës e për rrjedhojë është një argument i rremë.

Shembull

“- *Të nesërmen u thye një pjatë dhe zonjusha Lavina shpërtheu e tëra dhe i tha se do ta hiqte nga puna. Gledit i është mbushur mendja se e gjithë kjo s'ndodhi për punë të pjatës, por gjithë mllefi ishte te karfica. Ato kanë menduar se e ka marrë ajo, dhe më pas, e trembur, e ka vënë në vend, kur thanë se do të lajmëronin policinë. Por Gledi një gjë të tillë nuk do ta bënte kurrë.* (flet personazhi Edna)

- *“T'u them të drejtën, e kam mendjen top që ajo e kish marrë. Pastaj u frikësua dhe e la në vend...Gjithsesi asgjë s'mund të thuhet me siguri pa pasur prova”.* (flet Znj. Skinner)

- *“Gledi është vajzë e ndershme, nuk e pat vjedhur atë karficë. Atëherë përse qe aq e bindur zonjusha Skinner? Dhe për më tepër ajo s'është ndonjë marroke, përkundrazi! Përse mezi priste ta dëbonte një kameriere aq të aftë, kur e dinte fort mirë sa e vështirë ishte të gjente një tjetër? E çuditshme, apo jo? Dhe kjo gjë më bëri përshtypje. Jashtë mase. Pastaj edhe diçka tjetër! Zonjusha Emili vuan nga hipokondria. Përse nuk thërriste ndonjë mjek? Këta tipa i kanë fort për zemër mjekët. Ndërsa zonjusha Emili, jo.*

- *Ku doni të dilni mis Marpëll?*

...*“Ua them unë se ku mund ta gjeni. Në shtratin e Emili Skinnerit. Merrjani shenjat e gishtërinjve, po qe se nuk më besoni, por do ta shihni që i kam rënë në të...”*

Ta hajë dreqi! - mërmëriti. - Ndoshta ka të drejtë.

Shumë shpejt u bind se mis Marpëlli kishte me të vërtetë të drejtë.”¹³⁵

¹³⁵ Agatha Christie: “Shërbëtorja shembullore” te “Dëshmitari i akuzës”, vep. e cit., fq. 179 – 189.

9. Thirrje një ndarjeje në pjesë – me anën e kësaj mënyre supozohet se ajo që është e vërtetë për të gjithën, është e vërtetë dhe për pjesët.

Shembull

“- Ç’thua? E di shumë mirë se Zonjusha, para se të vinte në shtëpinë tonë, nuk e njihte Otton.

Heshtën të dyja duke u munduar më kot të gjejnë zgjidhjen. Mendimi i fëmijës u lodh. Pas pak Violeta thotë përsëri:

- Një fëmijë! Është krejt e pamundur! Si mund të ketë një fëmijë? Nuk është e martuar dhe vetëm njerëzit e martuar kanë fëmijë, këtë e di mirë.

- Ndoshta ka qenë e martuar.

- Mos fol budallallëqe! Sidoqoftë, s’ka qenë e martuar me Otton”.¹³⁶

10. Thirrje një dileme false – me anën e kësaj mënyre jepen dy zgjedhje, kur në të vërtetë mund të ketë më shumë zgjedhje të mundshme.

Shembull

“Fakti që Sokrati ishte i ditur dhe i drejtë është një shenjë që të diturit janë të drejtë. Këtu sigurisht që kemi një shenjë, por edhe pse propozimi është i vërtetë argumenti është i rrëzueshëm, meqë nuk formon një silogjizëm...Fakti që ai merr frymë me shpejtësi është një shenjë që ai ka ethe”. Ky argument është gjithashtu i kundërshtueshëm edhe pse deklarata mbi frymëmarrjen e shpejtë është e vërtetë meqë një person mund të marrë frymë me vështirësi pa pasur ethe”.¹³⁷

11. Thirrje dykuptimësisë – me anën e kësaj mënyre e njëjta fjalë përdoret si argument në vende të ndryshme, por që fjala ka kuptime të ndryshme.

Shembull

- “U përmenda dhe zura të ftillohesha nga ky terr një mbrëmje, kur po i afrohem Bazelit, më solli në vete pëllitja e një gomari në pazarin e qytetit. Ajo pëllitje vërtet që më shugulloi, më bëri të shkundem dhe aty për aty për çdo gjë m’u kthjellua në kokë.

- Gomari? Çudi! - vuri në dukje gjeneralesha. - E po edhe të çuditësh s’ka përse se mes nesh nuk janë ta pakta që madje edhe në dashuri mund të bien me një gomar, - tha dhe pa domuze nga vajzat që zbardhnin dhëmbët. - Edhe në mitologji rrëfëhet për këtë. Vazhdoni princ.

¹³⁶ Stefan Cvajg: “Dashuria e guvernantes dhe dy vogëlushet” te “Novela”, shtëpia botuese “Argeta – LMG”, Tiranë, fq. 298.

¹³⁷ Aristoteli: “Retorika”, vep. e cit., Libri I, kapitulli 2, [1357b].

- Që prej kësaj kohe i dua tmerrësisht shumë gomarët. U interesova për ta, se më parë s'më kish rastisur të shihja, dhe u binda që janë kafshë të pashoqe: punëtorë, të fuqishëm, të durueshëm, të lirë, të ambientueshëm; dhe pas kësaj zuri të më hyjë në zemër Zvicra, edhe pikëllimi m'u hoq si me dorë.

- Çudi e madhe është kjo që treguat, por kapërcejeni këtë pjesë për gomarin; hidhuni në ndonjë temë tjetër. Po ti, Agllaja, pse qesh ashtu? Edhe ti, Adelaida? Princi kallëzoi shumë bukur për gomarin. E ka parë me sytë e tij; po ti a ke parë ndonjëherë? Se ti nuk ke qenë jashtë shtetit.

- Unë kam parë gomar, mama, - i tha Adelaida.

- Kurse unë kam dëgjuar, - ia priti Agllaja. Që të tria u shkruanë në gaz.¹³⁸

12. Thirrje një argumenti faji nëpërmjet asociacionit – me anën e kësaj mënyre rrëzojmë një argument a pretendim, pasi personi që e propozon këtë pëlqen dikë dhe ky vetë nuk pëlqehet nga dikush tjetër.

Shembull

“Nëse “ajo që më e madhe nuk mund të mendohet” ekziston vetëm në një mendje, vetë ajo që më e madhe nuk mund të mendohet do të thotë “ajo që më e madhe mund të mendohet”. Po, padyshim, kjo është e pamundur. Pra, nuk ka absolutisht asnjë dyshim që “diçka që më e madhe nuk mund të mendohet” ekziston edhe në mendje edhe në realitet. Pra Anselmi thotë që:

- Zoti është qenia më e madhe që konceptohe
- Ai është më i madhi që ekziston si në realitet, ashtu edhe në mendim.
- Pra, Zoti ekziston.

Qëkurse u shpall, argumentimi i Anselmit shkaktoi tronditje. Një kritik i tha një tubimi lexuesish se kjo ishte njësoj “sikur të shihnin një prestigjator që nxirrte lepurin prej kapeles bosh. Ata nuk mund ta shpjegojnë si u ndodh lepuri atje, po janë fare të sigurtë që, në njëfarë mënyre, prestigjatori e ka futur në kapele.” Pati shumë mosmarrëveshje për faktin nëse Anselmi kishte shprehur një të vërtetë thelbësisht të rëndësishme filozofike apo kishte gabuar në mënyrë të qartë e të padyshimtë”.¹³⁹

13. Thirrje një gabimi zanafillës – me anën e kësaj mënyre përpiqemi për të vërtetuar ose për të rrëzuar një pretendim, për shkak të origjinës apo historisë, pa lidhje me pohimin.

¹³⁸ Fjodor Dostojevski: “Idioti”, vep. e cit., fq. 54.

¹³⁹ Linda Smith – William Raep: “Një hyrje tek idetë. Besimi dhe filozofia në të shkruarën dhe të tashmen”, vep. e cit., fq. 33.

Shembull

*“Kur ne pyesim nëse një rreth katror është i rrumbullakët apo katërkëndësh, ne mund të provojmë se ai është i rrumbullakët, duke u mbështetur tek koncepti “rreth” dhe se ai është katror, duke u mbështetur tek koncepti “katror”. Vetëm se rreth katror nuk ekziston; e njëjta gjë është edhe me mendimin “botë - fenomen”.*¹⁴⁰

14. Thirrje diçkaje tjetër duke shmangur vëmendjen nga çëshja kryesore – me anën e kësaj mënyre bëhet një prezantim hyrës që nuk është i lidhur me çështjen në fjalë.

Shembull

*“Mua ndaj dhe më duan e më qasin në këtë derë, që t’i zbavis mysafirët, - tha. - Se ndryshe, a mund të ketë vend këtu për një si unë? Këtë e kuptoj. Pse, a është e udhës që një si unë të zërë vend në një tryezë me një zotëri aq sqimatar, siç është Athanas Ivanoviçi? Ka vetëm një shpjegim, pra: ndaj dhe më pranojnë, sepse diçka e tillë është e paimagjinueshme”.*¹⁴¹

15. Thirrje një argumenti non sequitur (lat.) e që fjalë për fjalë do të thotë nuk rrjedh – kjo mënyrë përfshin komentet apo informacionet që nuk derivojnë logjikisht prej një premise a konkluzioni.

Shembull

*“Të pranosh si shkak të katastrofës se lumenjtë e Ballkanit derdhën prurjet e tyre në liqenin e qytetit, se u tërbuan retë mizore dhe na sollën shumë lagështi në veri është njësoj si të kërkosh të mbulosh një njollë duke hapur në vend të saj një vrimë”.*¹⁴²

16. Thirrje mohimit (të bësh të bardhën të zezë) – me anën e kësaj mënyrë prezantojmë informacion negativ për një person para se ai të flasë, me qëllim që ta injorojmë argumentin e tij.

Shembull

“Guvernantja duket sikur diçka përgjigjet. Po flet shumë ngadalë dhe të dy çupat nuk mundin t’i shquajnë fjalët e saj, as t’i kuptojnë. Po dëgjojnë pas pak përsëri zërin e nënës së tyre që thotë përsëri po me atë ton të rreptë:

- Arsyetime! Arsyetime!... Të gjitha vajzat e lehta kanë arsyetimet e tyre... po e vërteta është se i dorëzohen burrit të parë që u del përpara pa menduar asgjë!... Ah! Kanë besim në Perëndinë e mirë, e cila nuk do t’i

¹⁴⁰ Zhane Hersh: *“Habia filozofike”*, vep. e cit., fq. 189.

¹⁴¹ Fjodor Dostojevski: *“Idioti”*, vep. e cit., fq. 131.

¹⁴² Roland Ilia: *“A vë njeriu mend nga arsyeja?”* tek e përditshmja *“Shekulli”*, e martë, 14 dhjetor 2010, fq. 18.

neverisë pastaj... Po harrojnë se Perëndia nuk është vetëm e mirë, po edhe e rreptë!

Qëndron pak dhe pastaj vazhdon më me inat!

- Dhe një grua e këtillë vjen në një shtëpi të ndershme dhe bëhet pedagoge, merr përsipër të edukojë vajza të reja... Po kjo është turp! C'them! Është krim! S'besoj të pandehni se do të vazhdoj t'ju mbaj në shtëpi në këtë gjendje... "

Jashtë çupat zgjatin veshët...

Mornicat ua përshkojnë trupin...

Nuk i kuptojnë pa fjalë të gjitha këto, po është e tmerrshme për to të dëgjojnë zërin kaq të inatosur të së ëmës dhe, si përgjigje tani, të qarat e mbytura të guvernantes.

Lotë kullojnë nga sytë e vajzës fatkeqe, po kjo, siç duket, e bën nënën e tyre të inatoset edhe më tepër.

- Këtë dini të bëni tani: të qani!... - i thotë. - Po lotët tuaj nuk më mallëngiejnë aspak. Nuk ndiej asnjë mëshirë për gratë e këtilla, as që bëhem merak ç'do të bëni... Juve e dini shumë mirë kujt duhet t'i drejtoheni tani. Shkoni ta gjeni... Kjo që di është vetëm se nuk mund ta duroj asnjë ditë më tepër brenda në shtëpinë time prezencën e një njeriu që e shpërdoroi kaq paturpësisht detyrën e saj.

Si përgjigje në këtë fjalë, dëgjohet një e qarë e dëshpëruar, e egër, e qarë e një njeriu që pothuajse po vdes, që i trondit çupat jashtë, si të dredhurat e forta që vijnë pas një temperature të lartë.

Kurrë ato s'kishin dëgjuar njeri të qante ashtu.

Dhe thellësisht ndiejnë se një njeri që qante kështu, nuk është fajtor, nuk është e mundur të ketë bërë ndonjë gjë të keqe!... ”¹⁴³

17. Thirrje një deklaratë të veçantë (standard i dyfishtë) – me anën e kësaj mënyre një standard gjen zbatim në një tjetër që është i vetëzbatueshëm.

Shembull

"Kur bëri pyetjen e fundit, Mak Konori iu kthye pa dashur Centoviçit. Mirëpo kampioni botëror rrinte i ftohtë e i qetë si gjithnjë.

- Nuk mund të them asgjë. Sidoqoftë, ai zotëria luajti në mënyrë të jashtëzakonshme dhe tërheqëse; prandaj unë e lashë enkas që ta zhvillonte lojën sipas metodës së tij.

Në këto fjalë e sipër, Centoviçi u ngrit dhe e përfundoi bisedën si një tregtar.

- Në qotë se ai zotëria ose ju zotërinj dëshironi të luani nesër edhe një lojë jam gati të marr pjesë që nga ora tre e tutje.

¹⁴³ Stefan Cvajg: "Dashuria e guvernantes dhe dy vogëlushet" te "Novela", vep. e cit., fq. 304.

Pa dashur vumë buzën në gaz. Secili prej nesh e kuptoi mirë se Centoviçi nuk e la nga shpirtmadhësia të fitonte shpëtimtarin tonë”.¹⁴⁴

18. Thirrje një argumenti kashtë – me anën e kësaj mënyre pohohet një argument goditës, i cili është një përfaqësim më i dobët i së vërtetës.

Shembull

“- Po të kishit bërë mendje vërtet, që t’ia hiqni vetes, Terentjev, - e qeshi Eugjen Pavloviçi, - pas gjithë këtyre komplimenteve, të isha në vendin tuaj, nuk kisha për ta bërë, që gjithë sa janë të pëlcastin nga marazi...

- Jo, por edhe mënyra si është thënë, - ndërhyri Lebedjevi, - “Do vras veten në park, që kërkënd të mos shqetësoj”! Pse llaf që thuhet është ky? S’u shqetësoka njerëzia, sepse do zbreskë tri shkallina deri në park...”¹⁴⁵

19. Thirrje një gabimi kategorish – me anën e kësaj mënyre i vishet një cilësi diçkaje, që në fakt nuk mund ta ketë atë.

Shembull

“Po lopa, si mund t’i ngjisi shkallët si grua e shëndoshë që vjen duke u lëkundur nga pazari, ngarkuar me torba të fryra e me peshë në të dy anët? Si mund të imagjinohet derri me kollare duke shtypur butonin e ashensorit?”¹⁴⁶

3.7. Argumentimi dhe “lufta”

“Argumentimi është luftë” – kanë thënë **George Lakoff** dhe **Mark Johnson**.¹⁴⁷

Kur ne argumentojmë vetvetiu paraqitet një konflikt i pashmangshëm, një konflikt që edhe kur arrin në zbutje apo në “fitoren e paqes” (kur ne arrijmë të bindim të tjerët), prapëseprapë këtë “fitore” e mundëson disi “në mënyrë të dhunshme”. Ky imazh, negativ në pamje të parë, duket sikur lë të kuptojë që procesi argumentues synon më shumë të shkaktojë konflikt, sesa ta zgjidhë atë. Por, korifenjtë e antikitetit, Aristoteli dhe Ciceroni, e ndryshuan të gjithë këtë. Argumenti u shpik për të bindur të tjerët, për të ndryshuar ose për të bërë kompromis pozicionin e tyre në një çështje qendrore. Një argumentim efektiv nuk synon të shpallë thjesht një fitues, ashtu siç ndodh në një lojë futbollit mes dy skuadrash dhe as nuk

¹⁴⁴ Stefan Cvajg: “Novela e shahut” te “Novela”, vep. e cit., fq. 101.

¹⁴⁵ Fjodor Dostojevski: “Idioti”, vep. e cit., fq. 383.

¹⁴⁶ Artan Fuga: “Rënia e qytetit”, Botimet Papirus, Tiranë, 2012, fq. 313.

¹⁴⁷ George Lakoff – Mark Johnson: “Metaphores we live by”. Chicago and London: University of Chicago Press, 1980.

synon të tatojë inteligjencën e marrësit. E rëndësishme në gjithë këtë akt është të bindim të tjerët, që të ndryshojnë mendimin e vet. Siç duket, të dyja janë plotësuese të njëra-tjetrës: “*Argumentimi si tipi i ndërveprimit verbal i destinuar të modifikojë gjendjen e bindjeve të një subjekti, ka veçantinë që nuk vepron direkt mbi tjetrin (p.sh., t'i japësh tjetrit një urdhër), por vepron mbi organizimin e vetë ligjëratës (discourse), e cila është e destinuar të ketë efekte bindëse: thënësi që argumenton i drejtohet bashkëthënësit, për sa kohë që ky i fundit është në pritje të një aktiviteti logjik, në mënyra që ta mbyllë atë në një rrjet fjalish nga të cilat s'mund të shpëtojë*”¹⁴⁸

Retoricienët e rinj pretendojnë që dhuna ka të njëjtin qëllim si argumentimi – konfliktin. Por, nëse dhuna dhe lufta bëhen nëpërmjet forcës, argumentimi bëhet përmes rrugës së arsyes. Pretendimet, pyetjet përreth pretendimeve, kundërshtimet, ndryshimet e pretendimeve, kundërpretendimet ofrohen nga njerëzit, nga grupet shoqërore. Nëse askush nuk do të ofronte pretendime ose kundërpretendime, nuk do të kishte argumentim. Kështu që konflikti është i qenësishëm para argumentimit. Konfliktet argumentuese përfaqësojnë interesa të ndryshme shoqërore. Etosi i një pretenduesi ose i një dhënësi mund të mbështetet fuqishëm në ato interesa që ai (ajo) përfaqëson. Dhe në fund është audienca ajo që zgjidh konfliktin. Kështu që konflikti i vërtetë është midis folësit dhe audiencës dhe jo nëpërmjet palëve shoqërore konfliktuale.

Për sa më lart, arrijmë në përfundimin se, të argumentosh dhe të bindësh kërkon mjeshtëri dhe gati një stil të ngjashëm. Të dyja janë stile shkrimi që synojnë të ndikojnë në mënyra të ndryshme. Në këtë pikë paraprakisht duhet të përqendrohemi mirë te lloji i lokutorit të cilit i drejtohem: lloj neutral, lloj i pavendosur, lloj armiqësor etj., çka do të na bëjë të përcaktojmë qartë strategjinë që do të zbatojmë.

¹⁴⁸ Dominique Maingueneau: “*L’analyse du discours. Introduction aux lectures des archives*”, Hachette, Paris, 1991.



Përfundime për pjesën e parë

> Fusha e Retorikës paraqet interes të veçantë sa i përket argumentimit dhe argumentit. Fillimisht, në kuptimin klasik, shihej si fusha që merrej me aspektet fizike të shprehjes në vendet publike dhe politike (asamble apo salla gjyqi). Ishin oratorët ata që merrnin këtë mision e dilnin përpara auditorit, duke u karakterizuar nga një i folur bukur dhe bindës.

> Aristoteli dhe më pas Sokrati ishin ata që hodhën bazat e mendimit retorik. Përmes logjikës deduktive dhe induktive, të dy mjeshttrat e arsytimit, mëtonin të provonin vërtetësinë apo falsitetin e shumë gjërave të pranuar botërisht apo dhe nga vetë bashkëbiseduesit e tyre. Këta u bënë kështu udhërrëfyesit e arsytimit, elementi bazë që duhej të përshkonte çdo ligjërim retorik.

> Retorika aristoteliane orientonte ligjëruesin në tri elementet bazë që çdo orator duhet të ketë përgjatë ligjërimit: etosin – i lidhur me besueshmërinë e folësit që manifestohet në inteligjencën, karakterin dhe vullnetin e tij të mirë; patosin – i lidhur me ndjenjën, emocionin, psikologjinë, që shkaktohet tek audienca përgjatë fjalimit të vetë oratorit dhe logosin – arsytimet që përshkojnë vijën argumentuese të fjalimit. Sa më të harmonizuara janë këto elemente, aq më realizues dhe përmbushës është ligjërimi retorik.

> Ligjërimi retorik në vetvete bazohej në pesë rregulla klasike, të cilat ishin orientuese dhe zbatuese për cilindo orator në hartimin e ligjërimit të vet. Ato ishin: *inventio* (sajesë) – *dispositio* (përndarje) – *elocutio* (stil) – *memoria* (kujtesë) dhe *actio* (deklamim). Të këtyllat do të bëhen busull orientuese për kohët në vijim.

> Me kalimin e kohës interesimi ndaj fushës së retorikës bëhet më gjithëpërfshirës. Shekulli XIX hap një rrugë të re. Tashmë vihet re se retorika përfshinte më shumë sesa thjesht ligjërimin publik, ligjor dhe atë politik, të menduarin bindës, dhe se argumentimi ishte një faktor i rëndësishëm në shoqëri. Ligjërimi njerëzor nuk është i shkëputur nga kushtet e prodhimit. Kështu, urëlidhësja Pragmatikë, bëri që tanimë, në kuptimin bashkëkohor, retorika të vështrohet si një teori e re, si teoria e ligjërimit bindës, si tërësi e argumentimit, e realizuar nëpërmjet gjuhës së folur dhe të shkruar.

> Retorika e sotme interesohet vazhdimisht për strategjitë e ligjërimit apo për mënyrat e arsytimit joformale të gjuhës si akt komunikimi. Kjo do të thotë se argumentimi arrin efektshmërinë e vet, jo vetëm përmes shprehjes së mendimeve tona, por njëherazi dhe falë organizmit që u bëjmë mjeteve të ndryshme gjuhësore, ndaj në shtjellimin argumentues vijjnë në lojë një sërë fushash: logjika informale dhe të menduarit kritik, dialektika formale, pragma-dialektika, komunikimi etj. Të gjitha këto mjete të

vështruara në përdorim sipas konteksteve të caktuara, bëhen objekt studimi nga gjuhëtarët e sotëm. Ndër zërat kryesorë që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ndikim në studimin e kësaj teorie veçojmë: *Stephen Toulmin, Chaim Perelman dhe Lucie Olbrechts-Tyteca, Oswald Ducrot, Jean-Claude Anscombe*.

› Fjalët 'retorikë' dhe 'argument' në thelbin e përbashkët të tyre kanë *bindjen*. Në fakt vetë *bindja* bëhet qëllim në vetvete më tepër tek argumentimi, sesa në retorikë, pasi retorika nuk është e lidhur me një klasë të vetme subjektsh, por është universale në llojin e vet. Funkcioni i saj nuk është thjesht të bindë, por është më tepër – të zbulojë mjetet që përdorim për të arritur sukses gjatë bindjes.

› Gjatë argumentimit, komunikimi verbal mund të shoqërohet edhe nga komunikimi joverbal ku roli i këtij të fundit është gjithashtu mjaft i rëndësishëm. Ndërveprimet komunikative joverbale përfaqësojnë manifestimet trupore, shprehjet e fytyrës dhe pantomimat.

› Marrëdhëniet *logjike* duhet të mos barazohen me marrëdhëniet *argumentuese* në një tekst argumentues. Jo çdo pohim përbën argument dhe jo çdo gjë e bazuar në logjikë ka të bëjë me argumentin. Një marrëdhënie logjike mbizotërohet nga vërtetësia. Pra, nga dhënia e vlerave të vërteta fjalive të cilat ne artikulojmë. Ndërsa marrëdhëniet argumentuese nuk mund të përkufizohen si një marrëdhënie logjike e veçantë dhe as si e vërtetë.

› Sipas një arsytimi logjik deduktiv, premiset e një argumenti deduktiv na garantojnë një vërtetësi të konkluzionit: nëse premiset janë të vërteta, atëherë s'ka se si konkluzioni të jetë i gabuar (i rremë). Por, kjo nuk do të thotë se konkluzioni i një argumenti deduktiv është gjithnjë i saktë (i vërtetë) pasi arsytimi varet nga kuptimi i fjalëve dhe kuptimi i këtyre të fundit nuk varet vetëm nga përkufizimet në fjalor, por edhe nga konteksti, supozimet e përbashkëta dhe asociacionet vetjake ku këto gjejnë përdorim. Ndaj dhe konkluzionet i kemi të tipit të vërteta dhe të rreme.

› Në jetën e përditshme ekzistojnë lloje të ndryshme gabimesh logjike që vetë njerëzit bëjnë në prezantimin e pretendimit(eve) të tyre. Këto përbëjnë të ashtuquajturën *Teori e falsiteteve*. Me anë e këtyre argumenteve gjykojmë të vërtetën, por jo atë që është e drejtë.

› Argumentimi është një proces përmes të cilit ne i japim trajtë, formojmë vetëgjykimin dhe opinionin tonë. Duke shpjeguar saktësisht përse mbajmë opinionet të caktuara dhe argumentojmë në favor të tyre, na ndihmon vetë ne të qartësojmë mendimin tonë.

PJESA II

TEKSTI ARGUMENTUES

KREU IV

DISA NOCIONE BAZË PËR ANALIZËN E TEKSTIT

4.1. Koncepti “*tekst*” sipas gjuhësisë moderne

Si fillim theksojmë faktin që është mjaft e vështirë t'i japësh konceptit “*tekst*” një përkufizim të vetëm¹⁴⁹. Përderisa çdo lloj teksti ka natyrë dhe strukturë komplekse, atëherë dhe kuptimshmëria rreth tij është e tillë. Për më tepër, edhe vetë kuptimshmëria është e varur nga konteksti ku thuhet ky tekst. Ndaj që në momentin kur jemi përballë dilemës “*Si mund ta kuptojmë konceptin 'tekst'?*” është mirë që të theksojmë mbi të gjitha interesimin tonë vetëm dhe vetëm në kuadrin gjuhësor, sipas perspektivës së lëmisë *gjuhësi teksti*.

Nga punimet qoftë të autorëve të huaj¹⁵⁰, qoftë edhe atyre shqiptarë¹⁵¹, lidhur me përkufizimet që i janë bërë këtij nocioni, vërejmë se thelbi vërtitet drejt hallkave të mëposhtme:

¹⁴⁹ Nëse i referohemi FSHS-së: kuptimet që mbart kjo fjalë janë:

TEKST, ~ **I m.sh.** ~ **E**, ~ **ET**. 1. Fjalë a fjali të një veprë, të një dokumenti etj.; përmbajtje e shkruar ose e shtypur e një veprë e një akti etj.; fjalët e një veprë muzikore, të një kënge etj.; libër, letër etj. ku janë shkruar këto fjalë a fjali. Teksti i dramës. Teksti i telegramit. Teksti i operës.

2. Lëndë mësimore e shtypur në një libër a në një dispensë; pjesë të shkëputura nga një vepër ose nga disa vepra letrare të shtypura së bashku për qëllime mësimore; libër, dispensë etj., që përmban këto materiale. Tekst mësimor. Libraria e teksteve shkollore. I pajisën me tekste.

3. Pjesë e një materiali të shkruar ose të shtypur pa shënime, shpjegimet e ilustrimet për të. Teksti dhe fotografitë. Tekst me shënime. (Shih: FSHS, vep. e cit., fq. 1330).

¹⁵⁰ Një panoramë mjaft të gjerë dhe shtjelluese kanë dhënë bashkautorët Klodeta Dibra dhe Nonda Varfi të “*Gjuhësi teksti*”, vep. e cit., fq. 23 – 31, si edhe autorja Linda Mëniku tek: “*Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*”, vep. e cit., fq. 34 – 43. Duke i referuar dy referencave të mësipërme, veçojmë disa përkufizime që autorë botërorë kanë përcaktuar lidhur me këtë koncept: **Koch-u**: “*Çdo varg fjalish i sistemuar në kohë dhe hapësirë, në mënyrë të tillë që tregon një të tërë, do të mund të çmohet tekst.*”; **Helbig-u**: “*Teksti është një sasi e renditur fjalish kuptimplota (semantike) dhe qëllimplota (pragmatike) midis relacioneve të të cilave qëndrojnë*

kuptimi dhe funksioni, domethënë një tërësi strukturore që në vetëdije pasqyrohet si unitet relativisht i mbyllur i një gjendjeje (rrethane) komplekse.”; **Hasan-i**: “Teksti nuk është thjesht i përbërë nga fraza, ai është i realizuar nga frazat dhe i kodifikueshëm nëpërmjet frazave.”; **Oomen-i**: “Teksti përbën një supershenjë, e cila interpretohet duke iu referuar funksionit të saj tërësor. Teksti është një barazi që nuk mund të barazohet me shumën e kuptimeve të elementeve të tij, sepse shkon përtej kësaj shume.”; **Werlich-i** sjell dy qasje të ndryshme. Nga njëra anë konsideron tekst çdo shprehje që me ndihmën e shenjave të pikësimit të fjalisë prodhon një kod të caktuar dhe nga ana tjetër ai konsideron tekst “shprehje të shkruara të përbëra nga shumë fjalë”. **Mayordomo-ja**: “Teksti është një tërësi e formuar nga një numër n ($n > ose = 1$) fjalish që janë koherente dhe me kuptim...Gjatësia e tekstit, si njësi e parë e rendit gjuhësor që grumbullon njësi gjuhësore më të vogla, nuk është e përcaktuar.”; **Adam-i** e përkufizon si “një strukturë të përbërë nga sekuenca fjalish”; “një rrjet marrëdhëniesh hierarkike”; “njësi relativisht e pavarur, e përbërë nga një numër n sekuencash”; **Charaudeau-ja** shprehet: “Teksti është vënia në formë e një situatë të komunikimit ku përdoren kategori të renditura të gjuhës sipas mënyrave të organizimit të ligjërimit. Të flasësh pra, është një çështje strategjie për lokutorin. Flasim, organizojmë ligjërimet në funksion të identitetit, të imazhit që çdo njeri ka për bashkëbiseduesin e tij, për atë që tashmë është thënë.”; “Teksti është shfaqja materiale (verbale ose semiologjike: gojore/grafike/gjesture) e komunikimit, në një situatë të dhënë për t’i shërbyer të folurit të një lokutori të dhënë” (Shih: Patrick Charaudeau: “Grammaire du sens et de l’expression”, Paris: Hachette, 1992, fq. 643, 645) etj.

¹⁵¹ Studiuesit **Klodeta Dibra** dhe **Nonda Varfi** mbrojnë mendimin e dhënë prej **Jean-Michel Adam-it**: “Teksti është një strukturë hierarkike komplekse që përmban një numër n sekuencash – eliptike ose të plota – të të njëjtit lloj ose të llojeve të ndryshme.” (Shih: Klodeta Dibra – Nonda Varfi, vep. e cit., fq. 31); Sipas studiuesit **Shezai Rrokaj**: “Ne i përmbahemi mendimit se teksti është një njësi mbifrazore në të cilin frazat përbërëse kanë lidhje varësie e kushtëzimi të ndërsjellë. Ai është një vazhdimësi thëniesh të njëpasnjëshme që realizojnë gjuhësisht një mendim të plotë në përputhje me një përvojë të caktuar.” Apo: “Teksti paraqitet si një tërësi e vetëmjaftueshme semantikisht e gramatikisht. Ashtu si dhe tek njësitë e tjera maksimale (fjalë, thënia) edhe teksti paraqitet si një unitet thëniesh të thjeshta, të cilat funksionojnë brenda një hierarkie të caktuar. D.m.th., teksti nuk është shumë algjebrike e thënieve përbërëse të cilat kanë një status të barabartë. Si njësi “e ngopur” nga pikëpamja strukturore, kuptimore e referuese, teksti veçon në përbërje të tij thënie a elemente, të cilat përbëjnë bërthamën rreth së cilës vërtiten si satelitë njësitë e tjera.” (Shih: Shezai Rrokaj: “Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme”, vep. e cit., fq. 99 – 100); Studiuesi **Jani Thomai** duke mbështetur mendimin e prof. **Rexhep Ismajlit** (Shih: Rexhep Ismajli, “Shumësia e tekstit”, 1980, shtëpia botuese “Rilindja”, Prishtinë, fq. 89) lidhur me kufijtë e këtij nocioni pohon: “Tekst mund të jetë çdo thënie që ka një përmbajtje të plotë e të vetëqëndrueshme. Kështu, kufijtë e tekstit janë shumë të gjerë, që nga një fjalë deri te një vepër.” (Shih: “Metoda e analizës së tekstit” te “Teksti dhe gjuha”, vep. e cit., fq. 8); Sipas studiuesit tjetër **Xhevat Lloshit**: “Teksti është një pjesë ligjërimore e shqiptuar ose e folur, që paraqitet e mbyllur ose e përfunduar. Ai është një objekt gjuhësor konkret.”

- veshje materiale e ligjërimit (gojor, i shkruar, semiologjik), ose ndryshe rezultati material i aktit të komunikimit;
- tërësi strukturore e përbërë nga një fjalë a tërësi thëniesh;
- funksionon brenda një hierarkie të caktuar (pra, nuk është një shumë e thjeshtë algjebrike thëniesh);
- përftohet sipas një konteksti të caktuar.

Mendim mbizotërues në studimet e pragmatikës tekstore, në kohët e sotme, është ai i autorëve **Gilles Siouffi** dhe **Dirk van Raemdonck**. Këta shkojnë në të njëjtën hulli mendimi me përcaktimin që kishte bërë pak vite më parë **Sorinne-M. Ardeleanu-ja**¹⁵², sipas të cilëve teksti shihet si “*zinxhir gjuhësor i folur apo i shkruar, që formon një njësi komunikimi*”.¹⁵³ Ky zinxhir mund të përbëhet nga lloje, tipe tekstesh, të cilat ose mund të jenë të njëjta, ose të kombinohen mes tyre. Është pikërisht prania e këtyre ajo çka karakterizon natyrën e një teksti, *shfaqjen më të dukshme të tij*. Ndaj, një tekst mund të jetë: *një rrëfim, një përshkrim, një shpjegim, një argumentim, një monolog (ose dialog), një shpërthim ndjenjash*, por mund të jetë edhe një përzierje, shkrirje e disa ose e të gjitha natyrave të sipërpërmendura, ku gjejmë të mpleksura elemente rrëfimtare, përshkruese, vlerësuese apo shprehje ndjenjash për dikë a diçka përmes monologut apo dialogut. Në këtë rast teksti quhet “*i përzier*”. Realisht, shumica e teksteve janë praktikisht “*të përziara*”. Kështu p.sh.: një tekst shkencor mund të jetë edhe informues, edhe argumentues (kur autori shpalos një hipotezë të tij personale); një tekst

(Shih: Xhevat Lloshi: “*Stilistika dhe pragmatika*”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 1999, fq. 96); Ndërsa studiuesi **Hasan Mujaj** përcakton: “*Tekst quhet lidhja e njësive gjuhësore, gjuhësisht e drejtë dhe kuptimisht e qartë, por (ndonjëherë) edhe një fjalë e vetme, që shërben për të shprehur një intesion kumtues në formën e shkruar ose të folur. Ose: Teksti është manifestim i ndërlidhjes së drejtë të shenjave gjuhësore, të cilat përfaqësojnë një kuptim*”. (Shih: Hasan Mujaj: “*Gjuhësia e tekstit*”, vep. e cit., fq. 35). Studiuesja **Linda Mëniku**, pas një analize përshkruese të hollësishme që u bën përkufizimeve të autorëve botërorë lidhur me konceptin *tekst*, përfundon: “*Në mënyrë më të përmbledhur, nga përkufizimet e dhëna më lart për tekstin, elementet e përbashkëta të përkufizimeve janë: tema e njëjtë; ndarja e brendshme dhe e jashtme, renditja lineare e fjalive, koherenca, ekuivalenca, rimarrja, njësi e mbyllur.*” (Shih: Linda Mëniku: “*Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*”, vep. e cit., në nyjen: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/09/Doktoratura-Linda-Meniku-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gjuhesise.pdf>, fq. 50).

¹⁵² Sorinne-M. Ardeleanu përcaktonte: “*Ky proces që i nënshtrohet tërësisht rregullave të karakterit njohës dhe komunikues, mund të trajtohet si “rezultat material i aktit të komunikimit.”* Shih: “*Repères et principes fondamentaux fans l’analyse du discours*”, Ed.Universitätti “Stefan cel Mare”, Suceava, 1997, fq. 7.

¹⁵³ Gilles Siouffi, Dirk van Raemdonck: “*100 Fiches por comprendre la linguistique*”, Bréal, Rosny, 1999, fq. 138.

kronike përveçse që është informues, mund të përmbajë edhe sekuenca argumentuese, p.sh.:

“Shqipëria e qau dhe e vajtoi vjetë me radhë. Evropa derdhi lotë të hidhura. Të gjithë oborret, anembanë Evropës mbajtën zi, se fama e mirësisë së tij ish e përhapur aq shumë në botë, sa dhe armiqve u vinte keq për vdekjen e tij. Kur e dëgjoi sulltan Mehmeti tha: “Një luan të tillë do mos lindë më dheu kurrë” dhe pastaj shtoi: “Tani Evropa dhe Asia janë të mia! Mjerë krishterimi, se i humbi shpata dhe mburonja!”¹⁵⁴

Të kuptosh një tekst çfarëdo në kuadrin e gjuhësisë së tekstit, do të thotë ta shohësh si marrëdhënie të fenomeneve gjuhësore të ndryshme, të cilat ndihmësojnë dhe sigurojnë ecurinë dhe zhvillimin e tij.

Të kuptosh një tekst do të thotë ta dallosh brenda një radhe të caktuar tekstesh, të cilat ndajnë me të karakteristika të përbashkëta, në nivelin formal dhe në nivelin strukturor të përmbajtjes.

Të kuptosh një tekst do të thotë gjithashtu të dish ta kategorizosh atë në një *tip*, *lloj*, *gjini* të caktuar. Por, kjo e fundit ka sjellë edhe mosmarrëveshje, pasi gjinitë janë kategori të mjegullta, me kufij jo të saktë përcaktimi. Kështu, shpesh termi ‘*gjini*’ është ngatërruar me atë të *gjinive letrare* në letërsi, të njohura ndryshe me termin ‘*zhanër*’, (lat. ‘*genus*’, rrënja ‘*gener*’) dhe kjo ka bërë që herë të mos jepen plotësisht e herë të mpleksen specifikat e sakta të tekstit, sipas pikëvështrimit të gjuhësisë së tekstit.

Të kuptosh një tekst do të thotë të vëzhgosh:

a. rolin e elementeve gjuhësore që marrin pjesë në koherencën dhe kohezionin e tekstit, ndryshimet morfo-sintaksore që pësojnë;

b. karakteristikat e strukturës së përmbajtjes së tekstit – modalitetet shprehëse që ndikojnë në koherencën e tekstit, në vazhdimësinë dhe në integritetin kuptimor të çështjes për të cilën bëhet fjalë;

c. situatën ligjërimore dhe përbërësit pjesëmarrës në të (këta janë të një natyre heterogjene: fraza (të thjeshta, të përbëra), njësi sintaksore komplekse, shprehje parafjalore, ndajfoljore, lidhëzore etj.), faktorë këta që në bashkëlidhje me më të mësipërmit ndihmësojnë në zbërthimin e përmbajtjes së tekstit në të dyja rrafshet: *horizontal* dhe *pingul*¹⁵⁵.

Njohja dhe zotërimi i të gjitha elementeve të sipërpërmendura gjuhësore, do të na shërbejnë si pikat e nisjes për të analizuar llojin e tekstit argumentues sipas perspektivës së gjuhësisë së tekstit.

Pohojmë se koncepte të tilla si: *analizë ligjërimore*, *ligjërim*, *sekuencë*, *strukturë sekuencore*, *tekst*, *thënie (kumtim)*, *akt kumtuës*, *situatë kumtuës*, *thënës*, *lokutorë* janë baza e terminologjisë që zbatohen sot në

¹⁵⁴ Fan Noli: “Historia e Skënderbeut” te “*Vepra*”, 4, shtëpia botuese “Kombinati Poligrafik”, Tiranë, 1989, fq. 197.

¹⁵⁵ Shih: Jani Thomai: “Metoda e analizës së tekstit” te “*Teksti dhe gjuha*”, vep. e cit., fq. 6.

praktikat e analizave të teksteve, sipas kërkesave të reja të gjuhësisë dhe në kuadrin e gjuhësisë së tekstit. Nëse nuk ua dimë kuptimin në thelbin e vet koncepteve të mësipërme, atëherë dhe analiza që ne mëtojmë t'i bëjmë çdo lloj teksti, do të jetë sipërfaqësore, e thatë dhe jofrytëdhënëse.

4.2. Analiza ligjërimore dhe mënyrat e organizimit ligjërimit

Njerëzit e përdorin gjuhën për të ndryshuar ose modeluar të kuptuarit e realitetit ku jetojnë. Gjuha nuk është thjesht abstraksion, por është një përdorim aktiv i lidhur me komunikimin, me nevojat shoqërore dhe individuale. Pra, gjuha nuk është thjesht një organizim i lëndës gjuhësore, por është dhe veshje e mendimeve, e ndjenjave, e emocioneve tona. Është pikërisht ky përdorim i dytë që përdoret zakonisht për të përshkruar *analizën ligjërimore*. *Analiza ligjërimore (discourse analysis)*, nuk është as një metodë kërkimore cilësore dhe as sasiore. Kjo është një mënyre e të vënit në pyetje që iu bëhet metodave kërkimore cilësore dhe sasiore, pra mundëson ngritjen e hamendësimeve ontologjike¹⁵⁶ dhe epistemologjike¹⁵⁷. Me fjalë të tjera analiza ligjërimore nuk është gjë tjetër veçse interpretimi i një teksti a i një çështjeje të caktuar. Kjo analizë na mundëson të zbulojmë të fshehtat që ka teksti. Çdo tekst është i kushtëzuar dhe brendashkruhet në një ligjërimit të dhënë, prandaj kemi dhe termin *analizë ligjërimore*. Fusha e *analizës ligjërimore* njeh katër mënyra të organizimit ligjërimit:

¹⁵⁶ Sqarim: Ontologjia është shkenca që merret me studimin e çështjes, të origjinës, të esencës, të strukturës, të ligjësisë dhe të përcaktimeve të përgjithshme të të qenët si të qenë, pra me pak fjalë shkenca e qenies si qenie. Fjala *ontologji* (prej greq. së vjetër *óntos* – të qenët; *lógos* – dije, teori) shfaqet në fillim të shekullit XVII e përdorur nga Rudolf Göckel dhe Johannes Clauberg, ndërsa për herë të parë, në terminologjinë filozofike hyri përmes Kristian Volfit. Sipas Volfit, ontologjia si disiplinë filozofike është pjesa e parë dhe më e rëndësishme e metafizikës e cila përmban teologjinë racionale, kozmologjinë racionale dhe psikologjinë racionale. Shih nyjen: <http://en.wikipedia.org/wiki/Ontology> Po kështu shih: Didie Zhyllia: “*Fjalor i filozofisë*”, vep. e cit., fq. 305.

¹⁵⁷ Epistemologjia është degë e filozofisë që studion natyrën, metodat, kufizimet dhe vlefshmërinë e dijes dhe të besimit. Ky term bazohet në fjalët greke: “*επιστήμη*” (epistemë) – dije, shkencë; “*λόγος*” (logos) – (arsye). U dha në anglisht nga filozofi skocez James Frederick Ferrier (1808 – 1864). Shumica e debatit në këtë fushë është fokusuar në të analizuarit e natyrës së dijes dhe mënyrës sesi lidhet me nocione të ngjashme si e vërteta, besimi dhe justifikimi. Studion gjithashtu mjetet e prodhimit të dijes. Pra, me pak fjalë, epistemologjia iu përgjigjet pyetjeve: Çfarë është dije? Si fitohet kjo e çfarë dinë njerëzit rreth saj? Shih nyjen: <http://en.wikipedia.org/wiki/Epistemology> Po kështu shih: Didie Zhyllia: “*Fjalor i filozofisë*”, vep. e cit., fq. 98.

1. mënyrën e organizimit shprehës (enonciativ)
2. mënyrën e organizimit rrëfyes (narrativ)
3. mënyrën e organizimit përshkrues (deskriptiv)
4. mënyrën e organizimit argumentues

Çdonjëra nga mënyrat ka një *funksion bazë*, ku ky i fundit korrespondon me qëllimin ligjërues të fjalës së folësit nga njëra anë, si dhe me një parim të caktuar organizimi nga ana tjetër. Ky parim ka të bëjë me raportin që vendoset ndërmjet faktorëve të aktit të kumtimit, organizimit logjik dhe vetë ligjëritimit.¹⁵⁸

Vetëkuptohet ndarja e mësipërme është paraqitje e një tabloje të përgjithshme dhe jo modele të ngurosur, pasi heterogjeniteti i teksteve i përjashton automatikisht si të tilla. Vetëm për efekte studimi mund t'i ndajmë kaq prerazi, pasi ato janë plotësuese të njëra-tjetrës, p.sh., në një tekst narrativ kemi jo vetëm sekuenca narrative, por janë të pranishme edhe sekuenca përshkruese, edhe shpjeguese, pse jo edhe argumentuese.¹⁵⁹

Së fundi, do të shtonim se *analiza ligjërimore* nuk na jep përgjigje absolute të një problemi (çështjeje), por na mundëson të kuptojmë që esenca dhe zgjidhja e këtij problemi qëndron pikërisht në hamendësimet që ne vetë ngremë rreth tij. Duke na mundësuar që t'i bëjmë hamendësimet tona sa më të qarta, *analiza ligjërimore* synon të na ndihmojë të shohim problemin nga një qëndrim më i lartë, duke fituar kështu një pozicionim të qartë të problemit dhe të vetes tonë në lidhje me këtë problem.

4.3. Thënia dhe akti kumtues

Thënia është rezultat i një kumtimi, e raportit që lokutori mban me gjuhën e tij qoftë të shkruar, qoftë të shqiptuar. *Thënia* është e pajisur me kumtimin që marrësi deshifron me ndihmën e një kodi të përbashkët gjuhësor. Kësaj thënieje i korrespondon prodhuesi, i quajtur ndryshe thënës. Në fakt të thënët e diçkaje kërkon jo vetëm dhënien e sinjaleve dëgjimore a pamore, por së pari zgjedhjen e fjalëve e renditjen e tyre, se përndryshe në rolin e thënësit mund të vinim edhe një aparat riprodhimi tingullor. Por, gjatë ligjëritimit tonë, ndodh shpesh që nga ligjëratat e drejtë papritur të hidhemi në ligjëratat e zhdrejtë. Me fjalë të tjera ndodh shpesh ndërhyrja e një situatë kumtimi në një tjetër, dukuri e cila lidhet me një problematikë të veçantë në kuadrin e gjuhësisë së tekstit, atë të heterogjenitetit. Me *heterogjenitet*

¹⁵⁸ Për më gjerë shih: Patrick Charaudeau: "*Grammaire du sens et de l'expression*", vep. e cituar.

¹⁵⁹ Përmendim tregimin e Mark Tueinit: "Një fabul" në "*Është gjallë apo ka vdekur?*", shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1989, fq. 479.

kuptojmë takimin në të njëjtën situatë ligjërimore të elementeve që kanë të bëjnë me burime të ndryshme kumtimi. Në të njëjtin akt kumtues mund të dallojmë shumësi zërash, e njohur ndryshe prej **Oswald Ducrot-it** me termin *polifoni*¹⁶⁰. Brenda polifonisë mund të dallojmë:

1. *thënësit*

2. *lokutorët*

Thënësit janë qenie, zërat e të cilëve paraqiten në kumtim pa mundur t'u atribuohen fjalë precize: ata nuk "flasim" me të vërtetë, por akti kumtues lejon të shprehin pikëpamjet e tyre. Ndërsa me *lokutor* kuptojmë një qenie që në thënie prezantohet si përgjegjës i saj. Ky merr në ngarkim fjalët, por jo pikëpamjen që ato supozojnë. Bëhet fjalë për një proces të supozuar ligjërimor, ku ky lokutor nuk përkon domosdoshmërisht me prodhuesin fizik të thënies. P.sh., në thënien: *Unë i nënshkruari deklaroj se..., unë* i lokutorit të këtij teksti nuk është tjetër, veçse *unë* që nuk jam autori efektiv i kësaj gjëje.

Nga ana tjetër, sa herë flasim për *thënie*, nënkuptojmë njëherazi edhe aktin e të prodhuarit të thënies (jo tekstin e thënies), dhe anasjelltas (çdo akt të thëni nënkupton një thënie). Pikërisht ky akt njihet ndryshe si *akt kumtues*¹⁶¹. Pra, *akti kumtues* është akti i të prodhuarit të një thënieje nga ana e folësit, ku ky i fundit është përgjegjës për atë që thotë. Çdo akt kumtues përfshin këta pjesëmarrës: *thënësin, marrësin* si dhe *marrëdhëniet* mes tyre: rrethanat hapësinore, kohore apo aspektet e tjera të kontekstit.

Në gjuhësinë e sotme, sipas retorikës moderne, koncepti *thënie* konsiderohet përbërës i frazës. Nëse marrim parasysh atë që flet dhe situatën ku ky komunikim realizohet, mund të themi se kjo ligjëratë përbën kumtimin dhe vetë ligjërimi përbën aktin kumtues. Për të bërë një analizë të përshtatshme të aktit kumtues, duhet të marrim parasysh një numër të

¹⁶⁰ Oswald Ducrot: "*Les mots du discours*", vep. e cit., fq. 44. Shembull ilustrimi lidhur me këtë Ducroti merr nga fabula "Kafshët e sëmura nga murtaja" e La Fontenit: *Luani tha...Kam kullufitur bagëtinë/Dhe ç'faj më kishin? Asnjë faj!/Dhe nganjëherë kam ngrënë pastaj edhe barinë./Hidhet dhelpra dinake e thotë:/Ti paske ngrënë dele, po mirë, vërtet e ke/Se qenka një mëkat? Jo, jo, duke i ngrënë/Një nder të madh u paske bërë!.../Pas tigrin e ariut i vjen radha gomarit:/Në një luadh kuvendi kisha hyrë:/I njomë ish bari i shkretë, edhe vdisja urie./Kullota në luadhin, po sa? Veç nja dy fije./Të gjithë sa qenë aty bërtitën: "Bjerini shpejt!/Për këtë faj të rëndë dënimi ish litari./Të hajë barin e huaj! Ç'mëkat! Zot na ruaj!...(La Fonten: "Fabula të zgjedhura", Tiranë, 2005, fq. 103). Për më tepër lidhur me dukurinë e polifonisë shih: Christian Baylon – Xavier Mignot: "*Komunikimi*", vep. e cit., fq. 86.*

¹⁶¹ Termin "*enonciation*" (akt kumtues) e gjejmë të përdorur dhe me shqipërimin "*thëniezim*". Shih: "*Mprehtësi*", nr. 3, 1991, fq. 31, artikull nga Bruno Hongre (autor francez, që ka studiuar e botuar probleme të analizës së tekstit letrar), përkthyer nga Tomorr Plangarica.

konsiderueshëm parametrash si: tipin e aktit kumtues, kontekstin hapësinor dhe kohor, kushtet socio-historiko, kulturore, aktet ligjërimore etj.

4.4. Koncepti i sekuencës

Një tjetër koncept bazë që përfshihet në analizën ligjërimore është dhe *sekuenca*. *Sekuena* përcaktohet si njësi serie logjike bërthamash të bashkuara ndërmjet tyre në një lidhje kompakte. Ishte **Jean-Michel Adam-i** ai që parashtrroi kuptimin që mbart sekuenca më vetvete dhe më tej organizimi sekuencor i gjithë tekstit. Sipas tij: "*Sekuena mund të përkufizohet si strukturë, si rrjet marrëdhëniesh hierarkike, si njësi relativisht e pavarur me një organizim të brendshëm dhe në marrëdhënie varësie/pavarësie me të tërën ku bën pjesë.*"¹⁶² Kështu, çdo lloj teksti shihet si strukturë sekuencore e që përmban një numër n sekuencash, të plota ose mungesore.

Koncepti *i sekuencës* është i lidhur me dukurinë e koherencës tekstore, ku pa këtë të fundit një tekst nuk mund të jetë kuptimplotë e i arrirë. Kur flasim për koherencën tekstore, duhet të kemi parasysh faktin se frazat grupohen në një tekst me **sekuenca** të tipit *narrativ, përshkrues, argumentues, shpjegues-paraqitës, bashkëbisedues-dialogjik, poetik*¹⁶³. Të gjitha këto sekuenca janë në njëfarë mënyre ligje apo rregulla për këto tipe tekstesh. Nëse u pranojmë legjitimitetin këtyre **tipe sekuencave**, na rezulton që tekstet efektive janë realitete heterogjene të përbëra:

- qoftë (ndonjëherë) të një sekuence të një tipi të vetëm;
- qoftë nga sekuenca të tipeve të ndryshme;
- qoftë nga vijueshmëria e sekuencave të të njëjtit tip.

Analiza e sekuencave tekstore tregon se nëse një tekst lidh në përgjithësi shumë sekuenca, këto sekuenca nuk janë unitete përfundimtare. Ato mund të analizohen në dy nivele¹⁶⁴:

1. *mikro-propozicione (njësi të vogla treguese)*
2. *makro-propozicione (njësi të mëdha treguese)*

sepse, ashtu si **fjalja** nuk është një vazhdimësi e thjeshtë fjalësh, një **sekuencë** nuk është një vazhdimësi e thjeshtë frazash, por një njësi **globale**. Koherenca **rezulton nga** lidhjet lineare, por edhe nga rregulla që kanë të **bëjnë me** tërësinë e sekuencës. Kështu, "*sekuenca është në të njëjtën kohë një njësi e përbërë (së cilës i duhet përshkruar struktura e brendshme dhe përbërësit) dhe një unitet përbërës (së cilës duhet që në rastin e teksteve që*

¹⁶² Klodeta Dibra – Nonda Varfi: "Gjuhësi teksti", Tiranë, 2005, fq. 96.

¹⁶³ Jean-Michel Adam: "Types de séquences textuelles élémentaires", Pratiques, 1987, fq. 56.

¹⁶⁴ John Lyons: "Semantica", II, London: Cambridge, University Press, fq. 592.

kanë shumë sekuenca, t'i përshkruajmë lidhjet sekuencore; kalljen, ndërshënien dhe dominimin). Si njësi përbërëse sekuenca është një përbërës i tekstit; si njësi e përbërëse sekuenca është e formuar nga mikro-propozicionet".¹⁶⁵

4.5. Koncepti “gjini” në letërsi dhe në gjuhësi

Termi “*gjini*” sikurse e cekëm më lart, është përdorur tradicionalisht për kategoritë e krijimtarisë letrare. Shkenca e Teorisë së letërsisë bën ndarjen e teksteve sipas:

a) të ashtuquajturave gjini letrare:

1. epike
2. lirike
3. dramatike

b) formës gjuhësore:

1. prozë
2. poezi¹⁶⁶

Por, studimet e vazhdueshme në fushën e gjuhësisë, dëshmojnë që ky term gjen përdorim së fundmi edhe në aspektin pragmatik, duke u lidhur me mënyrën e të folurit (ligjërimin). Zakonisht, analiza e ligjëritit s’ka të bëjë me tekste që i përkasin një lloji unik. Nëse p.sh., i drejtohem ligjëritit politik, duhet të interesohemi për thënie të llojeve si: broshura, trakte, artikuj të shtypit etj. Koncepti *i gjinisë* nuk është lehtësisht i përdorshëm dhe ndaj një thënie mund të ketë një status kompleks. Gjinitë e *ligjëritit* nuk janë kategori jashtëkohore, por realitete historike të pandashme nga shoqëritë në të cilën veprojnë. Ato mund t’i shohim si një aktivitet social i ritualizuar, që i nënshtrohen një tërësie të shumëllojtë parametrash (shqiptimit, statusit të shqiptuesit, statusit të publikut, *topos-it*). Duke qenë këtu, duhet të saktësojmë se ka dallim midis *gjinisë dhe tipit të ligjëritit*.

Ja cilat janë:

1. Koncepti *tip ligjërimi* ka të bëjë me ndërthurjen e qëndrueshme të një tërësie tiparesh (përftesa të përsëritura në një tekst) të ndërvarura; është

¹⁶⁵ Jean-Michel Adam: “*Le récit*”, PUF, Paris, 1984, fq. 136.

¹⁶⁶ Ndërsa në tekstin “*Teoria e letërsisë*”, SH.B.E, Tiranë, 1993, autorët e tekstit nënvizojnë se termi “*zhanër*” në vetvete nuk bën të përdoret edhe për të emërtuar tri kategoritë themelore (prozë, poezi, dramë), edhe llojet e zhvilluara historikisht. Kështu, këta janë të mendimit se termi “*zhanër*” iu shkon më mirë këtyre të fundit. Autorët gjithashtu nuk janë dakord me mendimin që letërsia të ndahet në: 1. prozë 2. poezi, por në: 1. prozë (romani, tregimi, epopeja) 2. dramë (qoftë në prozë ose në vargje) 3. poezi (që afërisht i korrespondon “poezi lirike” antike). Për më tepër shih: Rene Uellek – Ostin Uoren, “*Teoria e letërsisë*”, SHBE, Tiranë, 1993.

një përdorim i gjuhës me disa tipare karakterizuese, që e dallojnë nga përdorimet e tjera. P.sh., dallohet ligjërimi familjar nga ai oratorik. Prirja mbizotëruese është të lidhë tipet e ndryshme të ligjëritimit me sektorë të gjerë të aktivitetit shoqëror.

2. Koncepti i *gjinisë së ligjëritimit* ka të bëjë me një anë të caktuar të një lloji tipi të ligjëritimit. *Gjinia* shfaqet në brendësi të tipit si një pjesë përbërëse e një tërësie më të gjerë p.sh.: *talk-show* është një lloj ligjëritimi në brendësi të tipit të ligjëritimit "televiziv" (edhe ky vetë është një pjesë e tipit të ligjëritimit "mediatik"); apo lloji i ligjëritimit *intim, familjar, ceremonial* etj., qëndron në brendësi të tipit të ligjëritimit *bisedor* e kështu me radhë.

Maingueneau-ja thotë: "*për lokutorin fakti i të zotëruarit të gjinive të ligjëritimit është një faktor i një ekonomie njohëse të konsiderueshme*".¹⁶⁷ Ky përvetësim i gjinive supozon që folësi të mos jetë i detyruar t'i kushtojë vëmendje konstante çdo thënieje në një situatë komunikuese çfarëdo, dhe në të njëjtën kohë, të jetë në gjendje të identifikojë menjëherë një thënie që i përket një tipi të ligjëritimit, edhe nëse bëhet fjalë për një numër të kufizuar të elementeve.

Në filozofinë e ligjëritimit, si më të mirënjohurin do të përmendnim **Bakhtine-in**,¹⁶⁸ i cili u mor me *llojet e ligjëritimit* ("*speech genres*"), mënyrat e të folurit dhe të të shkruarit që njerëzit mësojnë për të qenë së bashku, për të imituar a për të manipuluar. Kështu, këto lloje janë të shumta e të ndryshme p.sh., lloji letër formale drejtuar dikujt është krejt i ndryshëm nga lloji i një liste ushqimesh që bëjmë kur shkojmë në supermarket, apo një leksion i dhënë përpara një auditori të caktuar në universitet, është tjetër lloj ligjëritimi nga ai i një anekdote personale thënë mes miqsh. Megjithatë, ky është një nga vështrimet tërësore të konceptimit të *gjinisë*.¹⁶⁹

Duke qenë tanimë më të orientuar me domethënien e nocioneve pjesëmarrëse në *analizën ligjëritimore* të çfarëdo lloj teksti, më poshtë po përqendrojmë vëmendjen tonë në mënyrën e organizimit ligjëritimor argumentues, në veçoritë dhe tiparet që vetë këtë e karakterizojnë.

¹⁶⁷ Dominique Maingueneau: "*Analyser les testes de communication*", Dunod, Paris, 1998, fq. 49.

¹⁶⁸ Përmendim veprën "*Speech Genres and Other Late Essays*", University of Texas Press, (1986). Të kësaj kohe (1920 – 1930) janë dhe punimet e Norman Fairclough, i cili thekson rolin e kontekstit në një tekst: Gjinitë janë "*mënyra të ndryshme të (bashkë)interpretimit ligjëritimor*" (Fairclough, 2003, fq. 26).

¹⁶⁹ Për informacion më të hollësishëm rreth kuptimshmërisë që ka marrë në gjuhësi koncepti "lloj, gjini" shih: Gunther Kress: "The linguistic expression of social meaning: discourse, genre and text" te "*Linguistic processes in sociocultural practice*", Oxford University Press, 1989, fq. 20.

4.6. Teksti dhe shumëkuptimësia e tij

Tekst është çdo fragment i ligjëritimit dhe i çfarëdo gjatësie, ose e thënë sipas Jakobson-it: “*diçka menjëherë e perceptueshme*.”¹⁷⁰ Çdo tekst mbart një kuptim. Të kuptuarit është një veprimtari në të cilën marrin pjesë: prodhuesi (thënësi, autori) dhe pranuesi (marrësi). Të kuptuarit është përmbajtja gjuhësore që na shërben për të komunikuar, ose e thënë sipas Jakobson-it: “*diçka e kuptueshme, për shembull që mund ta përkthejmë*”. Të dyja së bashku, të kuptuarit dhe teksti, përbëjnë bazat gjuhësore. Mirëpo çdo tekst, ashtu sikurse çdo element gjuhësor, ka kuptim realisht vetëm në një kontekst dhe situatë të caktuar. Lidhur me këtë, vetë poststrukturalistët francezë flisnin për lidhshmërinë e tekstit me kontekstin, si nëpërmjet *ndërtëkst*it dhe *paratëkst*it, ashtu edhe nëpërmjet *metatëkst*it¹⁷¹. Ndaj, një tekst i thënë në kontekste të ndryshme, mbart kuptime të ndryshme (kuptimi është kontekstual). Madje i njëjti tekst mund të interpretohet ndryshe nga

¹⁷⁰ Roman Osipovich Jakobson: “*Essais de linguistique générale*”, Paris, 1963, fq. 62.

¹⁷¹ Gérard Genette, i cili duke u ndalur gjatë te *transtekstualiteti* (epërsia tekstore e një teksti, gjithçka që e vë në lidhje “sekrete” marrëdhënieje, me tekstet e tjera.), bën ndarjen në tipet: 1. *intertekstualiteti*: prania efektive e një teksti brenda një tjetri, citate, plagjiaturë dhe aluzione; 2. *paratëkstualiteti*: marrëdhëniet ndërmjet një teksti dhe paratëkst, ajo që është përreth trupit kryesor të një teksti, siç janë: tituj, nëntituj, ndërtituj, epigrafe, ilustrime, shënime etj. 3. *arkitekstualiteti* – emërtimi i një teksti si një pjesë gjinie apo gjini. (Genette-i i referohet emërtimit nga vetë teksti, por kjo mund të bëhet përmes inkuadrimeve dhe nga vetë lexuesi); 4. *metatëkstualiteti*: ka të bëjë me komentet kritike eksplicite ose implicite mbi një tekst të një tjetri tekst. 5. *hipertekstualitet*: çdo lidhje që bashkon një tekst B (hipertekst) me një tekst të mëparshëm (hipotekst). Bëhet fjalë për procese të shumta që lejojnë të prodhojmë një tekst ose gjini, duke u nisur nga një tjetër. Ky tip është i vështirë të dallohet nga kategoria e mësipërme. (Gérard Genette: “*Palimpsestes*”, Ed. Du Seuil, Paris, 1982).

Ashtu sikurse Genette-i që është marrë gjatë me llojin e rrëfimit (*récit*) (veçojmë veprën e tij kryesore: “*Narrative discourse: An essay in method*”, 1980), do të përmendnim gjithashtu edhe ndihmesën e jashtëzakonshme që ka dhënë gjuhëtari dhe filozofi francez: Roland Barthes me veprat kryesore: “*Mithologies*”, Editions du Seuil: Paris, 1957; “*Essais critiques*”, Editions du Seuil: Paris, 1981; “*Poétique du récit*”, Editions du Seuil: Paris, 1977, si edhe gjuhëtari lituanëz: Algirdas Julius Greimas me veprën e tij kryesore: “*Of Gods and Men*”, 1979 (Shih te: *Studies in Lithuanian Mythology*, trans. Milda Newman, Bloomington: Indiana University Press). Ndërsa ndër emrat shqiptarë do të përmendnim studiuesin dhe kritikun letrar Roland Zisi, i cili në veprën e tij: “*Veçoritë e narracionit dhe të përshkrimit në prozën rrëfimtare të Bilal Xhaferrit*”, shtëpia botuese “Panteon & Afërdita”, Tiranë, 2001, ka bërë një studim të hollësishtë lidhur me tipin e tekstit narrativ, jo vetëm në aspekt letrar, por edhe në atë gjuhësor njëherazi.

njerëz të ndryshëm. Për shembull, nëse shkëpusim një poezi nga Edgar Allen Poe dhe përpiqemi ta analizojmë, befas na mbërthen kureshtia dhe një sërë pyetjesh na lindin në kokë: Vallë ky interpretim teksti që unë bëj a përputhet me atë çka vetë autori ka dashur të thotë?; Interpretimi im tekstor a është në të njëjtën linjë me kuptimin e vërtetë sipas Poe-së?; Nëse hartuesi i tekstit vdes (pra vetë Poe-ja në këtë rast) dhe nuk na thotë kuptimin e vërtetë që teksti i tij mbart, atëherë a vdes bashkë me autorin dhe vetë e vërteta?

Gjatë interpretimit që bëjmë, ne besojmë që kjo është kuptimshmëria e vërtetë. Por, a është ajo vërtet e vërteta? E gjithë kjo ka të bëjë me shumëkuptimësinë e tekstit, pasi të kuptuarit e një teksti varet nga konteksti në të cilin dhe për të cilin thuhet. Madje mund të ndodhë që i njëjti tekst të interpretohet ndryshe nga zëra të ndryshëm e kjo vjen si pasojë e një sërë faktorësh: konteksti i ligjërimit (i sipërpërmendur), qëllimi i lokutorit në ligjërim, niveli i njohurive socio-kulturore i marrësit të tekstit, karakteri i marrësit (gjykon emocionalisht apo objektivist), mosha e tij etj. Ja një ilustrim:

- *“Kush është më i rëndësishëm, ministri i Jashtëm, apo i Brendshëm? - dëgjova ta pyeste vajza kur po largoheshim.*

U afrova edhe më, që të kapja përgjigjen e tij.

- *Hm, si të them. Gjërat e brendshme janë gjithmonë më të rëndësishme.*

- *Po të jashtmet janë më të bukura, - e kundërshtoi vajza.*

Ai qeshi:

- *E paske fjalën për fustanet. Ke të drejtë.”¹⁷²*

Të kuptuarit e tekstit varet gjithashtu nga lidhja e brendshme logjike-semantike e njësive të tekstit: njësive fonetike, morfologjike e fjalëformuese. Kjo lloj lidhje: formë – përmbajtje, na referon në lidhjen domethënie horizontale – domethënie pingule e tekstit. *Domethënia horizontale* – e gjithë pjesa “*mbi sipërfaqe*”, e njohur ndryshe sipas analizës semantike të strukturës tekstore si: *temë*¹⁷³, *e dhënë*¹⁷⁴, *e thënë*¹⁷⁵, ka të bëjë me informacionin e drejtpërdrejtë që jep teksti. *Domethënia vertikale* – e gjithë pjesa “*nën sipërfaqe*”, (*e fshehura ose e nënkuptuara*), e njohur ndryshe si *remë*, ka të bëjë me lidhjet e brendshme të njësive të tekstit, me strukturat e thella.

Sa më mirë t’i kuptojmë dy rrafshet (sipërfaqësor dhe nënsipërfaqësor), aq më thellë hyjmë në përkapjen kuptimore të vetë tekstit. Përkapja e teksti *kërkon* “*të depërtohet në thellësi të tekstit, të mos mbetemi*

¹⁷² Ismail Kadare: “*Vajza e Agamemnonit*”, shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2003, fq. 66.

¹⁷³ Klodeta Dibra – Nonda Varfi: “*Gjuhësi teksti*”, vep. e cit., fq. 68.

¹⁷⁴ Shezai Rrokaj: “*Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*”, vep. e cit., fq. 98.

¹⁷⁵ Hasan Mujaj: “*Gjuhësia e tekstit*”, vep. e cit., fq. 67.

në sipërfaqe, e kjo shërben që përmbajtja e tekstit jo vetëm të kuptohet plotësisht, por edhe të ndihet plotësisht."¹⁷⁶ Artikulimet e bëra lidhur me domethënien horizontale dhe vertikale të tekstit, mund të identifikohen si pikëpamje ose si argumentime. Kështu, krahas arsyeve të njohura, *eksplicite*, arsyetimi ynë përmban edhe arsye të panjohura, *implicite*. Përmbajtja implicite ose e njohur ndryshe si arsyetim i nënkuptuar, përbën një problem qendror në rindërtimin e argumentimit.

¹⁷⁶ Jani Thomai: "Metoda e analizës së tekstit" te "Teksti dhe gjuha", vep. e cit., fq. 7.



KREU V

TEKSTI ARGUMENTUES
ELEMENTET E ORGANIZIMIT TË TIJ NË SHQIPE

5.1. Tipare të përgjithshme të tekstit argumentues

“Ndërsa e pyesja këtë njeri (është e kotë t’ua them emrin, po ju tregoj vetëm se është një nga eksponentët tanë politikë) e bisedoja me të, pata këtë përshtypje o athinas: ishin të tjerët që e mbanin për të ditur, e në mënyrë të veçantë ai e konsideronte vetveten të tillë, ndërsa në të vërtetë, ai nuk ishte aspak ashtu. Atëherë unë u përpoqa t’i tregoja se nuk ishte i ditur, edhe pse ai besonte se ishte. Si përfundim tërhoqa mbi vete gjithë rrufetë e zemërimit të tij dhe të të tjerëve që ishin të pranishëm. Duke u kthyer mendova: “Sigurisht që unë jam më i ditur se ky njeri, megjithëse, në fund të fundit, që të dy nuk dimë asgjë, e nëse unë nuk di asgjë, të paktën jam i bindur për këtë gjë, sepse sado pak, diçka më shumë se ai e di, të paktën për vetë faktin se atë që nuk e di, as që e besoj se e di.”¹⁷⁷

Tipi i tekstit të mësipërm është ai i llojit argumentues.

Mund të përkufizohet *argumentues* një tekst në të cilin shfaqen edhe pse jo të vetme procedimet argumentuese. Teksti argumentues paraqet një program mbi të cilin formulohet një gjykim dhe përmban provat e nevojshme për ta mbështetur këtë.

Ai zhvillohet mes të paktën dy palëve, palë këto që mund të jenë të mirëqena, reale, por mund të jenë edhe të imagjinuara. Në këtë mënyrë kemi të bëjmë me një lloj debati real ose trillues, i cili bazohet në tezat e njërës palë dhe në kundërtezat e palës tjetër. Palët japin një gjykim, mbajnë një qëndrim, duke parashtruar një a disa argumente bindëse të nevojshme e të përshtatshme për të mbështetur interpretimin e vet. Në fund fiton ajo palë që është më bindësja, që ka forcën më të madhe argumentuese.

Po ç’do të thotë të argumentosh?

Të argumentosh domethënë:

1. të ndjekësh një rrugëtim arsyetues, i cili synon vlefshmërinë e një pohimi;

¹⁷⁷ Platoni: *“Apologjia e vërtetë e Sokratit; Kritoni, Fedoni, Elozhi i dashurisë ose simpoziumi”*, vep. e cit., fq. 21.

2. të mbështetesh në një tezë nëpërmjet argumenteve të bazuara në prova dhe arsyetime logjike;

3. të përfshish edhe aftësinë për të tejkaluar paragjykimet e tua, për të ofruar arsye të cilat të mbështesin pozicionin që vendos të mbrosh; kjo kërkon liri dhe para së gjithash qartësim me vetveten, duke peshuar arsyet dhe argumentet.

4. të dish të përballesh me të tjerët mbi një argument të caktuar, duke propozuar një këndvështrim të motivuar, i cili mbështetet në të dhëna, shembuj e argumente të llojeve të ndryshme, me një fjalë të dish të motivosh opinionin tënd, duke përpunuar studimet përsiatëse.

Qëllimi i kësaj lloji tipologjie tekstore nuk është thjesht transmetimi i informacionit, por ai i furnizimit të motiveve më bindëse, të tilla që ta bindin marrësin (lexues - dëgjues) për tezën e hedhur nga dhënësi i mesazhit. Një tekst i tillë kërkon të ndikojë mbi sjelljen e atij që merr mesazhin e emetuesit, pra kërkon ta bindë marrësin për një apo për një tërësi tezash të shfaqura prej vetë atij. Kjo paraqitje e tezave bëhet sipas një kriteri metodologjik të paraqitur në mënyrë esenciale, p.sh.,: nëse një argumentim mund të jetë një diskutim shkencor, është e rëndësishme të dish të seleksionosh me arsyetim provat, në funksion të hipotezave që do të paraqiten. Përplasja e mendimeve dhe e provave nxisin debatin, e që ky të ngelet i tillë deri në fund, duhet të bazohet vetëm në forcën e fjalës, arsyen, logjikën e ftohtë, dhe aspak në emocion apo humbjen e kontrollit. Përndryshe, nuk kemi të bëjmë më me argumentim.

Ky tip teksti mund të dallohet nga tipet e tjera. Konkretisht dallohet:

- nga një tekst narrativ, sepse ky tip është teksti që na rrëfen një histori apo një tërësi faktesh të lidhura zinzhir, të cilat zhvillohen në një kohë e në një vend përkatës.

- nga një tekst përshkruar, sepse ky është tipi i tekstit që “vizaton” apo “pikturon” me anë të fjalëve një realitet, të vëzhguar apo të imagjinuar.

- nga një tekst përsiatës, sepse ky është tipi i tekstit që përshkohet nga përbërës emotivë apo irracionalë, ndryshe nga ai argumentues, i cili përmes argumenteve që ofron, nuk e fsheh qëllimin bindës.

Të njohim një tekst argumentues do të thotë të gjejmë tek ai disa *karakteristika*:

- gjykimin mbi fenomene të veçanta të ekzaminuara;
- nëntokën në të cilën renditen tezat - hipotezat;
- provat e ndryshme, të përshtatshme për të mbështetur interpretimin, duke marrë parasysh vlefshmërinë e tyre logjike.

Tipet e provave mund të jenë:

1. prova të ngjarjes, fakte reale;
2. të dhëna, data, shembuj, (nga të cilat mund të deduktosh diçka);
3. shembuj (raste të veçanta, të cilat mund të përgjithësohen e t'i japin kështu themel një rregulli);

4. referenca apo citime konkrete (mendime ekspertësh). Të këtyllat karakterizohen nga:

- a. kushtet, limitimet, përjashtimet në të cilat provat kanë vlefshmëri;
- b. procedimet retorike të përdorura (ballafaqim, përkufizim, analogji, klasifikim);
- c. të vënët në pah të forcës së fjalës, me anë të mjeteve shprehëse si:
 - konektorë që shprehin lidhje të shembujve, lidhje përmbyllëse, apo lidhje që tregojnë raporte shkaku/efekti etj. (*si pasojë, atëherë, edhe pse, sepse, por, meqenëse, më në fund, përfundimisht* etj.)
 - folje si: *pohoj, provoj, tregoj, verifikoj* (por njëherazi qëllimi mund të jetë edhe kundërshti e diçkaje: *kundërshtoj, nuk jam dakord* etj.).

Me të gjitha këto veçori do të merremi më gjerësisht në vijimësi të punimit.

5.2. Struktura bazë e tekstit argumentues

Etapat e mundshme të një teksti të plotë çfarëdo janë: *një fillim – një zhvillim i brendshëm – një fund*. Njëri lloj i tekstit dallohet nga lloji tjetër mbi bazë organizimi të brendshëm, struktura që ky tekst ka. Ndaj, le të shohim se cila është struktura e një teksti argumentues.

Një tekst argumentues çfarëdo, ka si bazë logjike të vetë organizimit ligjërimor – argumentet, të cilat shfaqen nga të paktën dy palë:

1. **lokutori** që është vetë autori;
2. **interlokutori**, që mund të jetë një a më shumë veta, realisht ose në mënyrë imagjinare e që pozicionohet(hen) në raport të kundërt me autorin.

Procesi i argumentimit fillon me parashtrimin e temës nga pala e parë (lokutori). Tema nuk është e njëjta gjë me tezën. Tema ka të bëjë me çështjen për të cilën autori do të flasë (*exordium*). Shpesh vihet re që në titull e në vijim rreshtohen tregues të tillë si fushat leksikore, përsëritjet, rimarrjet etj., për ta shtjelluar këtë temë. Zakonisht përdoren për parantezë tekste të tipit si: histori të shkurtra nga antikiteti, slogane, proverba e kështu me radhë. Këto ndihmojnë autorin e tekstit për të bërë prezantimin e çështjes së tij (çka përkon të jetë faza hyrëse e vetë tekstit).

Pasi e bën këtë, autorit i duhet të paraqesë opinionin ose pikëpamjen e tij për këtë temë që do të mbrojë përgjatë rrugës argumentuese. Opinioni ose pikëpamja e autorit na referon te **teza** që mund të jetë një ose disa. Lokutori mund të parashtrorë dhe të argumentojë diçka, duke injoruar me kast argumentet e të tjerëve, ose mund të krijojë një debat trillues midis vetes dhe kundërshtarëve, fizikë a imagjinarë. Kështu, për ta realizuar këtë gjë futen të ashtuquajturit **zëra kumtues**, të cilët nënkuptojnë personat që parashtrorë një tezë, qofshin të pranishëm fizikisht apo jo në debat. Pra, ka

aq zëra në tekst, sa ka teza të shprehura. Kjo shumësi zërash ka të bëjë me fjalët që lokutori nuk i merr si të vetat, por i vë në mënyrë të shprehur ose jo mes thonjzave. Qëllimi që lokutori i ka vënë vetes është **efektshmëria** e argumentit. Kjo efektshmëri nuk bazohet vetëm mbi saktësinë e arsytimit, por edhe mbi aftësinë për t'u mbështetur dialektikisht, ndaj që gjithë procesi i argumentimit shtrihet në një plan të caktuar, në të cilin bëhen prezent strategji dhe mënyra të caktuara, të cilat mund të jenë: *shpjegim i thjeshtë, përkufizim, koment, diskutim a debat, analogji, krahasim, ballafaqim, ironi* etj.

Nga ana tjetër qëndron pala kundërshtare – interlokutori, e cila i kundërpërgjigjet tezës (tezave) të autorit me një a disa **kundërteza**. Procedurat logjike që mund të vëre në përdorim kjo palë, janë të ndryshme dhe relative nga kontekstet ku zhvillohet procesi i argumentimit. Si mënyra më klasike është ajo e paraqitjes fillimisht përmes një sinteze të ngjarjeve a të dhënave që parashtron autori i tekstit, duke u ndalur në vijim në argumentin, elementin a detajin më thelbësor, që për palën kundërshtuese është domethënëse dhe ka fakte konkrete për ta kundërshtuar. Në ndihmë të argumenteve të para mund të vijnë edhe procedurat patetike, që ai i mendon se janë në favor të mbrojtjes dhe kundërshtisë së tij, si: shtrimi i një antipyetjeje, përdorimi i një pyetjeje retorike, apo ironisë, përsëritjes, litotës etj.

E gjithë kjo strukturë realizohet nëpërmjet ndarjes në paragrafë, ose sipas terminologjisë së retorikës moderne – në sekuenca, tërësia e të cilave përbën shtjellimin e debatit argumentues. (*gjithë sa më lart përkon me fazën zhvilluese të vetë tekstit*).

Së fundi, gjithë kjo strukturë argumentuese do të rezultojë në një përmbyllje, në një **konkluzion**, vendi drejt të cilit argumenti udhëheq. Fundi në debatin argumentues (që përkon me fazën mbyllëse të tekstit) ka të bëjë me rrëzimin e provave të njëjës palë dhe triumfin e palës tjetër. Konkluzioni është vendi final i gjithë procedurës argumentuese. (*peroratio*)

Më poshtë po paraqesim një model të një teksti të llojit argumentues, pa u ndalur në analizë të thelluar të tij, çka do ta bëjmë në vijim me tekste-shembuj të tjerë. Konkretisht, po ndalemi në artikullin me titull: "*Potenciali i arsimit privat dhe interesat individualë e publikë*", shkruar nga **Ermal Hasimja**.¹⁷⁸

Autori i tekstit preferon të bëjë parashtrimin e temës së tij përmes një paraqitjeje përmbledhëse të debatit, lidhur me qëndrimin e shtetit ndaj çështjes së zhvillimit të arsimit të lartë privat kundrejt atij publik, qëndrim ky, i emetuar në dy teza të kundërta:

¹⁷⁸ E përditshmja shqiptare "*Panorama*" (suplement), e hënë, 10 shtator 2007, fq. 20.

1. shteti e shikon me dyshim dhe ndoshta me armiqësi arsimin privat;
2. shteti po e mbështet ose të paktën po e toleron arsimin privat.

Fill pas prezantimit të tezave subjekti argumentues (pra, vetë autori në rastin konkret) pozicionohet me një gjykim të tijin personal: “Unë do të preferoja të mos i shikoja këto si dy teza të kundërta, por si elemente kundërtë të njëjtë të qëndrimit”. Shkurt: nga njëra anë, shteti shpall dhe ekzekuton relativisht mirë një politikë hapjeje ndaj arsimit privat, ndërkohë që paradoksalisht zbulon edhe elemente të një skepticizmi të thellë ndaj tij dhe njëanshmërie të plotë ndaj universitetit publik... Duhet të jetë e qartë se nuk e shoh sektorin privat dhe publik si armiq të përbetuar, por si konkurrues të njëri-tjetrit”.

Vija logjike e çështjes në fjalë kërkon natyrisht mbrojtjen nga ana e autorit për atë që beson dhe rrëzimin e asaj çka ai nuk e beson dhe gjithë kjo procedurë kërkon thirrjen pranë të argumenteve dhe të kundërgjyqësive.

Më poshtë po i rendisim:

Tabela nr. 5

Argumentet e dhëna për qëndrim pro universitetit privat	Kundërgjyqësive të dhëna për qëndrim skeptik ndaj universitetit publik
Universiteti privat	Universiteti publik
1. realizon lirinë e zgjedhjes;	1. fatkeqësisht nuk ofron mundësinë e lirisë së zgjedhjes;
2. realizon barazinë më të lartë të mundshme të zgjedhjes nga ana e individit në shkallën e nivelit të edukimit të tij;	2. trajton njësoj një student ngelës me një tjetër që dëshiron të investojë;
3. është konkurrues si faktor zhvillimi;	3. deri para disa vitesh nuk ka pasur konkurrencë në arsim;
4. paralizojnë dhe dekonstruktin monopolin shtetëror mbi prodhimin dhe përcjelljen e dijeve;	4. ka ekzistencë kompleksin komunist, ka sjellë prodhimin e qytetarit dhe jo të individit (fati dhe identiteti i të parit lidhet pashmangshmërisht me fatin dhe identitetin kolektiv; ndërsa i dyti është individ i profesionist që dijen e përdor për qëllimet e veta);
5. kontribuon në shfuqizimin e prirjes etatiste;	5. nuk mund të udhëhiqet nga shteti, pasi ky i fundit nuk mund të jetë menaxhuesi më i mirë në

	të gjitha fushat;
6. ka liri zgjedhjeje në interpretimin e shumë çështjeve historike, të cilat janë jo plotësisht të qëndrueshme e të vërteta;	6. ky qëndron besnik dhe i përpiktë i historisë siç është shkruar (autori sjell shembull këtu “falsifikimet” e historisë);
7. plotëson nevojat e segmenteve të tregut të punës përmes degësh që nuk i ka universiteti publik.	7. nuk ofron shumësinë e degëve studimore.

Për tekstin sa më lart do të kishim një tabelë të tillë përmbledhëse:

Tabela nr. 6

HYRJA	Njohja: paraqitja e argumenteve	Kjo paraqitje argumentesh jepet që në titull: fakt-trajtimi diferencial me bursa shtetërore, prej të cilave përfitojnë vetëm studentët e universitetit publik.
ZHVILLIMI	Argumentet: pse sistemi i arsimit të lartë privat qëndron mbi atë publik	Shtatë argumentet e mësipërme.
MBYLLJA	Zgjidhja	Përmes të dhënave dhe argumenteve konkrete shpreh qëndrimin pro universiteteve private.

5.3. Kundërshtimi në tekstin argumentues. Kundërthëniet – kundërargumentet

Në bazën e çfarëdo teksti argumentues qëndron kundërshtimi i të paktën dy palëve. Kështu, argumenteve të njëjës palë i vihen në kundërshtim argumentet e palës tjetër, domethënë kundërargumentet. Por, nga ana tjetër, njerëzit në jetën e tyre të përditshme përdorin edhe kundërthëniet në funksion të këtyre kundërargumenteve. Cili është ndryshimi në fakt mes kundërthënieve dhe kundërargumenteve?

5.3.1. Kuptimi i kundërthënieve. Qesharakja

Në një tekst argumentues dy fjali mund të mos jenë të papajtueshme, por bëhen në saje të rrethanave të veçanta. Teknikat lejojnë të na paraqiten thënie si të pakrahasueshme, por njëkohësisht janë këto teknika, të cilat lejojnë të vendosen papajtueshmëritë, si më të rëndësishmet e gjithë argumentimit.

Dy fjali cilësohen kontradiktore në sistemin formal, kur njëra është mohim i tjetrës. Të paraqesësh fjali kontradiktore do të thotë t'i trajtosh sikur të jenë mohim i njëra-tjetrës. Të tregosh papajtueshmërinë e dy thënieve, do të thotë të tregosh rrethanat të cilat bëjnë të paevitueshme zgjedhjet mes dy tezave të paraqitura. Vetvetiu kur një pohim hyn në konflikt pa justifikime me një opinion të pranuar, atëherë ai bëhet qesharak. Qesharak është ai pohim që shkon kundër logjikës, ose e thënë ndryshe ai që mohon të dhënë apo formulimin e bërë pak më parë. P.sh.,:

Bota e qenieve njerëzore është ajo pa vetë qeniet.

Apo:

Plot do të thotë e zbrazur.

Madje mjafton vetëm një gabim faktesh, për ta hedhur një njeri të zotin te qesharakja. Mjaft të thotë:

$$2+2:2=2$$

kur ndërkohë sipas ligjeve matematikore, dihet që veprimi i pjesëtimit dhe i shumëzimit bëhet më parë se ai i mbledhjes dhe i zbritjes. ($2+2:2=3$).

Thënie e anëtarëve të ndryshëm të një grupi, po kështu i trajtojmë si të papajtueshme, përderisa grupi konsiderohet si një i vetëm.

Edhe një mendim i kundërt me atë që ne vetë kemi pohuar pak më parë, e pse jo dhe në kohë të ndryshme, na nxjerr në pah qesharaken. Por, këtu duhet bërë kujdes: nëse thënie nuk krahasohen me dy kohët e ndryshme të të thënit, pra nëse këtë kohë do ta trajtonim jo si solide, pjesë e një sistemi të cilit ne i referohemi, pra të ndarë, atëherë papajtueshmëria nuk do të ekzistonte.

Nga ana tjetër, do të jetë qesharak jo vetëm ai që i kundërvihet logjikës apo eksperiencës, por edhe ai që kërkon të shprehë parime, pasojat e të cilave janë të paprovuara në shoqëri.

Për sa më lart, të nxjerrët në pah të opinioneve të dikujt, që në fakt janë të papranueshme referuar logjikës ose e thënë ndryshe janë në kontradiktë të plotë me njëra-tjetrën, është një nga kundërshtimet më të forta që mund t'i bëhet vetë argumentimit në tërësi.

Shembull kundërthënieje: kur i njëjti person thotë gjëra të ndryshme në kohë të ndryshme lidhur me po të njëjtin argument:

Berisha për Metën

Tropojë, 2001

“I lir Meta, po e përdor plotfuqishmërinë e shtetit për të manipuluar “me dushk e larushk”, si asnjëherë tjetër e askund tjetër, votat e shqiptarëve dhe e përdori plotfuqishmërinë e shtetit për të ndëshkuar politikisht e fizikisht, me “hunj gome shpinës, pranga në duar e plumba kokës”, opozitën e djathtë që protestonte për çshenjtërimin e votës në Tropojë.”

Berisha për Metën

Fushata, qershor 2005

“Nuk mendoj se mund të largohen socialistët nga pushteti me Lëvizjen Socialiste për Integrim. Përkundrazi, me LSI-në do të ngulen në pushtet ata dhe kjo nuk do të ndodhë, sepse LSI është gjysma e mollës së kalbur, e ndarë në dysh. I lir Meta është një grupacion larg socialdemokracisë, pothuaj aq sa ç’ka qenë Partia e Punës në vitin 1991.”

Berisha për Metën

Krahasimi, mars, maj 2009, kohë kur Berisha fton I lir Metën në qeveri, të cilin më parë e kishte cilësuar si gjysmën e një molle të kalbur: *“Duke thënë këtë që nuk ka koalicion, theksoj se politika është arti i zgjidhjes së problemeve. Si PS-ja dhe LSI-ja, janë një mollë e kalbur, e ndarë më dy pjesë.”*

Pasi pati përsëritur disa herë se nuk do të bënte koalicion me LSI-në - citojmë: *“Aq sa mund të bëj koalicion me Partinë Socialiste, aq mund të bëj me Lëvizjen Socialiste për Integrim. As me njërin dhe as me tjetrën, absolutisht. Nuk janë për koalicion, nuk janë këto forca politike. Më thuaj ti mua se çfarë dëgjove nga programi i tyre, dil e bëj një anketë, pyet 100 shqiptarë dhe nëse do të thonë një fjalë të vetme nga programet e dy forcave.”*

Berisha ndryshon qëndrim:

“Jam këtu për të ftuar publikisht Lëvizjen Socialiste për Integrim, për të krijuar së bashku një qeveri të re, që do të mund ta quanim qeveri e integritit të vendit në BE. Siç deklarova dy ditë më parë, sovranin na dhuroi fitoren, por diktoi koalicionin. Nga partitë, me të cilat programet janë më afër, është LSI-ja. LSI-ja, në programin e saj ka si yll polar integrimin e Shqipërisë në BE. LSI-ja, në programin e saj ka punësimin si kryefjalë të reformave dhe përpjekjeve të saj. LSI-në e ftoj gjithashtu me bindjen time se kjo nuk ka të bëjë me shifrat në Parlament, por ka të bëjë me faktin se ajo është një përfaqësuese dinjitoze e spektrit të majtë.”¹⁷⁹

¹⁷⁹ E përditshmja shqiptare: “Gazeta shqiptare”, e enjte, 3 shtator 2009, fq. 4.

Për sa më lart, kjo lloj mungesë koherence e bën auditorin të humbasë besimin dhe të dyshojë në vërtetësinë e thënieve të ligjëruesit politikan.

Duhet të bëjmë kujdes në dallimin e vlerës që marrin kundërthëniet në lloje të ndryshme tekstesh. Ndryshon vlera e tyre kur autori i tekstit i përdor në tekste të llojit të mirëfilltë argumentues, nga ato kur ky autor i tekstit i vë në përdorim në ato të llojit si zhanër letrar, ku në këto të fundit marrin krejt vlerë artistike, stilistikore¹⁸⁰.

5.3.2. Kuptimi i kundërargumenteve

Kur përpiqemi të shprehemi me argumente ne jemi të vetëdijshëm për argumentet kundër të cilave ne duhet të formulojmë pretendimet tona, si dhe për kundërargumentet që mund të na paraqiten. Procesi i ngritjes së kundërargumenteve dhe kundërshtimeve është një pjesë integrale e ngritjes së argumenteve, e interpretimit dhe e analizës së tyre.

Ekzistojnë mjaft arsye për të paraqitur kundërargumente dhe kundërshtime:

1. një mënyrë është ajo që tregon që autori është i vetëdijshëm për pikëpamjet kundërshtare dhe nuk përpiqet që t'i fshehë ato. Kështu që ka më tepër gjasa ta paraqesim argumentin si të drejtë apo të balancuar për marrësin, çka sjell bindjen.

2. një tjetër tregon që dhënësi mendon për përgjigjet e marrësit, duke parashikuar kundërshtimet që shumë të tillë mund të kenë. Duke njohur marrësin me disa nga pretendimet që i kundërvihen tonave dhe duke treguar se si mund të trajtojmë kundërshtimet e mundshme, ne s'bëjmë gjë tjetër veçse parapërgatitim marrësin për kundërargumentet.

3. tjetra, duke krahasuar pozicionet tona me argumentet ose hipotezat alternative me të cilat ne përballemi, ne sqarojmë pretendimin të cilin mbrojmë.

Kur dikush merret me kundërshtimet ose kundërargumentet, mëton të përdorë një nga tri qasjet:

¹⁸⁰ Përmendim tragjedinë “Sidi” – Pjer Kornej. Shimena, sipas ligjeve të nderit feudal është e detyruar që të marrë gjakun për vrasjen e babait, të kërkojë nga mbreti dënimin me vdekje të Rodrigut. Por, dashuria e saj është akoma më e thellë, kur vihet përballë dilemës: të marrë apo jo hak. Kjo shprehet haptazi mes kundërthënieve të saj të shpeshta, të cilat marrin ngarkesë të veçantë emocionale: “Kërkoj të çgjakësohem, gjakësori m’është’ i shtrenjtë!... Është pak të thuash “e dua”, Elvirë, e adhuroj!// Ndonëse e dua shumë, rreziku i tij më vret!...Kërkoj kokën e tij dhe dridhem q’e kërkoj/Do vdes pas tij dhe prapë dua që ta dënoj...” (Pjer Kornej: “Sidi”, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1960, fq. 46.).

1. Strategjinë e të lëshuarit pe: pranimi i disa vlerave të një pikëpamjeje të ndryshme. Në disa raste kjo do të thotë të pranosh disa përbërës të një argumenti, ndërkohë që refuzon pjesë të tjera të tij.

Shembull

“- A më lejoni ta shkëpus nga shtrati komodinën?

-Natyrisht që jo. Mos e prekni.

-Atëherë nuk kam si t'jua tregoj - tha K. i shqetësuar, a thua se po pësonte ndonjë dëm të madh.

-Nëse e keni të nevojshme për të rrëfyer ç'ju ka ndodhur, atëherë merreni - tha Brystneri e shtoi me zë të lehtë. Po ju lëshoj më shumë se duhet, ngaqë jam e këputur.”¹⁸¹

2. Refuzimin: kjo nënkupton aftësinë për të treguar defekte të rëndësishme në pretendimin e një kundërshtari, gjë që tregon se argumenti i tij/i saj duhet të refuzohet.

Shembull

“Disa gjuhëtarë (Weigandi, Georgievi etj..) mendojnë se emrat e vendeve të trashëguar nga koha e lashtë si Tomor, Shkumbin, Durrës, Vlorë, Devoll, Shkodër etj., nuk kanë pësuar zhvillime fonetike në përputhje me ligjësitë e evolucionit fonetik të gjuhës shqipe. Madje Weigandi dhe Georgievi bëjnë të njëjtën vërejtje edhe për toponimetë latine të Shqipërisë, të cilat sipas tyre, paraqesin pamjen fonetike “të latino-dalmatishtes së vjetër”.

Por Çabej dhe Cimochowski mendojnë krejt ndryshe. Sipas këtyre ato kanë pësuar zhvillime fonetike në përputhje me ligjësitë e evolucionit të sistemit fonetik të gjuhës shqipe, dhe, si rrjedhim, dëshmojnë për autoktoninë e hershme të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme... Prandaj, mendimet e shprehura nga Weigandi, Georgievi etj., për këtë çështje nuk dalin të argumentuara dhe si rrjedhim nuk mund të merren si një mbështetje në të mirë të hipotezës së tyre për një shtegtim relativisht të vonë të stërgjyshërve të shqiptarëve në trevat e tyre të sotme”.¹⁸²

3. Paraqitjen e mungesës së koherencës: do të thotë të tregosh që çështja në fjalë duhet të kuptohet si pikëpamje kundërshtare, ndërkohë që mund të jetë e vlefshme në disa aspekte, por që nuk përmbush kriteret e koherencës të vetë çështjes në fjalë. Se sa mirë dikush ngre kundërshtime dhe merret me kundërgjegje, është një pjesë e rëndësishme e faktit se si ne vlerësojmë suksesin e një argumenti.

Shembull

“Unë dhe gjithë qyteti kemi dy javë që merremi me Parkun. Vjen Saliu tani, dhe në vend të merret me Parkun merret me mua. Ju ndoshta

¹⁸¹ Franc Kafka: “Procesi”, shtëpia botuese “Globus R.”, Tiranë, 1997, fq. 39.

¹⁸² Shaban Demiraj: “Gjuha shqipe dhe historia e saj”, shtëpia botuese “Asdreni”, Tiranë, 1988, fq. 162.

prisni që unë të përgjigjem paraqendë si Saliu por, meqenëse më intereson çështja e Parkut, thjesht do përpiqem të bëj dialog me të. Fjalët e tij janë marrë ekzaktësisht nga fjalimi i tij i djeshëm.

- Qeveria nuk mund të mos investojë për ndërtimin e rrugës së Elbasanit - deklaroi ai në mbledhjen e djeshme.

- Po pse, kush i ka thënë qeverisë të mos investojë në rrugën e Elbasanit? Ne thjesht kemi kërkuar të bëjë publik projektin e miratuar, siç e kërkon ligji.

- Sepse kjo përbën një domosdoshmëri të madhe, për faktin se Farka, e cila pak vite më parë ishte një zonë shumë modeste në popullatë, sot po shndërrohet dora-dorës, në një nga qytetet e mëdha të vendit.

- Farka po shndërrohet në qytet – e bukur kjo, po si do quhen qytetarët e Farkës sipas kryeministrit? Pastaj, nëse Farka po shndërrohet në qytet, pse u dashka të vijë në një qytet tjetër që është Tirana?

- Natyrisht, është e dhimbshme prerja e atyre pemëve atje...

- Mos më trego dhimbjen, se unë jam rritur me atë pemë dhe i kam parë të rriten, ndërsa ti i pe për herë të parë kur zbritë në Tiranë.

- ... Por rruga duhet zgjeruar.

- Kush je ti që vendos se cila rrugë duhet zgjeruar e cila jo? Po që se e vendoske ti, për çfarë na duhen ligjet dhe institucionet?

- Jam i bindur se ata qytetarë të cilët e kanë të domosdoshme rrugën e gjerë, të përshtatshme për të ardhur në qendër të Tiranës, do të votojnë, jo një herë, por shumë herë, për zgjerimin e rrugës.

- Ta zëmë se ka qytetarë që do të votojnë për zgjerimin e rrugës, po për qytetarët që nuk e duan zgjerimin, si i bëhet? Kush i numëroi sa janë njëra palë e sa tjetra? Apo mjafton bindja jote?

- ...Do të votojnë, jo një herë, por shumë herë, për zgjerimin e rrugës.

- Si gjithmonë, ky njeri nuk hoqi dorë nga votimi i të njëjtëve njerëz disa herë...

- Ajo zonë është një lagje banimi tashmë.

- Harroi që tre fjali më lart kishte thënë që ishte shndërruar në qytet të madh. E shihni se kush na qeveris!

- Shoh që për këtë çështje protestonte edhe “shkatërrimtari” i Golemit, njeriu i 100 profesioneve që nuk i del zot asnjërit prej tyre. Ju e dini vetë emrin e tij e nuk ka nevojë ta them. Blla, blla, blla...

- Ka 20 vjet që gjithë PD-ja imiton ato që thotë Saliu. Tani që u plak, po fillon Saliu të imitojë të vetët. E them këtë se kështu më kanë quajtur dikur ministrat e tij me Pangon në krye. Tani po i imiton Saliu fjalët e tyre. E rëndë kjo... ”¹⁸³

¹⁸³ Artan Lame: “Pemët, çështje brezash”. Marrë nga e përditshmja shqiptare “Shqiptarja.com”, e martë, 3 korrik 2012, fq. 4.

5.4. Ekspliciti dhe impliciti në tekstin argumentues

Për aq kohë sa qasja e logjikës formale ishte mbizotëruese, gjërat ishin të thjeshta, pasi sipas logjikës, argumentet që kanë premisa të shprehura qartë, kanë rrjedhimisht një përfundim të shprehur qartë. Por, me zhvillimin që pësoi mendimi retorik, tashmë gjërat nuk ishin më njësoj. Sipas retorikës së sotme argumentimi nuk nënkupton arsyetimin. Një ligjërim argumentues nuk është një ligjërim provash; as një ligjërim, i cili funksionon mbi principet e deduksionit logjik.

Tanimë interesi përqendrohet në strategjitë e ligjërimit apo në mënyrat e arsyetimit joformal të gjuhës natyrore. Kjo do të thotë se në përkapjen e kuptimit të një teksti ndërhyjnë shumësi faktorësh, sikurse përmendëm më lart: konteksti, rrethanat në të cilat ndodh shkëmbimi komunikativ midis dhënësit dhe marrësit të tekstit, qëllimin që ka emetuesi, lloji i marrësit (një grup i caktuar shoqëror apo kushdo), mosha e tij etj.

Ligjërimi njerëzor është ligjërim që nuk mund të shihet i shkëputur nga faktorët e mësipërm. Ndaj që ligjërimi ynë shënon jo vetëm tekstin dhe kontekstin e perceptueshëm, por edhe kushtet e fshehura që sundojnë situatat e përdorimit të gjuhës. Kjo do të thotë që kuptimet e thënieve përmbahen në vlerën e tyre si veprim. Çdo copëz e këtij veprimi përbën një akt të foluri. Me teorinë e akteve të të folurit janë marrë gjatë **J. L. Austin-i**¹⁸⁴ dhe **J. R. Searle-i**¹⁸⁵, roli i të cilëve në gjuhësi është thelbësor dhe i padiskutueshëm.¹⁸⁶ Ne e njohim ekzistencën e akteve të të folurit indirekt, pasi lokutori nuk i thotë auditorit atë çka ai duhet të bëjë; ky i fundit thjesht informohet. Kështu p.sh., kur dhënësi i thotë marrësit “*Sot do të bjerë shi*”, atëherë fillimisht kuptojmë që ky është thjesht një pohim mbi një fakt. Por, gjuha nuk shërben vetëm për të treguar apo për të përshkruar. Ajo shërben edhe për të drejtuar pyetje, për të dhënë urdhra, për të dhënë gjykim, për të falenderuar, përgëzuar etj. Ishte pikërisht **Austin-i** ai që bëri këtë diferencë, duke dalluar dy lloj thëniesh:

1. konstatuese, që mund të shqyrtohen si të vërteta ose si të rreme, pra që verifikohen, që i nënshtrohen kushtëzimit të vërtetësisë. Këto janë thjesht pohime.

¹⁸⁴ John Langshaw Austin (1911 – 1960) – filozof anglez.

¹⁸⁵ John Rogers Searle (1932) – filozof amerikan.

¹⁸⁶ Një ndihmesë e veçantë në literaturën gjuhësore shqipe, lidhur për sa më lart, është dhënë nga autorët: Klodeta Dibra – Nonda Varfi: “*Gjuhësi teksti*”, vep. e cituar; Shezai Rrokaj: “*Strukturalizmi klasik në gjuhësi*”, shtëpia botuese “EIB Voskopoja”, Tiranë, 1994; “*Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*”, vep. e cituar; Xhevat Lloshi: “*Stilistika dhe pragmatika*”, vep. e cituar; “*Komunikimi*”, (përkthim), vep. e cit., e ndonjë tjetër.

2. **ekzekutuese** (performative), që nuk kanë vlerë vërtetësie, nuk verifikohen nga praktika. Ato përdoren për të bërë diçka dhe jo thjesht për ta thënë.

Ndaj që, nëse do ta rimerrim thënien e dhënë më lart “*Sot do të bjerë shi*”, por tanimë në një kontekst të caktuar (p.sh., mamaja i thotë fëmijës në momentin kur ky po del nga shtëpia), atëherë tanimë do të kishim të bënim jo më thjesht me një pohim, por me një thënie ekzekutuese, që përbrenda përmban dukurinë e implicitit. Në këtë rast marrësi i mesazhit nënkupton “*Merr çadrën!*”. Pra, çdo thënie ka vlerën përkatëse në kontekstin e dhënë. **Austin-i** u interesua në veçanti për thëniet me kushtëzim vërtetësie dhe konsideronte se në strukturat e çdo akti të komunikimit mund të gjejmë:

1. *lokutorë*

2. *ilokutorë*

3. *perlokutorë*

Në një akt komunikimi një lokutor prodhon kombinime të tij, të organizuara në sequenca strukturash morfo-sintaksore, të cilat transmetojnë domethënie leksikore dhe gramatikore. Sipas **Austin-it** ky përbën *aktin lokutiv*¹⁸⁷: zgjedhja e koncepteve që do të kthehen në fjalë, e fjalëve që duhet t’u përgjigjen, e renditjes sintaksore, shqiptimi i tingujve ose veprimi i gjetjes së shkronjave, shkurt, gjithçka që përbën thënien në vetvete dhe prodhimin e saj. Por, prej lokutorit **Austin-i** dallon *aktin ilokutiv*¹⁸⁸, i cili ka të bëjë me qëllimin e folësit, me atë që ai synon nëpërmjet realizimit të një thënieje të caktuar. Nëse veprimtaria lokutive ka qenë e rregullt, në parim i adresuari ka në dispozicion bashkësinë e sinjaleve të nevojshme për të rindërtuar aspektin ilokutiv. Ndërkaq, akti ka jo vetëm qëllim komunikues, por njëherazi synon njëfarë efekti mbi interlokutorin çka **Austin-i** e cilëson si *akt perlokutiv*, pra efekt i krijuar nëpërmjet fjalëve.

I njëjti akt gjuhësor mund të përfshijë një numër të madh marrëdhëniesh të ndryshme, e njëjta përmbajtje mund të realizohet me forma gjuhësore të ndryshme (*akti lokutiv*) dhe mund të ketë efekte perlokutive të ndryshme, ndaj që aspektin ilokutiv mund ta konsiderojmë si më të rëndësishmin në përkapjen kuptimore të tekstit. Rrjedhimisht, ekzistenca e këtyre tri aspekteve është mjaft e qenësishme në ligjërimin argumentues.

¹⁸⁷ Sqarim: Shezai Rrokaj te “*Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*”, vep. e cit., fq. 125 përdor terminologjinë e sipërpërmendur, ndërsa Xhevat Lloshi te “*Komunikimi*” vep. e cit., fq. 93, si dhe te “*Stilistika dhe pragmatika*”, vep. e cit., fq. 312 përdor: 1. lokucionar 2. ilokucionar 3. perlokucionar. Për më tepër, shih gjithashtu dhe John Lyons, “*Semantica*”, II, vep. e cit., fq. 730.

¹⁸⁸ Christian Baylon – Xavier Mignot: “*Komunikimi*”, vep. e cit., sqarohet: ilokucionar - marrë nga anglishtja *illocutionary*, e cila ka parashtesën latine *in*, që domethënë “në”; perlokucionar - nga latinishtja *per* - “nëpërmjet”, fq. 93.

Lokutori transmeton diçka me qëllim që jo vetëm të bindë palën dëgjuese, por gjithashtu të shkaktojë një efekt të caktuar te kjo. I rëndësishëm është fakti se *si dhe sa* është në gjendje ky auditor të përkapë gjithë mendimin e thënë (*aspekti eksplicit*) ose të nënkuptuar (*aspekti implicit*) në ligjërim.

Le të marrim dy tekste të llojit deliberativ (politik) dhe të shohim rolin që luan pjesa mbi sipërfaqe dhe nënsipërfaqe në tekstet përkatëse.

Teksti 1.

*“Si çdo model sukcesi e ndryshimi rrënjësor, Tirana pati edhe kundërshtarët e saj, ndër të cilët përfaqësuesin më tipik të politikës së vjetër të së shkuarës, kryeministrin e dikurshëm Sali Berisha, i cili si të gjithë pensionistët e Tiranës së vitit 2011, ka sot mundësinë të pleqërojë në një qytet që iu ofron më të moshuarve plot vende të qeta ku të mund të kalojnë kohën e lirë, apo të shëtisin fëmijët e fëmijëve të tyre.”*¹⁸⁹

Teksti 2.

*“Zoti Edvin Kriza, atje ku je, në atë shesh, që sot, për fat të keq, e ke shndërruar si shesh të kuq, në një kohë që është sheshi i Nënë Terezës, do të të them se bërë çdo gjë të mos lejosh qytetarët të votojnë, të mos lejosh qytetarët të fitojnë. Ti, kurban i 18 shkurtit, do të dalësh në profesion të lirë, si piktori më i dështuar i këtij vendi.”*¹⁹⁰

Për sa më lart, të dy palët transmetojnë tek auditori një informacion (*aspekti lokutiv*), që në fakt nuk kanë për qëllim thjesht të informojnë publikun, por të akuzojnë, të shpotitin, të shprehin kundërshti të hapur, rivalitet, mospajtueshmëri bindjesh politike ndaj njëri-tjetrit (*aspekti ilokutiv*). Si mënyrë për ta bërë këtë, lokutorët përdorin mjete gjuhësore ngjyruese, të tilla që prodhojnë nëntekst. Pra, përmes formës eksplicite, shpërfaqet njëherazi një përmbajtje implicite. Konkretisht, marrësi nënkupton se:

1. lokutori i parë, përmes përcaktimeve të tilla si: *kryeministër i dikurshëm; përfaqësuesi më tipik i politikës së vjetër të së shkuarës; si të gjithë pensionistët/ka sot mundësinë të pleqërojë* - ironizon kundërshtarin e vet politik, duke e konsideruar si njeri të plakur, jo vetëm në kuptimin e drejtpërdrejtë të moshës, por edhe në kuptimin e figurshëm - në kuptimin e ekzistencës së tij politike.

¹⁸⁹ Edi Rama: “Vij nga e ardhmja, kundërshtarët nga e shkuara” tek e përditshmja shqiptare “Panorama”, e shtunë, 17 shkurt 2007, fq. 4.

¹⁹⁰ Sali Berisha: “Pas 18 shkurtit Rama në pension si piktor i lirë” tek e përditshmja shqiptare “Panorama”, e shtunë, 17 shkurt 2007, fq. 4.

2. lokutori i dytë përmes përcaktimeve të tilla si: *Zoti Edvin Kriza; e ke shndërruar si shesh të kuq; kurban i 18 shkurtit* - akuzon kundërshtarin e vet politik, duke e konsideruar si njeri të luftës e jo të paqes. Ky përcaktim del nga përshkallëzimi kuptimor që marrin mjetet gjuhësore të përdorura:

a. me fjalën “*i kuq*” bëhet asosacion i nocionit të ngjyrës së kuqe - *ngjyra simbolike e PS-së, me ngjyrën e kuqe të gjakut;*

b. me fjalën “*shesh*” bëhet asosacion, duke e lidhur këtë nocion me *fushën e betejës;*

c. me fjalën “*kurban*” bëhet asosacion me *njeriun që flijohet në emër të diçkaje;*

d. me emrin e “*Nënë Terezës*” gjithashtu. Vetvetiu ky emër nënkupton *Simbolin e Paqes dhe të Mirësisë*. Kështu, përmes përdorimit të implicitit, lokutori cilëson kundërshtarin e tij politik - *si njeri i luftës: “Ky njeri e ka shndërruar sheshin e Nënë Terezës në shesh të kuq”*. Në mbështetje të këtij cilësimi shërben dhe mjete tjetër gjuhësor: “*Kriza*”.

Dukuria e implicitit shfaqet jo vetëm përmes kuptimeve të fjalëve dhe ngjyimeve që ato marrin në kontekst, por edhe përmes shenjave të pikësimit, shenjave grafike (kur teksti jepet në formën e shkruar), apo zërit, intonacionit të lokutorit (kur teksti jepet në formën verbale). Të gjitha këto mjete krijojnë një efekt të caktuar te publiku: mosbesim, zemërim, tallje, përbuzje etj. (*aspekti perlokutiv*).

Punimet në literaturën e sotme të gjuhësisë moderne, i kushtojnë interesim të veçantë arsyeve dhe elementeve të nënkuptuara në ligjëratën argumentuese.¹⁹¹ Nocioni i *Teorisë së argumentimit* i zhvilluar nga **Anscombre-ja** dhe **Ducrot-i**, lidhet me faktin që vlera argumentuese e aktit kumtues përcaktohet nga vlera argumentuese e thënies. Sipas **Moeschler-it**¹⁹²: “*T’i japësh në mënyrë eksplicite apo implicite një orientim argumentues thënies tënde, s’do të thotë gjë tjetër, veçse të realizosh një akt orientues argumentues*”. Kjo do të thotë që folësi vë në përdorim jo vetëm shumëkuptimësinë e fjalëve, por edhe disa tregues të veçantë, duke e orientuar të thënë e tij drejt një orientimi argumentues. Lidhur me këta tregues, së fundmi janë marrë gjatë **Gilbert-i** (1991)¹⁹³ dhe **Blair-i** (1992)¹⁹⁴,

¹⁹¹ Përmendim studiuesit: Robert Ennis, R. H.: “Identifying implicit assumptions” te *Synthese* 5, 1982; Trudy Govier: “*Problems in argument analysis and evaluation*”, Dordrecht: Foris, 1987; Frans van Eemeren dhe Rob Grootendorst me veprat: “*Logic and argumentacion*”, Amsterdam, SICSAT, 1996 dhe “*Argumentation, communication, and fallacies. A Pragma - Dialectical Perspective*”, Hillsdale, N-J, Lawrence Erlbaum Associates, 1992.

¹⁹² Jacques Moeschler: “*Argumentation et Conversation – Eléments por une anale pragmatique du discours*”, vep. e cit., 1985.

¹⁹³ Gilbert, M.A.: “The enthymeme buster: a heuristic procedure for position exploration in dialogic dispute” tek “*Informal Logic* 13”, nr. 3, 1991, fq. 159 – 166.

të cilët duke i referuar nocionit të *topos-it*, qartësojnë edhe më funksionin e arsyeve implicite në një ligjërimit argumentues.

5.5. Konektorët dhe operatorët argumentues. Klasifikimi i tyre

Procesi i argumentimit nuk realizohet vetëm falë pranisë së argumenteve të ndryshme në formë prove, të dhëne e kështu me radhë. Në ndihmë të tij vijnë e ndërhyjnë edhe mjete të tjera si: *një pyetje, një mohim, një ndajfolje sasive, një pashirrmë* etj., mjete këto, të cilat analiza semantike tradicionale i kishte neglizhuar. Këto mjete përbëjnë një kategori të veçantë e që shërbejnë si mjete bazë në ligjërimit argumentues, të njohur nga gjuhësia e tekstit si *konektorë*.

Konektorët janë mjete lidhëse që shërbejnë për të bashkuar dy ose më shumë thënie, duke i dhënë secilës një rol të caktuar në një strategji argumentuese.

Konektorët nuk janë lidhëza. Nëse lidhëzat janë trajtuar nga gramatika tradicionale në kuadrin përtej fjalisë (plani ndërfrazor), përkundrazi, konektorët shihen nga këndvështrimi i gjuhësisë së tekstit si mjete lidhëse në gjithë gjatësinë e tekstit/ligjërimit (plani transfrazor).¹⁹⁵

Shumë autorë të huaj i kanë studiuar me imtësi, duke iu dhënë jo vetëm zërbërthimin kuptimor në kuadër të gjuhësisë së tekstit, por njëherazi edhe duke i klasifikuar ata.¹⁹⁶ Nga tërësia e tipologjive të propozuara do të veçonim për sa më poshtë vijojnë: (kuptohet që interesi ynë do të lidhet kryesisht me ata të llojit argumentues).

¹⁹⁴ Anthony Blair – Ralf Johnson: “Argumentation as dialectical” tek “*Argumentation I*”, nr. 1 1987, fq. 41 – 56.

¹⁹⁵ Përmendim punimet: Oswald Ducrot: “*Note sur l’argumentation et l’acte d’argumenter*” në: Cahiers de Linguistique française, Université de Genève, 1982. Ky i cilëson këto si “*fjalët e ligjërimit ose konektorë argumentues*”; Jacques Moeschler – Eddy Roulet: “*Argumentation et Conversation*”, vepër e cituar; Roulet, E., “*L’articulation du discours en français contemporain*”, vep. e cituar). Këta u ndalën në karakteristikat semantike, sintaksore e pragmatike të konektorëve në proceset argumentuese; Jean-Claude Anscombe – Oswald Ducrot: “*L’argumentation dans la langue*”, vep. e cituar. Këta u ndalën në llojet: udhëzues argumentues dhe udhëzuesit të kumtimit; Anne Reboul – Jacques Moeschler: “*La pragmatique aujourd’hui. une nouvelle science de la communication*”, Paris: Le Seuil, 1998 etj.

¹⁹⁶ Vlen të theksojmë që edhe në literaturën shqiptare është bërë një punë mjaft e çmuar lidhur me trajtesën që u është bërë konektorëve në veçanti e ku do të veçonim punimet e autorëve: Viktor Bakillari, Linda Mëniku, Arbër Çeliku, Bledar Toska (punime të cituara qysh në hyrjen e punimit tonë).

I. Lloji i parë i ndan në dy kategori të mëdha:¹⁹⁷

1. ata që udhëheqin tekstin, duke u nisur nga realiteti në funksion të kohës dhe të hapësirës. Të këtillët janë *konektorët kohorë* dhe *konektorët hapësinorë*. Këto lloje mbizotërojnë në tekstin narrativ dhe përshkruar.

a. konektorët kohorë funksionojnë për të shënuar një vazhdimësi kronologjike të ngjarjeve (kryesisht në tekstet narrative): *pastaj, në vazhdim, herën e parë* etj.

b. konektorët hapësinorë strukturojnë më tepër një përshkrim: *aty, përballë, këtej, lart, poshtë, përpara, pas*. Pjesa më e madhe formojnë çifte antonimike: *nga njëri krah/nga tjetri; nga njëra anë/nga ana tjetër; përballë/pas* etj.

Shembull: “Kam boll kohë të mendohem në *këtë* vjeshtë kaliforniane. Duhet të mësohem me time bijë dhe të mos e sjell ndërmend si atë vajzën e këndshme e të qeshur të mëparshme dhe as të bjerrem midis vegimesh pesimiste të së ardhmes, por ta marr çdo ditë ashtu si vjen, pa prituri mrekullira. Paula, që të mbijetojë, varet prej meje, tashti më përket përsëri, përsëri është në krahët e mi si një foshnje e porsalindur, për të kanë mbaruar gëzimet e lodhjet e jetës. Fle me copa dhe zgjohem tash e parë e bindur se është duke më thirrur, ngrihem përnjëherësh me vërtik dhe vrapoj në dhomën e saj, ku gjithmonë do të ketë diçka që s’është në rregull: i është ngritur temperatura apo tensioni, është duke djersitur apo ka të ftohtë, është zënë keq apo e kanë mbërthyer ngërçet. Gruaja që i shërben natën zakonisht zë e dremtit kur mbarojnë programet televizive në spanjisht. Atëherë unë shtrihem në një shtrat me Paulën dhe e shtrëngoq në gji, duke e rregulluar sa të jetë më mirë, sepse është më e madhe me trup se unë dhe lutem të ketë paqe...”¹⁹⁸

2. ata që ndjekin etapat e një arsytimi. Të këtillët janë *konektorët argumentues* si dhe *konektorët enumerativ* (numëruar). Këto lloje mbizotërojnë në tekstin argumentues.

a.konektorët argumentues japin provat për të justifikuar dhe për të nxjerrë një përfundim, për të dhënë argumente apo për t’iu kundërvënë këtyre argumenteve me të tjera më të forta: *pastaj, pra, por, jo vetëm*.

b.konektorët numëruar formojnë një lloj serie: *në fillim, pastaj, në vazhdim, në fund; në një krah, në krahun tjetër, në vend të parë, në vend të dytë, së fundmi, për të përfunduar* etj.

¹⁹⁷ Anne Reboul – Jacques Moeschler: “La pragmatique aujourd’hui. une nouvelle science de la communication”, vep. e cit., fq. 112. Gjithashtu shih dy nyjet e mëposhtme:

<http://pagesperso-orange.fr/j.dussieux/c-stjeandy/Le%20livret%20autocorrectif.pdf>
<http://artic.ac-besancon.fr/ienluxeuil/cqImdsavoir.doc>

¹⁹⁸ Izabel Aljende: “Paola”, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1999, fq. 255.

Shembull: “Sugjerimet e viteve 1881 dhe 1899 janë të ndryshme, por shërbejnë për arritjen e përfundimeve të ngjashme. Frashëri dëshironte bashkëveprimin e dialekteve, me qëllim që të mënjanohehin ato që ai i mendonte se ishin burim i përçarjes së shqiptarëve dhe me synimin në të njëjtën kohë për ta kthyer gjuhën shqipe, në një gjuhë të vetëmjaftueshme, për sa i përket leksikut të saj. Por, përveç kësaj, ai kishte vizionin e gjuhe të përbashkët letrare (të bazuar në një nëndialekt të Shqipërisë së Mesme), e cila do të mundësonte gjithashtu bashkimin e popullit.”¹⁹⁹

II. Një lloj i dytë është ai që i ndan në:²⁰⁰

1. konektorë logjikë;

2. konektorë që saktësojnë organizimin tekstual;

3. konektorë që shprehin qëndrimin e folësit apo të shkruarit.

Të tri llojet dallohen nga njëri-tjetri:

-Të parët lidhin thënien paraardhëse me atë pasardhëse, ose përmbajtje të ndryshme të tekstit.

Shembull: “Që ka pasur më parë disa shpjegime të sjelljes së Helenës, kjo dukej qartë edhe nga varianti homerik. E gjithë ngjarja e mbretëreshës së rrëmbyer është plot ekuivoke. Shkoi vetë ajo me Paridin apo u rrëmbye me forcë dhe pastaj u dashurua pas tij. Apo ndoshta as më parë as më vonë nuk e deshi rrëmbyesin, por ishte thjesht skllave e princit. Apo përkundrazi u magjeps në fillim prej tij, pastaj u zhgënjye dhe u ftoh, ose e kundërta, ishte ai që, pasi u dashurua në fillim pas saj, u ftoh, gjë e natyrshme në këso rastesh?

Për të gjitha këto mund të dyshoje nga leximi i Homerit. As gjatë luftës së Trojës, as pas mbarimit të saj, atëherë kur enigma e ikjes së saj duhej të sqarohet, nuk u jepet përgjigje këtyre pyetjeve.”²⁰¹

-Të dytët, të njohur ndryshe si konektorë pragmatikë, lidhen me strukturën e të gjithë tekstit. Këta lidhin jo vetëm fjali (a pjesë fjalie), por gjithashtu kumtimin me fjali, elemente të situatës jashtëgjuhësore me një thënie, një ose disa elemente implicite me një ose disa elemente eksplicite, pra e thënë shkurt udhëheqin lexuesin në tërësinë e pjesëve të tekstit.

Shembull: *Shumë studime tregojnë se ata persona që pijnë çdo ditë aspirinë, kanë më pak mundësi për t’u sëmurur nga kanceri i shtyllës kurrizore. Kjo nuk vlen vetëm për aspirinën, por edhe për ilaçet e tjera.*²⁰²

-Të tretët ndihmojnë që folësi të japë jo vetëm informacion mbi faktet, por edhe të shprehë pikëpamjet e tij personale.

¹⁹⁹ Janet Byron: “Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera”, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2012, fq. 66.

²⁰⁰ Klodeta Dibra – Nonda Varfi: “Gjuhësi teksti”, vep. e cit., fq. 90.

²⁰¹ Ismail Kadare: “Dosja H”, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, fq. 119.

²⁰² E përditshmja shqiptare “Shqip”, e shtunë, 17 shkurt 2007. fq. 29.

Shembull: “Duke marrë në konsideratë të gjithë rrjedhën e jetës së këtij krijuesi të mrekullueshëm, me të përpjetat dhe të tatëpjetat e saj deri në rrokullisjet e rrezikshme dhe plagëlënëse, do të thoshim se dukuria “e jashtëkohësisë” në veprën e tij, pa qenë realisht e tillë, është pasojë e të jetuarit dhe të krijuarit larg realitetit të vendlindjes. Por nga ana tjetër ajo, mendojmë se është një veprim i vetëdijshëm i Kutelit, i cili në asnjë moment të jetës së tij nuk pëlqen të jetë konformist, por as disfatist.”²⁰³

III. Një lloj i tretë është ai që i klasifikon në.²⁰⁴

1. udhëzues të kumtimit

2. udhëzues argumentues

Anscombe-ja dhe **Ducrot-i** përdorën termin *udhëzues*, duke theksuar që udhëzuesit, jo vetëm lidhin dy njësi semantike, por njëherazi u japin këtyre të fundit një rol argumentues. Ndaj, roli i tyre është i dyfishtë: në rrafshin semantik dhe në rrafshin argumentues.

1. Për të bërë dallimin e llojit të parë nga lloji i dytë, autorët e konkretizuan me thënien e mëposhtme:

Unaza kushton vetëm njëqind euro.

Kjo thënie e thënë në një kontekst të caktuar, na çon drejt një përfundimi të tillë si:

Blije unazën!

Ndërsa thënia:

Unaza kushton jo më pak se njëqind euro.

na çon drejt një përfundimi të tillë si:

Mos e blej unazën!

2. Sipas **Anscombe-së** dhe **Ducrot-it** të gjitha fjalitë që shprehin një pikëpamje, gjithmonë ndërthejnë në vetvete një marrëdhënie argumentuese. Kështu mund të ndodh që në një thënie prania e fjalës *por*, të japë dy pikëpamje të kundërta. P.sh.,: në thënien:

Poli është i pasur, por ai është i martuar.

nëse bazohemi te pjesa e parë e kësaj thënieje, një grua mund të dalë në përfundimin që:

²⁰³ Spiro Gjoni: 'Jashtëkohësia' e Mitrush Kutelit në optikën e dy regjimeve”, te “*Letërsia si e tillë*”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 1996, fq. 33.

²⁰⁴ Jean-Claude Anscombe – Oswald Ducrot: “*L’argumentation dans la langue*”, vep. e cituar.

Është ide e mirë ta njoh më mirë Polin.

por, nëse bazohemi te pjesa e dytë e kësaj thënieje, gruaja mund të dalë në përfundimin se:

Kjo nuk është ide e mirë në fund të fundit.

Fakti që këto dy përfundime na drejtojnë drejt drejtimeve të kundërta argumentuese, vjen si rezultat i përdorimit të konektorit argumentues *por*. Ky konektor është po ashtu përgjegjës për faktin që fiton interpretimi i përfundimit të dytë.

Kështu, konektori *por* i referohet një *topos-i*, i cili është:

Sa më shumë dikush është i pasur, aq më shumë ndjell një grua për ta njohur më mirë atë.

dhe

Sa më shumë dikush është i lidhur me një grua, aq më pak ndjell një grua tjetër ta njohë më mirë atë.

Në këtë rast, *topos-i* i dytë ka një forcë argumentuese më të madhe se i pari. Ky *topos* i dytë përcakton drejtimin argumentues të mundshëm të thënies, i cili na çon në një përfundim implicit:

Nuk ia vlen të përpiqem ta njoh Polin më mirë.

Sipas modelit të mësipërm dhënë nga **Anscombri-ja** dhe **Ducrot-i**, le të marrim disa shembuj të tjerë konkretizimi:

Teksti 1.

Biseda nuk ishte shumë e singertë, por atmosfera ishte miqësore.

Teksti 2.

- "Tashmë e kam gjetur thesarin. Kam një deve, paratë nga dyqani i qelqurinave dhe pesëdhjetë monedha ari. Në vendin tim mund të jem njeri i pasur."

*- "Por pranë piramidave nuk gjendet asgjë nga sa the."*²⁰⁵

Teksti 3.

*- "Çdo vajzë tjetër në vendin e saj, do të thoshte të kundërtën, ose do të qeshte për naivitetin, por ajo, pa buzëqeshur, u përgjigj: - Po."*²⁰⁶

²⁰⁵ Paulo Coelho: "Alkimisti" te "Përkthime", III, sjellë në shqip nga Nonda Varfi, shtëpia botuese "Albatros", Tiranë, 2008, fq. 98.

²⁰⁶ Ismail Kadare: "Rënia e Trojës" te "Koha e shkrimeve", shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1986, fq. 105.

Teksti 4.

*“Rruga përpara do të jetë e gjatë. E përpjeta që duhet të ngjisim është shumë e thepisur. **Por** kurrë nuk kam pasur kaq shumë shpresë, se ne do të arrijmë atje ku duhet.”²⁰⁷*

Teksti 5.

- *“Njerëzit nëpërmjet gojës së murgut, kujtojnë se dëgjojnë zërin e Zotit, kjo i shtyn të vrasin. Ai brez bën më shumë punë se një top.*

- ***Por**, komandant, edhe papa-Janaroja thotë se është zëri i Zotit, - ia preu fjalën rreshteri. Megjithatë predikon tjetër gjë. Njëri thotë: “Vrisni! Vrisni!” Tjetri thotë: “Mos vrisni, mos vrisni.” Cili nga të dy është zëri i Zotit? Mos vallë Zoti ka shumë gojë?”²⁰⁸*

Në të gjitha tekstet e mësipërme vihet re se konektori por ka një rol të shumëfishtë, pasi:

1. i jep vazhdimësi shprehjes, rrjedhës së mendimit;
2. i jep logjikë argumentit vijues;
3. i jep vlerë kundërshtuese gjithë thënies.

Kështu në tekstin 1. konektori por argumenton faktin që:

Megjithëse mungonte sinqeriteti, prapëseprapë atmosfera ishte miqësore.

Këtij konektori i referohet njëri prej topos-it të mëposhtëm:

Sa më e ngrohtë dhe e përzemërt është biseda mes palëve, aq më e fortë dhe domethënëse është lidhja mes tyre.

dhe

Sa më e ftohtë është biseda mes palëve, aq më tipike dhe formale është lidhja mes tyre.

Po kështu në shembujt vijues konektori por jo vetëm argumenton, por njëherazi edhe kundërshton (një fakt a të dhënë), duke iu referuar një topos-i përkatës.

2. Thesari i perceptuar nga alkimisti si gjë e pasuri, në fakt është një lloj thesari tjetër për djaloshin: dashuria që ka ky për Fatimen. (topos-i)

3. Ajo nuk veptoi, sikurse çdokush në vendin e saj do të bënte, pasi ajo vajzë ishte ndryshe nga të gjitha të tjerat. (topos-i).

²⁰⁷ Shkëputur nga fjalimi i Obamës: e përditshmja shqiptare “Korrieri”, e mërkurë, 5 nëntor 2008.

²⁰⁸ Niko Kazançaqis: “Vëllavrasësit” te “Përkthime”, I, sjellë në shqip nga Nonda Varfi, shtëpia botuese “Albatros”, Tiranë, 2008, fq. 193.

4. Ndonëse vështirësitë dhe pengesat do të jenë të mëdha, ato do t'i kapërcejmë. (*topos-i*).

5. Murgu flet në emër të Zotit. Papa-Janoja gjithashtu. "Kujt t'i besohet? Cili nga të dy është zëri i Zotit? Mos vallë Zoti ka shumë gojë?" (*topos-i*).

Shpesh konektorin por e shohim të shoqërohet nga konektorët e tjerë: sepse, sigurisht. P.sh.:

1. "Ne mund ta qëllonim dhe ta vritnim kalin që në fillim, por nuk e bëmë vetë këtë gjë, sepse duke vrarë kalin, do të formonim hindjen e tyre se diku nën tokë kalon vërtet ujësjellësi ynë dhe atëherë ata do të bënin çmos për ta gjetur." ²⁰⁹

2. "Shpresoja që Znj. Franç mund të më huante ca të holla. Më donte shumë, sigurisht, por nuk ma merrte mendja se i interesonte fort gjendja e vështirë financiare e një çifti të ri. Që në fillim, dhe unë e pata vënë re diçka të tillë, i kisha dhënë të kuptonte se unë dhe ime shoqe nuk para shkonim mirë: që jetonim të ndarë me pak fjalë. Avokat, më duheshin ato para... Ja përse nuk i thashë gjysmë fjale dhe e lashë Françin të mendonte si i pëlqente." ²¹⁰

Në shembullin 1. vlera argumentuese e konektorit por gërshetohet me vlerën argumentuese të konektorit sepse, duke shpjeguar kështu pasojën e një veprimi hipotetik që mund të kishte ndodhur (turqit do të zbulonin që aty kishte ujë). Nga ana tjetër vetë vlera kundërshtuese që mbart në vetvete ky konektor në thënie, bën që asgjë të mos ndodhë (turqve iu fshihet gjurma e të pasurit ujë).

Në shembullin 2. konektori sigurisht është mjete gjuhësor, të cilin autori i tekstit e ka zgjedhur për të përforcuar mendimin e tij, duke na çuar drejt një konkluzioni: *Më donte shumë*. Ky konkluzion neglizhohet nga kumtimi i thënies që vijohet nga konektori por, ku ndryshe nga i pari, ky i fundit, e drejton thënien drejt një konkluzioni tjetër: "*Mendoja se më donte shumë, por jo deri në atë pikë...*"

Si përfundim për sa më sipër mund të themi se, roli i konektorëve dhe i operatorëve të tjerë është mjaft i rëndësishëm në përkapjen kuptimore të vetë tekstit argumentues.

²⁰⁹ Ismail Kadare: "*Këshjella*", vep. e cit., fq. 173.

²¹⁰ Agatha Christie: "*Dëshmitari i akuzës*" te "*Dëshmitari i akuzës*", vep. e cit., fq. 72.

5.5.1. Klasat gramatikore me të cilat shprehen konektorët argumentues

Konektorët argumentues shprehen me klasa të ndryshme gramatikore, që mund të jenë:

- ndajfolje si dhe shprehje ndajfoljore: *shumë, tjetër, më mirë, përndryshe, në këtë mënyrë, nga ana tjetër, në të kundërt, pikërisht, sigurisht, për rrjedhojë etj.*

"...E gjithë kjo të kujton botimin, ose më saktë ribotimin në kohën tonë. Por ribotimi i një vepre të cilën s'e mbron kush. Veç një shije publike. Rapsodi është pjesë e makinës së eposit. Ai është edhe botues, edhe librar, edhe bibliotekar, e ndërkaq ai është më shumë se kaq, ai është njëkohësisht bashkautor i vonë, që ka të drejtë të ndryshojë tekstin..."²¹¹

- shprehje të ndryshme lidhëzore²¹²: *dhe, por, sepse, megjithëse, për shkak të, për këtë arsye, për këtë qëllim etj.*

"Zënia vend në tryezë ishte një histori e tërë, kur Silva në vend që të kishte rolin kryesor u tërhoq mënjanë me shpresën se gjithçka do të rregullohej vetë. Dhe vërtet çdo gjë u rregullua për bukuri."²¹³

- pjesëza: *demek, kushedi, madje, ndoshta, mos, vallë, gati sa, vetëm që, vetëm e vetëm, po e po etj.*

"Nuk e kishte menduar kurrë se ata (kushedi pse, megjithëse ende mendonte për Vilin, ajo i përfuthte tani të dy bashkë, duke e quajtur Vilin "ata"), pra, nuk e kishte menduar kurrë se do të ishin treguar aq mospërfillës me të. Megjithatë nuk ndihej e fyer. Ishte e bindur se më tepër se mospërfillje kjo ishte një mungesë e shkaktuar nga pamundësia për t'u parë më shpesh. Kaq shumë qenkan të dhënë pas atij, Homerit, mendonte me ankim. Gati sa nuk e urrente atë vjetërsirë."²¹⁴

- shprehje performative: *mendoj, pohoj, besoj, deklaroj, këmbëngul etj.*

"Por, mua nuk më duhet ky kompliment i tij i pavërtetë. As romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë", as romanet e mi të tjerë, që vetë mendoj se janë më të mirë se ai, nuk kanë vlerë letrare artistike të nivelit evropian. Jo. Nivelet letrare artistike evropiane, nivelet shkencore dhe filozofike evropiane, besoj se i njoh pak a shumë..."²¹⁵

- shprehje komplekse: *si pasojë e, siç mundëm të vinim re, sa për fillim, meqë ra fjala, me një fjalë, si përfundim etj.*

²¹¹ Ismail Kadare: "Dosja H", vep. e cit., fq. 60.

²¹² Klodeta Dibra – Nonda Varfi: "Gjuhësi teksti", vep. e cit., fq. 92.

²¹³ Ismail Kadare: "Gjakfohtësia", shtëpia botuese "Kombinati Poligrafik", Tiranë, 1980, fq. 39.

²¹⁴ Ismail Kadare: "Dosja H", vep. e cit., fq. 180

²¹⁵ Rexhep Qosja: "Mjerimi i provincializmit" tek e përditshmja shqiptare "Gazeta shqiptare", e enjte, 3 shtator 2009, fq. 19.

- "Është një lagje e tërë,- tha prifti, - dhe më duket se quhet "Lagjja 1Maji."

- Me një fjalë kjo ishte si një vulë gjigande në mes të qytetit."²¹⁶

Si një shembull gjithëpërfshirës, të pranisë së një shumësie llojesh konektorësh, po marrim tekstin e mëposhtëm:

"Si përfundim, ne, pyetjes se a është qyteti një pikë dialektologjike, do t'i përgjigjeshim "jo". Pse? Sepse, me sa kemi parë në studimin tonë për të folmen e qytetit të Lezhës, me sa po shohim në qytetin e Tiranës, po edhe nga sa ka dalë nga kërkimet e kolegëve të tjerë në vise të tjera, që i përmendëm më lart, mund dhe duhet të themi se qyteti (çdo qytet) i sotëm është një yjësi (kostelacion) pikash. Një konceptim i tillë, besojmë, do të na e afrente objektin e studimit të sotëm gjuhësor në qendrat urbane, në qoftë se duam të ecim me hapin e kërkimeve të sotme sociolinguistike."²¹⁷

Në këtë tekst, tipik i llojit argumentues, ku autori ndjek një formë induktive të arsytimit, rol mjaft domethënës në procesin argumentues luajnë konektorët. Dallojmë rolin e:

- konektorëve logjikë që shprehin **marrëdhënie shpjegimi**: në qoftë se;

-konektorëve logjikë që shprehin **marrëdhënie kohore**: me sa kemi parë me sa po shohim , nga sa ka dalë, (këta konektorë kanë nuanca të përziera shpjegimi dhe kohe), të sotme;

-konektorëve logjikë që shprehin **marrëdhënie hapësire**: nga kërkimet e kolegëve të tjerë, në vise të tjera, i përmendëm më lart;

-konektorëve logjikë që shprehin **marrëdhënie të zgjerimit të informacionit**: edhe nga sa;

- konektorëve logjikë që shprehin **marrëdhënie përmbyllëse**: si përfundim;

- konektorë **pragmatikë që lidhin strukturën e gjithë tekstit**: sepse, një konceptim i tillë, i përmendëm më lart;

- konektorë që shprehin **qëndrimin individual**: pyetjes... do t'i përgjigjeshim, në studimin tonë besojmë.

Ata që vlejnjë për t'u theksuar në veçanti janë konektorët që shprehin qëndrimin individual të autorit, sepse falë këtyre dhe përballjes që këta krijojnë me zërat e tjerë në ligjëratë (nga sa ka dalë nga kërkimet e kolegëve të tjerë në vise të tjera, që i përmendëm më lart), e bëjnë tekstin të ketë vlerë retorike, komunikuese dhe dialogjike (prania e një mjedisi polifonik).

Në vijim do të prezantohen modele analizash tekstore, ku ndër elementet e tjerë trajtesë specifike do të marrin konektorët, sipas konteksteve përkatëse.

²¹⁶ Ismail Kadare: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", shtëpia botuese "Onufri", Tiranë, 2001, fq. 137.

²¹⁷ Gjovalin Shkurtaj: "Mbërritje inkurajuese në sociolinguistikën shqiptare" të "Kërkime universitare", nr. 11, 2005, universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër, fq. 15.

5.6. Roli i foljeve në tekstin argumentues

Krahas konektorëve të shprehur me ndajfolje, pjesëza, pasthirrma etj., të gjitha pjesëmarrëse të rëndësishme në një tekst argumentues, një rol të rëndësishëm luajnë edhe foljet. Në dallim nga konektorët e tjerë këto përcaktohen nga gjermani H. Vater si “*mjeti më i domosdoshëm në realizimin e tekstit*.”²¹⁸ Folja si pjesë ligjërata tregon, rrëfen. Por rrëfyesi, ai që na tregon, mund të jetë edhe thënës, edhe lokutor njëherazi në kohën kur flet²¹⁹. Kur flasim për kohën si koncept kemi parasysh që ajo mund të jetë:

1. kategori objektive
2. kategori gramatikore (aspekti gjuhësor)
3. mjet i kompozicionit (aspekti letrar)

1. Koha si formë e ekzistencës së materies, ekziston jashtë dhe pavarësisht nga vetëdija e njeriut, pra ka karakter objektiv.

2. Kategoria e kohës në gjuhë jepet përmes foljes. Kuptimi i vërtetë i foljes është i barasvlershëm me shprehjen e veprimit ose gjendjes, të vendosur në bashkëlidhje me folësin. Koha si kategori gramatikore, ka të bëjë me marrëdhëniet kohore, të cilat gjejnë shprehje sistematike në kundërvëniet gramatikore: e shkuar – e tashme – e ardhme.²²⁰ Koha si kategori gramatikore ka lidhje me kohën si kategori objektive. Megjithëse marrëdhëniet kohore objektive midis dukurive të realitetit janë gjithandej të

²¹⁸ Arbër Çeliku: “*Koherenca tekstore. Hyrje në konceptet bazë të gjuhësisë së tekstit nëpërmjet një qasjeje krahasuese të shqipes me gjermanishten*”, vep. e cit., fq. 120.

²¹⁹ Këto dy lloj identitetesh na udhëheqin drejt dikotomisë narrator - shkrimtar, çka studiuesi Roland Zisi i diferencon qartazi këto dy nocione: “*Disi problematik paraqitet çifti autor - narrator apo shkrimtar - narrator, të cilat shpesh rrezikojnë mosdallimin prej njëra-tjetrës dhe rëndom identifikimin e njëres me tjetrën. Hetimi i këtij problemi prej dijetarëve, teoricienëve, narratologëve, madje edhe nga vetë shkrimtarët, qysh nga Aristoteli deri më sot, ka bërë të mundur pranimin e formulimit aksiomatik se: Autori nuk mund të identifikohet me narratorin dhe anasjelltas. (Roland Zisi: “*Veçoritë e narracionit dhe të përshkrimit në prozën rrëfimtare të Bilal Xhaferrit*”, vep. e cit., fq. 27.) Ja një shembull ku ngjarjet rrëfohen në vetën e parë nga një personazh historik (narratori), i zhvendosur në kohë ky i fundit nga vetë autori, në kohën e tashme: “*Arianit Komneni e tërhoqi nga këto mendime kur i tha: Jam nëntëdhjetë e dy vjeç. Kam tre djem. I madhi quhet Gjergj si Arianit Komneni i madh. I dyti quhet Mihal si Mihali që ngriti të parën principatë shqiptare të krishterë në Janinë. I treti quhet Gjon dhe ka marrë emrin e djalit të Skënderbeut, nipit të Arianitit dhe që përbën të vetmen lidhje mes dy burrave, të cilët Islami i ndau në fe dhe krishterimi nuk i bashkoi dot në pushtet. Sara është vajza ime e vetme. Është pesëmbëdhjetë vjeç dhe besoj se pas saj nuk do kem më fëmijë...*” (Ben Blushi: “*Të jetosh në ishull*”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2008, fq. 63).*

²²⁰ Në vend të këtij trinomi, autorët Klodeta Dibra – Nonda Varfi te “*Gjuhësi teksti*”, vep. e cit., propozojnë përdorimin e binomit: e shkuar – jo e shkuar, fq. 81.

ngjashme, në gjuhë të ndryshme kemi sisteme kohore të ndryshme, madje ka gjuhë që nuk kanë kohë.²²¹ (në hebraishte, arabishte, indonezishte apo gjuhë të tjera malaziane mungon kategoria gramatikore e kohës). Nëse i referohemi shqipes, vëmë re se kjo gjuhë ka një pasuri kohësh, që rrallë i ndeshim në gjuhë të tjera. Studiuesi **Mehmet Kraja** thekson: “*Shumësia e trajtave të foljes tregon dy gjëra themelore: se koha është relative, pra, se varet nga pozicioni real dhe këndvështrimi iluzior i individit, që domethënë se koha, përveç se është kategori reale, është edhe kategori subjektive, e para, dhe e dyta, se ekziston shumësia e veprimeve të ndryshme, që kanë pozicion të ndryshëm ndaj subjektit, në të shumtën e rasteve kundërshtues me njëri-tjetrin*”.²²²

3. Koha në një vepër letrare mund të jetë: *reale/artistike; sinkronike/kronologjike; kohë e veprimit/kohë e të treguarit; kohë e tanishme/kohë e shkuar*.²²³ Mjetet që e bëjnë të mundur shprehjen e saj janë jo vetëm foljet, por dhe deiktikët e tipit: *dje, për një vit, shumë e shumë kohë më parë, kurrë, shpesh* etj. Por, vetëkuptohet që folja si pjesë e ligjëratës, zë vendin kryesor. Vetë letërsia në tërësinë e saj është rrëfim. Rrëfimi në brendinë e tij ka shprehjen e veprimit ose të gjendjes. Veprimi ose gjendja është e kushtëzuar në kohë, prandaj, deduktivisht, folja me kohët e saj sundon esencialisht në letërsi.

Për sa më sipër, interesimi ynë në qëllim të këtij punimi, është në fakt për foljet që përdoren në kategorinë e ligjëritit (*discours*) dhe jo ato të tregimit (*récit*), përderisa dhe vetë lloji i tekstit argumentues bën pjesë në llojin e parë (kategorinë e ligjëritit).²²⁴

1. Lidhur me të mësipërmet, kur flisnin për teorinë e akteve të të folurit, ishin **Austin-i** dhe **Searle-i** që bënë një klasifikim të qartë të tyre, duke u bazuar te foljet, te llojet e tyre.

Sipas **Austin-it**,²²⁵ aktet ilokutive kategorizohen në pesë klasa:

1. *Vendimore* ku hyjnë folje të tilla si: *vendos, liroj, dënoj*;
2. *Ushtruese* ku hyjnë folje të tilla si: *emëroj, caktoj*;
3. *Zotuese* ku hyjnë folje të tilla si: *premtoj, betohem, marr përsipër*;

²²¹ Shih: John Lyons: “*Hyrje në gjuhësinë teorike*”, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2001, fq. 284 – 295.

²²² Mehmet Kraja: “Kohët e rrëfimit”, e përditshmja shqiptare “*Tema*”, 9 shtator 2007, fq. 10.

²²³ ISP: “*Letërsia në shkollë*”, nr. 1, përgatitur nga Departamenti i Kurrikulës pranë ISP-së, Tiranë, 2000, fq. 159 – 164.

²²⁴ Sipas ndarjes që H. Weinrich bën (1971) dallohen kohë të foljeve ligjërimore, bisedimore si dhe kohë të foljeve rrëfyese. Shih: Arbër Çeliku: “*Koherenca tekstore. Hyrje në konceptet bazë të gjuhësisë së tekstit nëpërmjet një qasjeje krahasuese të shqipes me gjermanishten*”, vep. e cit., fq. 120.

²²⁵ John Langshaw Austin: “*How to do Things with Words*”, Oxford Univ. Press, 1962, fq. 153.

4. *Mirësjelljeje* ku hyjnë folje të tilla si: *kërkoj ndjesë, falënderoj*;

5. *Parashtruese* ku hyjnë folje të tilla si: *pohoj, mohoj, mendoj, supozoj, ngulmoj, kundërshtoj, nuk jam dakord*.

Ndërsa **Searle**-i²²⁶ i klasifikon këto akte mbi kriteret më semantike:

1. *Pohuese* (kanë si qëllim të shprehin përgjegjshmërinë e lokutorit mbi të vërtetën e pohimit të shprehur): *pohoj, mendoj, pretendoj, supozoj* etj.

2. *Drejtuese* (kanë si qëllim të japin përpjekjet e lokutorit për të bërë diçka kundrejt auditorit): *ftoj, sugjeroj, lutem, ngre pyetjen, urdhëroj, insistoj, reklamoj* etj.

3. *Zotuese* (kanë si qëllim të detyrojnë lokutorin të përshtatë një sjellje, një qëndrim në të ardhmen): *premtoj, garantoj, marr përsipër, siguroj, ofroj* etj.

4. *Shprehëse* (kanë si qëllim të shfaqin gjendje të veçantë psikologjike të lokutorit): *falënderoj, uroj, përgëzoj, kërkoj ndjesë, fajësoj* etj.

5. *Deklaruese* (kanë si qëllim të emërojnë, të shpallin diçka a dikë): *emëroj, autorizoj, licencoj, përuroj* etj.

Për sa më lart, shumëllojshmëria e foljeve që dalluan këta autorë, është e pranishme në tekstet e llojit argumentues përgjatë gjithë fazave përshkuese që **Stephan Toulmin**-i përcaktoi në ligjërimin argumentues:

hyrje – paraqitja, deklarimi i të dhënave – përcaktueshmëria – përligjja – mbështetja – kundërshtimi.

Në tipin e tekstit argumentues, thëniet mund të përmbajnë jo vetëm folje vetore, por njëherazi edhe pavetore. Këtë natyrë pavetore të thënieve e përforcon prania e një modaliteti të degëzuar, që shërben për të arritur shprehjen e qëndrimeve emocionale dhe të vlerësimeve subjektive në mënyrë të përthyer përmes arsyetimit. Të tilla janë foljet: *duhet, është e nevojshme, përbën, domosdoshmëri, lipset, është fakt se, është me rëndësi* etj. Për të shprehur subjektivitetin e vet në këtë lloj ligjërimi, autori përdor folje të tilla si: *mendojmë, pohojmë, vij, këmbëngul, kundërshtoj, nuk jam dakord* etj.

Në tekstin argumentues gjejnë përdorim thuajse të gjitha mënyrat dhe kohët e foljeve: e shkuar – e tashme – e ardhme, të varura nga çasti i ligjërimin. Madje këto kohë mund t'i gjejnë të gërshetuara, në përdorim brenda të njëjtit tekst p.sh., në atë të llojit të ligjërimin politik:

²²⁶ John Searle: "Speech Acts", An essay in the philosophy of language. Cambridge, Cambridge Univ. Press, 1969. Gjithashtu: "A taxonomy of illocutionary act" te "Language, Mind and Knowledge", ed. Keith Gunderson (Minneapolis: University of Minnesota Press, 1975), fq. 344 – 369.

“Qyteti që mora në dorëzim në vitin 2000, ishte një qytet i nxirë nga pluhuri i dembelizmit, mungesa e lidershit dhe vdekja e shpresës... Katër vjet më vonë, unë do të jem në këtë foltore, duke parë bashkë me ju ndryshimet e mëdha të këtij mandati të ri, rrugët e reja, blloqet e banimit, të sistemuara e të furnizuara rregullisht me ujë, me lulishte e kënde lojërash, shkollat, kopshtet e çerdhet tona të rindërtuara tërësisht... Le të nisemi kështu siç jemi në një udhëtim, që sa hap e mbyll sytë na çon në vitin 2011 dhe le të shohim në retrospektivë gjithçka që ne do të realizojmë me mandatin e ri të 18 shkurtit.”²²⁷

Në këtë tip ligjërimi (të llojit politik) ndodh gjithashtu që termat gjuhësore 'e shkuar' dhe 'e ardhme' që i referohen një kohe të caktuar objektive, të përdoren qëllimtazi me efekt argumentues (*vij nga e ardhmja, kundërshtarët nga e shkuara*), duke nënkuptuar idenë që diçka që është e shkuar në kohë, vjetrohët e del nga moda si dhe nga vetë shoqëria, (duke iu referuar kështu kundërshtarëve të vet politik), përkundër idesë që diçka që lidhet me të ardhmen gjeneron progres, perspektivë dhe mbështetje nga vetë shoqëria (duke iu referuar kështu partisë që ky përfaqëson).

Një analizë më të detajuar lidhur me vendin dhe rolin që luajnë foljet në vetë tekstin argumentues, do ta shohim në analizat e mëposhtme tekstore.

5.7. Roli i figurave të ndryshme pjesëmarrëse në tekstin argumentues

Një rol të veçantë në shprehjen e subjektivitetit të një tekst argumentues, luajnë njëherazi figura si: *metafora, ironia, pyetja retorike, përsëritja, litota* etj.

a. Metafora

Është përcaktuar sipas retorikës klasike si “*mbretëresha e tropeve*”. Në themel ajo ndërtohet mbi bazën e asosacionit të mendimeve. Krijohet duke ia përshtatur një sendi fjalën që tregon emrin, cilësinë ose veprimin e një sendi tjetër, me të cilin ka ngjashmëri.

Shembull: “*Pastaj ai i kishte thënë se shumë qytetet në botë kishin pasur përballë Kalin e tyre të Drunjtë dhe fakti që në kohën e tanishme flitej kaq shumë për të, kjo do të thoshte se Kali i mocëm ishte shfaqur përsëri. S’ka rëndësi se është në formë fugoni, apo zyre, apo veture qeveritare, vazhdo ai. Ai është shfaqur atje dhe kjo është kryesorja. Më kupton, Leni? Duhet të jesh i verbër që të mos e shikosh.*”²²⁸

²²⁷ Edi Rama: “Vij nga e ardhmja, kundërshtarët nga e shkuara” tek e përditshmja shqiptare “Panorama”, e shtunë, 17 shkurt 2007, fq. 4.

²²⁸ Ismail Kadare: “Rënia e Trojës” te “Koha e shkrimeve”, vep. e cit., fq. 126.

Kështu, përmes saj ndërtohen struktura të tëra impliciti në tekst.

b. Ironia

Arsyetimi i absurdes fillon duke supozuar të vërtetë një fjali A, për të treguar se rrjedhojat e saj janë kontradiktore dhe për të kaluar prej kësaj nga një e vërtetë jo-A. Kjo do të thotë se ne pranojmë momentalisht një tezë të kundërt me atë që në fakt synojmë të mbrojmë. Dhe për ta bërë këtë, pra për të argumentuar kundërshtinë e një teze të kundërt, ne ndjekim dy rrugë:

1. ose e pranojmë përmes një mohimi të pastër,
2. ose e ironizojmë atë.

Kuptohet që procedurat argumentuese nuk janë të njëjta. Kështu, mohimi i pastër dhe i thjeshtë hedh poshtë një thënie, duke përdorur një operator të jashtëm, ndërsa ironia ka aftësinë ta hedhë poshtë pa përdorur mjete eksplicite. P.sh., thënies: *“Fakti që dikush merr frymë me shpejtësi, është një shenjë që ai ka ethe”*. mund t’i kundërvihet thënia: *“Dikush mund të marrë frymë me vështirësi, edhe pa pasur ethe”*. Pra, argumenti në thënien e parë është i kundërshtueshëm në thënien e dytë dhe kjo qartazi bëhet përmes konektorit *edhe*. Ky lloj arsyetimi fillon me figurën e ironisë. Ironia bën të mundur apo nënkupton të kundërtën e asaj që ne themi, apo ndiejmë. Kur ne themi: *“O, sa e dua atë njeri!”* e në ndihmë të kësaj thënieje vjen dhe intonacioni – kur jemi në rastin e ligjërit të folur, ose shenjat grafike si: pikëçuditësja apo thonjëzat – kur jemi në rastin e ligjërit të shkruar, vetvetiu kuptojmë *“Nuk e dua aspak atë njeri; Kam antipati për të; E urrej”*. Një lloj mjet i shpeshtë ekstralinguistik që e shoqëron është dhe një lloj buzëqeshje e vazhdueshme. Një formulim ironik nuk është sigurisht i njëjtë sikurse me një formulim të gënjeshtërt, përderisa nuk ka synim që të merret *“si i vërtetë”*. Ironia na lejon të mos gënjejmë, kur flasim për diçka, që është e pamundur për t’u thënë drejtpërdrejt. Pasi, në rastin se nëse do të na duhet flasim për diçka që është e pamundur të flitet, atëherë natyrshëm nuk do të arrinim të shmangnim të gënjerit. Kjo na bën të pohojmë se ironia është në shërbim të së vërtetës, apo të paktën ajo i shërben për ta zvogëluar prirjen për të gënjer. Ndaj shpesh cilësohet si një lloj kodi i dyfishtë. Për sa më lart, kemi këtë tabelë përmbledhëse:

Tabela nr. 7

Gjendja e modalitetit	Mesazh thjeshtë	Statusi i vërtetë	Synimi i të thënit
E drejtpërdrejtë/ Faktike	Moti është i bukur.	E vërtetë (Moti është i bukur.)	Për të informuar
Ironi	Moti është i bukur!	E rreme (Moti tmerr!)	Për të bërë humor
Gënjeshtër	Moti është i bukur.	E rreme (Moti është tmerr!)	Për të gënjyer

Ironia shpërfaqet jo vetëm në mjetet gjuhësore që ne përzgjedhim, por njëherazi edhe përmes tonit dhe ngjyimit të zërit gjatë ligjërimit të folur.

Shembull: “Ç’kuptim ka t’i kundërvihesh mafies, kur ajo është një faktor aq i rëndësishëm në ekuilibrin tonë ekonomik e kohezionin tonë politik e shpirtëror? Sa më shumë kalon koha, aq më shumë po bindem se pa mafien ne nuk kemi jetë. Ajo na garanton rendin, ajo na garanton ekonominë, zhvillimin...”²²⁹

c. Pyetja retorike

Është një pyetje formale, ku vetë lokutori nuk pret të marrë përgjigje, vetëm sa dëshiron të shprehë qëndrimin e vet. Ky qëndrim emeton emocione të ndryshme, si: dyshim, mosbesim, indinjatë, zemërim etj. Krahas pyetjeve retorike qëndron edhe përgjigjja retorike, e cila vetëm formën e ka afirmative, kurse brendia e saj njihet si rrjedhojë e natyrshme e asaj që është pohuar më sipër.

Shembull: “Ra një shi që marrosi dynjanë, shkroi dikur në një poezi D. Agolli. Të gjithë ata që u lagën lajthitën në çast. Për të zezën e vet, njëri, që e mbante veten të mençëm, u fut nën strehë dhe shiu s’e zuri, po dhe marrëzisë i shpëtoi. Por e keqja erdhi më pas: të gjithë të lajthiturit filluan ta tregojnë me gisht atë që s’ishte marrosur, sepse vetëm ai kishte mbetur ndryshe. C’të bënte, veçse të lutej që të përsëritej dhe një herë shiu i

²²⁹ Artikulli me titull: “Përpjekja” nga Fatos Lubonja, tek e përditshmja shqiptare “Standard”, e shtunë, 10 qershor 2006, fq. 35.

marrëzisë, që të bashkohej edhe ai me të marrët dhe të mos e përqeshnin më!"²³⁰

d. Përsëritja

Është një tjetër element mbizotërues në tekstin argumentues. Përmes saj arrihet fuqizimi i mendimit, duke synuar të theksojmë atë çka është më e rëndësishme. Në këtë rast ka rëndësi të madhe edhe tonaliteti i zërit që e shoqëron.

Shembull: *"E përqafova. Do të kisha dashur t'i thosha disa fjalë përgëzuese. Do të kisha dashur të qëndroja e dërrmuar mes gjithë atyre njerëzve. Do të kisha dashur t'i tregoja ndonjë histori të këndshme për fëmijërinë tonë dhe për krenarinë që ndieja duke e parë ashtu, të adhuruar nga të tjerët. Do të kisha dashur t'i shpjegoja se duhet të largohesha menjëherë për të kapur autobusin e fundit për në Saragosë. Do të kisha dashur"*.²³¹

e. Litota

Është figura përmes së cilës lokutori pohon diçka, por domosdoshmërisht përmes mohimit të pohimit. Ky lokutor pretendon të thotë më pak, por me synimin për të shprehur në mënyrë të nënkuptuar më shumë.

Shembull: *"Por kjo kërkon në mënyrën më të specializuar, njohjen e poetikës së brendshme të veprës letrare, kërkon një profesionalizëm të spikatur, çka unë dyshoj se ne mund ta bëjmë tani për tani."*²³²

5.8. Roli i intonacionit dhe i efekteve grafike në tekstin argumentues

Intonacioni luan rol të veçantë në tekstin argumentues, kryesisht të formës së folur, pa përjashtuar edhe atë të formës së shkruar. Kur teksti është i formës verbale, lokutori vë në përdorim krahas shenjave të pantonimisë (gjestet, mimika etj.) edhe zërin e tij, në mënyrë që të ndikojë më tepër tek auditori. Të tilla argumente të llojit ndjesore, luajnë një rol të veçantë gjatë ligjërimin të lokutorit. Intonacioni (uljet dhe ngritjet e zërit nga ana e

²³⁰ Monika Stafa: "Sharlatanët", tek e përditshmja shqiptare "Shqip", e mërkurë, 29 gusht 2007, fq. 28.

²³¹ Paulo Coelho: "Në breg të lumit Piedra u ula dhe qava", te "Përkthime", III, sjellë në shqip nga Nonda Varfi, vep. e cit., fq. 154.

²³² Floresha Dado: "Pse duhet rishkruar historia e letërsisë shqipe?", tek e përditshmja shqiptare "Panorama", e hënë, 10 shtator 2007, fq. 25.

lokutorit) është i lidhur ngushtësisht me aspektin e patosit. Kjo ulje - ngritje e zërit që mund të vijë si në formë të kontrolluar nga ana e lokutorit, ashtu dhe të pakontrolluar, ndikon në ngjalljen e një emocioni pozitiv a negativ (varet nga situata) të vetë auditorit.

Por, në rastin kur ky lloj teksti na paraqitet i shkruar, atëherë kjo ulje - ngritje zëri, faktohet:

I. Me fjalë:

“ - Ajo që më ka ngjarë mua, - vijoi të flasë K., i cili uli pak zërin e vështroi fytyrat e njerëzve të radhës së parë dhe fjala e tij u duk ca e rregullt. - Ajo që më ka ngjarë është një rast i veçantë, jo aq i rëndësishëm dhe unë nuk e vlerësoj shumë; po është shenjë e veprimeve që përdoren ndaj shumë të tjerëve. Për këtë po luftoj, jo për veten.

Pa e kuptuar kishte ngritur zërin. Dikush duartrokiti nga një anë e sallës duke i ngritur duar lart e thirri:

- Të lumtë! Përse jo? Të lumtë, të lumtë, shumë mirë.”²³³

II. Me anën e pikësimit dhe efekteve grafike ku përfshihen:

a. shenjat e pikësimit: pikëpyetja, pikëçuditësja, trepikëshi;

b. thonjëzat

c. shkrimi i fjalëve me shkronja të mëdha e të vogla, shkrimi i tyre në formë të drejtë, të pjerrët (*italic*), të theksuar apo të nënvizuar.

a. Çdo shenjë pikësimi që vendoset në fund të thënies, shpreh një intonacion të caktuar: pohor, mohor, pyetës, thirrmos apo thjesht të papërfunduar. Ndryshimet dhe variacionet drejtshkrimore ngjallin reagime të ndryshme emocionale, të cilat përkojnë me ndryshimin e intonacionit kur teksti paraqitet i folur. Nga tërësia e shenjave të pikësimit po ndalemi në veçanti te trepikëshi, si një nga shenjat e pikësimit që lidhet me nëntekstin e tekstit.

Trepikëshi është shenjë pikësimi, që nënkupton një lloj mendimi të lënë përgjysmë. Trepikëshi është një nga format e shprehjes së implicitit në vetë tekstin argumentues. Ky i fundit mund të gërshetohet edhe me lloje të tjera tekstesh. Si rrjedhojë sekuencat e tipit argumentues mund t'i gjejmë të pranishme për shembull edhe në një tekst narrativ. Lokutori në shembullin e mëposhtëm argumenton, duke lënë të nënkuptohet diçka në fund: “Mund t’ju them se pas atyre që dëgjova, gjendja nuk më duket aq e rëndë. Jo, jo. Është e vërtetë se jeni i arrestuar, por jo siç arrestohet një vjedhës. Kur njeriu

²³³ Franc Kafka: “Procesi”, vep. e cit., fq. 53.

*arrestohet për vjedhje, kjo është gjë e keqe, kurse ky lloj arrestimi...*²³⁴ Pra, ky është një lloj arrestimi absurd në fund të fundit.

Trepikëshi mund të gjejë shprehjen e vet edhe përmes një elementi jogjuhësor:

“Atë hop në paradhomë u dëgjua një rrapëllimë, sikur po thyheshin pjata. Të gjithë mbajtën vesh.

Po shkoj të shoh njëherë si është puna- tha K. dhe u nis pa u ngutur, a thua se donte t’u jepte rastin që ta ndalonin.

Kur u gjend në paradhomë dhe po mundohej të shquante gjë në errësirë, kapi dorezën e derës dhe ndjeu se mbi dorën e tij u mbështet një dorë më e vogël dhe dera u mbyll. Ishte infermierja që po e priste.

*Nuk ka ndodhur gjë - murmuroi. - Përplasa një pjatë në mur, që ju të dilnit.*²³⁵

b. Thonjëzat janë shenja grafike në një tekst të shkruar. Fjalët e vëna qëllimtazi mes thonjzash, (përjashtojmë rastin e citimeve apo referimeve), nënkuptojnë gjithnjë një nëntekst tjetër kuptimor të asaj çka thuhet. Kur lokutori dëshiron të shprehë diçka të kundërt të asaj që mendon, ose të shprehë diçka me ironi, atëherë ai i vendos fjalët e tij në thonjëza: *“...Po në këtë fluturim të çuditshëm që mund të shëmbëllet vetëm me Meksikën dhe me republikat e tjera të Amerikës së Mesme, një grusht njerëzish në Shqipëri kanë mundur të mbajnë e të shtojnë rrogat e tyre dhe të rrinë të patundur në mes të furtunave. Këta njerëz janë të vetëquajturit “ekspertë”. Shqiptarë dhe “ekspertë”! Po “ekspertë” në ç’degë? Në gjithë degët e botës, - dhe në ca të tjera përveç të gjithëve”.*²³⁶

c. Shkrimi i fjalëve qëllimtazi me shkronja të mëdha apo të vogla, të drejta a të pjerrëta, të zeza a të nënvizuara, luan një rol mjaft domethënës në tekstin argumentues të shkruar. Mënyra e ndryshme e paraqitjes së fjalëve lidhet me një funksion të caktuar, funksion ky që mund të jetë: ironizues, përcaktues, veçues etj. Secila mënyrë krijon efekt dhe njëherazi tërheq vëmendjen përgjatë leximit.

Më poshtë po marrim një shembull të përgjithshëm, ku vërehet përdorimi i të gjitha mjeteve për sa shtjelluam më lart.

²³⁴ Franc Kafka. Po aty, fq. 32.

²³⁵ Franc Kafka. Po aty, fq. 113.

²³⁶ Faik Konica: “Vepra”, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1993, fq. 234.

“Ora e fundit, Berishës i thahet shatërvani, Basha hap pusetat”²³⁷

Tiranë - Lajmi i orës së fundit

“Inaugurimi më i fundit i Berishës ka pasur të njëjtin fund si edhe të tjerët. Shatërvani ka ndërprerë hedhjen e ujit përpjetë rreth orës 20:00 – 20:30, një gjë e paralajmëruar nga kriza e vazhdueshme për ujë të pijshëm në këtë zonë, si në gjithë Tiranën. Për të mos e lënë shatërvanin thatë që në ditën e parë të inaugurimit të tij, është dashur ndërhyrja e punëtorëve, të cilët janë detyruar të hapin pusetat në dy krahët e rrugës për të rregulluar “defektin e vogël”. Kanë vënë në punë gjeneratorët dhe i janë rikthyer shatërvanit, shiriti i të cilit është prerë vetëm pak orë më parë nga kryeministri. Një punë tjetër shkel e shko, thjesht për efekt fushate që ndryshe nga zhveshje, nga asfalti, këtë herë është shfaqur me ndaljen e rrjetit. Këtë sektor e mbulon vetëm Berisha”.

Në tekstin e mësipërm, vëmë re se autori nuk ka thjesht qëllim të informojë, por të vërë në dukje e të ironizojë një fakt. Që ta bëjë këtë, ai përzgjedh fjalët duke i veshur me një ngjyrim të caktuar emocional. Përdorimi i tyre me këtë vlerë dhe në një kontekst të caktuar shkakton dukurinë e implicitit. Konkretisht, kjo duket që në titull: shterimi i shatërvanit të porsangritur, emeton nëntekstin e shterimit, marrjes fund të qeverisë Berisha. Në shërbim të vlerës kontekstuale që marrin fjalët, autori ndërhyt edhe me treguesit e tjerë ndihmues: thonjëzat apo shkronjat e pjerrëta, të cilat përçojnë domethënie dhe efekt të caktuar – ironi. “Për të mos e lënë shatërvanin thatë që në ditën e parë të inaugurimit të tij, është dashur ndërhyrja e punëtorëve, të cilët janë detyruar të hapin pusetat në dy krahët e rrugës për të rregulluar “defektin e vogël”.

²³⁷ E përditshmja shqiptare “Zëri i popullit”, e shtunë, 17 shkurt 2007, fq. 16.

KREU VI

ANALIZA PRAKTIKE DHE KËSHILLA METODOLOGJIKE

6.1. Tipologjia e planeve argumentuese

Për të bërë analizën e një teksti argumentues sipas perspektivës së Retorikës së re, do të thotë të analizojmë një shumësi faktorësh që marrin pjesë në tekst. Çdo lloj teksti ka natyrë dhe strukturë komplekse. Për rrjedhojë kuptimshmëria rreth tij është e tillë.

Në tekstin argumentues gjithë analiza e mendimit vërtitet rreth argumenteve dhe kundërargumenteve. Mandej kjo analizë filtrohet deri në konstruktet gramatikore sipas skemës: *Kush flet?*; *Kush është autori?*; *Çfarë thotë?*; *Çfarë autoriteti ka për çështjen për të cilën flet?*; *Kujt i drejtohet?*; *Për çfarë tipi auditori është menduar (shkruar) ky argumentim?*; *Kundër kujt është?*

Të gjitha përgjigjet e këtyre pyetjeve vijnë me vënien në zbatim të procedurave dhe strategjive të ndryshme argumentuese që përdor autori i tekstit, për të parashtruar e për të ndikuar te lexuesi a dëgjuesi. Çdo strategji argumentuese lidhet me një plan të caktuar.

Dalohen këto tipologji planesh:

a. plani analitik - parashtron të dhënat e një teze, pa e diskutuar atë (konstatimi i tezës/ shkaqet/ zgjidhjet ose pasojat)

b. plani dialogjik (krahasues) - përqsas tezën e autorit me një a më shumë teza

c. plani dialektik - lejon një diskutim (tezë/antitezë/sintezë)

a. Në planin *analitik* dallojmë një strategji të llojit didaktik të autorit të tekstit. Kjo lloj strategjie ka si funksion përligjjen e qëndrimit, të pikëpamjes dhe synon të sqarojë lexuesin e ta bëjë atë të gjykojë. Dallohet nga përdorimi i konektorëve logjikë dhe nga përdorimi i argumenteve të tipit logjik.

Shembull

“Të gjithë duan të jetojnë të lumtur, vëlla Galioni, por, kur duhet të qartësojnë se çfarë e bën jetën të lumtur, u vagëllohen sytë. Është kaq e vështirë të kalosh një jetë të lumtur, saqë sa më shumë mundohemi ta kërkojmë atë, aq më shumë na largohet, nëse nuk kemi zgjedhur rrugën e duhur. Kur rruga pastaj, na çon në drejtim të kundërt, pikërisht shpejtësia

bëhet shkas që të largohemi akoma më shumë nga lumturia. Prandaj, fillimisht duhet të vendosim se ku duam të shkojmë, pastaj të shohim se cilën rrugë të zgjedhim për ta gjetur sa më shpejt lumturinë. Gjatë udhëtimit do ta kuptojmë, se sa ecim çdo ditë dhe sa i jemi afruar asaj drejt së cilës na shtyn dëshira e natyrshme, nëse kemi zgjedhur rrugën e duhur...

Askush nuk mund të jetë i lumtur nëse nuk ka një mendje të shëndoshë dhe askush nuk ka një mendje të shëndoshë nëse dëshiron diçka që do ta dëmtojë atë. I lumtur është ai që ia beson arsyes gjithë drejtimin e jetës së tij; i lumtur është ai që është i kënaqur me gjendjen e tij, cilado qoftë ajo, dhe i mjaftojnë ato që ka.”²³⁸

b. Në planin *dialogjik* dallojmë një strategji të llojit deliberativ të autorit të tekstit. Ky lloj ka si funksion të shqyrtojë dy teza të kundërta, të përzgjedhë midis dy zgjedhjeve të mundshme, nëpërmjet një arsytimi të argumentuar. Dallohet nga përdorimi i pyetjeve, nga efektet e paralelizmit si dhe nga argumentet logjike.

Shembull

“Historiografia komuniste, përveç shtrembërimit, deformimit dhe tjetërsimit të fakteve historike, çka është një formë e një manipulimi banal të historisë, paraqiti një të vërtetë, të vetmen të vërtetë të pakundërshtueshme, të hartuar nga qendra dhe institucione shkencore që do përlligjinin këtë të vërtetë. Fill pas kësaj e vërteta do të përhapej në institucionet e arsimit ku do të ndodhte indoktrinomi dhe ngulitja e kësaj të vërtete në mendjen e shqiptarëve për breza me radhë. Pushteti totalitar nuk mund të legjitimohet vetëm përmes dhunës, i nevojiten dhe mitet e themelimit, simbole për të legjitimuar vijueshmërinë në pushtet. Mbase, si një trill i fatit, institucionet kombëtare të përpunimit të dijes në Shqipëri, sikurse Akademia e Shkencave apo Instituti i Historisë, janë themeluar bashkë me sistemin komunist... Megjithë përmbysjen e regjimit, sikurse dhe përmbysjen e atij versionit të historisë, ende nuk është përmbysur mënyra e të menduarit për Historinë, si një shkencë, e vërteta e së cilës arrihet me mjete shkencore, racionale dhe është tërësisht objektive. Ç’mendim që mbyt çdo kundërshti, çdo interpretim të ndryshëm të ngjarjeve! Për pasojë ekziston vetëm ose një histori e manipuluar ose një histori e vërtetë. Tashmë që regjimi komunist ka rënë, nuk mund të ketë veç një Histori të Vërtetë...”²³⁹

²³⁸ Seneca: “*Dialogjet*”, shtëpia botuese “Plejad”, Tiranë, 2004, fq. 93.

²³⁹ Sokol Lleshi: “Historia si legjitim i pushtetit” tek e përditshmja shqiptare “*Koha jonë*”, e hënë, 10 shtator 2007, fq. 15.

c. Në planin *dialektik* dallojmë një strategji të llojit polemist të autorit të tekstit. Me anën e këtij lloji autori denoncon një rrethanë a ideologji. Dallohet nga përdorimi i hiperbolës, enumeracionit, krahasimit, metaforës, termave zhvlerësues, aliteracionit, apostrofit dhe pyetjeve retorike.

Si *shembull* mund të sjellim debatin Kadare - Qose²⁴⁰. Ky debat, i nisur nga një “sprovë” e Kadaresë, një libërth që arsyetonte rreth identitetit kombëtar të shqiptarëve (*Identiteti evropian i shqiptarëve – provë, 2006*) u përshkua nga një seri akuzash e kundërakuzash në planin moral, intelektual e politike mes shkrimtarit Ismail Kadare dhe akademikut Rexhep Qosja. Në kundërshtim të tezës së Kadaresë se identiteti i shqiptarëve është perëndimor, vjen teza e Qosjes, sipas të cilit identiteti shqiptar është simbiozë e ndikimit perëndimor dhe atij lindor, simbiozë e ndikimit krishterë dhe mysliman. Ja disa fragmente të kësaj polemike:

Kadare...

Për identitetin

“Askush nuk mund të jetë aq naiv sa të mos e kuptojë se një identitet i ndarë është një komb i ndarë. Askush s'mund të jetë aq i ngathët nga mendja që të mos e kuptojë se përjashtimi i gjysmës ose shumicës së kombit shqiptar nga identiteti evropian, do të thotë përjashtim nga Evropa. Dhe përjashtimi nga Evropa nuk është larg dëbimit nga Evropa. Ky nuk është as përfundim teorik e as filozofik. Kombi shqiptar, përpara se ta lexojë në libra e ka ndier në mishin e tij këtë lemeri....”

Qosja...

Për identitetin

“Kemi shqiptarë me identitet katolik, shqiptarë me identitet ortodoks, shqiptarë me identitet mysliman, shqiptarë me identitet protestant dhe shqiptarë me identitet ateist, por të gjitha këto identitete të veçanta, më të ngushta, më të vogla, në saje të të përbashkëtave të përmbajtura në secilin prej tyre bashkohen në atë përgjithësinë, në atë të përgjithshmen, në atë të tërën që i themi IDENTITETI KOMBËTAR SHQIPTAR. Ai që i ka të qarta këto, ai që ka kuptim për marrëdhënien e të veçantave me të përgjithshmen, nuk do të akuzojë se po ndan shqiptarët në të krishterë dhe në myslimanë...”

Më poshtë po paraqesim tri analiza konkrete të teksteve argumentuese që i kemi marrë për efekt studimi.

²⁴⁰ Shih të përditshmet shqiptare: “Shekulli”, 17 maj 2006; “Shqip” 10 - 11 qershor, 2006 si dhe nyjen:

<http://www.zeriyt.com/aktualiteti-shqiptar/debati-mbi-identitetin-e-shqiptareve-mes-goses-dhe-kadarese-t30174.0.html>

Teksti 1.

Po japim lajmet! – shkruar nga **Ylli Manjani**²⁴¹

Kështu, në këtë tekst komunikues vëmë re se kemi dy palë: shkruerit dhe marrësit, të cilët krijojnë një aktivitet të gjallë ndërlidhës, dhe jo thjesht një proces njëkahësh të përcaktuar nga Saussure-i: “*një mesazh, i cili përcillet nga një folës aktiv tek një dëgjues pasiv.*”²⁴² Në këtë artikull, artikullshkruerit ka për qëllim jo thjesht të pasqyrojë gjendjen reale të politikëbërjes në Shqipëri, por të vërë në lojë e të përleshë të gjithë faktorët pjesëmarrës të kësaj politike, e këtë e bën jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por duke iu veshur elementeve gjuhësore petkun e ironisë e që shpesh shkon deri në sarkazëm. Duke shigjetuar një subjekt të vetëm, autori shigjeton fenomenin në tërësi – monopolizimin që i është bërë politikës shqiptare në tërësi nga një parti-subjekt e vetme. Ja thënie tipike:

- *Kolektivat punonjëse të punësuar nga PD-ja, ia kanë arritur me sukses të na zhysin në errësirë të plotë.*
- *Ministri i Ekonomisë na njoftoi me transparencë të plotë se situata energjitike pritet të jetë më e zezë sesa ç'e kishim menduar.*
- *KESH e blen energjinë të paktën trefish më shtrenjtë se qeverisja e korruptuar socialiste.*
- *Në kuadër të luftës kundër informalitetit çdo biznes bën mirë të paguajë ndonjë lekë në dorë që të kryejë ndonjë punë tek administrata e shërbesave.*
- *Nuk duhet të harroni se këtë muaj administratën e gjeni në zyrë deri në orën 13.00. Thuhet se me rastin e reduktimit të orarit të punës ka edhe ulje tarifash në bursën e korrupsionit. Këtë gjë na e dëshmoi edhe marrëveshja më e fundit që ministri i Transportit lidhi me shoqatën e ndërtuesve, ku të dy palët pranuan se korruptojnë me sukses njëra-tjetrën.*
- *“Top Channeli” të paguajë 12 milionë euro në këmbim të fjalës së lirë.*
- *Pavarësisht ndonjë mangësie rutinë si p.sh., përhapje sëmundjesh, mungesë ilaçesh apo personeli mjekësor, punët i kemi mirë shumë.*
- *Spitalet pritet të përmirësohen edhe më shumë deri në mbylljen përfundimtare të tyre.*

Mbi bazën e mjetit ironi, organizimi ligjërimitor i të gjithë tekstit është i bazuar në procedimet e mëposhtme argumentuese:

²⁴¹ E përditshmja shqiptare “Shqip”, e diel, 5 gusht 2007, fq. 10. Teksti i plotë mund të gjendet gjithashtu në nyjen:

<http://www.scribd.com/doc/7350186/Gazeta-Shqiptare-58>

²⁴² Ferdinand de Saussure: “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme”, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2002, fq. 148.

Analogji

- *Pas gati 10 vjetësh Majlinda Bregu rijep lajmet çdo fundjavë në televizione... Ashtu si edhe në vitet '92 – '97 Majlinda vazhdon të na japë lajmet.*

Ballafaqim

- *Evropa na do më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe shumë më shumë se nën qeverisjen socialiste.*
- *KESH e blen energjinë të paktën trefish më shtrenjtë se qeverisja e korruptuar socialiste.*
- *Vjedhjet në rrjet kanë pësuar progres të ndjeshëm, në krahasim me periudha të ngjashme të qeverisjes socialiste.*

Klasifikim

- *Ministri i Ekonomisë na njoftoi me transparencë të plotë se situata energjetike pritet të jetë më e zezë sesa ç'e kishim menduar.*
- *Nga Drejtoria e Ujësjetësimit, u njoftuam se gjysma e Tiranës të paktën ka 24 orë ujë pa ndërprerje.*
- *Biznesi është shumë herë më i lumtur se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.*
- *Thuhet se me rastin e reduktimit të orarit të punës ka edhe ulje tarifash në bursën e korrupsionit. Këtë gjë na e dëshmoi edhe marrëveshja më e fundit që ministri i Transportit lidhi me shoqatën e ndërtuesve, ku të dy palët pranuan se korruptojnë me sukses njëra-tjetrën.*
- *Media e lirë ka pasur zhvillime të papara. Në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive, u vendos që "Top Channeli" të paguajë 12 milionë euro në këmbim të fjalës së lirë.*
- *Punët në shëndetësi i kemi vaj. Spitalet pritet të përmirësohen edhe më shumë deri në mbylljen përfundimtare të tyre.*

Përkufizim

- *Fundja ç'rëndësi ka kjo kur sipas Majlindës, Evropa na do kështu siç jemi.*
- *Më mirë se kaq nuk mund të bëhet.*
- *Kot nuk thonë turk millet pis millet.*
- *I kemi punët shumë shumë mirë.*
- *Punët i kemi mirë shumë.*
- *Përfundimisht jemi shumë mirë.*

- Ashtu si edhe në vitet '92 – '97 Majlinda vazhdon të na japë lajmet. Ju flet qeveria! Lajmet mbaruan me sukses. Tani zgjohuni se nuk flihet kaq gjatë!

Për të mbështetur interpretimin e vet e që mendimi i tij të bëhet sa më i besueshëm, autori i tekstit fut në shërbim elementet bazë si *provat*, të dhënat apo *shembujt*. Konkretisht:

- ...Pas tre korrikut 2005 ia kanë arritur me sukses të na zhysin në errësi të plotë.

- ...KESH e blen energjinë të paktën trefish më shtrenjtë se qeverisja e korruptuar socialiste.

- ...Shqipëria në moshën e internetit u sqarua njëherë e mirë se transparenca kushton të paktën edhe njëherë aq sa çmimi i shitjes së kompanisë. Po fundja kjo nuk ka rëndësi, se djali i Kryeministrit të Shqipërisë (kushdo qoftë) është gjithmonë drejtor në Telekom.

- Këtë muaj administratën e gjeni në zyrë deri në orën 13.00.

- "Top Channeli" të paguajë 12 milionë euro në këmbim...

- Turqia edhe njëherë si përherë na i prishi planet e qeverisë sonë për të shitur armë aty ku s' duhet...

- Majlinda nuk tha asgjë se e kishte sqaruar më së miri Luli i Ministrisë së Jashtme. Ky i fundit doli shumë i lodhur nga një debat në media me Nishanin e Ministrisë së Brendshme...

- ...Kohët e fundit po tronditet baza e qeverisë për shkak të frikës së Xhuvelit për ndryshime qeveritare dhe kërkesës së Dules për disa shtesa e ndryshime në qeveri. "...Ministrit (të shëndetësisë) i del koha edhe për të qarë hallet e reformës në drejtësi, apo për të emëruar ndonjë demokristian zëvendësprokuror të Përgjithshëm.

Për të arritur qëllimin e vet, autori i tekstit vë në përdorim gjithashtu një sërë mjetesh shtesë. Konkretisht, kundërthëniet, - tipike këto në një tekst argumentues, gjejnë shprehjen e vet qysh në fillim me fjalinë:

Një mirësi e përgjithshme na ka pllakosur tash 2 vjet qeverisje të partisë së Majlindës.

Vërehet që ka një logjikë kontradiktore, pasi nga dija jonë e përgjithshme dimë që koncepti 'mirësi' përfshin gëzimin, të mirën, begatinë e për rrjedhojë në përdorim duhet të shoqërohet me folje si: *ka, mbizotëron, rrezaton* e të tilla syresh, por kurrsesi logjika nuk pranon që "mirësia të pllakosë", pasi folja *pllakos* mbart në vetvete nuancë tërësisht negative. Kështu, menjëherë sa themi fjalën *pllakos* vetvetiu mendja na shkon tek e keqja, e liga, e zeza, pse jo deri te mortii. Ndaj, sipas kuptimit që mbart, del qartazi roli që luan ironia në argumentim si dhe efektet që ajo shkakton: të nënkuptojë (dikë a diçka) dhe njëherazi ta përqeshë.

Kalimi që bën lokutori në personalizëm: partia e Majlindës; djali i Kryeministrit të Shqipërisë; Luli i Ministrisë së Jashtme; Nishani i Ministrisë së Brendshme, është një tjetër mjet në funksion të ironisë e që na

çon drejt implicitit të tekstit: një parti që është personalizuar nga një grusht i vogël njerëzish dhe aspak një parti në interes të të gjithëve e për të gjithë popullin.

Mjet tjetër domethënës është prania e shumësisë së zërave, ku krahas lokutorit ndërhyjnë edhe zërat e tjerë (dukuria e polifonisë). Akti kumtues, qoftë vetë akti ilokutor në përgjithësi ose akti i argumentimit në veçanti, paraqitet si prodhim i një entiteti i lokalizuar qartë, që është lokutori. Kur kemi folur për aktin kumtues kemi folur për praninë e një dikotomie: thënës - lokutor. Kumtuesi (thënësi) është përgjegjësi i aktivitetit ilokutor, ndërsa lokutori është vetëm përgjegjës i aktit lokutiv. Lokutori në tekstin konkret që po analizojmë, paraqet në aktin e tij kumtues disa kumtues (thënës). Konkretisht:

Majlinda nuk tha asgjë se e kishte sqaruar më së miri Luli i Ministrisë së Jashtme. Ky i fundit doli shumë i lodhur nga një debat në media me Nishanin e Ministrisë së Brendshme, i cili insiston ende të nënshkruajë në emër të qeverisë marrëveshjen për vizat. Meqë dolëm te vizat, Majlinda na njofton se i kemi punët shumë shumë mirë; Ju flet qeveria!

E rëndësishme është të kuptohet që lokutori merr në ngarkim fjalët, por jo pikëpamjen që ato supozojnë. Përmes pohimit të thëniesve të thënësve dhe veshjes së tyre me petkun e ironisë, lokutori synon të arrijë një efekt: marrësi i aktit të komunikimit (lexuesi) të nënkuptojë të kundërtën e asaj çka vetë ky autor (dhënësi) thotë. Dhe këtë e bën jo vetëm në mënyrë të tërthortë, përmes ironisë, por edhe drejtpërdrejt:

Nëse doni të merrni vesh se ç'ndodh me të vërtetë merrni të kundërtën e asaj që thotë Majlinda.

Mjeti i ironisë gjen shprehjen e vet në tekst edhe përmes treguesve të tjerë, si: përdorimi i llojeve të ndryshëm të konektorëve, përsëritjet e vazhdueshme, përmbysja e rendit të gjymtyrëve etj.

Konkretisht veçojmë:

- përdorimin e llojeve të konektorëve: *aq mirë... sa edhe; për shkak të; po herë ... e herë ...; më mirë se kaq; sipas ..., Evropa na do kështu siç jemi; po fundja; edhe njëherë si përherë; megjithëse...; pavarësisht; aq mirë sa...; kështu që...; përfundimisht etj.* Një rol mjaft domethënës luan konektori shumë i përdorur herë në shkallë krahasore e herë në sipërore:

Evropa na do më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe shumë më shumë se nën qeverisjen socialiste.; Jemi shumë shumë mirë; I kemi punët shumë shumë mirë; Përfundimisht jemi shumë mirë.

- përdorimin e metaforave: *deti këtë vit është bërë kos, prandaj të marrim nga një lugë e të shkojmë të hamë; punët në shëndetësi i kemi vaj; zgjohuni se nuk flihet kaq gjatë!; etj.*

- përdorimin e përsëritjeve: *lajmet; lajmet e Majlindës; Majlinda tha; Majlinda nuk tha; Sipas Majlindës; Jemi shumë shumë mirë; Përfundimisht jemi shumë mirë* etj.

- përdorimin e thonjzave: *lajmet "profesionale" të Majlindës;*

- apo përmbysjen e rendit të gjymtyrëve në thënie si:

Nëse doni të merrni vesh se ç'ndodh me të vërtetë merrni të kundërtën e asaj që thotë Majlinda: Më mirë se kaq nuk mund të bëhet; Pavarësisht ndonjë mangësie rutinë si p.sh., përhapje sëmundjesh, mungesë ilaçesh apo personeli mjekësor, punët i kemi mirë shumë.

Të gjithë treguesit e mësipërm janë mjete që autori i tekstit vë në shërbim të qëllimit të vet: jo vetëm të ironizojë e të vërë në lojë palët shkaktare të gjendjes politike ku Shqipëria ndodhet, por gjithashtu të bëjë efekt të marrësi i këtij teksti, duke arritur në një përfundim: të grishë, të bëjë thirrje për ndërgjegjësim (*aspekti perlokutiv*). Dukshëm e shpreh ndërtimi i thënies metaforike përmbyllëse të tekstit:

Tani zgjohuni se nuk flihet kaq gjatë!

Teksti 2.

Çmoje votën tënde – shkruar nga **Selim Belortaja**²⁴³

Ky lloj teksti është tekst argumentues, i llojit përsiatës. E veçanta qëndron se procesi argumentues nuk është ndërtuar mbi bazën e një kundërshtimi me teza dhe antiteza mes dy palësh. Këtu nuk kemi palë kundërshtare të shfaqura haptazi, por paraqitja e tyre bëhet përmes logjikës së një lloj monologjie. Kjo monologji shfaq tri palë (zërat kumtues): vetë autorin – palën e kërkuesit të votës – palën e dhënësit të votës. Karakterizohet nga përdorimi jo vetëm i argumenteve logjike nga ana e autorit të tekstit, por njëherazi edhe atyre ndjesore. Procedura që përdor autori ndjek vijën e mëposhtme logjike:

Fillimisht subjekti argumentues pozicionon veten e vet qysh në fillim të ligjërimit argumentues me anë të një qëndrimi hipotetik ndaj përmendjes së një slogani të përdorur përgjatë fushatës elektorale nga palët partiake: *Shkunde votën!; Mund të risillja edhe thjesht atë sloganin trim rinor që çirret: shkunde votën! Por s'më vjen gjëkund për mbarë. Një thirrje që s'ia gjej dot fillin e kuptimit.*

Mandej i drejtohet palës së dhënësit të votës, të cilëve iu drejtohet herë duke hamendësuar, herë duke paralajmëruar e herë duke i pyetur drejtpërdrejt:

²⁴³ E përditshmja shqiptare "Gazeta shqiptare", e premte, 16 shkurt 2007, fq. 23.

- Mund të shkundësh mollët e dardhat, kumbullat e qershitë , hajde ja edhe mbulesa e çarçafët... Po votën çne?

- Të pyesin diçka për emrin, vendlindjen, listën, pasaportën, regjistrin, vendbanimin apo certifikatën 'e blinduar' me ...dy të tjera letra identifikimi! Të kërkojnë të shkoqisësh bash ato gjëra, që partitë e tyre e shteti ynë i përbashkët s'i bëri e s'i bën dot prej plot...16 vjetësh!

- Dikush të mbërthen nga pëllëmba e të lyen gishtin. Pyetja "ç'bojë është kjo e sa kohë mund të mbajë vallë"? – të përshkon vetiu kujtesën e mendimin.

- Sa do të donte i ziu kandidat atë çast të kishte një sy mbi letrën e siglën tënde. Ç'nuk do të jepte ai për ta çuar majën e stilolapsit tënd mu atje tek rreshti e emri i vet. Sa do të donte së paku të të pëshpëriste në vesh një premtim pune për bashkëshorten...

- Në dorë pastaj të fusin nja tre letra-formularë me matrica siglash, emrash e inicialesh.

- Kujdes ama. Pushteti i QYTETARIT zgjat shumë pak.

- Mund të të lërë me orë e ditë të tëra të kalbesh sporteleve për një hipotekë, një vërtetim a një certifikatë. Mund të të lërë pa ujë e pa dritë kur të dojë. Mund të shpërdalë plane e projekte ku t'i leverdisë.

për të ardhur mandej në pozicionin e atij që shpjegon, klasifikon, përcakton:

- Pyetja: "Ç'bojë është kjo e sa kohë mund të mbajë vallë"? - të përshkon vetiu kujtesën e mendimin. Një pyetje e paevitueshme, pas gjithë atij debati e vuajtje në KOZ, mbi bojën, bojatisjen dhe vetë...bojaxhinjtë. (shpjegon)

- Ndërsa gishti tregues i ndonjë ndihmës-komisioneri, tregon kah dhoma e fshehtë. Që në fakt nuk është fare dhomë. Shumë më tepër ngjan me një ambalazh kartoni. (përcakton dhe klasifikon)

- Sa do të donte së paku të të pëshpëriste në vesh një premtim pune për bashkëshorten, bursë "të jashtme" për fëmijën, vizë Shenghen për të gjithë bashkë. Asgjë nga këto s'bën dot tashmë. Ky është momenti yt dhe vetëm yti. (përcakton)

- I varfri pushtetar është si bleta mashkull. Ai nevojitet e "rron" kryesisht për këtë çast votimi. Vetëm për riprodhim të pushteteve të tjera. Pas këtij momenti vetë krijesat që ai sjell në jetë, e braktisin e i largohen. Situatën në dorë e merr makineria e rëndë e "nënës mbretëreshë". Rripat e ingranazhet e ekzekutivit. Pushteti që zgjat me vite, që mbron e riprodhon vetveten. (përcakton)

- Pasuria jote, fuqia për të bërë drejtësi, janë vetëm ato pak çaste. (përcakton)

- Këtu fillon edhe procesi i vërtetë. Këtu ti dhe unë, kushdo nga ne bëhet më i fortë edhe se sa vetë pushteti. (shpjegon dhe përcakton)

- *“Ta çmosh votën tënde do të thotë të kuptosh mashtrimin, t’i shpëtosh sugjestionit e hipnozës që shpërndajnë llafemëdhenjtë e grabitqarët e pushtetit. Të peshosh votën do të thotë të përbuzësh atë që mendon se mund të ta blejë me çmimin e një thesi mielli e ca pako makaronash. Apo qoftë edhe me pagesën e një liste veresie.”* (shpjegon dhe përcakton)

e së fundmi në momentin final: konkludon.

- *Prandaj dhe këmbëngul në timen dhe i them çdonjërit: përpara se “ta shkundësh” të lutem çmoje votën. Çmoje dhe ... peshoje! Vetëm pas kësaj ... lëshoje!”*

- *Është moment i rrallë e i lartë për ty, i dashur qytetar. Është momenti i durimit dhe i kthjelltësisë, i respektit për veten dhe i përgjegjësisë. Prandaj para se “t’i shkundësh” ato letrat e palosura tek kutia e xhamtë , para se të lëshosh pra pushtetin tënd në duar e ca njerëzve jashtë teje ... Çmoje votën tënde!*

Pra, gjithë ky proces argumentimi shtrihet në linjën:

hamendësim – dyshim – shpjegim – klasifikim – përcaktim – konkludim

Vetë argumentimi është i pandashëm nga akti kumtues. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka argumentim pa akt kumtues, por që veçoritë e aktit kumtues janë përbërëse të aktivitetit argumentues. Jo vetëm sepse akti argumentues i realizuar në ligjërimit është një akt ilokutiv, ashtu si pohimi, pyetja, urdhri etj., por veçanërisht sepse vetë akti kumtues mund të ndërhyjë në aktivitetin argumentues dhe kjo bëhet përmes një tërësie treguesish. P.sh., një çështje mund të shprehet përmes formash të ndryshme: një pyetjeje, një deklaratë, një urdhri etj: *Mund të ma thuash të vërtetën?/Dëshiron të ma thuash të vërtetën?/Do të doja që të ma thojë të vërtetën../Do të ishte mirë sikur të më thojë të vërtetën./Sa keq që nuk ma thua të vërtetën!/Thuama të vërtetën!* etj. Gjithë sa më lart, lidhet me aktet e të folurit, të cilat gjejnë shprehjen e vet te foljet, kohët dhe mënyrat e tyre.

▪ Roli i foljeve

Me qëllim që autori i tekstit të bindë marrësin e tij për domethënien, vlerën dhe rëndësinë që realisht ka vota në momentin e aktit të votimit, ligjërimit i tij vishet nga forma foljore të ndryshme. Folja është element shumë i rëndësishëm dhe e pranishme në të gjithë gjatësinë e tekstit. Dallojmë folje të tipit: *paralajmëruese, këshilluese, dëshirore* e njëherazi *nxitëse*.

Paralajmërim me forma foljore në mënyrën lidhore

- *Të pyesin diçka për emrin, vendlindjen, listën, pasaportën, regjistrin, vendbanimin apo certifikatën 'e blinduar' me ...dy të tjera letra identifikimi! Të kërkojnë të shkoqisësh bash ato gjëra, që partitë e tyre e shteti ynë i përbashkët s'i bëri e s'i bën dot prej plot...16 vjetësh!*

- *Dhe fill mbas daljes tënde në rrugë mund të tallet sa të dojë. Mund të të lërë me orë e ditë të tëra të kalbesh sporteleve për një hipotekë, një vërtetim a një certifikatë. Mund të të lërë pa ujë e pa dritë kur të dojë. Mund të shpërndajë plane e projekte ku t'i leverdisë. (paralajmërim me formë foljore në mënyrën lidhore, të shoqëruar gjithashtu me folje modale).*

Dëshirë me forma foljore në mënyrën kushtore

- *Sa do të donte i ziu kandidat atë çast të kishte një sy mbi letrën e siglën tënde. Ç'nuk do të jepte ai për ta çuar majën e stilolapsit tënd mu atje tek rreshti e emri i vet. Sa do të donte së paku të të pëshpëriste në vesh një premtim pune për bashkëshorten, bursë "të jashtme" për fëmijën, vizë Shenghen për të gjithë bashkë.*

Këshillë dhe nxitje përmes formash foljore në mënyrën lidhore dhe urdhërore

- *Çmoji pra këto çaste mbrapa dhomës së fshehtë!*

- *Të lutem çmoje votën. Çmoje dhe ... peshoje! Vetëm pas kësaj...lëshoje!../ Çmoje votën tënde!*

• Lidhur më kategorinë e foljeve, një tjetër tipar që vëmë re në tekst, është përdorimi i kohës së ardhme përmes formave foljore të së tashmes, dhe shpesh kjo e fundit me vlerën e një pohimi të përhershëm. Kjo, që autori ta bëjë sa më aktual ligjërimin e tij e me qëllim që të shtojë edhe më shkallën e përgjegjshmërisë dhe të ndërgjegjes te vetë marrësi i këtij teksti. Konkretisht:

- *Në simbolikën e vet, 18 shkurti duket një ditë e madhe. Llafet e fishekzjarrët mund të zgjatin gjithë javën. Në fakt nuk është as edhe një ditë e tërë. As edhe një orë e plotë. Është vetëm punë çastesh. Është ajo farë drithërimë e lehtë që na përshkon të hyjmë në sallën e votimit e përballemi me një rresht komisionerësh.*

- *Një rresht i vetëm, por me dy grupe fytyrash. Gjysma e qeshur që beson se "jemi tanët". Gjysma tjetër hundëvarur e syvëngër që beson se "na i njuh mirë" bindjet kundërshtare. Tre - katër syresh zgjasin duart e flasin njëherësh. Dy të vëngër, dy të qeshur. Të pyesin diçka për emrin, vendlindjen, listën, pasaportën, regjistrin, vendbanimin apo certifikatën 'e blinduar' me ...dy të tjera letra identifikimi! Të kërkojnë të shkoqisësh bash*

ato gjëra, që partitë e tyre e shteti ynë i përbashkët s'i bëri e s'i bën dot prej plot...16 vjetësh!..Të tjera çaste gjurmëlënëse vijjnë më pas në 18 shkurtin tonë. Dikush të mbërthen nga pëllëmba e të lyen gishtin.

- Mbizotërojnë foljet që tregojnë gjendje apo vendndodhje (foljet statike) si: *s'më vjen për mbarë; këmbëngul në timen; është; beson; të përbuzësh*; por njëherazi dhe foljet që tregojnë veprim (foljet dinamike) si: *të kërkojnë, të mbërthen; të fusin; tregon; të përshkon; fillon; zgjat; mbron; riprodhon; të lërë; të shpërndarë; të peshosh; të blejë; lëshoje.*

- **Fusha leksikore** e fjalëve luan gjithashtu një rol domethënës. Fjalët, si elemente të fushës leksikore, vendosen në lidhje sintagmatike e paradigmatisht me njëra-tjetrën. Kjo do të thotë që kuptimet që marrin fjalët janë të ndryshme, në varësi të konteksteve të ndryshme. Nga teksti i mësipërm veçojmë:

- *Mund të shkundësh mollët e dardhat, kumbullat e qershitë, hajde ja edhe mbulesa e çarçafët. Edhe xhepat mund t'i shkundim po ta lypë nevoja. Po votën çne? Ç'e mirë mund të vijë nga kjo, vetë votës dhe pastaj...votimit? Kur dimë se edhe frutat vetë, kur vilen me të shkundur, nuk janë më për pazar. Pas gjysmë ore madje, nuk janë as për t'i ngrënë vetë dhe pak më vonë, nuk janë as edhe ...për t'i parë... Prandaj para se "t'i shkundësh" ato letrat e palosura tek kutia e xhamtë, para se të lëshosh pra pushtetin tënd në duar e ca njerëzve jashtë teje, ...çmoje votën tënde!*

- *Pyetja: "Ç'bojë është kjo e sa kohë mund të mbajë vallë"? - të përshkon vetiu kujtesën e mendimin. Një pyetje e paevitueshme, pas gjithë atij debati e vuajtje në KQZ, mbi bojën, bojatisjen dhe vetë...bojaxhinjtë.*

- Përdorimi i foljeve ndjek herë-herë vlerën e intensitetit të veprimit, duke shkaktuar kështu efektin e shkallëzimit. Konkretisht:

- *Tre - katër syresh zgjasin duart e flasin njëherësh. Dy të vëngër, dy të qeshur. Të pyesin diçka për emrin, vendlindjen, listën, pasaportën, regjistrin, vendbanimin apo certifikatën 'e blinduar' me ...dy të tjera letra identifikimi! Të kërkojnë të shkoqisësh bash ato gjëra, që partitë e tyre e shteti ynë i përbashkët s'i bëri e s'i bën dot prej plot...16 vjetësh!..Të tjera çaste gjurmëlënëse vijjnë më pas në 18 shkurtin tonë. Dikush të mbërthen nga pëllëmba e të lyen gishtin.*

- *Dhe fill mbas daljes tënde në rrugë mund të tallet sa të dojë. Mund të të lërë me orë e ditë të tëra të kalbesh sporteleve për një hipotekë, një vërtetim a një certifikatë. Mund të të lërë pa ujë e pa dritë kur të dojë. Mund të shpërndajë plane e projekte ku t'i leverdisë. Dhe t'ju heqë vizë në çast nevojave më jetike për ty e kolegët e tu votues e qytetarë.*

- *Ta çmosh votën tënde do të thotë të kuptosh mashtrimin, t'i shpëtosh sugjestionit e hipnozës që shpërndajnë llafemëdhentë e grabitqarët e pushtetit. Të peshosh votën do të thotë të përbuzësh atë që mendon se mund të ta blejë me çmimin e një thesi mielli e ca pako makaronash...*

▪ Roli i përemrave dhe i ndajfoljeve

Në tekstin e mësipërm rol të rëndësishëm luajnë jo vetëm foljet, por edhe ndajfoljet dhe përemrat. Konkretisht në tekst kemi përdorim të gjerë të përemrave vetorë, dëftorë, të pacaktuar si dhe ndajfoljeve të kohës. Veç, duhet bërë kujdes në përdorimin e këtyre me funksion herë anafore, herë deiksisi, si një rast i veçantë edhe ky i referimit. Sipas John Lyons-it: *“Ndërsa tek anafora shprehja paraprijëse dhe rimarrja anaforike u referohen të dyja një elementi jashtëgjuhësor, tek deiksisi tekstual rimarrja nuk i drejtohet një njësie tjetër gjuhësore që, nga ana e vet, ka një referues jashtëgjuhësor, por i drejtohet një pjese (ose vendi) të tekstit të kuptuar si objekt jashtëgjuhësor (ose më saktë metalinguistik).”*²⁴⁴ Dhe më pas vijon: *“Dukuritë deiktike, duke kryer funksionin e vendosjes dhe të identifikimit të qenieve, objekteve, ngjarjeve, proceseve dhe veprimeve, në raport me kontekstin hapësinor-kohor të realizuar nga akti i komunikimit, janë më të rëndësishme se dukuritë anaforike, të cilat në thelb do të vareshin nga dukuritë deiktike.”*

Konkretisht në tekstin tonë:

Në dorë pastaj të fusin nja tre letra-formularë me matrica siglash, emrash e inicialesh. Ndërsa gishti tregues i ndonjë ndihmës-komisioneri, tregon kah dhoma e fshehtë. Që në fakt nuk është fare dhomë. Shumë më tepër ngjan me një ambalazh kartoni. Këtu fillon edhe procesi i vërtetë. Këtu ti dhe unë, kushdo nga ne bëhet më i fortë edhe se sa vetë pushteti.

vëmë re se ndajfolja këtu del në rolin e një deiktiku dhe jo të një anafore. Ky lloj nuk i referohet një njësie jashtëgjuhësore, së cilës i jemi referuar më parë e që ky element të ketë lidhje identiteti me elementin paraprijës, por në fakt i referohet gjithë tekstit si shtrirje hapësinë-kohë (paratekstit dhe pastekstit). Pra, ndajfolja këtu nuk tregon vendin konkret ku zhvillohet procesi i votimit, por një pikë të caktuar të vetë tekstit.

Më poshtë po rendisim disa përdorime të tjera përemrash dhe ndajfoljesh herë në rolin e anaforave e herë të deiktikëve.

- *Sa do të donte së paku të të pëshpëriste në vesh një premtim pune për bashkëshorten, bursë “të jashtme” për fëmijën, vizë Shenghen për të gjithë bashkë.* (anaforë e shprehur me përemër të pacaktuar).

- *Asgjë nga këto* (deiktik tekstual i shprehur me përemër dëftor) *s’bën dot tashmë. Ky* (deiktik tekstual i shprehur me përemër dëftor) *është momenti yt dhe vetëm yti.* (anaforë e shprehur me përemër pronor).

- *Prandaj para se “t’i shkundësh” ato letrat* (deiktik tekstual i shprehur me përemër dëftor) *e palosura tek kutia e xhamtë, para se të lëshosh pra*

²⁴⁴ John Lyons: “*Semantica*”, I, London: Cambridge, University Press, 1977, fq. 637.

pushtetin tënd në duart e ca njerëzve jashtë teje, ... Çmoje votën tënde! (anaforë e shprehur me përemër pronor).

- Të kërkojnë të shkoqisësh bash ato gjëra, që partitë e tyre e shteti ynë i përbashkët s'i bëri e s'i bën dot prej plot...16 vjetësh! (deiktik tekstual i shprehur me përemër dëftor).

Llojet e ndryshme të ndajfoljeve, përemrave, a shprehje të ndryshme, na referojnë domosdoshmërisht në lloje të ndryshme konektorësh. Këta luajnë një rol të veçantë në realizimin e vazhdimësisë logjike të tekstit. Konkretisht në thënien:

- *Shkunde votën!... Po votën çne? Ç'e mirë mund të vijë nga kjo, vetë votës dhe pastaj...votimit? Kur dimë se edhe frutat vetë, kur vilen me të shkundur, nuk janë më për pazar. Pas gjysmë ore madje, nuk janë as për t'i ngrënë vetë dhe pak më vonë, nuk janë as edhe ...për t'i parë.*

ndajfolja kur është një konektor pragmatik, pasi nuk vendos lidhje të mirëfilltë kohore me thënien paraardhëse, por krijon lidhje ndërmjet pjesëve të tekstit. Ndërsa shprehja ndajfoljore pas gjysmë ore është qartazi një konektor logjik që shpreh marrëdhënie kohe. Konektorë të tillë shprehin jo vetëm marrëdhënie kohe, por edhe marrëdhënie të tjera p.sh.:

- *Prandaj dhe këmbëngul në timen dhe i them çdonjërit përpara se "ta shkundësh" të lutem çmoje votën.* (konektor logjik që shpreh marrëdhënie shpjegimi).

- *Llafet e fishekzjarrët mund të zgjatin gjithë javën. Në fakt nuk është as edhe një ditë e tërë. As edhe një orë e plotë.* (konektor logjik që shpreh marrëdhënie kundërshtie).

- *Prandaj para se "t'i shkundësh" ato letrat e palosura tek kutia e xhamtë, para se të lëshosh pra pushtetin tënd në duar e ca njerëzve jashtë teje, ...çmoje votën tënde!* (konektorë logjikë që shprehin marrëdhënie shpjegimi dhe kohe).

Gjithashtu ndeshim edhe lloje të tjera konektorësh si: ata pragmatikë apo ata që shprehin qëndrimin e folësit:

- *Mund të të lërë pa ujë e pa dritë kur të dojë. Mund të shpërndajë plane e projekte ku t'i leverdisë...Siç mund të jetë edhe krejt ndryshe. Nëse mendohesh dhe e peshon mirë votën tënde.* (konektorë pragmatikë).

- *Kujdes ama!* (konektor që shpreh qëndrimin e folësit).

Këta të fundit (konektorët që shprehin qëndrimin e folësit) zënë një vend qendror gjatë gjithë tekstit. Konkretisht, qysh në fillim vërejmë konektorin argumentues kundërshtues por, që shpreh qëndrimin e vetë autorit:

- *Mund të risillja edhe thjesht atë sloganin trim rinor që çirret: shkunde votën! Por s'më vjen gjëkund për mbarë.* Konektori por që shpreh qëndrimin e folësit, i referohet një topos-i, të cilin vetë autori i tekstit e jep pak më poshtë:

- *Mund të shkundësh mollët e dardhat, kumbullat e qershitë, hajde ja edhe mbulesa e çarçafët. Edhe xhepat mund t'i shkundim po ta lypë nevoja. Po votën çne? Ç'e mirë mund të vijë nga kjo, vetë votës dhe pastaj...votimit? Ky topos përcakton drejtimin argumentues të thënies, i cili na çon në përfundimin implicit: *Vota duhet peshuar dhe çmuar.**

Së fundi, rol mjaft domethënës në interpretimin argumentues të tekstit luajnë përdorimet e thonjëzave nga ana e autorit. Nuk e kemi fjalën për atë lloj që citojnë një ligjëratë të drejtë të kumtuesve përkatës, por për ato që mbartin një mënyrë të tërthortë të të shprehuri e që shpërfaqin dukshëm dukurinë e implicitit. Konkretisht: *gjysma e qeshur që beson se "jemi tanët"; gjysma tjetër hundëvarur e syvëngër që beson se "na i njuh mirë" bindjet kundërshtare.; të pyesin diçka për emrin, vendlindjen, listën, pasaportën, regjistrin, vendbanimin apo certifikatën 'e blinduar' me ...dy të tjera letra identifikimi!; bursë "të jashtme" për fëmijën; situatën në dorë e merr makineria e rëndë e "nënës mbretëreshë"; rripat e ingranazhet e ekzekutivi; para se "t'i shkundësh" ato letrat e palosura tek kutia e xhamtë etj., duke mbartur kështu herë kuptim ironik e herë metaforik në tekst.*

Teksti 3.

*Letër ambasadorit tonë në SHBA – shkruar nga Auron Tare*²⁴⁵

Në një rrafsh të përgjithshëm mund të themi se teksti i mësipërm i takon tipit të tekstit argumentues dhe më specifiku: kategorisë *letër publike*, e llojit polemizues.

Përderisa kemi të bëjmë me ligjërim të shkruar, palët ndodhen në distancë nga njëra-tjetra. Si rrjedhojë, ligjërimi është i bazuar vetëm në mjetin gjuhë dhe pa pjesëmarrjen e mjeteve të tjera ekstragjuhësore si: toni, gjestet, mimika etj. Gjithë teksti është i lidhur dhe i mirësistemuar sipas kriterëve të tekstualitetit dhe përbën një tërësi të përfunduar sipas fazave hyrje – zhvillim – përfundim dhe sipas një modeli që vetë kategoria e letrës ka në vetvete (hyrjet dhe mbylljet klishe).


Organizimi ligjërimor është i ndërtuar mbi bazë argumentesh dhe arsyetimi, arsyetim ky i ndërtuar mbi bazën e një marrëdhënieje që sendërtohet në dy kuptime:

²⁴⁵ E përditshmja shqiptare "Korrieri", 19 janar 2008. Teksti i plotë mund të gjendet gjithashtu në nyjen:

<http://floart-press.blogspot.com/2008/01/letr-ambasadorit-ton-n-shba-i-nderuar-z.html#links>.

- marrëdhënie mes dy palësh ku këto palë vërtiten rreth një qerthulli të përbashkët: argumenteve.

Si pasojë kemi lidhjen:




- marrëdhënie mes një apo disa argumentesh nga njëra anë dhe një konkluzioni nga ana tjetër.

Në tekst kemi praninë e tri palëve, ose e thënë ndryshe, e tre zërave kumtues (dukuria e polifonisë), të cilët mëtojnë drejt një qëllimi të vetëm: të argumentojnë bindjet e tyre:

1. *Zëri i parë kumtues*: Zoti Auron Tare – subjekti argumentues, autori i këtij teksti;

2. *Zëri i dytë kumtues*: Zoti Ambasador në Amerikë – subjekti shënjestër, të cilit i kundërvihet ky autor;

3. *Zëri i tretë kumtues* – të rinjtë dhe studentët e tjerë shqiptarë, të cilët shërbejnë si faktorë mbështetës të argumenteve që parashtron autori.



Mënyra që ndjek lokutori në arsyetimin që bën është paraqitja e argumenteve, deklarimi i fakteve, duke e shoqëruar shpjegimin me argumentet logjike përkatëse në funksion të të cilave hyjnë një ansamble mjetesish gjuhësore, shprehëse të qarta këto të fundit të pozicionimit, qëndrimit që ky lokutor mban përgjatë gjithë procesit të argumentimit. Si elemente të tilla përmendim: elementet implicite (ironia, metafora); përdorimi i foljeve shprehëse të qëndrimit të subjektit argumentues; përdorimi i llojeve të ndryshme të konektorëve apo elementeve të ndryshme grafike: thonjëzat, shkronjat e pjerrëta etj.

Le të shkojmë më thellë me analizën tonë përmes përgjigjeve të pyetjeve të natyrshme që dalin:

Pyetja 1. Cili është problemi ose çështja që autori ngre për ta debatuar?

Përgjigje 1. Prezantimi i Shqipërisë që i bëhet gjithë botës mbarë jo me përmasat, vlerat dhe vërtetësinë e duhur, e kjo si pasojë e disa diplomatëve pseudointelektualë që ka Shqipëria.

Pyetja 2. Cilat janë faktet, argumentet që thërret për ndihmë autori në të mirë të konkluzionit që do të shpalosë në fund?

Përgjigje 2. Të shprehurit e opinionit përmes të dhënave, fakteve dhe pohimeve kategorike nga ana e autorit, dhe jo vetëm kaq. Në përforsim të opinionit personal, autori nënvizon edhe atë të disa të rinjve shqiptarë në Boston, të cilët kishin marrë pjesë në prezantimin që diplomati ynë shqiptar (konkretisht Z. Ambasador) i bëri shtetit të tij, Shqipërisë.

Argumentet janë:

- Niveli shumë i ulët dhe aspak i pranueshëm për një ambasador:
- Kompetencë njohurish jo e përshtatshme për rangun e një ambasadori (*Mjafton të dëgjosh fjalën tuaj dhe kushdo mund të gjykojë vetë mbi këto njohuri.*)
- Mosnjohja në nivelin e duhur të gjuhës së huaj (anglishtes), përmes së cilës ai prezanton shtetin e tij.
- Tolerim i skajshëm i kriterëve që duhet të përmbushë një kandidat i mundshëm për pozicionin e një diplomati. Lidhur me këtë kritika e autorit shkon deri në rang ministrie.
- Prezantimi që Z. Ambasador i bën Shqipërisë, nuk ka rrjedhë logjike. Nis me personalitetet shqiptare (ku përzihet arti, historia, letërsia, etj), vazhdon me gjeografinë, del sërish në aspekt historik duke filluar me 1999, për të kaluar te pellazgët dhe prapë në 1991 me anijet.
- Shtrembërim dhe keqinterpretim faktesh që Z. Ambasador bën në sytë e opinionit publik: *Skënderbeu luftoi për interesin e Kishës Kristiane; Shqipëria ka ca kufij me Greqinë dhe kufizohet nga Serbia dhe Mali i Zi; në Maqedoni jetojnë një milionë shqiptarë; Skënderbeu – luftëtari që luftoi 57 vjet kundër turqve (fillimisht thotë 30 e më pas 40); Perandoria Romake shtrihej nga Roma në Istambul, Shqipëria tashmë ka ndërtuar Korridorin 8; shqipja vjen nga pellazgjishtja.(!)*
- Të bërët qesharak dhe patetik. (*Nënë Tereza ishte shqiptare dhe më pas: ajo vizitoi vendin tim (meqë ishte shqiptare, vizitoi vendin e saj); Nëna Tereza ishte "very teenager" kur iku nga Shqipëria; Skënderbeu ishte: Guvernatori i Parë i Shqipërisë, personi që nuk i jepte lejen turqve të shkonin në Itali apo cilësimi i skajshëm që autori i bën: gentleman (xhentëlmen - zotëri); flamuri shqiptar është me shqiponjë si i amerikanëve; ka dy koka sepse Guvernatori Skënderbe e kishte ushtrinë nga Veriu dhe Jugu e ku trupi i shqiponjës është vetë Guvernatori Skënderbe dhe dy kokat janë Veriu dhe Jugu.(!)*)

Pyetja 3. Si e mbron autori tezën e vet, pra ç'loj strategjie ndjek?

Përgjigje 3. Strategjia që përdor autori për të argumentuar opinionin e vet nuk është as didaktike (kjo ka si funksion përligjjen e qëndrimit, pikëpamjes dhe synon ta sqarojë lexuesin dhe ta bëjë atë të gjykojë), as heuristike (kjo ka si funksion të shqyrtojë dy teza të kundërta, të përzgjedhë njërin nëpërmjet një arsytimi të argumentuar), por polemizuese (kjo ka si funksion të denoncojë një rrethanë a ideologji).

Pyetja 4. Cilat janë tezat dhe antitezat?

Përgjigje 4. Si më poshtë vijojnë:

Tabela nr. 8

TEZAT	ANTITEZAT
1. Në Shqipëri falen shumë gjëra. Mesa duket ish-ministri juaj i Jashtëm, i cili nuk dinte vetë asnjë fjalë anglisht, e ka falur këtë kërkesë të rëndësishme për ambasador në Uashington.	1. Personalisht mendoj se niveli gjuhësor i përdorur nga ana Juaj në këtë prezantim në një auditor universitar, lë shumë për të dëshiruar dhe është në nivele jo të pranueshme për një ambasador; unë mendoj se kryediplomati ynë në Uashington duhet të flasë një anglishte perfekte.
2. ...anglishtja juaj edhe mund të gëlltitej...	2. ...nëse prezantimi juaj mbi Shqipërinë do kishte ndopak rrjedhë logjike.
3. jo të kërcejë degë më degë pa asnjë lidhje.	3. duhet të bëjë një pasqyrë të saktë të vendit të tij në mënyrë kronologjike dhe logjike.
4. Ferit Murati ka shpikur Viagrën	4. si mjek që jeni duhet ta dini se Ferit Murati nuk ka shpikur Viagrën, por ka bërë studime mbi rolin e qarkullimit të oksidit nitrik, studim që u mor për bazë në zhvillimin e metodave të reja për trajtimin e impotencës.

5. Shqipëria ka ca kufij me Greqinë dhe kufizohet nga Serbia e Mali i Zi.

6. Në Maqedoni jetojnë 1 milionë shqiptarë

7. Nëse auditori i atij universiteti në Utah nuk e ka shumë idenë se kush ka qenë Skënderbeu, luftëtari që luftoi 57 vjet kundër turqve dhe njëherë personi që nuk i jepte lejen turqve të shkonin në Itali...

8. Presidenti Willson (apo xhentëlmëni), në vitet 1913 – 1914 luajti rolin e shpëtimtarit të Shqipërisë; Willson ka thënë në Konferencë se “Amerika është me Shqipërinë”...

9. Perandoria Romake shtrihej nga Roma në Istambul, (duke harruar se), kjo është me të vërtetë për të qeshur.

5. Kosova nuk është më pjesë e Serbisë.

6. ...një deklaratë jo diplomatike, e cila mund të bëhet nga Qytetari Sallabanda, por kurrsesi nga një Ambasador i RSH-së.

7. (...a thua se Skënderbeu ynë kishte qenë Drejtori i Doganës së Vlorës), me siguri që ata e njohin shumë mirë historinë e vendit të tyre.

8. Presidenti Willson në vitet kur Lufta e Parë Botërore nuk kishte filluar akoma, as që e ka përmendur ndonjëherë vendin, të cilin sot ju e përfaqësoni. Ajo që ju kërkonit të thonit, (por që e bëtë lëmsh) është fakti se Presidenti Willson mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris në Janar 1919. Ishte këtu, në këtë Konferencë dhe jo në vitin 1913, siç shpreheni ju, që Presidenti Willson mbrojti parimin e vetëvendosjes së vendeve të vogla, ndër të cilat ishte edhe Shqipëria; me gjithë deklaratimet tuaja patetike, deri më tani nuk njihet asnjë dokument që të vërtetojë fjalët tuaja.

9. Perandoria Romane ishte e shtrirë jo vetëm në një territor më të gjerë, por Istambul apo Stamboll u quajt kështu vetëm pas marrjes së Kostandinopojës nga Otomanët.

10. Auditori amerikan dëgjoi se Shqipëria tashmë ka ndërtuar Korridorin e 8-të...

10. ...një lajm ky i panjohur deri më tani në Shqipëri dhe në rajonin tonë, deklarim ky i cili do të habisë jo pak bashkatdhetarët Tuaj në Shqipëri dhe politikanët e Ballkanit dhe ata të Bashkimit European.

11. Shqipja vjen nga pellazgjishtja... "Enigma"²⁴⁶ është një prej fakteve të pamohueshëm në këtë drejtim.

11. Deri më sot askush në qarqet shkencore linguistike nuk ka sjellë ndonjë fakt për të provuar se shqipja është pasardhëse e pellazgjishtes.

12. Ju mund të flisni për Kryeministrin e vendit Tuaj në prezantimet që bëni...

12. ...por si diplomat Ju nuk mund të harroni se kreu i Shtetit është Presidenti i Republikës.

Pyetja 5. Si i përgjigjet autori këtyre kundërshtimeve?

Përgjigje 5. Fakti që autori praktikon letrën e hapur publike dhe jo forma të komunikimit të ligjërimit gojor, e bën serioz dhe bindës, dy veçori këto që duhet të karakterizojnë çdo lloj debati qytetar dhe civil. Kështu, Z. Tare sulmon duke përdorur logjikën e ftohtë, të mbështetur në fakte e argumente dhe aspak atë emocionale, patetike e fyese.

Çdo thënie në tekst është një akt të foluri i vështruar në tri aspekte:

1. aspekti lokutiv ose akti i të thënit diçka, sipas gramatikës së një gjuhe të dhënë (ana materiale e një shprehjeje);

2. aspekti ilokutiv, ose akti i kryer i kësaj thënieje me një qëllim të caktuar;

3. aspekti perllokutiv, ose akti efektiv nga fakti i të thënit të diçkaje.

Si shprehëse të qarta të aktit ilokutiv janë përdorimet e sintagmave dhe foljeve të tipit: *kur pashë nivelin me të cilin ju prezantuat//personalisht mendoj se/është mjaft e qartë se.../e pashë prezantimin tuaj me keqardhje/përse unë mendoj se...; do bënit mirë të mësonit; si mundët ju të bëni një deklaratë të tillë/megjithatë, përsëris se.../ nuk mund të lë pa përmendur se.../dëshiroj ta mbyll këtë letër të hapur.*

Nga sa vërehet foljet që shpesh marrin karakter intensiv, janë tregues të fortë të qëndrimit të vetë autorit. Ato paraqiten herë pohuese: *pashël/mendoj/më erdhi mjaft rëndë/supozoj/ju nuk mund të deklaroni*, herë shprehëse: *përsëris/si mundet ju të bëni një deklaratë të tillë/të kërcejë degë*

²⁴⁶ Sqarim: Bëhet fjalë për librin e Robert d'Angely-së: "Enigma", Tiranë, 1988. (Shënimi ynë).

më degë, herë deklaruese: do bënit mirë të mësonit/ gafat tuaja historike mbi figurat politike amerikane sigurisht që do t'i kenë lënë me gojë hapur/dëshiroj ta mbyll.

Pyetja 6. A na bind ky autor me argumentet e veta? Pse po apo pse jo?

Përgjigje 6. Po. Argumentet janë si më poshtë:

Tabela nr. 9

1. nivel i ulët gjuhësor dhe mungesë e theksuar koherence në lidhje me faktet historike.	1. kompetencë e lartë jo vetëm kulturore dhe jokulturore ²⁴⁷ , por dhe gjuhësore, historike, etnolinguistike.
2. shtrembërues e keqinterpretues faktesh historike.	2. interpretues korrekt i këtyre fakteve historike, të cilat i karakterizon jo thjesht sinteza, por dhe analiza (shtjellon detajisht përmes të dhënave e dokumenteve në rrjedhë të kohës).
3. emotiv, pasionant dhe aspak logjik.	3. krejtësisht logjik dhe i zhveshur nga emocionet. (natyrshmëria dhe të qenët logjik gjatë ligjërimit tonë është një mjet i fuqishëm bindës);
4. qesharak përballë auditorit.	4. bindës dhe argumentues me auditorin.

Që të jemi bindës, nuk mjafton thjesht të rendisim njëra pas tjetrës argumentet logjike. E rëndësishme është që të jemi të mirorganizuar me mendimet dhe provat tona, në mënyrë që të ndikojmë tek audienca, ta bindim atë. Kjo do të thotë që nuk duhet t'i shfaqim argumentet tona si pjesë të izoluar, ose si pjesë që duhet të deshifrohen. Nëse ne izolojmë argumentet tona në pjesë dhe këto të fundit i copëzojmë më tutje në pjesëza, ose i heqim nga konteksti, ne ndryshojmë vetë argumentin. Të mirorganizuar me njëra-tjetrën dhe të mbështetura edhe nga tregues të tjerë

²⁴⁷ Sipas Richard Hudson-it përcaktohen 3 lloj njohurish: 1. njohuri kulturore që mësohen nga të tjerët 2. njohuri jokulturore e përbashkët. 3. njohuri jokulturore jo e përbashkët. Për më tepër shih: "Sociolinguistika", shtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2002, fq. 86.

si: ngjyrimet që i japim fjalëve, gjuhën dhe stilin e përdorur, këto argumente do të jenë shtylla kryesore në fitoren e luftës sonë. Kur **Lakoff-i** dhe **Johnson-i** shpallën se: “*Argumentimi është luftë*”, metafora e tyre mbartte idenë e vlerës dhe fuqisë shprehëse që vetë fjala transmeton. Kjo luftë, e parë në kontekstin dhe sfondin rrethues të vet, do të thotë:

1. ekzistencë konflikti

2. vetë ky konflikt me intensifikimin dhe përshkallëzimin që përshkon, lejon të krijojë paqen dhe qartësinë e vetë argumentit.

Pra, arsyeja është ajo që zgjidh në mënyrë jo të dhunshme këtë konflikt.

Ndaj, për sa më lart, argumentet duhet të shihen të lidhura ngushtësisht edhe me elementet e tjera përmbajtësore të tekstit, elemente këto që realizojnë dy kriteret bazë: kohezionin dhe koherencën. Nëse kohezioni i përqendron linjat formale të lidhja e një fraze me një tjetër, të lidhja e një njësie sintaksore komplekse me tjetrën e të gjitha këto lidhje realizohen në saje të ndihmesës së konektorëve, ku këta të fundit mundësojnë mirorganizimin dhe vazhdimësinë e fragmenteve plotësuese, koherenca përqendron marrëdhëniet semantike dhe logjike, të krijuara ndërmjet përbërësve të tekstit; qëndron mbi ekuilibrin mes nevojshmërisë së futjes së elementeve të reja të kuptimit dhe nevojave të vazhdimësisë tematike. Marrëdhënia logjike nga një fjali të tjetra siguron vazhdimësinë e tekstit.

Elementet që realizojnë lidhjen leksiko-gramatikore të elementeve të tekstit sipërfaqësor, pra kohezionin e tekstit janë: rimarrjet me llojet dhe nënlojet e veta (e plotë/e pjesëshe; paralelizmi; parafraza); proformat (anaforat²⁴⁸, deiksisët: përemrat vetorë, dëftorë, ndajfoljet kohore, vendore) etj. Këto elemente, duke qenë të mirëharmonizuara, sjellin një shtrirje të qartë mendimi dhe logjike, duke i dhënë tekstit arritshmërinë dhe efektshmërinë e duhur. E gjitha kjo ka të bëjë me koherencën, si tregues të së cilës mund të veçonim gjuhën që përdor autori, kuptimet që fjalët marrin në kontekst, fushën leksikore, stilin etj.

Ja konkretisht treguesit e kohezionit dhe të koherencës në tekstin në fjalë:

Rimarrje e plotë (e njëjta fjalë pa ndryshim të kategorisë leksiko-gramatikore):

- *E pashë prezantimin tuaj me keqardhje, por megjithatë nuk do të ulesha dhe t'ju shkruaja këtë letër, nëse nuk do dëgjoja gati të njëjtat mendime nga*

²⁴⁸ Sqarim: sipas kontekstit gjuhësor, nuk është figura retorike që përdoret në letërsi, por dukuri sintaksore-gramatikore që përdoret për të rimarrë një element gjuhësor të thënë paraprakisht.

Lidhur me këtë koncept, një shtjellim të hollësishëm kryesisht në plan qasës-krahasues midis shqipes dhe ndonjë gjuhe tjetër, por edhe vetëm në shqipe, e gjejmë tek autorë të tillë si: Eldina Nasufi, Jonida Gjuzi-Bushi, Anila Çepani e ndonjë tjetër.

disa të rinj shqiptarë në Boston, të cilët kishin marrë pjesë në një prej prezantimeve Tuaja me komunitetin atje.”; “Vlera e një diplomati nuk varet nga madhësia e territorit të vendit të vet, as edhe nga numri i popullsisë së tij, por nga mënyra se si ai diplomat e përfaqëson vendin e tij.

Rimarrje e pjesshme (e njëjta fjalë me ndryshim të kategorisë leksiko-gramatikore):

- Ju nuk mund të deklaroni se Shqipëria “ka ca kufij me Greqinë” dhe “kufizohet nga Serbia dhe Mali i Zi” apo Skënderbeu – “luftëtari që luftoi 57 vjet kundër turqve.”

Parafrazë (nënllaj i rimarrjes shprehur me modifikim të kategorisë gramatikore):

- Personalisht mendoj se niveli gjuhësor i përdorur nga ana Juaj në këtë prezantim në një auditor universitar, lë shumë për të dëshiruar dhe është në nivele jo të pranueshme për një ambasador, i cili ka kontakte të vazhdueshme me kancelaritë e rëndësishme të Uashingtonit.”; “Është e pamundur që në një letër të tillë të renditen të gjitha gabimet, pasaktësitë dhe gafat tuaja historike për Shqipërinë dhe rajonin.

Anaforat dhe deiksisët:

Personalisht mendoj se në një prezantim si ai tuaji...; (anaforë); Për sa i përket këmbënguljes suaj se shqipja vjen nga pellazgjishtja, kjo ndoshta mund të ishte pjesë e një bisede mes miqsh në ndonjë klub të Tiranës, por kurrësi pjesë e një prezantimi të një ambasadori në një auditor universitar. (deiktik); Ju nuk mund të harroni se kreu i Shtetit është Presidenti i Republikës dhe në prezantimin Tuaj, Ju nuk mund të harroni një fakt të tillë themelor, i cili respekton sikur edhe formalisht hirarkinë shtetërore. (deiktik); Është e pamundur që në një letër të tillë (deiktik) të renditen të gjitha (deiktik) gabimet, pasaktësitë dhe gafat tuaja historike për Shqipërinë dhe rajonin, por nuk mund të lë pa përmendur se njohuritë tuaja për historinë e antikitetit dhe mesjetën e vendit tuaj janë të pamjaftueshme për të pasur guximin që Ju t'i prezantoni në një auditor universitar, kudo (deiktik) qoftë ai. (anaforë); Ishte këtu, në këtë Konferencë dhe jo në vitin 1913...” (deiktikë); “Për sa i përket këmbënguljes suaj se shqipja vjen nga pellazgjishtja, kjo ndoshta mund të ishte pjesë e një bisede mes miqsh në ndonjë klub të Tiranës, por kurrësi pjesë e një prezantimi të një ambasadori në një auditor universitar. Kjo mund të thuhet akoma më tepër për këmbënguljen tuaj se libri “Enigma”... (deiktik).

Fusha leksikore që mbizotëron në tekst: qytetar i thjeshtë - qytetari; prezantim - prezantohet; mendoj - gjykoj; fakt - dokument - dëshmi.

Tregues të qartë të mendimit dhe të qëndrimit që mban autori janë figurat patetike si: përsëritja, litota, metafora, ironia, ku kjo e fundit herë-herë shkon deri në sarkazëm. Konkretisht:

Përsëritje: Z. Ambasador; personalisht mendoj se; përsëris se.

Litotë: nuk do të ulesha dhe t'ju shkruaja këtë letër, nëse nuk do dëgjoja gati të njëjtat mendime nga disa të rinj shqiptarë; Ju nuk mund të deklaroni se Shqipëria "ka ca kufij me Greqinë" dhe "kufizohet nga Serbia dhe Mali i Zi", duke harruar se Kosova nuk është më pjesë e Serbisë.; nuk mund të lë pa përmendur se...

Metaforë: anglishtja juaj edhe mund të gëlltitej; një ambasador duhet të bëjë një pasqyre të saktë të vendit të tij në mënyrë kronologjike dhe logjike dhe jo të kërceje degë me degë pa asnjë lidhje; gafat tuaja historike mbi figurat politike amerikane sigurisht që do t'i kenë lënë me gojë hapur; ajo që ju kërkonit të thonit (por që e bëtë lësh).

Ironi: në Shqipëri falen shumë gjëra; mesa duket ish-ministri juaj i Jashtëm, i cili nuk dinte vetë asnjë fjalë anglisht, e ka falur këtë kërkesë të rëndësishme për ambasador në Uashington.; a thua se Skënderbeu ynë kishte qenë Drejtori i Doganës së Vlorës); auditori amerikan dëgjoji se Shqipëria tashmë ka ndërtuar Korridorin e 8-të, një lajm ky i panjohur deri më tani në Shqipëri dhe në rajonin tonë.

Sarkazëm: një auditor universitar, nuk mund të mos nënqeshë kur merr leksione mbi historinë botërore nga Ju.; ndoshta shpjegimet tuaja naive mbi flamurin shqiptar se gjoja ai është "me shqiponjë si e amerikanëve" apo "ka dy koka, sepse Guvernatori Skënderbe e kishte ushtrinë nga Veriu dhe Jugu e ku trupi i shqiponjës është vetë Guvernatori Skënderbe dhe dy kokat janë Veriu dhe Jugu" mund të mos krijojnë të qeshura. Por nëse ju e quani Perandorinë Romake të shtrirë nga Roma në Istambul, (duke harruar se Perandoria Romane ishte e shtrirë jo vetëm në një territor më të gjerë, por Istambul apo Stamboll u quajt kështu vetëm pas marrjes së Konstandinopojës nga Otomanet), kjo është me të vërtetë për të qeshur; vlera e një diplomati nuk varet nga madhësia e territorit të vendit të vet, as edhe nga numri i popullsisë së tij, por nga mënyra se si ai diplomat e përfaqëson vendin e tij. Shembulli më i mirë që ilustron këtë frazë është Konica, pasardhësi i të cilit është Sallabanda ynë i mjerë.

Tregues mjaft domethënës në përkapjen e tekstit dhe të nëntekstit janë gjithashtu konektorët, të cilët jo vetëm krijojnë dhe orientojnë marrëdhëniet logjike midis pjesëve të tekstit, por njëherazi janë shprehës të qëndrimit emocional të vetë autorit. Konkretisht kemi:

Konektorë logjikë. Të këtyllët shprehin marrëdhënie logjike që lidh përmbajtje të ndryshme të tekstit. Këto raporte mund të jenë të kohës, të hapësirës, të kundërvënies, të zgjerimit të informacionit, të shpjegimit, të shtjellimit, të përfundimit.

- përpara disa javësh një miku im gazetar amerikan i një të përditshmeje...; nëse auditori i atij universiteti në Utah nuk e ka shumë idenë se kush ka qenë Skënderbeu, të cilin ju një herë e quanit "Guvernator i Parë i Shqipërisë", apo xhentëlmen, luftëtar që luftoi 57 vjet kundër turqve dhe

njëherë “personi që nuk i jepte lejen turqve të shkonin në Itali” (a thua se Skënderbeu ynë kishte qenë Drejtori i Doganës së Vlorës), me siguri që ata e njohin shumë mirë historinë e vendit të tyre.; auditorët universitare sigurisht që mund të mos e njohin mirë historinë e Shqipërisë...; promovimi i arritjeve, sukseset, historia, kultura, turizmi, letërsia janë disa nga temat interesante që mund të trajtohen dhe jo të habitet dëgjuesi me kotësira të tipit “ka ca dokumente në botë si libri “Enigma” që është bestseller se flet për Shqipërinë” apo “shikoni filmin The Fifth Element se është zëri i Inva Mulës”, apo “Ferit Murati ka shpikur Viagrën”...; vlera e një diplomati nuk varet nga madhësia e territorit të vendit të vet, as edhe nga numri i popullsisë së tij, por nga mënyra se si ai diplomat e përfaqëson vendin e tij.

Konektorë pragmatikë. Të këtuillët shërbejnë për të udhëhequr lexuesin dhe për ta orientuar në strukturën e tekstit.

Është mjaft e qartë se në prezantimin tuaj, Ju nuk mund të jeni në gjendje të shprehni të gjitha ato që dëshironi...; Presidenti Willson në vitet kur Lufta e Parë Botërore nuk kishte filluar akoma, as që e ka përmendur ndonjëherë vendin të cilin sot ju e përfaqësoni. Ajo që ju kërkonit të thonit (por që e bëtë lëmsh) është fakti se...

Konektorë shprehës të qëndrimit të folësit a të shkruesit. Të këtuillët pohojnë qëndrimin që mban folësi a shkruesi e që në rastin konkret bëhet fjalë për këtë të fundit.

Gjithsesi, shumëkush që do të lexojë këtë letër do habitej se përse unë mendoj se kryediplomati ynë në Uashington duhet të flasë një anglishte perfekte.; Personalisht mendoj se niveli gjuhësor i përdorur nga ana e Juaj në këtë prezantim në një auditor universitar, lë shumë për të dëshiruar...; Është e pamundur që në një letër të tillë të renditen të gjitha gabimet, pasaktësitë dhe gafat tuaja historike për Shqipërinë dhe rajonin, por nuk mund të lë pa përmendur se...; Megjithatë, përsëris se nëse prezantimi juaj mbi Shqipërinë do kishte ndopak rrjedhë logjike, anglishtja juaj edhe mund të gëlltitej...; Dëshiroj ta mbyll këtë letër të hapur me një pasazh...

Lidhur me anën grafematike të tekstit vëmë re të përdoren thonjëzat jo thjesht për efekt citimi, por gjithashtu në funksion të dhënies së ironisë që vetë autori i tekstit synon. Të tilla përmendim: *ka ca dokumente në botë si libri “Enigma” që është bestseller, se flet për Shqipërinë; Skënderbeu luftoi për interesin e Kishës Kristiane; Nëna Terezë ishte “very teenager” kur iku nga Shqipëria; Shqipëria “ka ca kufij me Greqinë”; Skënderbeu: Guvernatori i Parë i Shqipërisë, xhentëlmen, luftëtar që luftoi 57 vjet kundër turqve, personi që nuk i jepte lejen turqve të shkonin në Itali; shpjegimet tuaja naive mbi flamurin shqiptar se gjoja ai është “me shqiponjë si e amerikanëve” apo “ka dy koka, sepse Guvernatori Skënderbe e kishte ushtrinë nga Veriu dhe Jugu e ku trupi i shqiponjës është vetë Guvernatori Skënderbe dhe dy kokat janë Veriu dhe Jugu.”*

Dukshëm vërehet që thënia përmbyllëse jepet në formën e një citati, referimi i të cilit nuk bëhet pa synim: *“Vlera e një diplomati nuk varet nga madhësia e territorit të vendit të vet, as edhe nga numri i popullsisë së tij, por nga mënyra se si ai diplomat e përfaqëson vendin e tij.”* Ky referim, i futur mes thonjzash, do të na çojë drejt një ironie që shkon deri në shkallën e sarkazmës: *“pasardhësi i të cilit është Sallabanda ynë i mjerë.”* Sarkazma e shprehur me cilësorin “i mjerë”, krijon një efekt të dyfishtë të marrësi i tekstit:

1. ngjall ndjenjën e keqardhjes a të mëshirës për personin në fjalë;
2. bën apel për gjendjen intelektuale me të cilën prezantohet Shqipëria nëpër botë.

Ky *topos* shërben në përmbylljen e konkluzionit si dhe të qëllimit që ka vetë subjekti argumentues ndaj subjektit shënjestër.

6.2. Prania e argumenteve në tekste

Nuk ka pse fjala *argument* të jetë e shkruar diku që ne të kuptojmë ekzistencën dhe rëndësinë e vet. Argumentet ndodhen gjithkund. P.sh., çdo lloj material që ne lexojmë, në vetvete përbën interpretimin e një personi të caktuar mbi një tërësi informacioni. Në këtë gjerësi informacioni na jepen të dhëna, fakte, që thjesht mund të ngelen në këtë kuadër e jo më tepër. Pra, nuk na bindin, nuk argumentojnë. E rëndësishme është fakti që të dallojmë diferencën mes të dhënave dhe argumenteve. Diferencat e opinioneve janë pasqyrë e qartë e zhvillimit të dijes njerëzore dhe këto shprehen në debatet lidhur me çka është “e vërtetë”, “e drejtë” apo në të kundërt “e rreme”, “e padrejtë”. Argumentimi nuk është pronë vetëm e një fushe. Përkundrazi, ne të gjithë e përdorim atë në jetën e përditshme. Në një mënyrë apo në tjetrën ne jemi në marrëdhënien të bindur - bindës, argumentues - joargumentues. Sa më shumë që i përforcojmë aftësitë dhe gjykimet tona, aq më të aftë bëhemi për të menduar në mënyrë kritike, për të arsyetuar, për të bërë zgjedhje dhe për të peshuar fakte. Ja disa ilustrime, ku, ku më shumë e ku më pak, elementet argumentuese janë të kudondodhura.

Tekst filozofik

Sokrati: “Kur një njeri vepron, kjo ndodh sepse përherë ai priret të arrijë diçka të cilën e sheh si të mirë. Edhe në rastin më të keq: edhe një kriminel mendon të arrijë diçka për të cilën beson se është e mirë për të. Vetëm një qenie psikikisht e papërgjegjshme, një budalla mund të bëjë përjashtim prej kësaj. Atëherë si lind e keqja? “E keqja, thotë Sokrati, rrjedh

nga fakti se njeriu gabohet lidhur me çështjen e së mirës”. Një të mirë të gënjeshtërt, ai e merr si një e mirë e vërtetë, ai parapëlqen një të mirë më të vogël sesa një të mirë më të madhe, ai sakrifikon një të mirë të madhe për t’u dhënë pas një të mirë më të vogël. Dhe gabohet. E keqja vjen nga padija. (sipas Sokratit, detyra themelore është zhvillimi, forcimi i ndjenjës së të vërtetës te njeriu). Padituria prej së cilës rrjedh një veprim i keq nuk është një padituri objektive, e cila mund të ishte shënuar nëpërmjet një dijeje të jashtme më të madhe ose me më shumë informacion. Është një padituri më e madhe, një paaftësi e brendshme për të dalluar dhe për të gjykuar. Të njohësh të vërtetën e mirë, është në vetvete edhe një veprim moral. Për të njohur të mirën e vërtetë, në fillim duhet të bëhesh i aftë për këtë. Vetë kjo është një sjellje morale.”²⁴⁹

Tekst kritikë letrare

“Për Fishtën dhe veprën e tij prej tashti do të shkruhet shumë: edhe për shkak se ishte kaq gjatë i përjashtuar prej letërsisë shqipe; edhe për shkak se vepra e tij është e pastudiuar: edhe për shkak se kjo vepër është shumë interesante për studime me metoda të ndryshme. Por, për Fishtën dhe veprën e tij do të shkruhet shumë edhe për shkak së për të është folur dhe shkruar në mënyra të ndryshme sa ishte gjallë, apo menjëherë pas vdekjes. Do të shkruhet shumë për të për shkak se ekziston miti i tij. Mitin e Fishtës e kanë krijuar: ithtarët, miqtë, adhuruesit e tij të shumtë, por edhe individët e ndryshëm që edhe kanë dashur ta bëjnë mit. Për të gjallë e kanë pagëzuar Homeri i Shqypnisë, Tirteu shqiptar. E kanë krahasuar me Gëten dhe me Shilerin. I kanë thënë: poet i Kombit; poet popullor, poet luftëtar, apostulli i pavarësisë, poet i shnosh! E kanë quajtur: tipi vigan i racës: mbreti i poetëve shqiptarë: ai qi na ka ushqye shpirtin, na ka çilun mendjen, na ka ngrohun zemrën dhe armatosur krahun: gjenia më e naltë e fisit arbnuer: pjella ma fisnike e ma e bukur e tokës së të parëve tanë: krenija e kombit tonë! Kryevepra e tij “Lahuta e Malcis”, është çmuar si bibël kombëtare dhe është quajtur: përmendore kombëtare: monument klasik i rodit trako-ilir: udhëndriçues për ata që dëshprehen; vade mekum i çdo atdhetari. E të tjera. Përpos të vetëve, shqiptarëve, Fishtën e kanë madhëruar edhe të huaj, si Antonio Baldaçi, që e quan “energjin e Fretënve shqiptarë” dhe shkrimtari i famshëm italian, Gabriel D’Anuncio, që në kohën kur Shqipëria ishte e

²⁴⁹ Platoni: “Apologjia e vërtetë e Sokratit; Kritoni, Fedoni, Elozhi i dashurisë ose simpoziumi”, vep. e cit., fq. 68.

okupuar prej Italisë, e quan “Poeti ma i madh i popullit të lumnueshëm të Shqypnis”...”²⁵⁰

Tekst narrativ

“Ata nuk janë si malet. Malet janë më të bukura. Kush mbërrin përpara tyre, nuk mund të mos mendojë për madhësitë e krijimit. Ata janë prova e gjallë e dashurisë, që Zoti ka për ne, por kanë vetëm fatin për ta dëshmuar këtë gjë. Ata nuk janë si lumenjtë, që rrjedhin dhe ndryshojnë peizazhin.

- Është e vërtetë. Po përse të mos jemi si malet?

- Ndoshta ngaqë fati i maleve mund të jetë i tmerrshëm. Ata janë të detyruar të sodisin gjithnjë të njëjtin peizazh...”²⁵¹

Tekst gazetaresk

“Vetëm gjëmimi dhe dëmet u dëgjuan dhe u shkaktuan në një lokal përballë prokurorisë së përgjithshme mesnatën e Shën Valentinit. Fitili ishte ndezur përgjatë shumë e shumë kohësh, kurse shkëndijën tek ai e kanë vënë jo njerëz “të panjohur” me maska, jo natën, por personazhe të njohur të publikut dhe ditën; ata që paguhen nga publiku dhe që rëndom quhen politikanë. E kanë ndezur shkëndijën fatale ditë mbas dite, përballë kamerave, në forume partiake apo në seli qeverisëse. Me teknologjinë që di të prodhojë vetëm urrejtje dhe tension. Në Ballkan baruti është gjithmonë i thatë dhe jo aksidentalisht ai mund të shpërthejë në çdo moment. Aftësia e shndërrimit të garave politike në luftë politike që zhvillohet me mjete jopolitike, janë në dukje vetëm topi fillestar dhe i pistë i dëborës që shkakton ortek. Një mallkim apo kërcënim fushate – dhe Shqipëria ngjan se ndodhet në një fushatë zgjedhore që zgjat prej 15 vjetësh – tek njerëzit e thjeshtë shndërrohet në armë, shndërrohet në të drejtën për të përdorur armën ndaj kundërshtarit dhe për ta trajtuar atë me armiqësi dhe si armik. Dhe atëherë kur mbërrihet tek tritoli, nuk ka pse të ketë më kuriozitet, nuk ka pse të bëhet pyetja e kotë: Kush e përgatiti tritolin?

Edi Rama, lideri i së majtës, i cili fatmirësisht u largua vetëm pak çaste përpara se shpërthimi të quhej “fatal”, - jo thjesht për individin, por edhe për vetë demokracinë në vend - u tregua i rezervuar në komentimin e tij.

²⁵⁰ Rexhep Qosja: “Gjergj Fishta dhe çështja shqiptare” te “*Maja e çelur*”, Antologji e letërsisë bashkëkohore shqiptare, Gjergj Zheji – Natasha Xhafka:, SHBLSH, print. Itali, 1996, fq. 423.

²⁵¹ Paulo Coelho: “Në breg të lumit Piedra u ula dhe qava” te “*Përkthime*”, III, sjellë në shqip nga Nonda Varfi, vep. e cit., fq. 281.

“Më lejoni të mos besoj që mbas kësaj ngjarjeje qëndrojnë njerëz që mbajnë poste zyrtare apo edhe të zhytur në llumin e krimit. Aleati i tij Meta shkon dhe më larg. Për LSI-në, nuk ka dyshime: Vendosija e tritolit është një provë e qartë që tregon se “Berisha është rikthyer në strategjinë e shantazhit dhe presionit të hapur si në vitet e tragjedisë së tmerrshme të 1996 – 1997”.

Por zoti Berisha, kryeministër i vendit, kërkon të jetë dorëjashtë. Vetëm dje pasdite, pothuaj 17 orë pas krimit, mbërriti komenti i tij i parë. “Qeveria ka marrë masat për të garantuar zhvillimin normal të veprimtarisë politike të Ramës”, ishte reagimi qeveritar për tritolin pranë Ramës, që edhe në këtë rast e quan “Edvin”.

Orë më parë vetë Rama kishte dëshmuar: “Shqipëria që unë dua është vend ku kryeministri i telefonon kryetarit të opozitës menjëherë mbas një ngjarjeje të tillë”, duke e ditur mirë se këtë telefonatë nuk do të merrte kurrë, sepse e di mirë që në Shqipëri, një gjë e tillë nuk është traditë.

Ky është momenti që vërtet Shqipëria meriton kujën, sepse Shqipëria deri tani nuk ka merituar ‘garën’, por duelin, Shqipërisë nuk i kanë afruar konkurrimin, po ndeshjen për jetë a vdekje, Shqipëria është bërë dëshmitare e një fjalori të drejtpërdrejtë vdekjeje edhe kur flitet për ardhmërinë e saj.

Ndaj përpara se Prokuroria dhe policia e Shtetit ta konsiderojnë këtë një akt terrorist, qytetarët duhet të mbajnë shënim sesa terrorizëm politik derdhet përditë në ekranet e televizioneve dhe faqet e gazetave. Përpara se të gjenden individë që goditën direkt, duhet të gjenden frymëzuesit e tyre.

Në një vend në të cilin është normale që gjithë politikanët të klasifikohen kriminelë, që kriminel quhet dhe Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm, kryetarët e partive të mëdha – plus edhe ata të partive më të vogla dhe deputetët – nuk është një vend normal.

Ky është çasti dhe motivi i duhur për të reflektuar se për çfarë rrethanash dhe arsyesh kemi mbërritur të gjithë së bashku në këtë pikë, një pikë që trishtueshmërisht ngjan e pakthyeshme. Të paktën me këta protagonistë.”²⁵²

Tekst i një letre të thjeshtë

“Nëse do e dija se kjo do ishte hera e fundit që do të të shihja të dilje nga dera, do të të përqafoja dhe do të të jepja një puthje dhe do të të thërrisja përsëri që të të jepja edhe të tjera. Nëse do e dija se kjo do ishte hera e fundit që do dëgjoja zërin tënd, do magnetofoja çdo fjalë tënden që të mund të të dëgjoja përsëri, përsëri. Nëse do e dija që këto do ishin momentet e fundit që

²⁵² Artikulli me temë: “Këmbanat politike të mortit” nga Lorenc Vangjeli, tek e përditshmja shqiptare “Gazeta shqiptare”, e premte, 16 shkurt 2007, fq. 22.

do të të shihja, do të të thoja “të dashuroj” dhe do supozoja jo logjikisht se e dije më parë.”²⁵³

Tekst recetë kuzhine

Si të ushqehemi

“Ushqimi i përditshëm nuk mjafton vetëm të jetë i pasur me të gjitha vlerat ushqimore, por e rëndësishme është dhe marrja e tij në vendet e caktuara. Nuk është mirë që gjatë ditës të hamë disa herë duke marrë sasi të mëdha ushqimi, pasi aparati tretës ngarkohet tepër dhe organizmi ka tepër çrregullime. Marrja e ushqimit gjatë ditës varet nga mosha dhe puna që bëjmë. Kështu, te fëmijët lidhet me kërkesat fiziologjike të organizmit të tyre, sepse te ata ushqimi zëvendëson energjitë e humbura dhe është bazë për formimin e qelizave dhe indeve të reja.”²⁵⁴

Tekst nga Bibla

4. Maturia në përdorimin e gjuhës

1. Vëllezër të mi, mos u bëni shumë mësues, duke ditur se do kemi një gjykim më të ashpër,
2. sepse të gjithë gabojmë në shumë gjëra. Në qoftë se dikush nuk gabon në të folur, është njeri i përsosur, dhe është gjithashtu i aftë t'i vërë fre gjithë trupit.
3. Ja, u vëmë fre në gojë kuajve, që të na binden, dhe ta drejtojmë kështu gjithë trupin e tyre.
4. Ja, edhe anijet, edhe pse janë shumë të mëdha dhe shtyhen nga erëra të forta, drejtohen nga një timon shumë i vogël, atje ku do timonieri.
5. Kështu, edhe gjuha është një gjymtyrë e vogël, por mbahet me të madh. Ja, një zjarr i vogël ç'pyll të madh djeg!
6. Edhe gjuha është një zjarr, një botë paudhësie: ajo është vendosur midis gjymtyrëve tona, gjuha e fëlliq gjithë trupin, ndez ecjen e natyrës dhe ndizet nga Gehena.
7. Sepse çdo lloj bishash, shpendësh, zvarranikësh edhe kafshësh të detit, mund të zbuten dhe janë zbutur nga natyra njerëzore,
8. kurse gjuhën asnjë nga njerëzit s'mund ta zbusë; është një e keqe e papërmbajtshme, plot me helm vdekjeprurës.

²⁵³ Fragment nga letra e lamtumirës së Gabriel Garsia Marques, drejtuar njerëzve të tij, para se ai të vdiste.

²⁵⁴ Evgjëni Harizi: “*Si të gatuajmë*”, shtëpia botuese “Botagri”, Tiranë, 2006, fq. 33.

9. Me atë ne bekojmë Perëndinë dhe Atin, dhe me të ne mallkojmë njerëzit që janë bërë sipas shëmbëllimit të Perëndisë.

10. Nga e njëjta gojë del bekimi dhe mallkimi. Vëllezër të mi, nuk duhet të ishte kështu.

11. Mos vallë burimi nxjerr nga e njëjta vrimë ujë të ëmbël e të hidhur?

12. A mundet të prodhojë fiku ullinj, ose hardhia fiq? Kështu, asnjë burim nuk mund të japë ujë të kripur dhe të ëmbël.²⁵⁵

Tekst nga Kushtetuta

A parashikon Kushtetuta Autonomi për qeverisjen vendore?

Po. Në nenin 13, Kushtetuta parashikon shprehimisht se shteti shqiptar është krijuar mbi parimet e decentralizimit dhe të autonomisë vendore. Gjithashtu, nenet 108-115 e bëjnë të qartë se organeve të ndryshme të pushtetit vendor u është garantuar e drejta për të lidhur kontrata, mbledhur taksa dhe administruar të ardhurat dhe pronat e tyre në mënyrë të pavarur.²⁵⁶

Neni 30

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendin gjyqësor të formës së prerë.²⁵⁷

Tekst poezie

Në mundsh

“...Në mundsh të flasësh me maskarenj, por nderin ta ruash
A të ecësh përkrah mbretit pa krenari që t'verbos
Nëse armiku ose miku s'të bëjnë dot të vuash
Dhe gjithçka e çmon, por veç sa meriton.
Në mundsh të mbushësh dy minuta aq të rënda
Me vepra që peshojnë – Dije dhe mos ke asnjë dyshim
Se jotja do t'jetë bota, me gjithë ç'ka brenda
Dhe burrë do të jesh, o biri im!”²⁵⁸

²⁵⁵ Bibla, Jakob, 3, 4, vep. e cit., fq. 268.

²⁵⁶ Kushtetuta dhe materiale shpjeguese, vep. e cit., fq. 8.

²⁵⁷ Po aty, fq. 16.

²⁵⁸ Rudyard Kipling (1865 – 1936): “Në mundsh...”, fituar çmimin Nobel për poezi më 1907.

Tekst fabule**Ujku dhe qengji**

Kush është më i fortë përherë ka të drejtë,
Do ta tregojmë tani shpejt.

Një qengj etjen ish duke shuar
Në një burim ujëkulluar;
Një ujë i agjëruar që sillen n'ato anë
Me barkun zgrop i qaset pranë.
“Sa të turbullosh ujin qëkur m’u bëre trim?
I thotë bisha me tërbim;
Për trimërinë tënde të kam për të dënuar.”
“O mbret, - përgjigjet qengji, - kjo madhëria juaj
Gjakun mos ta turbullojë,
Por më mirë le të shikojë
Se pi ujë në vendin tim
Në burim
Njëzet hapa më poshtë se ju;
Kështu që s’është e mundur dhe shkakun s’e kuptoj
Si ujët mund ta turbulloj.”
“E turbullon, - i thotë kjo bishë e pamëshirshme, -
Dhe vitin e kaluar ti më ke sharë një herë.”
- Po si të paskam sharë kur ende s’kisha lerë?
Përgjigjet qengji, - unë ende po pi sisë.
- Në mos je ti, vëllaj, - Po s’kam Asnjë.
- Ahere ndonjë nga të shtëpisë,
Se ju në qafë më keni rënë,
Ju, me qen dhe me çoban.
Kështu më thanë. Dënim veç gjakut s’ka!”
Edhe në pyll, thellë mënjanë,
Ujku e shpie dhe e ha
Pa e zgjatur më davanë.²⁵⁹

Tekst aforizmash

- Në qoftë se jeta nuk të ofron një lojë që ia vlen ta luash, atëherë krijo vetë një të tillë.

²⁵⁹ La Fonten: “*Fabula të zgjedhura*”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2005, fq. 27.

- Nëse nuk e zgjidh dot problemin, atëherë kjo do të thotë se po luan brenda rregullave.

Tekst reklame

Reklamë për shitjen e një makine

Tekst 1.

SHITET

(Ti s’do ta mbash mend këtë)

Tekst 2.

Para se të digjet, SHITET

(Ti s’do ta harrosh këtë)²⁶⁰

Tekst fotografie²⁶¹



²⁶⁰ Paul Arden: “Jo sa i mirë je, sa i mirë kërkon të jesh”, shtëpia botuese “Spektër sh.a./Botimet “Max”, Tiranë, 2005, fq. 62.

²⁶¹ Nyja: <https://blog.writecheck.com/wp-content/uploads/2012/12/argument-essay-2.png>

Shënim: Pse kam të drejtë?...



Përfundime për pjesën e dytë

> *Argumentimi* është veprimtari verbale, që përdoret shpesh në gjuhë të zakonshme mes njerëzve. Ky përcaktim vetvetiu na çon në dykuptimësinë proces - prodhim. Pra, kjo do të thotë që argumentimi i referohet jo vetëm aktivitetit të paraqitjes së arsyeve, por edhe *teksteve* të shkurtra a të gjata që rezultojnë nga ai. Koncepte të tilla si: *analizë ligjërimore, ligjërime, sekuencë, strukturë sekuencore, tekst, thënie (kumtim), akt kumtues, situatë kumtuese, thënës, lokutorë*, janë baza e terminologjisë që zbatohen sot në praktikat e analizave të teksteve, sipas kërkesave të reja të gjuhësisë dhe në kuadrin e gjuhësisë tekstore.

> Teksti argumentues përbën padyshim funksionin tekstor më kompleks e më të rafinuar. Çdo tekst argumentues ka në thelb të vet argumentin dhe argumentimin. Ky lloj karakterizohet nga veçori që e dallojnë nga llojet e tjera. Një tekst argumentues është teksti në të cilin shfaqen procedimet argumentuese: *ballafaqime, përkufizime, analogji, klasifikime, ironi*. Në këtë tip, autori i vetë tekstit orvatet të përligjë apo të mbarështrojë një *tezë* (apo disa) kundrejt një *antiteze*, duke dashur të *bindë* marrësin (-it); të japë një *grykim*; të mbajë një qëndrim, duke parashtruar një apo disa *argumente* bindëse të nevojshme e të përshtatshme për të mbështetur interpretimin e vet. Në shërbim të këtij të fundit hyjnë *provat, të dhënat, shembujt*, të cilat shërbejnë për të ilustruar argumentimin e dhënë. Në fund të argumentimit ka gjithnjë një *konkluzion*. Ky është vendi final i gjithë procedurës argumentuese.

Të gjitha elementet e sipërpërmendura, kur janë në mirorganizim me njëra-tjetrën formësojnë një tekst të qëndrueshëm si nga ana strukturore, ashtu dhe ajo kuptimore dhe funksionale.

> Funksionet e këtij tip teksti janë: *bindës* dhe *polemizues*. Gjatë përpjekjeve që bëhen nga ana e autorit në mbrojtjen e një argumenti të caktuar, vihen në përdorim mjaft mënyra për të bindur palën dëgjuese. Qëllimi kryesor i këtij autori është të kundërshtojë përmes argumenteve të tij mendimin apo pozicionin e palës kundërshtare. Në fund fiton ajo palë që është më bindësja.

> Strategjitë apo procedurat argumentuese që përdor autori i tekstit, janë të ndryshme. Kështu, nëse lokutori preferon të ndjekë rrugën e një shpjegimi të thjeshtë (stili direkt), atëherë ky në vetvete është sa më konkret dhe mbështetet në *argumentet logjike*. Shpesh si të tilla shërbejnë *provat, faktet reale, përvoja direkte, ilustrime të drejtpërdrejta, referencat konkrete* etj. Përgjithësisht, të provuarit nxit efektin bindës tek auditori. Por, në ndihmë të të parave (argumentet logjike), lokutori mund të vërë në përdorim edhe *argumentet ndjesore* e ku te të tillat hyjnë: *niveli i gjuhës, pasthirrmat, shprehjet pyetësose, fushat leksikore* etj. Nëse lokutori preferon të ndjekë një

rrugë të ndërlikuar e të tërthortë (stili indirekt), ky shpjegim ka pamjen e vargëzimit të ideve, të argumenteve që lidhen logjikisht ndërmjet tyre. Në këtë rast është e nevojshme të përkapet prapamendimi i asaj çka nuk thuhet drejtpërsëdrejti nga lokutori, por vetëm sugjerohet apo ndoshta dhe fshihet. Kjo arrihet përmes një tërësie faktorësh si: inteligjenca e lokutorit, njohja që ai ka rreth fushës ku shtrihet argumenti, përqendrimi absolut etj.

> *Argumentimi*, ky art dhe shkencë njëherazi, është shpesh mjete nëpërmjet të cilit njerëzit mbrojnë besimet e tyre ose interesat vetjake në dialogun racional, në të folurën e përditshme dhe gjatë procesit të debatit. Është i bazuar në komunikimin dialogjik dhe ndërpersonal, por gjithashtu zbatohet edhe në komunikimin në grup dhe atë të shkruar. Përfshin artet dhe shkencat e debatit civil, dialogun, bashkëbisedimin dhe bindjen. Studion rregullat e deduktimit, të logjikës dhe të rregullave procedurale, si në mjediset artificiale dhe ato të botës reale.

Si një teori më vete në ditët e sotme, *argumentimi* është një fushë ndërdisiplinore e kudondodhur, që tërheq vëmendjen e gjuhëtarëve, logjicienëve, filozofëve etj., dhe ka përdorim të gjerë e të shumanshëm.

BIBLIOGRAFI

A. LITERATURË SHQIPE

1. **Agalliu, F.** *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Kombinati Poligrafik, Tiranë, 1988.
2. **Bajnica, I.** *Shqipja standarde dhe probleme rreth saj*, në “Gjuha shqipe” nr. 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007.
3. **Bakillari, V.** *Mjetet lidhëse në frëngjisht dhe në shqip – punim për titullin “Master”*, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, 2006.
4. **Bakillari, V.** *Lidhëzorët kushtorë dhe hipotetikë në gjuhët frënge dhe shqipe*, në “Kërkime universitare”, nr. 25, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2009.
5. **Bakillari, V.** *Lidhëzorët në gjuhët frënge dhe shqipe. Klasifikimi i tyre logjiko - semantik*, në “Kërkime universitare”, nr. 27, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2010.
6. **Bakillari, V.** *Analizë lidhëzore në një tekst argumentues*, në “Kërkime universitare”, nr. 32, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2012.
7. **Byron, J.** *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2012.
8. **Çeliku, A.** *Koherenca tekstore. Hyrje në konceptet bazë të gjuhësisë së tekstit nëpërmjet një qasjeje krahasuese të shqipes me gjermanishten*, shtëpia botuese “Asdreni”, Shkup, 2005.
9. **Çepani (Sema), A.** *Anafora në gjuhën shqipe – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”*, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, departamenti i gjuhës shqipe, Tiranë, 2011.
10. **Demiraj, Sh.** *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë, 1988.
11. **Dibra, K.** *Il testo descrittivo nella lingua albanese e quella italiana (Teksti përshkrues në gjuhën shqipe dhe atë italiane) – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”*, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës italiane, Tiranë, 1997.
12. **Dibra, K. – Varfi, N.** *Gjuhësi teksti*, SHBLU (1999, 2005) si dhe shtëpia botuese “Albatros”, Tiranë, 2007.
13. **Dibra, K. – Varfi, N.** *Deiksis dhe shprehjet deiktike në gjuhën shqipe*, në “Studime albanologjike”, I, botim i universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, Tiranë, 2000.
14. **Gjata, L.** *Argumentimi në gjuhë dhe teksti argumentues në frëngjisht dhe në shqip – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”*, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës frënge, Tiranë, 2005.

15. **Gjuzi (Bushi), J.** *Anafora dhe deiksisi: një përpyetje përkuqfizimi*, në "Kërkime universitare", nr. 34, universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër, 2012.
16. **Gjuzi (Bushi), J.** (në proces): *Anafora dhe deiksisi në gjermanisht dhe shqip* – disertacion për marrjen e gradës shkencore "Doktor i shkencave", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë.
17. **Hudson, R.** *Sociolinguistika*, shtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2002.
18. **Ismajli, R.** *Shumësia e tekstit*, shtëpia botuese "Rilindja", Prishtinë, 1980.
19. **Islamaj, Sh.** *Gjuha dhe identiteti*, shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 2008.
20. **Kostari, J.** *Për disa çështje të koherencës anaforike si dukuri e gramatikës së tekstit*, në "Gjuha jonë", botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë si dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, I – 4, Tiranë, 1995.
21. **Lafe, E.** *Gjuha dhe shkrimi*, në "Gjuha shqipe", nr. 3, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007.
22. **Lyons, J.** *Hyrje në gjuhësinë teorike*, shtëpia botuese "Dituria", Tiranë, 2001.
23. **Lloshi, Xh.** *Stilistika dhe pragmatika*, shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 1999.
24. **Lloshi, Xh.** *Komunikimi*, përkthim me bashkautorësi: Christian Baylon – Xavier Mignot, Logos – A, Shkup, 2007.
25. **Mëniku, L.** *Çështje të konektorëve të tekstit në gjuhën shqipe*, në "Studime albanologjike", I, botim i universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, Tiranë, 2000.
26. **Mëniku, L.** *Konektorët e tekstit në veprën e Kadaresë*, në "Ismail Kadareja dhe vepra e tij", botim i universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, 2006.
27. **Mëniku, L.** *Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe* – disertacion për marrjen e gradës shkencore "Doktor i shkencave", Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, departamenti i gjuhës shqipe, Tiranë, 2013.
28. **Mita, J.** *Lidhjet anaforike dhe të kontekstit në periudhat rrethanore të kohës*, në "Studime albanologjike", II, botim i universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, Tiranë, 1996.
29. **Murati, Q.** *Probleme të gjuhës së sotme dhe historike të shqipes*, në "Gjuha shqipe", nr. 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007.
30. **Murati, Q.** *Gjashtë pyetje për prof. Xhevat Lloshin*, në "Gjuha shqipe", nr. 1, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007.
31. **Murati, Q.** *Idriz Ajetit: prijatar për njësimin e gjuhës shqipe*, në "Gjuha shqipe", nr. 2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2007.

32. **Mujaj, H.** *Gjuhësia e tekstit*, shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2004.
33. **Nasufi, E.** *Disa veçori gjuhësore të fenomenit të anaforës*, në “Kërkime universitare”, nr. 19, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2008.
34. **Nasufi, E.** *Shprehjet anaforike dhe roli i tyre në didaktikën e të lexuarit dhe të të shkruarit në gjuhë të huaj* – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, departamenti i gjuhës frënge, Tiranë, 2009.
35. **Nasufi, E.** *Roli i anaforës në realizimin e kohezionit dhe koherencës*, në “Kërkime universitare”, nr. 32, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2012.
36. **Rrokaj, Sh.** *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, shtëpia botuese “EIB Voskopoja”, Tiranë, 1994.
37. **Rrokaj, Sh.** *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, SHBLU, Tiranë, 2000.
38. **Sosyr, F.** *Kursi i gjuhësisë së përgjithshme*, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2002.
39. **Shkurtaç, Gj.** *Mbërritje inkurajuese në sociolinguistikën shqiptare*, në “Kërkime universitare”, nr. 11, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2005.
40. **Shkurtaç, Gj.** *Si të shkruajmë shqip*, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2008, 2012, 2013.
41. **Topalli, T.** *Gjuhësi teksti*, shtëpia botuese “Gjergj Fishta”, Shkodër, 2011.
42. **Toska, B.** *Komunikimi, dialogjizmi bakhtinian dhe konektorët pragmatikë*, në “Kërkime universitare”, nr. 19, universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, 2008.
43. **Toska, B.** *Studim përqasës i konektorëve në tekstet argumentues të gjuhës angleze dhe asaj shqipe* – disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor i shkencave”, Tiranë, 2012.
44. **Thomai, J.** *Metoda e analizës së tekstit*, në “Teksti dhe gjuha”, SHBLU, Tiranë, 1992.
45. **Uellek, R. – Uoren, O.** *Teoria e letërsisë*, SHBE, Tiranë, 1993.
46. **Xhaxhiu, M.** *Letërsia antike greke*, SHBLU, Tiranë, 1998.
47. **Zisi, R.** *Veçoritë e narracionit dhe të përshkrimit në prozën rrëfimtare të Bilal Xhaferrit*, shtëpia botuese “Panteon & Afërdita”, Tiranë, 2001.
48. **Zheji, Gj. – Xhafka, N.** *Maja e çelur, Antologji e letërsisë bashkëkohore shqiptare*, SHBLSH, Tiranë, 1996.

B. LITERATURË E HUAJ

1. **Adam, J-M.** *Le récit*, PUF, Paris, 1984.
2. **Adam, J-M.** *Types de séquences textuelles élémentaires*, Pratiques, 1987.

3. **Adam, J-M.** *Éléments de linguistique textuelle (théorie et pratique de l'analyse textuelle)*, Pierre Mardaga, 1990.
4. **Adam, J-M.** *Cadre theorique d'une typologie sequentielle*, në "Etudes de Linguistique appliquee", Nathan université, Paris, 1991.
5. **Adam, J-M.** *Les textes: types et prototypes. Récit, description, argumentation, expliciation et dialogue*, Nathan université, Paris, 1992.
6. **Adam, J-M.** *Linguistique textuelle. Des genres de discours aux textes*, Nathan université, Paris, 1999.
7. **Ardeleanu, S-M.** *Repères et principes fondamentaux fans l'analyse du discours*, Ed.Universitãti "Stefan cel Mare", Suceava, 1997.
8. **Ardeleanu, S-M. – Axenti, E. – Coroi, I-C. – Lilo, R. – Soltan, A. – Varfi, N. – Zbant, L.** *Le discours en action - étude théorique et pratique sur la discursivité*, Chişinău, CEP USM, 2007.
9. **Aristotel**, *Retorica*, botim i eBooks@Adelaide, 2007.
10. **Aristotel**, *Topika*, Bude, Paris, 1967.
11. **Anscombre, J.-C. – Ducrot, O.** *L'argumentation dans la lingua*, Bruxelles: Mardaga, 1983.
12. **Austin, J.L.** *How to do Things with Words*, Oxford Univ. Press, 1962.
13. **Bakhtine, M.** *Speech Genres and Other Late Essays*, University of Texas Press, 1986.
14. **Bakhtine, M.** *The dialogic imagination*, The universtity of Texas Press, 1982.
15. **Beaugrande, R-A.** *Factors in a Theory of Poetic Translating*, Assen: van Gorcum, and Amsterdam: Rodopi, 1978.
16. **Beaugrande, R-A.** *Text, Discourse, and Process, Toward a Multidisciplinary Science of Texts*, Norwood, N.J.: Ablex, 1980.
17. **Beaugrande, R-A.** *Linguistic Theory: The Discourse of Fundamental Works*, London: Longman, 1991.
18. **Beaugrande, R-A. – Dressler, W.** *Introduction to TextLinguistics*, London-N. Y, 1981.
19. **Bizzell, P. – Herzberg, B.** *The Rhetorical Tradition: Readings from Classical Times to the Present*, NY: Bedford/St.Martin's, 2000.
20. **Blair, A., – Johnson, R.** *Argumentation as dialectical*, në "Argumentation", nr. 1, 1987.
21. **Bouvet, D.** *La dimension corporelle de la parole. Les marques posturo-mimo-gestuelles de la parole, leurs aspects métonymiques et métaphoriques, et leur rôle au cours d'un récit*, Peeters, Paris, 2001.
22. **Braet, A.** *De klassieke statusleer in modern perspectief*, Groningen: Wolters-Noordhoff, 1984.
23. **Charaudeau, P.** *Langage et discours. Éléments de sémiolinguistique*, Hachette-Education, Paris, 1983.
24. **Charaudeau, P.** *Grammaire du sens et de l'expression*, Hachette-Education, Paris, 1992.

25. Charaudeau, P. *Une analyse sémiolinguistique du discours*, Hachette-Education, Paris, 1995.
26. Crowley, Sh. *Ancient rhetorics for contemporary students*, A Simon & Schuster Company Needham Heights, Massachusetts, 1994.
27. Dressler, W. *Morphonology*, Ann Arbor, Karoma Press, 1985.
28. Dressler, W. *Textlinguistik*, Hardcover, Wissenschaftliche Buchgesellschaft, 1978.
29. Ducrot, O. *La preuve et le dire*, Mame, Paris, 1973.
30. Ducrot, O. *Les mots du discours*, Editions de Minuit, Paris, 1980.
31. Ducrot, O. *Note sur l'argumentation et l'acte d'argumenter*: Cahiers de Linguistique française, 4, Université de Genève, 1982.
32. Ducrot, O. *Logique, structure et énonciation*, Editions de Minuit, Paris, 1989.
33. Ducrot, O. – Schaeffer, J-M. *Nouveau dictionnaire encyclopédique des sciences du langage*, Seuil, Paris, 1995.
34. Eemeren, F. – Grootendorst, R. *Logic and argumentacion*, Amsterdam, SICSAT, 1996.
35. Eemeren, F. – Houtlosser, P. *Strategic manoeuvring in argumentative discourse*, në "Discourse Studies 1", nr. 4, 1999.
36. Ennis, R. *Identifying implicit assumptions*, në "Synthese 5", 1982.
37. Gennete, G. *Palimpsestes*, Ed. Du Seuil, Paris, 1982.
38. Gilbert, M. A. *The enthymeme buster: a heuristic procedure for position exploration in dialogic dispute*, në "Informal Logic 13", nr. 3, 1991.
39. Goffman, E. *Forms of Talk*, University of Pennsylvania Publications in Conduct & Communication, 1981.
40. Govier, T. *Problems in argument analysis and evaluation*, Dordrecht: Foris, 1987.
41. Greimas, A-J. *Of Gods and Men*, në "Studies in Lithuanian Mythology", trans. Milda Newman, Bloomington: Indiana University Press, 1979.
42. Jakobson, R. *Essais de linguistique générale*, Paris, 1963.
43. Kienpointner, M. *Rhetoric and argumentation-relativism and beyond*, në "Philosophy and Rhetoric 24", nr. 1, 1991.
44. Kopperschmidt, J. *Methodik der Argumentationsanalyse*, Stuttgart: Fromann-Holzboog, 1989.
45. Kress, G. *The linguistic expression of social meaning: discourse, genre and text*, në "Linguistic processes in sociocultural practice", Oxford University Press, 1989.
46. Lakoff, G., – Johnson, M. *Metaphores we live by*, University of Chicago Press, Chicago and London, 1980.
47. Lehman, D. *An alternative to speech*, Princeton University Press, 1986.
48. Lyons J. *Semantics*, I, Cambridge University Press, London, 1977.
49. Lyons J. *Semantics*, II, Cambridge University Press, London, 1996.

50. Maingueneau, D. *L'analyse du discours. Introduction aux lectures des archives*, Hachette, Paris, 1991.
51. Maingueneau, D. *Analyser les textes de communication*, Dunod, Paris, 1998.
52. Moeschler, J. *Argumentation et Conversation – Eléments pour une analyse pragmatique du discours*, Paris: Hatier-Crédif, 1985.
53. Miller, K-D. *Voice of Deliverance: The Language of Martin Luther King, Jr. and Its Sources*, New York: The Free Press, 1992.
54. Perelman, C. – Tyteca, L. *La nouvelle rhétorique: Traité de l'argumentation*, Université libre de Bruxelles ose përthimi në anglisht: (1969): *The new rhetoric. A treatise on argumentacion*, University of Notre Dame Press, 1958.
55. Reboul, O. *Rhetorique et dialectique chez Aristote*, në "Argumentation 4", nr. 1, 1990.
56. Reboul, O. *Can there be non-rhetorical argumentacion?*, në "Philosophy and Rhetoric 21", nr. 3, 1998.
57. Reboul, A. – Moeschler, J. *La pragmatique aujourd'hui. une nouvelle science de la communication*, Le Seuil, Paris, 1998.
58. Roulet, E. *L'articulation du discours en français contemporain*, Berne: Peter Lang, 1985.
59. Searle, J. *Speech Acts*, Cambridge University Press, Cambridge, 1969.
60. Searle, J. *A taxonomy of illocutionary act*, në "Language, Mind and Knowledge", ed. Keith Gunderson, Minneapolis: University of Minnesota Press, 1975.
61. Siouffi, G. – Raemdonck, D. *100 Fiches pour comprendre la linguistique*, Bréal, Rosny, 1999.
62. Toulmin, S.E. *The uses of argument*, Cambridge University Press, Cambridge, 1958.
63. Varfi, N. *Précis de lexicologie française*, Tiranë, 1996.
64. Varfi, N. *Introduction à la lexicologie du français*, Lausanne, UNIL, 1999.
65. Varfi, N. *Lexicologie (exercices)*, Tiranë, 1999.
66. Varfi, N. – Lilo, R. – Nasufi, E. *Recueil d'exercices (Linguistique textuelle)*, Albatros, Tiranë, 2008.

C. FJALORË TË NDRYSHËM

1. *Fjalor i shqipës së sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 2002.
2. *Fjalor enciklopedik*, hartoi dhe përgatiti Pasho Baku, shtëpia botuese "Bacchus", Tiranë, 2002.
3. *Fjalor i filozofisë*, Botime enciklopedike, shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1982.

4. *Oxford Advanced learner's dictionary of current English*, Oxford University, Press, 1974.
5. **Thomai, J.** *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
6. **Thomai, J. – Samara, M. – Shehu, H. – Feka, Th.** *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2004.
7. **Zhyllia, D.** *Fjalor i filozofisë*, përktheu nga origjinali Rajmonda Vuçini, shtëpia botuese “Enciklopedike”, Tiranë, 1994.

D. KORPUSI LETRAR I VJELË

1. **AEDP** *Studio gjithçka, arsyes vendin e parë*, fondacioni SOROS, Tiranë, 1998.
2. **AEDP** *Mprehtësi*, nr. 3, Tiranë, 1991.
3. **Allende, I.** *Paola*, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1999.
4. **Arden, P.** *Jo sa i mirë je, sa i mirë kërkon të jesh*, shtëpia botuese “Spektër sh.a./Botimet “Max”, Tiranë, 2005.
5. **BIBLA** *Diodati i ri*, përkthimi 1991-1994, botim i Shoqatës shqiptare të Biblës, Tiranë, 1995.
6. **Blushi, B.** *Të jetosh në ishull*, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2008.
7. **BQPZ** *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë*, nr. 2, shtëpia botuese “Mihal Duri”, Tiranë, 1992.
8. **Christie, A.** *Dëshmitari i akuzës*, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2002.
9. **Cvajg, S.** *Novela*, shtëpia botuese “Argeta - LMG”, Tiranë, 1999.
10. **Dostojevski, F.** *Idioti*, shtëpia botuese “Uegen”, Tiranë, 2000.
11. **Eco, U.** *Gjashtë shëtitje në pyjet e tregimtarisë*, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 2007.
12. **Fuga, A.** *Rënia e qytetit*, Botimet Papirus, Tiranë, 2012.
13. **Gjoni, S.** *'Jashtëkohësia' e Mitrush Kutelit në optikën e dy regjimeve*, në “Letërsia si e tillë. Probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare”, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 1996.
14. **Harizi, E.** *Si të gatujmë*, shtëpia botuese “Botagri”, Tiranë, 2006.
15. **Hersh, Zh.** *Habia filozofike (Një histori e filozofisë)*, përkthyer nga Artan Fuga, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1995.
16. **Homeri** *Iliada*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1979.
17. **ISP**, *Letërsia në shkollë*, nr.1, përgatitur nga Departamenti i Kurrikulës pranë ISP-së, Tiranë, 2000.
18. **Kadare, I.** *Gjakftohtësia*, shtëpia botuese “Kombinati Poligrafik”, Tiranë, 1980.

19. Kadare, I. *Koha e shkrimeve*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1986.
20. Kadare, I. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2001.
21. Kadare, I. *Vajza e Agamemnonit*, shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2003.
22. Kadare, I. *Dosja H*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
23. Kadare, I. *Kështjella*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1976.
24. Kafka, F. *Procesi*, shtëpia botuese “Globus R.”, Tiranë, 1997.
25. Keko, T. *Prostituta*, shtëpia botuese “Maluka”, Tiranë, 2006.
26. Kikina, K. – Gjoni, L. *Matematika e përgjithshme*, SHBLU, Tiranë, 2001.
27. Konica, F. *Vepra*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1993.
28. Kornej, P. *Sidi*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1960.
29. La Fonten *Fabula të zgjedhura*, shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2005.
30. Mopasan, G. *Një jetë*, shtëpia botuese “A. Z. Çajupi”, Tiranë, 1994.
31. Noli, F. S. *Vepra 4*, shtëpia botuese “Kombinati Poligrafik”, Tiranë, 1989.
32. Noli, F. S. *Vepra 5*, shtëpia botuese “Kombinati Poligrafik”, Tiranë, 1989.
33. Platoni *Apologjia e vërtetë e Sokratit, Kritoni, Fedoni, Elozhi i dashurisë ose simpoziumi*, në origjinal nga Nino Marziano dhe shqipëruar nga Lazër Radi, shtëpia botuese “Liria”, Tiranë, 1997.
34. Plutarku *Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980.
35. QAKAPP (1998): *Kushtetuta dhe materiale shpjeguese*, Tiranë.
36. Qosja, R. *Panteoni i rralluar*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988.
37. Seneca *Dialogjet*, shtëpia botuese “Plejad”, Tiranë, 2004.
38. Smith, L. – Raeper, W. *Një hyrje tek idetë. Besimi dhe filozofia në të shkuarën dhe të tashmen*, shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë, 1999.
39. Shekspir, U. *Vëllimi I*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982.
40. Tuein, M. *Është gjallë apo ka vdekur?*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1989.
41. Uoolf, V. *Njolla në mur (tregime)*, shtëpia botuese “Skanderberg books”, Tiranë, 2011.
42. Varfi, N. *Përkthime, I*, shtëpia botuese “Albatros”, Tiranë, 2008.
43. Varfi, N. *Përkthime, III*, shtëpia botuese “Albatros”, Tiranë, 2008.
44. Varnalis, K. *Apologjia e vërtetë e Sokratit*, shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë”, Tiranë, 2001.
45. Volo, F. *Regëtimat e dritës së mëngjesit*, shtëpia botuese “Dudaj”, Tiranë, 2012.
46. Zheji, Gj. – Xhafka, N. *Maja e çelur, Antologji e letërsisë bashkëkohore shqiptare*, SHBLSH, print. Itali, 1996.

E. Janë shfrytëzuar gjithashtu nyjet e mëposhtme si dhe të përditshme të ndryshme

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Bledar-Toska-Fakulteti-Gjuheve-te-Huaja.pdf>

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/09/Doktoratura-Linda-Meniku-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gjuhesise.pdf>

http://fhf.edu.al/doktorata/Anila_Cepani.pdf

<http://ebooks.adelaide.edu.au/a/aristotle/a8rh/index.html>

<http://www9.georgetown.edu/faculty/bassr/heath/syllabuild/iguide/king.html>

<http://www.artofmanliness.com/2010/11/30/history-of-rhetoric/>

http://en.wikipedia.org/wiki/Figure_of_speech

http://grammar.about.com/od/terms/Glossary_of_Grammatical_Rhetorical_Terms.htm

<http://en.wikipedia.org/wiki/Ontology>

<http://en.wikipedia.org/wiki/Epistemology>

<http://pagesperso-orange.fr/j.dussieux/c-stjeandy/Le%20livret%20autocorrectif.pdf>


<http://artic.ac-besancon.fr/ienluxeuil/cqlmndsavoir.doc>

<http://www.zeriyt.com/aktualiteti-shqiptar/debati-mbi-identitetin-e-shqiptareve-mes-qoses-dhe-kadarese-t30174.0.html>

<http://www.scribd.com/doc/7350186/Gazeta-Shqiptare-58>

<http://floart-press.blogspot.com/2008/01/letr-ambasadorit-ton-n-shba-i-nderuar-z.html#links>

<https://blog.writecheck.com/wp-content/uploads/2012/12/argument-essay-2.png>



INSTITUTI ALBANOLOGJIK

Doc. dr. Edlira Mantho

**Rreth argumentimit dhe
tekstit argumentues në gjuhën shqipe**

Recensues

Prof. dr. Klodeta Dibra

Prof. dr. Qemal Murati

Redaktura teknike

Mustafa Berisha

Kopertina

Studio grafike "Venera 2000"

Madhësia: 11.5 tabakë shtypi

Formati: 16x23.5 cm

Shtypshkronja

"Pro Graf"

Prishtinë, 2014